

31 dhjetor 2025 • 1, 2, 3 e 4 janar 2026

Numri 10232

KOHA DITORE

www.koha.net



SHIRAZ

KOHA DITORE

E përditshme e pavarur informative

Themelues: Veton SURROI
Numri i parë u botua më 31 mars 1997

Pronare dhe botuese:
Flaka SURROI

Redaksia

Kryeredaktore:
Brikenda REXHEPI

Zëvendëskryeredaktor:
Elmaz ISUFI

**Ndihmëskryeredaktor/
Redaktor i kulturës:**
Granit KURTI

Redaktorë përgjegjës:
Driton MEHMETI
Visar LOCI
Nita LLESHI-DOBROSHI
Besnik KRASNIQI

Redaktorë në Portal:
Endrit BERISHA
Shkumbin SEKIRAQA
Nora SHABANI-HYSENI
Besjana BAJRAMI-POLISI

Redaktorë/Autorë:
Mimoza KOPRANI-MUÇAJ
Eraldin FAZLIU
Donika VOCA-GASHI

Ndihmësredaktore:
Minushe REXHEPI

Redaktor i sportit:
Arsim MAXHERA

**Redaktor i mediave
sociale/i qendrës grafike**
Ben KAJTAZI

Fotografia:
Driton PAÇARADA

Adresa:
KOHA
Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë)
Xhorxh Bush p.n.
10000 Prishtinë

Fahu postar 202

Telefonat:
(00 383 38) 249-104 249-105;
249-106; 248 014 dhe 248 015

e-mail:
redaksia@kohaditore.com;
lajmet@kohavision.net; info@koha.net

Marketing dhe shitje KOHA
(KOHA Ditore; KTV, Koha.net,
ARTA dhe KOHA Print):
tel: (00 383 38) 249-104; 249-105;
249-106; 248 014 dhe 248 015
e-mail: marketing@koha.net
berat@koha.net, afrim@koha.net
marketing@kohaditore.com

Xhirollogaria:
ProCredit - 1110086926000189
NLB - 1701001010645930
TEB - 2011000000081423
Raiffeisen - 1501001002095874
BKT - 1901217632031247
B. Ekonomike - 1401000000903831
BpB - 13002712000030870

Shtypshkronja "KOHA Print"
045 701 288

Marketingu për jashtë:
Era Press GmbH
Sihlstrasse 38 CH-8001 Zürich
Tel.+41(0) 43 497 32 80
koha@erapress.ch

Nuk lejohet ribotimi i pjesshëm apo i plotë,
në cilindo medium, i cilitdo material për të cilin
KOHA (KOHA Ditore, KTV, KOHA.net, ARTA)
i mban të drejtat e rezervuara, pa autorizimin
paraprak me shkrim nga KOHA.

**Dorëshkrimet dhe fotografitë
nuk kthehen**

Rubrika e përhershme "Shpreh" është krijuar si
hapësirë e "Kohës Ditore" për të botuar letrat,
opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve
dhe qytetarëve. Të gjitha shkrimet nuk duhet të
jenë më të gjata se 500 fjalë. Redaksia mban të
drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos
botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës



K O L U M N E /faqe 3-19

• Verifikimi i borës
Shkruan: Brikenda Rexhepi

• Edhe pushtet, edhe opozitë
Shkruan: Elmaz Isufi

• Në zënie të hapit
Shkruan: Flaka Surroi

• Tango ballkanike në kryeqytetin e Evropës
Shkruan: Granit Kurti

• Pse lexoheshin gazetetat nga faqja e fundit?
Shkruan: Veton Surroi

• Uroj një vit pa zgjedhje
Shkruan: Augustin Palokaj

• Një barsoletë për realitetin kosovar dhe realiteti izraelit që ngjan si barsoletëi
Shkruan: Visar Loci

• Një doli për më pak budallaki
Shkruan: Besnik Krasniqi

• Pse s'jemi si ata
Shkruan: Nita Lleshi

• Kur mungon alternativa, fiton pushteti
Shkruan: Driton Mehmeti

• S'ka më kohë për të humbur: 2026-a të sjellë institucione funksionale e progres
Shkruan: Aivo Orav

• Dhjetë dëshirat e mia për vitin 2026
Shkruan: Jonathan Hargreaves



• Mikpritja më e ngrohtë në vendin që i duhet urgjent një qeveri
Shkruan: Rainer Rudolph

• 2026: Më pak gënjeshtër online?
Shkruan: Olivier Guérot

• Trëndafili i Rilkes
Shkruan: Enver Robelli

• Kur gjithçka mund të përmbysët – Një shënim për edukimin medial
Shkruan: Eevamari Laaksonen

• Rruga e Kosovës drejt prosperitetit: roli i reformave strukturore
Shkruan: Sebastian Sosa

• Së bashku më të fortë për paqe
Shkruan: Özkan Ulutaş

• Një urim optimisti
Shkruan: Demush Shasha

• Një vit i ri imagjinar
Shkruan: Arben Qirezi

ARBËRI /faqe 5-20

- Viti i votës
- Dëmtimi i raporteve transatlantike, sfidë e vitit për BE-në
- Viti që i numërohen pasojat
- Kokëfortësia politike që paralizoi shtetin
- Lista Serbe – kronikë e një rikthimi të kontrolluar
- Peshorja e Hagës mes luftës çlirimtare dhe akuzave për krime
- Fluturojnë, fluturojnë... çmimet
- Lufta për pushtet në KPK

J E M I /faqe 12, 13, 23, 24

B O T Ë /faqe 25-30

- Bota në duart e Trumpit
- Dy jetë të reja në dy vjet lufte
- Stigma e ushtarëve të harruar të Ukrainës që "vdiqën në mënyrën e gabuar"

K U L T U R Ë /faqe 31-36

- Marigona Qerkezi – ylli në ngritje të përhershme
- Jeta e baletit
- "Shkodra Elektronike" në lojë me zhurmat e përditshmërisë
- Bota e animuar për një sekondë deri në 24 skica
- Kultura në ritëm suksesesh dhe dështimesh
- Matrica e ndryshueshme e knusit*

M A G A Z I N A /faqe 37-40

- 2025-ta, viti i fustanit transparent
- Shëndetësia e personalizuar
- A është i gatshëm "Hollywoodi" t'ua hapë dyert videove me AI
- Nga çipat te chatbot-et: Si e përcakttoi Inteligjenca Artificiale vitin 2025
- Horoskopi

S P O R T /faqe 41-46

- VITI I FUTBOLLIT
- Arkitekti Foda tregon sekretet e suksesit të Kosovës
- Majlinda e kërkuar edhe si trajnere, refuzon ofertë të majme nga Emiratet Arabe
- Me gjithë sfidat, xhudoja kosovare e mban nivelin superior
- Nënkampioni botëror mezi iu kthye karatesë pas dënimit nga federata
- Ronaldo e Zidane të Superligës së Kosovës
- Ardhjet e vitit
- "Për ty babë" - rrëfimi i Berishajt, sportistja më e mirë në Malin e Zi



Verifikimi i borës

Dikur, sado vonë, narrativat e shtrembëruara mbesin veç pjesë e atyre që i kanë ndërtuar, e gazetaria për qytetarin rikthehet në vendin e vet. Aty ku e vërteta është e rëndësishme, qoftë edhe ajo për borën që dikur shkrihet e harrohet



Brikenda Rexhepi

Ky vit u përmbyll pa një projekt të USAID-it. Pati qenë i përvitshëm, realizohej në dhjetor dhe analizonte mediat. E kujtoj për një diskutim të para nja katër vjetësh që paralajmëronte lindjen e një narrative, më shumë sesa që vlerësonte sektorin. Aty e pata dëgjuar së pari, por nuk është që s'ishte ndërtuar më herët. U përhap shpejt dhe e dëgjoje sa poshtë, sa lart. Në thelb kjo narrative kontestonte konceptin e mediave dhe gazetarisë profesionale. Ndonëse u shtrua në një panel qëllimshëm, nisej nga një premisë e shtrembëruar: Në Kosovë “ka media që janë kritike dhe më pak kritike”.

Qëllimi ishte të anashkalohej ideja e mediave profesionale dhe joprofesionale – atyre që respektojnë parimet etike të raportimit faktik e objektiv, që bazohen në interesin publik dhe që bëjnë prerazi dallimin mes lajmit dhe opinionit, dhe të atyre që nuk e bëjnë këtë. Klasifikimi në më pak a më shumë kritike, varësisht se kush si e sheh, më pati irrituar po aq sa fakti që një interpretim i tillë po tentonte të legjitimohej në një forum që synonte vlerësimin profesional të sektorit. Nuk ia pati dalë të hynte në atë vlerësim, por kjo nuk e ndali.

Pas atij forumi e pata hasur këtë diskurs edhe në shumë të tjera, të shtyra kryesisht nga njerëz ose që nuk e dinë gazetarinë, ose qëllimisht duan ta dëmtojnë atë. Koncepti bazohej në idenë që kur gazetari raporton për një fakt, duhet edhe “të jetë i lirë” që ta interpretojë atë, për shembull të tregojë nëse është mirë apo keq apo është ashtu ose kështu. Sa më shumë që interpretohej aq më kritik do të ishte ndaj pushtetit. E interpretimi bëhej çdoherë e më i lirshëm. Në anën tjetër, nëse nuk interpretohej ose nuk e bartje si konfrontimin në statuse rrjetesh sociale nuk ishte mjaftueshëm kritik. Narrativa u zhvillua në këtë drejtim dhe nuk është që nuk megjulloi qëllimin e ekzistimit të mediave, si dhe konsideratën për lexuesin, pra që ai vetë ta ketë mundësinë e vlerësimit nëse një informatë është mirë apo keq, është kështu ose ashtu. Shumë informata të rëndësishme për t'u raportuar profesionalisht humbën në garën e interpretimeve dhe ajo u rrit në rrafshin e klikimeve, ku gjeti një masë të madhe konsumuesish tashmë të përgatitur nëpër shkollat tona.

Por megjithatë hovi nuk zgjati shumë nën maskën e gazetarisë. Kjo qasje zhvendosi krijuesit e përmbajtjeve, pra “interpretuesit e lirë”, në pozicionin e rivalëve politikë dhe secila parti i krijoi të vetët aq sa mundi e deshi. Në fillim të dyja palët menduan se gjetën çelësin e suksesit. Por as kjo nuk zgjati shumë. Pasojat u shpërfaqën më shpejt sesa që u mendua. Ato nisën të fliten haptas në zgjedhjet e fundit, por disa parti e kuptuan më herët. Qysh në shkurt disa prej tyre nisën t'u kërkojnë krijuesve të përmbajtjeve të tilla të mos i përkrahnin. “Je bërë më XX (parti) se unë”, i kishte thënë në fillim të vitit kryetari i një partie një interpretuesi. E kishte kuptuar që qytetari mund edhe mos ta

kapë me të parën, por që përfundimisht sharjet e talljet e irritojnë atë dhe kthehet kundër. Dikush e kuptoi më vonë e dikush shumë më herët, qysh në fillim. Pra edhe më shumë se para katër vjetësh. Dhe e shfrytëzoi, për t'i nxitur dhe në fund për të mbledhur atë që i takonte.

Tregimi i interpretuesve është një rrëfim i dhimbshëm për shoqërinë tonë. Tregon se sa të manipulueshëm jemi. Por nga ana tjetër është edhe shpresëdhënëse – që dikur, sado vonë, narrativat e shtrembëruara mbesin veç pjesë e atyre që i kanë ndërtuar, e gazetaria për qytetarin rikthehet në vendin e vet.

Viti 2025 ishte i tmerrshëm. Jo që nuk pati projekte të USAID-it. Së paku për mua nuk ishte i tmerrshëm për këtë arsye. Ishte një vit i keq, sepse drama me krijimin e institucioneve që një lojë poshtëruese për shtetin dhe qytetarët e tij. Lojë e politikanëve tanë nga njëra anë dhe në një rrafsh tjetër, atë të masave ndëshkuese, e politikanëve të BE-së. Viti u krye, për më keq, edhe pa borë për festa. Është e pamundur të lëshohemi në atmosferën e Vitit të Ri kështu të ngarkuar e të ndotur. Bora, përveçse të afron me ndjenjën festive, edhe pastron. Kështu kam dëgjuar. Mund edhe të mos jetë, por s'po e verifikoj. Më duhet për këtë paragraf.

Dy nga kolumnet që miqtë tanë ambasadorë i kanë shkruar për këtë edicion festiv të “Kohës Ditore”, francezi dhe finlandezja, flasin për këtë. Për rëndësinë e verifikimit nëse bora pastron apo jo. Mbase jo specifikisht për borën si borë. Është veç interpretim. Në të vërtetë ata nuk e kanë përmendur borën fare. Miku francez pyet për 2026-n, nëse do të jetë vit pa gënjeshtër dhe bën thirrje për ta kultivuar higjienën digjitale, ashtu siç bëjmë për atë fizike. Tregon për mobilizimin francez që ka demaskuar strukturat më famëkeqe të dezinformimit global dhe që ka nisur krijimin e infrastrukturës ligjore evropiane për t'u mbrojtur nga rreziqe të tilla. Ju ftoj ta lexoni!

Mikja finlandeze shkruan për vendimin e vitit 1917 të shtetit të saj, kur ai fitoi pavarësinë. Një vendim i thjeshtë që e ka shndërruar shoqërinë finlandeze në një fortifikatë që, ndonëse është në prag të derës ruse, as edhe një qime nga ana tjetër e kufirit nuk mund të bjerë mbi të. Ju ftoj ta lexoni po ashtu. Posaçërisht, me rëndësi është ta lexojnë ata që do ta udhëheqin Kosovën më 2026, kur ajo i mbush 18 vjet. Finlanda e ka bërë ndryshimin si foshnjë, e ne mos ia dalshim edhe tash në moshë madhore... – s'po guxoj të them mos qofshim hiq, se traumat e hershme ma sjellin ndërmend Serbinë. E traumat e vona ma shpërfaqin qarkun vicioz ku sillemi vit pas viti, zgjedhje pas zgjedhjesh, si patriotë të një shoqërie të lodhur - pa para, pa shkollim cilësor, pa barna nëpër spitale, pa drejtësi.

Sot e kam një ndjenjë gëzimi që do t'i kem disa ditë të lira këtë javë dhe mbase mund ta marr edhe një javë pushimi nga viti i kaluar. Për këtë ende nuk u kam treguar kolegëve dhe po mendoj të mos u tregoj fare, veç le ta lexojnë në këtë shkrim.

Uroj për rikthim në një të ardhme më të mirë që të nisë më 2026!

brikenda@koha.net

Ndryshimi i ndryshimit, rasti i Vetëvendosjes

Për të ruajtur pozicionin fitues në një skenë politike të paprofilizuar, mediokre e të korruptuar, LVV-ja ndryshoi edhe vetveten: nga retorika dhe stili i qeverisjes, deri te praktikat e përditshme institucionale. Ky transformim reflektoi edhe evoluimin e lidershipit, nga një qasje kryesisht konfrontuese drejt një stili më pragmatik



Elmaz Isufi

Ardhja e Lëvizjes Vetëvendosje në pushtet në vitin 2020, dhjetë vjet pasi kishte kaluar nga “rruga” në institucione, u perceptua si një thyerje e praktikave politike në Kosovë. Rotacioni në pushtet, nëpërmjet një subjekti të krijuar jashtë strukturave tradicionale, nuk përfaqësoi vetëm ndryshim formal, por u shoqërua edhe me diskurs të ri të qeverisjes.

Lëvizja Vetëvendosje për këto vite nuk ndryshoi vetëm sjelljen, por edhe mënyrën se si fitohet mbështetja politike. Ajo arriti të përshtatet relativisht shpejt nga një lëvizje opozitare “rebeluese” në një forcë qeverisëse, duke riformuluar strategjitë e saj në përputhje me rrethanat institucionale. Ky tranzicion u lehtësua nga lidershipi i saj, i cili për një kohë të gjatë ishte identifikuar me opozitarizmin aktiv dhe kritikën ndaj elitave politike, duke krijuar një kapital të fortë që më pas u shndërrua në mbështetje elektorale.

Në këtë kuptim, suksesi i përsëritur i Vetëvendosjes në tri palë zgjedhje tjera nacionale mund të interpretohet si rezultat i ndryshimit të ritmit politik.

Ndryshe nga periudhat e mëparshme, kur pushtetet në Kosovë ishin produkt i koalicioneve dhe kompromiseve mes partive, kjo fazë u karakterizua edhe nga përpjekja e këtij subjekti që konsolidimin ta kërkonte nëpërmjet marrëdhënies së drejtpërdrejtë me qytetarin.

Vetëvendosje nuk e ndërtoi mbështetjen e saj përmes figurave tradicionale të establishmentit politik e as i bëri llogaritë tek “aleancat” me partitë tjera parlamentare, por u “shkri” brenda masës së qytetarëve të molisur dhe të zhgënjyer nga keqqeverisja gati njëzetvjeçare. Zëri kritik i qytetarëve u shndërrua në platformë politike, ndërsa diskursi i artikulluar nga lideri i saj funksionoi si kanal përmes të cilit kjo pakënaqësi u institucionalizua. Zërave dëshpërues që nuk ishin dëgjuar mjaftueshëm, Vetëvendosje u dha fuqi dhe legjitimitet.

Për të ruajtur pozicionin fitues në një skenë politike të paprofilizuar, mediokre e të korruptuar, LVV-ja ndryshoi edhe vetveten: nga retorika dhe stili i qeverisjes, deri te praktikat e përditshme institucionale. Ky transformim reflektoi edhe evoluimin e lidershipit, nga një qasje kryesisht konfrontuese drejt një stili më pragmatik.

Një rol vendimtar në rritjen e mbështetjes për LVV-në, nga 2010 e deri në zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025, luajti paaftësia organizative dhe pasojat e trashëgimisë së partive opozitare, PDK, LDK dhe AAK. Këto parti u penalizuan nga keqqeverisja dydekadëshe, nepotizmi, korrupsioni dhe lidhjet me elemente të kimit të organizuar, ndërsa në perceptimin e fundit qytetar edhe për mungesë gatishmërie për t'u vënë në funksion të interesit shtetëror gjatë proceseve të vështira, e sidomos gjatë ngërçit të fundit institucional që zgjati gati një vit.

Diskursi i opozitës për pesë vjet mbeti kryesisht në funksion të kritikës mbi mënyrën se si po qeveris VV-ja, pa ofruar alternativë serioze.

Opozita nuk u ofroi mbështetje politike e institucionale veprimeve për shuarjen e strukturave ilegale serbe, nuk kundërshtoi masat ndëshkuese të BE-së që erdhën si përgjigje ndaj veprimeve në veri për vendosjen e rendit dhe ligjit, e nuk u bë hisedare edhe e iniciativave të tjera siç ishin marrëveshjet financiare ndërkombëtare. Këto që më shumë ishin të rëndësishme nacionale, nga padija e opozitës u shndërruan në favore për subjektin që drejtonte qeverinë.

Paradokset nuk kishin fund – ta zëmë, në vend se propozimi për kontrollin mbi rritjen e çmimeve të produkteve bazë të vinte nga opozita, ai propozim vinte nga Qeveria. Në vend se kërkesa për reformë në drejtësi të vinte nga opozita, ajo vinte nga Qeveria; në vend që opozita të kërkonte konfiskim të pasurisë së fituar jashtëligjshëm, atë e kërkonte pushteti; në vend që mbështetja për lehonat, studentët, pensionistët... të vinte nga opozita, nismat për to vinin nga Qeveria; edhe rritja e pagës minimale ishte vullnet i Qeverisë, edhe shtesat për fëmijë...

Kundërshtimi dhe “bllokimi” i tyre nëpërmjet formave të ndryshme, përfshirë edhe i kërkesës për interpretim në Kushtetuese, sado legjitim, në sytë e shumicës së publikut e nxori destruktive.

Ky diskurs çoi në dobësimin e kapitalit politik dhe besimit publik të partive opozitare, ndërsa krijoi hapësirë manovrimi shtesë për LVV-në dhe mundësinë që ajo të konfirmojë mbështetjen e madhe qytetare.

Nga hyrja e saj si forcë protestuese deri te ngjitja në pushtet, LVV ka dëshmuar se politika moderne nuk është vetëm ushtrim i pushtetit, por edhe një proces i vazhdueshëm përshtatjeje dhe transformimi i vetvetes. Rasti i Lëvizjes Vetëvendosje po ashtu përbën një ilustrim të konceptit “ndryshimi i ndryshimit”. Dhe përballë konceptit “mosndryshim” të opozitës, me të drejtë disa thonë se Kurtin mund të rrëzojë vetëm Kurti.



Foto: Driton Papanaj

Mëngjesin e 26 gushtit të këtij viti është hapur njëra prej dy urave që Qeveria në detyrë e Kosovës nisi t'i ndërtonte mbi lumin Ibër, i cili e ndan Mitrovicën në jugun e banuar me shqiptarë dhe në verin e banuar me serbë. E më 17 dhjetor po mbi Ibër është hapur ura tjetër për qarkullimin e këmbësorëve. Urat e reja janë ndërtuar pranë urës kryesore mbi Ibër, për hapjen e së cilës Kosova dhe Serbia ishin pajtuar në vitin 2014 në kuadër të dialogut për normalizim të marrëdhënieve. Punimet për rivitalizim përfunduan në qershor të vitit 2018, por ajo nuk është hapur kurrë për automjete

NGA ZGAFELLJA

Në zënie të hapit

Ne që jemi rritur në kohën kur i këndohej liderit të gjithëdijshëm, e dimë se çfarë domethënie ka trushpërlarja. E dimë edhe sa mund duhet për ta shpërlarë trurin nga shpëlarja ideologjike. E dimë se çfarë do të thotë frika e ndrydhja, por e dimë edhe çka do të thotë çlirimi



Flaka Surroi

Nuk e di se sa herë në këta 12 muaj e kisha përsëritur se në 20 vjetët e fundit, ky kishte qenë viti më i rëndë që e kisha jetuar, përjetuar e mbijetuar. Dhe jo që në këta 20 vjet nuk kisha përjetuar humbje të mëdha me peshë shumë të rëndë emocionale. 2025-a, për shumë e shumë arsye ishte një vit për të tejkaluar sa më shpejt. Por jo edhe pa i nxjerrë mësimet nga ai – se si nuk duhet komplikuar vetes jetën dhe se si nuk ka rrezik më të madh sesa të besosh se shpëtimi i këtij vendi është një lider i vetëm dhe absolut.

Tashmë i dimë rezultatet e zgjedhjeve, në të cilat, në shenjë proteste për krejt maltretimet që i kemi përjetuar në 2025-n, e shfrytëzova të drejtën time për të votuar duke e prishur fletëvotimin me në “X” të madh – aq sa ma zuri faqja.

E vetëdijshme se për votën time aq ua ka bërë partive politike që nëntë muaj të vitit i kaluan duke u përpjekur për t’u pozicionuar sa më mirë karshi militantëve të tyre dhe sidomos duke bërë përpjekje thuajse mbinjerëzore për të marrë sa më shumë vota nga diaspora.

Kësaj radhe, aq ma bëri mua për cilëndo parti – sepse “sille kah ta sillsh”, atë që ma vërtetuan vjet qe se nuk ka absolutisht asnjë dallim mes tyre sa i përket listës së prioritetëve: i pari pushteti bashkë me beneficionet personale, e fundit Kosova.

Mjaftonte të përcilleshin tri fushatat që na bënë të dilnim katër herë për të votuar: me programe politike proforma, me premtime koti, shumë syresh të perealizueshme, me intensitet propagande të përqendruar rreth liderëve dhe marrëveshjet e çastit të fundit për kthimin e votës militante në favor të një kandidati, për ta shndërruar në borxhli. Kah fundi, nisën edhe këngët për liderin.

Ne që jemi rritur në kohën kur i këndohej liderit të gjithëdijshëm e dimë se çfarë domethënieje ka trushpërlarja. E dimë edhe sa mund duhet për ta shpërlarë trurin nga shpërlarja ideologjike. E dimë se çfarë do të thotë frika e ndrydhja, por e dimë edhe çka do të thotë çlirimi.

E ndrydhje më të madhe sesa cirku rreth konstituimit të Kuvendit që na e hëngri thuajse gjithë vitin nuk ka pasur. Loja e shpifur e fajësimit dhe bartjes së përgjegjësisë nga njëra palë te tjetra flisnin për papjekurinë e secilit prej tyre, dikush më shumë e dikush më pak. Papjekurinë për të mos qenë në gjendje të kuptojnë se shteti është shumë më i rëndësishëm sesa sedra e tyre, e sidomos më i rëndësishëm sesa interesat e tyre të ngushta personale të përcjella nga përfitimet që shumë mirë kanë ditur t’i kurdisin pararendësit e tyre, po aq shpirtngushtë.

Manipulimi i pafund me Kushtetutën e ligjin dhe interpretimi i lirë i dispozitave juridike sipas tekeve e qe-jeve vetëm sa e brishtëi edhe me një sistem juridik që edhe ashtu ka shumë të meta me shumë pasoja. E

krijoi një situatë të zgjatur të përkohshmërisë, sikur të ishim një “shtet i përkohshëm”, siç e kishte përkufizuar një ministër me dy shtetësi. Shtet që na kushtoi shumë për ta krijuar. Aq shumë sa do të duhej të ishim tejte të marrë ta lëmë të na ikë duarsh.

E mund të na ikë, nëse politikanët oportunistë mbesin të paprekshëm.

Për shkak të vitit të shkuar, po hyj në 2026-n me një shije të hidhur zhgënjimi në kufi me dëshpërimin. Sivjet brezi im do ta kremtojë 45-vjetorin e maturës – në kohën kur ne do të duhej të mendonim se si ta mbërrijmë moshën e pensionit, që na troket te dera, me sa më shumë sh-tendosje dhe me ëndrra për një jetë të qetë, e shpresojmë edhe të gjatë, pa telashe dhe me dëfrim.

Do ta kremtojë duke e gjetur veten në një shtet që nuk është në gjendje ta krijojë sisteme pensionale e shëndetësore; në një vend ku librat shërbejnë për t’i zbukuruar dollapët; ku të rinjtë vendosin të mos kenë fëmijë sepse nuk kanë si t’i mbajnë ku e gjithë jeta na reduktohet në “a e ndive çka tha ky, e çka tha ai” – pa e përjetuar një agim në të cilin zgjohesh pa dhembje të kresë, sepse e sheh që edhe ty, në këtë moshë, të mbyllet perspektiva.

E një fije shprese megjithatë është aty. Po ajo shpresë që na e ka dhënë fuqinë të kalojmë nëpër faza shumë më të rënda, sepse e kemi ditur se ka më mirë.

Kurse e mira nuk ka skaj. Vetëm duhet zënë hapin. Gëzuar!

flaka@koha.net



Granit Kurti

Isha përbetuar tri herë – sapo aeroplani u shkëput nga toka e stjuardesat sorollaten të bëhen gati të demonstrojnë për të satën herë instruksionet e lidhjes së rripit të sigurisë, të reagimeve në raste emergjencash e protokolle të ngjashme – se nuk do të merrja me vete asgjë, as kujtime a shënime prej atje. Pos shijes, mbase edhe aromës, së çokollatës belge. Mbase edhe ndonjë foto të cilat përherë përfundojnë diku nëpër skuta memoriesh të telefonit, pa ndonjë peshë reale kujtimesh.

Prej agjendës e paragjykova si një tufë takimesh protokollare, me ca takime joformale, në të cilat një grup gazetarësh nga vendet e Ballkanit Perëndimor, ftohet në Bruksel, i flitet për integritet evropiane, rregullat, se sa larg a afër BE-së jemi, e prej tyre, gjysma s’i kuptojnë as integritet, rregullat jo se jo, përfshirë edhe mua. Shënimet që mbajta në takime qenë më shumë shtirje për ta aktruar përqendrimin dhe ngulmim për të mos ia thyer vetes përbetimin e trefishtë, që prej atje të mos merrja asgjë me vete. Në cep të fletës së bllokut të shënimeve, fjalës “tango” ia kisha vënë një “X” para numrit 3, si për ta shumëzuar trefish.

Tre prej gjashtë folësve kryesorë



Për shkak të temperaturave të larta, në fund të korrikut dhe fillim-gushtit janë shfaqur qindra vatra zjarri në Kosovë. Shkaktarë sipas autoriteteve në disa raste kanë qenë edhe personat e pa-përgjegjshëm. Zjarret, që përveç kulturave bujqësore kanë prekur edhe zona të banuara, kanë shkaktuar dëme te mëdha materiale. Me zjarret gjatë sezonit të verës janë përballur edhe vendet fqinje dhe shumë shtete të Evropës

Tango ballkanike në kryeqytetin e Evropës

Për një udhëtim të shpejtë aty ku synojmë kaherë, thyerjen e përbetimit, besimin në politikanë-hoxhallarë dhe ëndrra integrimi, për shijen e çokollatës, disa shënime të parëndësishme dhe për tangon e largët

në takime, në dukje me peshë, në esencë sipërfaqësorë, por të domosdoshëm për t’ia bërë “tik”, do ta përmendnin theksueshëm klisenë e famshme: “Për tango duhen dy”. Nëse qytetarë të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor janë të zotë të luajnë tango, nuk ka fort nevojë që matjet të bëhen me soj “Barometri të Ballkanit”, prezantimi i të cilit qe sebeb edhe për udhëtimin e grupit të gazetarëve, financuar me fonde të BE-së, i përmbyllur me cakërrim gotash, urime të parakohshme festash, shoqëruar me ushqim ballkanik si shenjë respekti për ne, ballkanasit, ku flija – së cilës i është ngulitur rrëmojësa me flamurin e vockël të BE-së – pa ceremoni, por në muhabet e sipër, shpallet misi i tavolinës. Kur njëri prej nesh, ballkanasve, ngulmon se na bashkon bakllavaja, gazetarët ftohen tash për një takim tjetër joformal, me një tjetër zyrtar, edhe ky i lartë i BE-së, që edhe një herë t’ua shpjegojë të dhënat e “Barometrit...”. Dhe takimi nis me një lloj paralajmërimi se statistikata, përqindjet, grafikonët..., janë vetëm maja e Icebergut. Se prezantimi që kishim parë është thjesht dydimensional. Se ai merr kuptim kur analizohet. Në konfidençë thotë gjëra jo fort me peshë, tregon se me matjet e bazuara në anketimin e 6 mijë e kusur respondentëve, rrafsh 68 për qind e të anketuarve u besojnë më fort institucioneve religjioze – hoxhallarëve e priftërinjve – sesa mediave. Godet mediat sociale, jep një grimë shpresë se besimi në to po bie, ua këput shpresat mediave përnjëmend për përkrahje me fonde të BE-së dhe takimi përfundon me riformulimin e definicionit për tangon, tash në formën se krejt ky raport – i yni me BE-në – është “një tango dhe jo solo”.

Tangoja është e largët për vendet e Ballkanit. Gjashtë të atij perëndimor, valle të përbashkët kanë të famshmen tre hapa para, dy prapa. Edhe në raport me BE-në.

“Barometri...” na thotë se 26 për qind e qytetarëve të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor shpresojnë se do t’i bashkohen BE-së në vitin 2030, e 25 për qind shpresojnë që kjo të ngajë më 2035. Serbët janë në fund të tabelës me 15 për qind – zyrtarët e BE-së shqetësohen – dhe sikur harrojnë se janë po këta që jo se nuk shpresojnë, por nuk duan. Dhe këtu merr kuptim edhe besimi në institucione religjioze, te politikanët e kishës.

Në tabelë prijnë shtetasit e Shqipërisë me 43 për qind, pasohen prej atyre të Kosovës me katër për qind më pak. Dhe këtu merr sërish kuptim besimi tek “institucionet” religjioze, te politikanët-hoxhallarë që xhenetin e premtojnë në tokë, jo në botën e përtëjme. Sepse fushatat zgjedhore, premtimet e zëshme, më fort u ngajnë hytbeve.

Njëri prej panelistëve, ballkanas, thotë atë që ka qejf ta dëgjojë BE-ja, se “ka kaluar kohë e gjatë prej luftërave dhe duhet gjetur mënyra për të bashkëpunuar”. Gazetari nga Sarajeva, pyet si pa zë, “Me kë?” dhe ne, shqiptarëve na tregon se ende ka në trup copa granatash. I kthen të qeshurat me një barsoletë aty për aty dhe ia heq bakllavasë rrëmojësen me flamurin e vockël të BE-së.

Zyrtari i tretë, i lartë, i BE-së, tangon e përmend që në krye të fjalim-

it të shkruar, flet mirë njëren prej gjuhëve ballkanike dhe në dukje kjo i krijon një soj afërsie me njërin krah të panelistëve, përfaqësues organizatash rinore nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

“Barometri i Ballkanit” thotë se 68 për qind e të rinjve të anketuar duan të dalin jashtë vendeve të tyre për punë ose banim: 34 për qind përhershëm. Po aq përkohësisht. “Vetëm 29 për qind preferojnë të qëndrojnë në vendet e tyre”, është statistika që përmendet rrëshqitazi. Zyrtari sërish merr fjalën, duket i shqetësuar, sikur mendon një grimë, panelistët presin komentin. “Derisa po flisje, hetova se jashtë kishte rënë nata”, thotë rrufeshëm dhe uron festat e fundvitit.

Është natë e kthjelltë në Bruksel dhe për dikë që vjen nga një vend ku sheshi “George Bush” në zemër të qytetit bëhet përshesh politikash, kacafytjesh e shkeljesh ligji, spektakli me drita në “Tregun e Madh” – me vullë gotike e baroke, i shpallur trashëgimi botërore qysh më 1998 – është një lloj ikjeje nga realiteti i përditshëm.

Me Gerin energjik nga Shqipëria, vendosim me çdo kusht ta gjejmë rrugicave me kalldrëm simbolin e Kryeqytetit të Evropës, “Manneken Pisin” e famshëm, të skulpturuar edhe në suvenire gjithandej. “Takimi” me skulpturën dyrellëmbëshe, s’është aq mbresëlënëse por mjaftueshëm për ta kujtuar se çdo 28 Nëntor, “Djaloshiit që pshurret”, në shenjë nderimi për ne shqiptarët, i vishen tirqit. Ose për ta theksuar a riformuluar kërkesën që një anketë si puna e “Barometrit...” duhet të bëhet edhe në vendet e BE-së, mbase me pyetjen e vetme për ta, se si na shohin ne, ballkanasve. Për ta marrë një përgjigje për ne, shqiptarët.

“Shqiptarët janë me origjinë të pastër evropiane. Ata janë burra të gjatë, shpatullgjerë, me fytyra të bukura dhe nuk ngajnë me asnjë nga pjesëtarët e përkatësive tjera...”, do të shkruante gazetari anglez, Frederic Moore nja 120 a kusur vjet, në kohën kur “shqiptari është mësuar të dyshojë se çdo evropian është spiun!” Ose të tillë që gjithmonë “u kanë rezistuar reformave, pasi me zbatimin e tyre njëherësh do të ndërhyhej në privilegjet e tyre”.

Përbetimin për të mos marrë asgjë prej atje – as kujtime a shënime pos shijes, mbase edhe aromës së çokollatës belge – e kisha shkëlur tashmë, kur nga lart shiheshin dritat e Prishtinës, e piloti përsëriste kërkesën që të mos hiqen rripat e sigurisë. Tek kur aterruam, m’u kujtua se çokollatën s’e kisha shijuar. Dhe nuk më mbetej merak.

Qe natë e kthjelltë. Mjaftueshëm për të refuzuar kategorikisht që të shndërrohemi në shifra përqindjesh të njerëzve që duan të ikin prej këtij vendi. Sepse ky vend mund dhe duhet të bëhet. Për ne dhe fëmijët tanë.

Gëzuar për një vit të cilin vazhdojmë ta ëndërrojmë! Pa e harruar realitetin!

© KOHA Ditore

SHËNIME MARGJINALE

Pse lexoheshin gazetatat nga faqja e fundit?

...pse udhëtoi një lajm morti nëntë muaj në distancë dykilometërshe, pse kontrollohemi nga algoritmet dhe pse është i nevojshëm përqaftimi?



Veton Surroi

1. Ky shkrim, siç do të shihni, nuk është prodhim i Inteligjencës artificiale.

Fakti që duhet cekur se nuk është i këfillë, do të thotë se sot kemi një numër të konsiderueshëm shkrimesh, postimesh në Facebook apo recitimesh mendimesh të thella nga influenceret me dekolte po aq të thella që tingëllojnë të përkryera në gjuhë e strukturë.

Por dëshmia se ky nuk është produkt i Inteligjencës artificiale - për aq sa është inteligjencë, është produkt i asaj natyrale - lidhet me konstatimin se kur kanë ekzistuar gazetatat e shtypura në letër, një pjesë e konsiderueshme e lexuesve e fillonin leximin jo nga faqja e parë, por nga faqja e fundit e gazetës.

Pse?

Këtu nuk ndihmon Chatgpt, se po ta pyesni atë do t'jua japë një elaborim të gjatë, por pa i gjetur thjeshtësinë dhe thelbin e përgjigjes. Thjeshtësia dhe thelbi i përgjigjes është se një pjesë e konsiderueshme e njerëzve e fillonte leximin nga faqja e fundit, sepse prej aty kalohej menjëherë te lajmërimet për vdekje dhe përkujtimet për të vdekurit.

Faqet e përkujtimeve - apo në gjuhën e redaksive të gazetave, faqet e të vdekurve - ishin të vërteta të pakontestueshme, mbase edhe për dallim prej atyre që ishin të kontestueshme e që fillonin në faqe të parë, sepse çdo gjë që fillonte në të parën ishte e kontestueshme e çdo gjë që përfundonte tek e parafundit nuk kishte kontestim.

Ose, ta marrim nga një kënd tjetër, siç do të thuhej më për toke, lexuesi e fillonte prej faqeve të fundit, sepse nuk donte të mbetej jashtë kodit shoqëror, nuk donte të mbetej i painformuar lidhur me një vdekje të dikujt, një emri që e njihje personalisht apo ia njihje rrethin familjar apo kishte një ndërlidhje që krijonte ndjenjën e obligimit që të shkonte në varrim apo të shprehte ngushëllimet.

2.

Njërit prej bashkëpunëtorëve të mi shumë të afërt për shumë vjet i kishte vdekur nëna në fillim të këtij viti.

Jetojmë më pak se dy kilometra larg njërit-tjetrit, por lajmi për vdekjen e saj udhëtoi nëntë muaj. Kur arriti, lajmi i bartur fjalë pas fjale mbante më vete edhe zemërimin e thyerjes së kodit tonë shoqëror - si është e mundur që nuk kisha shkuar në varrim apo ngushëllime? Dhe, madje, si nuk e kisha bërë këtë për një person me të cilin para 35, a 30, a 20 vjetësh kisha pasur afërsi aq të madhe?

Në fëmijërinë time, kur jetonim në Bolivi, një lajm i këfillë do të arrinte me një letër, ndoshta për një muaj, ndoshta për dy, por jo

tetë. Dhe Bolivia ishte 11 mijë kilometra larg, jo dy.

Dhe, vërtet, si ishte e mundur që kjo të ndodhte, paradoksalisht, në revolucionin informativ, ku marrim vesh çdo sekondë se çka ndodh në çdo cep të botës, ku jetojmë në një botë aq të digjitalizuar sa Danimarka ka vendosur që letra e fundit që do të dorëzohet në kuti postare do të jetë më 30 dhjetor.

(Për ata që janë më të rinj, kutitë postare kanë qenë kuti metalike në të cilën është futur letra me pullë postare të ngjitur në të - pulla postare ka pasur një ngjitës me primesa të së ëmblës, kur duhej lagur me gjuhë për ta ngjitur në zarf a kartolinë).

Kutitë postare u zhdukën nga qyteti ndoshta në të njëjtën kohë kur humbi peshën e vet kolona e afisheve të fletëmorteve që ngjiteshin në drunjtë e rrugës kryesore të Prishtinës, që atëherë u bë sheshi “Nënë Tereza”. Kur u bënë gjithnjë e më të parëndësishme afishet, morti fitoi rëndësinë e vet në faqet e fundit të gazetës.

3.

Rruga e lajmit të mortit u transformua me shpejtësinë me të cilën kaluam një shekull, kaluam prej socializmit në shoqëri të hapur, prej revolucionit industrial në atë informativ, prej okupimit në liri e pavarësi.

Dikur ishte thirrja telefonike, në kohën kur telefonat ishin të pak-të. E njoh cingërimën e telefonit të zi, i cili mbante numrin 3437, më vonë 23437, në të cilin erdhi lajmi për vdekjen e gjyshes.

Ishin afishet - ato të vendosura në aletë e qyteteve e në dyer banesash dhe shtëpish; lajme definitive.

Dhe, pastaj faqet e të vdekurve në gazeta e kur shkuan edhe gazetatat u bënë lajmërimet në Facebook, me ciklin e vet 24-orësh, me drejtpërdrejtësinë e transmetimit të ndërrimit të jetës së një personi, ndonjëherë gati si të ishte transmetim i drejtpërdrejtë.

E si atëherë të mos më mbërrijë lajmi për vdekjen e një gruaje nëntë muaj pas?

Arsyeja e parë dhe e natyrshme ishte largimi shumëvjeçar mes meje dhe personit të cilit i vdiq nëna; do të bëhen gati njëzet vjet që kemi humbur kontaktin normal - jo atë intensiv, të cilin e kishim e që bënte të dëgjoheshim e shiheshim disa herë në ditë, por një normal, në të cilin do të komunikonim një herë në aq sa ta definonim se është normale.

Dhe, këtu, te normaliteti kalojmë tek arsyeja e dytë. Është vështirë të përcaktohet se çka është shkalla e komunikimit, që do të quhet “normale” në periudhën e Facebookut e mediave të tjera sociale, për shkak se jetojmë me nënkuptueshmërinë se i kemi të gjitha informatat, aty në telefon. Ky është megjithatë një iluzion, apo madje vetiluzion kolektiv, sepse në telefon i kemi informatat të cilat na serviren në bazë të algoritmeve të kompanive të mëdha, e këto algoritme ndërtohen me ndërveprimin tonë me rrethin e mediave sociale. Algoritmi nuk më ka

treguar se i ka vdekur nëna një personi, të cilin unë duhej ta ngushëlloja në varrim, për arsye të thjeshtë se ai person jeton në një botë tjetër algoritmike, me miqtë e tij virtualë, me afinitetet politike, kulturore e të tjera, që nuk e sjellin afër botës sime algoritmike. Facebooku na ka kufizuar në 5 mijë miq virtualë e algoritmi i tij na udhëzon çdo ditë që vëmendja jonë të jetë e drejtuar kah, kush, kë e shau në debat të mbrëmjes, a do të puthet një banor i “Big Brotherit” me tjetrin, reklamat e patundshmërive, veshjeve sportive, aranzhimeve turistike - vdekja e një personi të rëndomtë nuk përbën interes të veçantë.

E kështu mbërrijmë tek arsyeja e tretë, se kemi kaluar prej jetës në hapësirë publike fizike, në jetë të hapësirës publike virtuale. Dikur dilej në qytet për të parë e për t'u parë, pihej një kafe për të këmbyer informata, mendime, dëshpërime e gëzime - lajmi i mortit ishte aty diku - në afishe e gazetë, pjesë e hapësirës publike. Tash dalim në Facebook, dimë për njëri-tjetrin edhe më shumë se mbase kemi nevojë, prej ushqimit e pijes, veshmbathjes deri te paralajmërimi se për kë do të votojmë. Por, dimë për aq sa na ka udhëzuar dhe kufizuar algoritmi të dimë, një udhëzim dhe kufizim që pas një kohe kalon në konvencion; jemi të kënaqur me atë që dimë brenda balonës sonë informative dhe këtë e dëshmojmë duke hapur telefonin për të parë ç'ka të re në Facebook.

4.

Në botën tonë virtuale ndodh të dimë shumëçka, por jo gjithëherë të dimë për atë që na përket dhe për të cilën kemi përgjegjësi. Kjo ndodh jo sepse jemi bërë më pak njerëzorë, por sepse kemi pranuar, shpesh pa e vënë re, që një pjesë të marrëdhënieve tona t'i delegojmë tek algoritmi.

Algoritmi na informon, por nuk na obligon. Na tregon çfarë është e re, por jo çfarë është e rëndësishme. Dhe morti, si ngjarje thelësisht njerëzore dhe shoqërore, humbet pikërisht aty ku humbet hierarkia e vlerave: në një hapësirë ku gjithçka matet me vëmendje dhe asgjë me përgjegjësi.

Kështu ndodh që lajmi të udhëtojë shpejt, por të mos mbërrijë në kohë. Jo sepse nuk ekzistojnë mjetet, por sepse mungon prania. Jo sepse jemi larg, por sepse jetojmë secili në një hapësirë tjetër informimi, në një normalitet tjetër, të përcaktuar nga ajo që na shfaqet në ekran.

Prandaj, ky rrëfim nuk është as nostalgji dhe as refuzim i botës digjitale. Është një kujtesë e thjeshtë se disa gjëra nuk mund të zëvendësohen: as morti, as kujtesa, as detyrimi njerëzor për të qenë aty — fizikisht dhe në kohë. Ja pse është me rëndësi të takohemi, në këto ditë festash e në çdo ditë tjetër deri te festa tjetër.

T'i flasim njëri-tjetrit. Të dëgjohe mi duke u shikuar në sy. T'i shtrëngojmë duart. Të përqafohemi përmallshëm. T'i ruajmë rrëfimet gjallë duke i këmbyer me njëri-tjetrin, me fjalë të gjallë, në botën e prekshme.

SHIKIM NGA BRUKSELI

Uroj një vit pa zgjedhje

Në politikë perceptimi është më i rëndësishëm sesa realiteti. Politikanët janë sikur magjistarët. Ata krijojnë iluzione. Sa më të mirë në krijimin e iluzioneve, përshtypjes, aq më të suksesshëm do të jenë. Për Qeverinë çdo e mirë vjen nga ta. Për opozitën, gjithçka e keqe është për fajin e Qeverisë. Gjërat pozitive për Qeverinë janë fryt i punës së tyre, ndërsa ato negative pasojë e situatës globale. Kështu është gjithkund e jo vetëm në Kosovë. Por kjo fushatë permanente duhet të ketë kufij, e ai kufi është arritur në Kosovë me tri palë zgjedhje në vitin 2025. Prandaj do të ishte mirë që 2026-a të mbahej mend si një vit i futbollit dhe, me Kosovën dhe Shqipërinë në Botëror, pa zgjedhje në Kosovë



Augustin Palokaj

Në vitin 2025 u habita se pse nuk ka valë të mëdha emigrantësh, të cilët nga Gjermania, Franca dhe Britania e Madhe shkojnë për të jetuar në vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo do të ishte një pyetje logjike nëse vlerësohen situata e përgjithshme dhe kushtet e jetës me deklaratat e politikanëve në pushtet. Nga Kroacia, përmes Serbisë e deri në Kosovë dhe Shqipëri kemi dëgjuar vetëm për rritje pagash, ndërtim urash, shkollash, rritje ekonomike, ulje të papunësisë. Disa nga këto pohime të dëshmuara e disa larg realitetit. “Kroatët kurrë në histori nuk kanë jetuar më mirë”, përsëriste gjatë tërë vitit kryeministri i Kroacisë, Andrej Plenković. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, aq shumë ka folur për suksese, sa që ka shkuar aq larg të thotë se: “Për inat pse Serbia po përparon, po forcohen Kroacia dhe vendet e tjera që ta rrëzojnë Serbinë”. E “Serbia” është vetë ai. Mediat proqeveritare në Serbi kanë pasur edhe tituj: “Serbët u dërgojnë kushërinjve të tyre në Gjermani miell, sheqer dhe vaj”, sepse në Gjermani “ka krizë”. Për rezultatet e “qeverisjes së mirë” dhe sukseset ka folur edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Nuk i ka lënë mangu as kreu i Qeverisë së Shqipërisë, Edi Rama.

E nga Gjermania vetëm lajme jo të mira. Rritja e ekstremitet të djathtë, ngadalësim i rritjes ekonomike, krizë e paparrë në tridhjetë vjetet e fundit, sulme terroriste, vonesa të trenave. Aq ka tërhequr Gjermania vëmendjen e qytetarëve nga rajoni, sa që në një medium në Kroaci ndër lajmet më të lexuara të vitit ka qenë ai se në Gjermani ka rënë borë në muajin shkurt dhe kjo ka shkaktuar probleme në trafik. Duhet të kenë menduar “ah të shkretët gjermanë! Me gjithë problemet që kanë, veç edhe borën e kanë pasur mangu!” Pa probleme serioze nuk kanë qenë as Franca e as Britania. Përdërisa në Kosovë disa politikanë kanë qëndruar edhe në Ministri, edhe në Kuvend, në Francë tri herë ka rënë Qeveria. Mezi është miratuar buxheti, ndërsa papunësia ka nisur të rritet. Britania ka probleme me çmimet, me inflacionin dhe me stabilitetin fiskal. Për të mos harruar problemin me emigrantët.

Se në vendet e Ballkanit është mirë dhe në ato perëndimore ka krizë, është një lloj paradoksi. Është më shumë iluzion. Mjafton të shihet lëvizja e njerëzve ku shkojnë për të

punuar dhe për të jetuar. Lëvizja është nga jugu drejt veriperëndimit. Kroacia ka humbur gjysmë milioni banorë në dhjetë vjetet e fundit. Kanë shkuar për të jetuar dhe punuar në Austri, Gjermani dhe Irlandë. Serbia ka humbur në këtë periudhë edhe më shumë. Mbi 50 mijë qytetarë të Serbisë kanë shkuar për të punuar në Kroaci. Ndoshta për të plotësuar vendet që u lanë zbrazët nga kroatët që shkuan në Irlandë. E Kosova dhe Shqipëria kanë ndoshta edhe zvogëlimin më të madh të numrit të banorëve në tërë Evropën për shkak të largimit të qytetarëve, kryesisht të rinj, drejt vendeve perëndimore. Me shumë kasot shqiptarë në vendet e Evropës Perëndimore sesa në Shqipëri apo sesa në Kosovë. Me siguri të gjithë ata ikin nga të mirat.

Nuk duhet fajësuar politikanët për një propagandë të tillë, sepse atë punë e kanë. Në politikë perceptimi është më i rëndësishëm sesa realiteti. Politikanët janë sikur magjistarët. Ata krijojnë iluzione. Sa më të mirë në krijimin e iluzioneve, përshtypjes, aq më të suksesshëm do të jenë. Për qeverinë çdo e mirë vjen nga ta. Për opozitën gjithçka e keqe është për fajin e Qeverisë. Gjërat pozitive për Qeverinë janë fryt i punës së tyre, ndërsa ato negative pasojë e situatës globale. Kështu është gjithkund e jo vetëm në Kosovë. Por kjo fushatë permanente duhet të ketë kufij, e ai kufi është arritur në Kosovë me tri palë zgjedhje në vitin 2025.

Qytetarët lodhen edhe nga “të mirat”. Si të mos lodhen duke dëgjuar një lider partie të përmendë se do t'i bëjë rrogat 1.000 euro. Pensionet do t'i rrisë 50 për qind, tjetri do të ndërtojë autostrada e aeroporte. Të mos flasim për stadione futbollit, sala sporti e zhvillim digjital. Po të realizoheshin këto premtime, edhe shumë vende të BE-së do t'ia kishin lakmi Kosovës. Sepse ka shumë vende të BE-së të cilat nuk e kanë arritur akoma atë nivel rrogash, për të cilat po flitet në Kosovë.

Arsyeja pse në Kosovë njerëzit janë lodhur në vitin 2025, e me këtë gjendje edhe ata që i quajmë “miq ndërkombëtarë”, është fushata e pandalshme zgjedhore që në fakt po zgjat aktivisht që nga vjeshta e vitit 2024. Njerëzit munda të jetojnë, e madje edhe të kënaqen, me dy a tri muaj premtime, lavdërime, kritika dhe ofendime mes garuesve politikë. Por kur kjo bëhet kaq gjatë, atëherë nuk është më as zbatimëse, as e këndshme e as e shëndoshë. Dhe në vitin 2026 kosovarët meritojnë pak pushim. Prandaj do të ishte mirë që 2026-a të mbahej mend si një vit i futbollit dhe, me Kosovën dhe Shqipërinë në Botëror, pa zgjedhje në Kosovë. Kosovës në fillim të vitit i duhet një zgjidhje që të mos ketë më zgjedhje, së paku për një vit që pak të marrë frymë. Dhe natyrisht një ajër pak më i pastër, që edhe fryma që marrin të mos u bëhet problem.

VITI 2026

Viti i votës

Si asnjëherë tjetër, më 2025, qytetarët iu drejtuan kutive të votimit katër herë. Janë mbajtur dy palë zgjedhje parlamentare dhe dy runde të zgjedhjeve lokale. Ajo që pritet nga partia fituese e zgjedhjeve të 28 dhjetorit dhe ato opozitare, është që të mos e çojnë vendin në zgjedhje sërish në pranverë kur të vijë puna e zgjedhjes së presidentit të Republikës

Marigona Brahimi

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Kosova e nisi dhe e përfundoi 2025-tën me zgjedhje. Katër cikle zgjedhore u zhvilluan brenda një viti. Një palë zgjedhje parlamentare në shkurt, një palë lokale në tetor, raundi i dytë i tyre në nëntor dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare në dhjetor.

Rezultati i procesit të parë nuk u materializua. Partitë politike mbajtën qëndrime të kundërta, që secili kampi i quajti bllokuese dhe për pasojë u pamundësua formimi i institucioneve.

E në matjen që bënë partitë në zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit, disa humbën elektorat e një e shtoi atë.

Në vitin 2026, sfida e parë e kryesore do të jetë ajo për zgjedhjen e presidentit, moszgjedhja e të cilit mund të nxisë zgjedhje të reja. Bara do të jetë mbi Lëvizjen Vetëvendosje si fituese e zgjedhjeve. Pritjet janë që fitorja plebishitare e dhjetorit do t’ia lehtësojë kësaj partie që të kalojë testin për zgjedhjen e kryetarit të ri të shtetit.

Në zgjedhjet e 28 dhjetorit, nga mbi 900 mijë votat e rregullta, Lëvizja Vetëvendosje doli forcë e parë me 49.33 për qind apo 432 mijë vota. Ende pa u numëruar 74 mijë votat e diasporës dhe gati 10 mijë me kusht, LVV mori mbi 36 mijë vota më shumë se më 9 në shkurt 2025.

PDK-ja doli e dyta me 21 për qind apo 184 mijë vota. Sipas rezultatit të votave të rregullta, PDK-ja mori mbi 12 mijë vota më pak sesa në shkurt.

LDK-ja është humbësja më e madhe e këtyre zgjedhjeve. Ajo ra për rreth 52 mijë vota. Nga 18.27 për qind u tkurr në 13.57 për qind.

Rënie pësoi edhe AAK-ja. Mori mbi 16 mijë vota më pak se në zgjedhjet e fillimvinit kur ishte në koalicion me Nismën. Nga 7,06 për qind, ra në 5,66 për qind.

Në votë u ngrit Lista Serbe, e cila mori 42.235 sosh, mbi 2 mijë më shumë se në zgjedhjet e kaluara.

Bazuar në përllogaritjen e votave të numëruara, LVV-ja ka siguruar 56 ulëse në Kuvend, PDK-ja 23, LDK-ja 15 dhe AAK-ja 6. Ky rezultat ia mundëson LVV-së që me votat e deputetëve të komuniteteve pakicë joserbe ta formojë shumicën parlamentare e rrjedhimisht edhe Qeverinë.

Gjuha që dogji urat

Fushata zgjedhore e partive politike për zgjedhjet e 9 shkurtit, u vlerësua skajshmërisht polarizuese. Gjuha e përdorur, sidomos nga Vetëvendosje u konstatua si nxitëse nga Misioni i BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve. 30 ditë zgjati fushata zgjedhore. Vetëvendosje kërkonte gjysmë milioni vota. Mori 396 mijë. Partitë tjera nuk kishin kësó qëllimesh. Më shumë e dëshironin një dominim të partive opozitare bashkërisht sa i përket fuqisë elektorale. Më 9 shkurt u dhanë rezultatet e preliminare dhe 42.3 për qind të votave sa fitoi nuk ia siguruan LVV-së shumicën parlamentare që e pati në 4 vjetët e kaluara. Nuk i mjaftuan as votat e minoriteteve joserbe.

Në entuziazmin e fitores së VV-së u vendosën edhe muret që bllokuan bashkëpunimin me partitë opozitare.

Në sheshin kryesor të Prishtinës, para qytetarëve, kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti, i quajti “hajvana” opozitën.

“E keni parë çfarë rrenash prej premtimeve kanë dhënë. Thonin buxheti i shtetit do të bëhet më i madh se bruto produkti vendor. Çfarë hajvanash! Ose jepnin premtime për koeficient më shumë se programi i tyre. Çfarë hajvanash! Por, ka

kalu koha e hajvanatit”, ka thënë Kurti në mbrëmjen e 9 shkurtit.

Kjo deklaratë, sipas njohësit të çështjeve politike, Artan Alijaj ishte strategji e tij për t’i shembur urat e bashkëpunimit me opozitën e deriatëhershme, pasi e donte edhe një mandat tjetër pa ta. Sipas tij kjo gjuhë i parapriu një polarizimi, që qëllim do të kishte vetëm një disponim tjetër elektoral të shprehur me zgjedhje tjera.

“Ajo ndoshta ka qenë edhe një mesazh i drejtuar edhe partive opozitare në atë kohë që krijimi i shumicës do të jetë problematike dhe mendoj që pastaj çdo gjë që ndodhi prej natës së 9 shkurtit e deri më tash është vetëm një vazhdimësi e atyre, të themi, strategjive politike që i kanë përdorë partitë politike në vend për të shty procesin ndoshta në një kohë të pacaktuar dhe për të synuar ndoshta që të krijojnë një disponim qytetar, qoftë kundër njërës palë, ose kundër palës tjetër”, ka thënë Alijaj.

Kuvendi peng i kalkulimeve

Rezultati zgjedhor i 9 shkurtit nuk u jetësua. Vetëvendosje bashkë me 7 deputetë të grupit multietnik dhe me një të komunitetit serb i siguruan veç 56 vota. Opozita në anën tjetër kishte 55. Nëntë ishin të Listës Serbe por ata nuk përfshiheinin në kalkulimet e asnjërës palë. Së paku, deklarativisht jo. Qëllimi fillestar ishte të konstituohej Kuvendi. Nga prilli e deri në tetor seancat për konstituim u mbajtën një ditë po e një jo. Tetë muaj nga mbajtja e zgjedhjeve Kuvendi arriti të konstituuohej. Njëherë, Vetëvendosje nuk lëvizte nga propozimi i saj për kryetar Kuvendi - derisa e lëvizi Gjykata. Më pas, kjo parti nisi të japë alternativa, por opozita s’i pranonte. Propozonte emra për të cilët opozita ishte shprehur se nuk ia votonte. Disa herë nga LVV-ja deklaruan se i kanë numrat për formimin e Qeverisë, por në të njëjtën kohë u mungonin për konstituimin e Kuvendit. Nuk i pati as për njërën as për tjetrën. Lëvizjen e parë zhblllokuese për të dalë nga ngërçi e bëri PDK-ja. Ia votoi LVV-së emrin e pestë të propozuar për kryetar Kuvendi. Sjellja politike e PDK-së sipas analistit Aliaj, ishte më parimorja në krahasim me partitë e tjera parlamentare. Më kritik ai është shprehur ndaj Lidhjes Demokratike e cila nuk pranoi kurrfarë alternative dhe refuzoi të gjitha ftesat. S’donte marrëveshje me LVV-në, por edhe për opozitën nxori kushte.

“Erdhën me atë propozimin e tyre për një Qeveri uniteti, që edhe ajo në njëfarë forme nuk bënte sens. Pasi, i kishin dy opsione në tavolinë, ishte opsioni që të shkonin me Lëvizjen Vetëvendosje dhe opsioni që të shkonin me Partinë Demokratike të Kosovës dhe të formojnë qeverinë e të dalin nga kriza. Që në fillim kanë qenë në hapa të gabuar. Por hapi më i mirë i tyre ka qenë kur kanë vendosur që të votojnë për nënkryetarin e Kuvendit që vjen nga komuniteti serb”, ka thënë Alijaj.

Edhe AAK-ja mbajti qëndrime konsistente kundër LVV-së, ndonëse edhe ajo i ofroi votat e saj për disa emra të caktuar. E Nisma Socialdemokrate shprehte vullnet të ishte pjesë edhe e Qeverisë me LVV-në edhe e Qeverisë me opozitën.

Për koalicion me LVV-në kërkoi postin e kryeparlamentarit, gjë që nuk e mori.

Me disa beteja në Kushtetuese e aktgjykime të saj në formë instruksionesh, Kuvendi u konstituua më 10 tetor. Por, votat për Qeverinë nuk u siguruan. Dy herë dështoi të votohet prej 61 deputetëve mandatar i

Vetëvendosjes për kryeministër e kabinetin qeveritar. Më 20 nëntor, presidentja e shpërndau Kuvendin dhe shpalli zgjedhjet e jashtëzakonshme nacionale për datën 28 dhjetor.

Alijaj thotë se përgjatë gjithë muajve të bllokadës partitë pa përfashtim ekzekutuan lojëra e strategji politike vetëm në interesa partiak e assesi shtetëror.

“Gjatë tërë vitit kemi parë lojëra politike, strategji partiake se cila nga to do të dalë më mirë nga ky proces i bllokimit. Mendoj që secilës parti veç e veç, i ka konvnuar që të prolongohet zgjidhja e problemit, në këtë rast formimi i institucioneve të Kosovës. Ka qenë thashë në interesin e të gjitha palëve. Në bazë të numrave, matematika na ka treguar që formimi i Qeverisë ka mundur të bëhet, mirëpo komplikimi më i madh ka ardhur si rezultat i faktit që kemi të bëjmë me zgjedhjen e Presidentit të Kosovës në mars të vitit të ardhshëm”, ka thënë ai.

Pushteti lokal pa dominim absolut

Në mes të dy palë zgjedhjeve parlamentare, u zhvilluan dy runde votimesh për zgjedhjen e kryetarëve të komunave dhe asambleve. Në nivel lokal qytetarët u dhanë partive pushtet të balancuar. Shtatë komuna i fitoi Vetëvendosje, më së shumti në historikun e saj prej kur merr pjesë në zgjedhjet lokale. Fitore shënoi në Podujevë, Shtime, Kamenicë, Mitrovicë të Jugut, Gjilan, Obiliq e Fushë-Kosovë. Në po kaq komuna arriti fitore edhe LDK-ja, por i humbi dy bastionet e saj: Fushë-Kosovën dhe Obiliqin. Kryesimin e komunave e mori në Lipjan, Istog, Prishtinë, Pejë, Dragash, Junik e Viti. Partia Demokratike fitoi në gjashtë Komuna, Skenderaj, Ferizaj, Han i Elezit, Prizren, Kaçanik dhe Vushtrri. Pushtetin e humbi në Mitrovicë të Jugut, e në Drenas fitoren ia mori Ramiz Lladroviç që kandidoi me një iniciativë të themeluar prej tij.

Në pesë komuna fitoi AAK-ja duke e ruajtur pushtetin në Deçan, Gjakovë, Suharekë, Rahovec e Klinë. Nisma fitoi në Malishevë e KDTP-ja në Mamushë. Ndërkaq, si forca më e madhe politike në nivel lokal doli Lista Serbe me fitore në të 10 komunat e banuara me shumicë serbe.

Fitorja plebishitare e LVV-së dhe shembja e opozitës

Pas zgjedhjeve lokale, ishte radha për ato parlamentare. Zyrtarisht ishin 12 ditë fushatë zgjedhore, por partitë e nisën atë menjëherë pas shpalljes së zgjedhjeve. Disa nga to u përcaktuan që në fillim, që garës t’i futen pa koalicionë por listat t’i linin të hapura për ata që donin t’u bashkoheshin. Kështu vendosi PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja. LVV-ja hyri në koalicion me tri subjekte politike, Listën Guxo, Alternativën dhe PSHDK-në. Nisma provoi deri në momentet e fundit të gjejë partner koalicioni, por nuk ia doli. AAK-ja ishte e prerë se nuk e do në koalicion, pasi menjëherë pas zgjedhjeve të shkurtit ku i fituan bashkë 8 deputetë, Nisma me tre të saj u shkëput nga AAK-ja me arsyetimin se nuk i detyrohet asgjë. Kësisoj, si adresë e parë ishte LDK-ja. Tentoi për disa ditë radhazi por s’u arrit marrëveshje. Pas saj iu afrua edhe PDK-së. E në fund, kur nuk u arrit marrëveshje as me te, kryetari i Nismës Fatmir Limaj, u shpreh se me këtë subjekt do të bashkohet në Kuvend. Por kjo mundësi nuk iu dha. Sipas rezultateve preliminare, Nisma u ndal në 1.7 për qind, shumë nën pragun prej 5 për qind.



Më 2025, qytetarëve u është dashur 4 herë t’ua mësyjnë kutive të votimit. Dy herë për zgjedhje nacionale dhe në dy runde të zgjedhjeve lokale

Vetëvendosje i mori votat e rreth gjysmës së votuesve. Këso rezultati, sipas analistit Adrian Zeqiri nuk ka pritur as vetë LVV-ja.

“E para ka qenë një mungesë e mobilizimit të elektoratit te partitë e opozitës, ka pasur një apati për sa i përket mesazhit politik, të cilin ato e kanë përcjellë dhe siç u pa nuk kanë arritur ta ruajnë as votën e vet. Elementi i dytë që mendoj që gjithashtu ka pasur një ndikim, ka qenë një mospjesëmarrje e votuesit rezident të Kosovës dhe një pjesëmarrje masive e votuesit jo-rezident të Kosovës, që ka ardhur në formën e votës së diasporës. Nga ana tjetër, ndarja benefiteve sociale për kategori të caktuara një javë parapara zgjedhjeve, sigurisht se ka pasur efektin e vet, të energjizimit të një pjese të votuesit të Lëvizjes Vetëvendosje”, ka thënë Zeqiri.

LDK performoi më së dobëti. Zeqiri thotë se kjo parti ka mbajtur nivelin e diskursit publik më lartë se popullata dhe e ka humbur taktin me ta. Ai thotë se rënia kaq e madhe do të mund të krijojë grupe të pakënaqura brenda partisë.

“Unë mendoj se ka munguar emocioni në mesazhin politik, të cilin zoti Abdixhiku dhe përgjithësisht Lidhja Demokratike e ka dhënë. Kjo mungesë e emocionit e ka sjellë këtë rezultat, këtë apati tek votuesit, një pjesë e votuesve të tyre. Mendoj që Lidhja Demokratike tani është duke i përjetuar momentet më të vështira në historinë e vet politike dhe ka rrezik të madh që fraksione të ndryshme të mos pajtohen dhe të ketë edhe ndarje”, ka theksuar ai.

Rënie pati edhe Partia Demokratike. Ajo nuk arriti të ruajë votën e saj edhe pse në Kuvend ishte partia më e madhe opozitare. Sipas Zeqirit, PDK-ja, ashtu si LDK-ja nuk e ka gjetur një kryetar që buron nga baza e që i ka kaluar të gjitha nivelet e lidershipit brenda partisë, pa nevojën e mbështetjes së grupeve të interesit.

“Bedri Hamza nuk ka ardhur në krye të partisë si rezultat i një lufte politike e një lidershipi individual e kështu me radhë. Ka ardhur si emëruesi më i gjerë i përbashkët në kuadër të fraksioneve që janë brenda Partisë Demokratike. Është lider konsensual. Mirëpo lideri konsensual, që është i mirë t’i mbajë fraksionet e ndryshme brenda partisë së bashku, nuk do të thotë që detyrimsht është edhe lider i mirë në sy të qytetarëve”, ka thënë Zeqiri. Ai vlerëson se përveç LDK-së dhe PDK-së, edhe AAK-ja do të përballet me çështjen e lidershipit, që sipas tij, ka rrezik ta shpërbëjë këtë parti në një periudhë të mesme.

Zgjedhja e presidentit, testi i parë për Qeverinë e re

Një qeveri e dalë nga zgjedhjet e 28 dhjetorit do ta ketë sfida serioze në mars të këtij viti kur do të nisin procedurat për zgjedhjen e presidentit të ri të Republikës. Për zgjedhjen e tij duhen votat e 80 deputetëve. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve - 61 sosh, zgjidhet President. Por ka edhe një kusht, në sallë duhet të jenë minimumi 80 deputetë.

Zeqiri thotë se me rezultatin që ka marrë Vetëvendosje më 28 dhjetor, Kurti do të ketë mundësi të mëdha të manovrimit për presidentin e ri. Me këtë mbështetje popullore, thotë se më nuk ia ka borxh as presidentes Vjosa Osmani mandatin e dytë.

“Nëse Kurti ka mundur të mendojë që më 2021 rezultatin të cilin e mori ishte një lloj aksidenti si rezultat i pandemisë ose me mbështetje të zonjës Vjosa Osmani etj, kësaj radhe e ka të sigurt këtë rezultat që e ka fituar vetë. Është një ndër liderët më të pakontestueshëm në skenën politike në Kosovë dhe nuk është i varur prej Vjosa Osmanit. Në një situatë ku opozita gjendet një defensiva të plotë me lidership dhe me rezultate zgjedhore, ai ka mundësi të mëdha të manovrimit për sa i përket zgjedhjes së Presidentit”, ka thënë Zeqiri.

Zeqiri vlerëson se LVV-ja mund ta kalojë këtë test pa një koalicion paraparak me partitë tjera parlamentare, pasi sipas tij, nuk ka subjekt politik përveç Vetëvendosjes që i shkojnë për shtati zgjedhjet e reja në mars.

“Unë nuk shoh që këto parti janë të gatshme që të shkojnë në një proces tjetër elektoral, edhe për arsye se ky rezultat do t’i shkundë themelet e lidershipit brenda këtyre partive. Me liderë të njëjtë, ose me liderë ad-hoc të cilët nuk e kanë kaluar një proces të brendshëm elektoral, nuk besoj që ka apetit tek partitë e opozitës që të shkohet prapë në zgjedhje”, ka deklaruar ai.

Një rezultat të ngjashëm prej 50 për qind të votave LVV-ja e pati marrë edhe më 14 shkurt 2021. Veç dy muaj pas, sfida e pati zgjedhjen e presidentit. Propozimin e saj, për Vjosa Osmanin presidente, e pati mbështetur LDK-ja.



Nuk ishte vetëm vazhdimi i luftës në Ukrainë, për të cilën Evropa vazhdon ta paguajë çmimin më të madh, as konflikti në rripin e Gazës, ku BE-ja nuk kishte ndonjë ndikim, sfidat kryesore. Ajo që vuri në test si kurrë më parë BE-në ishte kthimi i Donald Trumpit në Shtëpinë e Bardhë. Edhe pse në BE dukej se tashmë ishin më të përgatitur për paparashikueshmërinë e Trumpit sesa që ishte në vitin 2016, megjithatë doli të mos jetë ashtu

NJË VIT JO I LEHTË PËR BASHKIMIN EVROPIAN, PËR NATO-N DHE EVROPËN NË TËRËSI

Dëmtimi i raporteve transatlantike, sfidë e vitit për BE-në

Më ardhjen e Trumpit për herë të dytë në Shtëpinë e Bardhë dhe qasjen e tij të re Evropa u gjet në situatën më të vështirë në histori, në atë në të cilën më nuk mund të llogarisë se aleanca me Amerikën është e vetëgarantuar

Augustin Palokaj

Ishte ky një vit jo aq i lehtë për Bashkimin Evropian, për NATO-n dhe Evropën në tërësi. Në vitin e parë të mandatit të plotë të udhëheqësve të rinj në krye të BE-së dhe të NATO-s, këto institucione u përballën me shumë sfida, disa prej të cilave edhe ekzistenciale. Nuk ishte vetëm vazhdimi i luftës në Ukrainë, për të cilën Evropa vazhdon ta paguajë çmimin më të madh, as konflikti në rripin e Gazës, ku BE-ja nuk kishte ndonjë ndikim, sfidat kryesore. Ajo që vuri në test si kurrë më parë BE-në ishte kthimi i Donald Trumpit në Shtëpinë e Bardhë. Edhe pse në BE dukej se tashmë ishin më të përgatitur për paparashikueshmërinë e Trumpit sesa që ishte në vitin 2016, megjithatë doli të mos jetë ashtu.

Më ardhjen e Trumpit për herë të dytë në Shtëpinë e Bardhë dhe qasjen e tij të re Evropa u gjet në situatën më të vështirë në histori, në atë në të cilën më nuk mund të llogarisë se aleanca me Amerikën është e vetëgarantuar.

Administrata e Trumpit ia ndali ndihmën Ukrainës, duke kritikuar administratën e deriatëhershme të Bidenit se ishin “naivë”. Kështu ajo që tash quhet “ndihmë amerikane”, në fakt është vetëm shitje e armëve që nga SHBA-ja shkojnë në Ukrainë e për ato paguajnë evropianët. Edhe kjo është e domosdoshme duke pasur parasysh superioritetin e armatimit amerikan.

Nga ana tjetër, Trump nisi mandatin me kërcënime ndaj disa aleatëve evropianë se do t’ua okupojë territorin, duke thënë se SHBA-ja në njërin apo tjetrin mënyrë do të marrë Grenlandën, sepse i duhet. E ai është territor i Danimarkës, vend i BE-së dhe aleat në NATO. Pastaj kërcënoi BE-në me masa ndëshkuese tarifore, dhe bashkëpunëtorët e tij të ngushtë e

sulmuan BE-në duke e quajtur si “të paaftë” e madje edhe si një “diktaturë që censuron lirinë e shprehjes”. Dhe Trump në fillim të mandatit vuri në dyshim edhe përkushtimin amerikan ndaj NATO-s.

Të gjitha këto sfida u tejkaluan disi, por lanë shumë plagë, për shërimin e të cilave do të duhet të kalojë shumë kohë. Në samitin e NATO-s në Hagë të Holandës, nën presionin amerikan, vendet anëtare u pajtuan që të rrisin investimet në mbrojtje në nivel të 5 për qind të Bruto Prodhimit Vendor. Kjo është një rritje dramatike duke marrë parasysh se disa vende anëtare të Aleancës nuk e kanë respektuar as vendimin e para 10 vjetësh për shpenzime prej 2 për qind për mbrojtje. Fakti mbetet se dallimi në fuqinë ushtarake mes SHBA-së dhe aleatëve evropianë në NATO është tepër i madh. Mbi 80 për qind e gjithë fuqisë së NATO-s është amerikane, ndërsa vendet e BE-së nuk përmbushin as 20 për qind të fuqisë së përbashkët pasi vende anëtare janë edhe Kanadaja, Britania e Madhe, Turqia dhe Norvegjia, që japin një kontribut domethënës. Prandaj evropianët u pajtuan se duhet të investojnë më shumë për mbrojtje dhe se nuk mund të varen vetëm nga garancitë kolektive të sigurisë, të cilat përmes NATO-s në fakt i ofron Amerika. Trump natyrisht këtë e paraqiti si fitore të tij.

Një marrëveshje tjetër me të cilën u evitua lufta tregtare mes BE-së dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës ishte marrëveshja të cilën e arritën presidenti Trump dhe presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Me këtë marrëveshje SHBA-ja vendosi vetëm tarifa të kufizuara ndaj prodhimeve nga BE-ja, ndërsa BE-ja hoqi pengesat për disa prodhime amerikane. Por edhe kjo marrëveshje la shumë paqartësi, të cilat akoma nuk janë zbardhur në tërësi.

Administrata amerikane la jashtë loje BE-në edhe në negociatat për të arritur paqen në Ukrainë. Këto negociata po i bën administrata amerikane ndaras me Rusinë dhe Ukrainën, ndërsa pala ukrainase njoftoi BE-në dhe partnerët e tjerë evropianë. Kështu BE-ja vazhdon në skenën globale të jetë më shumë paguese sesa aktore apo si thuhet në anglisht “payer not e player”. BE-ja mbetet superfuqi financiar, ekonomike dhe tregtare, por këtë fuqi nuk po arrin ta shndërrojë në një front më të madh politik në skenën globale.

Në samitin e fundit BE-ja u desh të merret vesh për të garantuar për një kredi prej 90 miliardë eurosh për Ukrainën për t’i mundësuar atij shteti funksionimin në dy vjetët e ardhshëm. Në njërin anë ky ishte një sukses, sepse BE-ja dëshmoi se është serioze kur thotë se do të ndihmojë Ukrainën aq sa do të jetë e nevojshme. Por në anën tjetër dëshmoi po ashtu se ka vende të cilat nuk duan më ta ndihmojnë Ukrainën. Hungaria, Çekia dhe Sllovakia nuk deshën të jenë pjesë e këtij vendimi. Kjo dëshmon ndasitë brenda Bashkimit Evropian në një çështje aq të rëndësishme sa është lufta në Ukrainë. Për më tepër kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, deklaroi se ai “nuk e di se përse ka nisur lufta në Ukrainë”, pavarësisht faktit se Rusia ka sulmuar Ukrainën. Nuk është e lehtë për BE-në kur brenda saj ka hiq më pak se tri vende anëtare të cilat nga të tjerët konsiderohen si “Kal Troje të Putinit”. Sidomos pasi në politikën e jashtme vendoset me konsensusin e të gjitha vendeve anëtare. Dhe ky është problemi kryesor pse BE-ja nuk mund të ketë qëndrime më të qarta në politikën e saj të jashtme. Kjo rëndon edhe më shumë imazhin e saj në botë.

Në përgjithësi raportet me administratën e Trumpit mbeten të paparashikueshme për BE-në dhe me

këtë edhe sfida në këto raporte për tre vjetët e ardhshëm sa Trump do të jetë president amerikan. Deri atëherë nuk do të jetë më e qartë se cilat janë dhe a ka më vlera të përbashkëta.

Në aspektin e brendshëm Bashkimi Evropian u përball edhe me dy sfida. E para ishte nisja e negociatave për buxhetin shumëvjeçar të BE-së dhe e dyta afëra e korrupsionit në të cilën u përfshinë ish-përfaqësuesja e lartë për politikë të jashtme dhe siguri, Federika Mogherini, dhe drejtori në Drejtorinë e përgjithshme, Stefano Sanino, i cili është veteran i stafit të lartë në Komisionin Evropian. Ata dyshohen se kanë manipuluar një tender për selinë e akademisë diplomatike të Bashkimit Evropian. Kjo aferë, edhe pse përsëritet, parimi se ata janë “të pafajshëm derisa nuk dëshmohet fajësia”, ka dëmtuar edhe më shumë imazhin e institucioneve të Bashkimit Evropian.

Bisedimet për Kornizën shumëvjeçare financiare të BE-së do të jenë shumë të vështira, sepse dallimet mes vendeve anëtare janë të thella. Komisioni Evropian ka propozuar një kornizë shtatëvjeçare financiare për periudhën prej vitit 2028 deri në vitin 2034 në vlerë prej më shumë se 2000 miliardë eurosh. Për vendet që paguajnë më shumë e marrin më pak nga buxheti i BE-së, kjo shumë është “tepër e lartë dhe e paarsyeshme”, ndërsa për vendet që më shumë përfitojnë nga ky buxhet është tepër e vogël. Për institucionet e BE-së ky propozim është ose tepër i vogël, ose shumë i kufizuar për të realizuar prioritetet politike që BE-ja i ka parashikuar për të ardhmen. Bisedimet mes vendeve anëtare do të jenë aq të vështira saqë pakkush beson se negociatat do të mund të përfundojnë deri në fund të vitit që vjen. Pikërisht këto negociata do të jenë sfida më e madhe e Bashkimit Evropian edhe për vitin e ri 2026.

Në vitin 2025, BE-ja ka pasur edhe disa suksese dhe rezultate konkrete. Ka ruajtur, sado simbolik të ketë qenë, stabilitetin ekonomik. Ka zvogëluar dukshëm importin e naftës dhe gazit nga Rusia dhe ka miratuar vendimin që deri në fillim të vitit 2027 të përfundojë tërësisht importin e këtyre derivateve nga Rusia. Investimet në energji janë rritur, është rritur prodhimi i energjisë nga burimet e ripërtërishe dhe janë miratuar vendimet për investime të mëdha në të ardhmen në rritjen e kapaciteteve të shpërndarjes së rrymës në Evropë. Pa dyshim, BE-ja ka mbetur kampion në investime në ruajtjen e mjedisit edhe pse tash e ka në anën e kundërt administratën amerikane, e cila, duke ndjekur qëndrimet e presidentit Trump, nuk beson fare në ngrohjen globale dhe vendimet për ruajtjen e ambientit i konsideron si “mashtime” dhe të rrezikshme për zhvillimin ekonomik.

BE-ja në vitin 2025 pretendoi se ka arritur sukses të jashtëzakonshëm në procesin e zgjerimit. Por vetëm dy nga dhjetë shtete të përfshira në procesin e zgjerimit kanë arritur progres. Shqipëria ka hapur të gjithë kapitujt në procesin negociator për vetëm një vit pasi ka pritur disa vite. Mali i Zi ka mbyllur disa kapituj dhe i është afruar përmbylljes së negociatave, prandaj edhe realisht konsiderohet si një vend i cili në një afat trevjeçar apo së paku deri në fund të vitit 2029 të bëhet anëtar i BE-së. Të gjitha vendet e tjera kanë ngecur, madje Serbia e Gjeorgjia kanë pasur kthim prapa.

Në të gjitha këto tundime me të cilat përballlet BE-ja, pozitive duket fakti se shumica e madhe e qytetarëve të vendeve anëtare sipas anketave besojnë në BE-në dhe e shohin anëtarësinë e vendeve të tyre si një gjë pozitive. Mbi këtë BE-ja do të tentojë të punojë në vitin e ri 2026 për të forcuar edhe funksionalitetin e saj të brendshëm, edhe pozitën e saj në botë.

VITI 2026

OPINION

Një barsoletë për realitetin kosovar dhe realiteti izraelit që ngjan si barsoletë

Rrëfimi për jetën mesatare në Kosovë, për shkretëtirën e kthyer në tokë bujqësore, për lypësen me ‘pos” të bankës dhe për biftekun e përgatitur me printer



Visar Loci

Mes shumë premtimesh e rrenash, lëvdatash e statistikash në fushatën që sapo mbaroi, një prej tyre ironikisht mund të jetë e vërtetë.

Ministri në detyrë, Murati, në fillim të dhjetorit tha se familjet kosovare po e mbyllin 2025-tën me gati 5 miliardë euro depozita në banka. Nuk foli se sa persona i kanë gjithë ato para, kush ka kursyer, nëse këto kurtime janë sjellë nga jashtë, mos veç ndonjë person a dy të vetëm e kanë gjysmën apo si është puna.

Në këtë amull, shpëtim është mesatarja. Nëse ky 5-miliardësh pjesëtohet me numrin e popullatës, del se secili person, edhe fëmijët, të kenë nga 3000 euro në llogari. Jo keq për një familje 4-anëtarëshe – 12 mijë euro kursime.

Nëse është e vërtetë ose nëse të paktën kështu do të ishte shpërndarja, kjo do të përbente sinjal të mirë se klasa e mesme, ajo që e mban një shoqëri gjallë, është e fortë dhe stabile.

Por shporta e përditshme, inflacioni e kriza politike e tregojnë krejt të kundërtën.

Të kundërtën e kësaj mesatareje të artë prej 3000 eurosh kursime për secilin person, e tha edhe vetë ministri pak ditë më vonë. Njoftoi se mbi 90 mijë familje të cenueshme gjatë dhjetorit kanë përfituar subvencionim të faturave të energjisë.

Çka i bie kjo?

Nëse në rastin e parë më kursime nxorëm mesatare, e njëjta logjikë shkon edhe tash. Mbi 90 mijë familje nga 4 anëtarë, mesatarisht i bie minimumi 360.000 persona janë të cenueshëm. Janë gati çereku i popullsisë, sipas regjistrimit të fundit. Pra ka shumë të varfër; pastaj ajo që do të duhej të ishte shumica – shtresa e mesme po varfërohet.

Në gjithë këtë mashttrim me shifra, kam dëgjuar edhe një barsoletë në një vend fqinj, ku një pensionist shpërthen duke dëgjuar për pensionin

mesatar që ka shkuar gati në 1000 euro.

Kështu e thotë plakur: “Ja, unë i kam 80 vjet dhe nipi im i ka 10. Vitet tona së bashku bëjnë 90. Nëse e nxjerrim mesatare, del se të dy jemi 45-vjeçar. Nuk është keq apo jo? Por e vërteta është se as unë si 80-vjeçar e as nipi im 10-vjeçar nuk jemi aktiv në shtrat!”.

Pak a shumë, kjo është shtresa mesatare në Kosovë, e pafuqishme për të diktuar ndonjë politikë apo për të ndryshuar ndonjë situatë.

E nëse ky realitet në Kosovë shpjegohet më së miri me barsoletë, atëherë dua të ndaj edhe përshtypjet nga një vizitë në Izrael së fundmi, e që realiteti atje mund të duket si barsoletë për ne, ose për disa.

Izraeli është i ngritur mbi shkretëtirë, por shifrat flasin se po kthehet në gjigant të prodhimit bujqësor.

Gjithë shkretëtirën e ka kthyer në tokë pjellore (diçka që neve në Kosovë na ka falë Zoti, veç duhet ta punojmë), ka shpikur sistemin e ujitjes pikë-pikë për vete e për botën (neve shpesh na ka shërbyer ky sistem i ujitjes për të vjedhur subvencione nga Ministra e Bujqësisë) dhe kultivon pa fund, gjithçka.

Shembujt se gjithçka mund të bëjë dora e njeriut janë të shumtë.

Në veri, Izraeli ndan kufirin me Libanin me një mur të lart e gjarpëror. Dhe nga kodra deri ku mund të shkohej si civil, shihet ara e lëvruar dhe e mbjell fiks deri te muri në kufi. Pra që asnjë pëllëmbë tokë të mos shkojë dëm.

Njëjtë ishte edhe në kufi me Gazën në jug të vendit, e për arat skaj rrugës as që ia vlen të flitet. Gjithkund, pafund sera, të mbjella në një tokë të përfituar nga shkretëtira.

Në ditën e parë të vizitës, bashkë me disa kolegë gazetarë nga Kosova e Shqipëria, u vendosëm në Jerusalem. I madh, rrugës për t'u bërë metropol dhe i gjithi i veshur me gurë. Asnjë ndërtesë nuk bën dallim, fasada është e njëjtë.

Nëse shkon në Jerusalem dhe nuk viziton vendet e shenjta, s'ke bërë asgjë. Para se të futemi në kompleksin ku janë Kupola e Shkëmbit (Dome of the rock) dhe xhamia Al-Aqsa, që konsiderohet vendi i tretë më i shenjtë për besimtarët myslimanë pas Mekës e Medinës, organizatorët e turrit kërkojnë kujdes.

Njëlloj si marrëdhëniet mes popujve në këtë vend, edhe siguria brenda kompleksit Haram al-Sharif, është e komplikuar. Në hyrje dhe rojet janë izraelite e brenda kompleksit ku-jdestaria është e Jordanisë.

Hyrja në xhaminë Al-Aqsa nuk lejohet për gjithkënd. Veç për meshkuj myslimanë. Të huajt, si ne që ishim, duhet të dëshmonin se janë myslimanë përmes ndonjë duaje apo ndonjë sure Kurani.

Pak metra tutje është Muri i Lotëve, vendi më i shenjtë për hebrejtë e pak minuta ecje edhe Kisha e Varrit të Shenjtë, ku sipas besimit të krishterë, u kryqëzua, u varros dhe u ringjall Krishti.

Në mbrëmje, në dalje të një restoranti na pret një lypësë. Me thirrjen “sadaka”, ajo ofron një tas plastike për metelik e në dorën tjetër ‘posin’ e bankës. Nëse s'ke para, mund të japësh sadaka edhe me kartelë bankare. Zgjidhje që në Kosovë nuk e gjen as në shumë markete.

Të nesërmen mbërrim në muzeun e Holokaustit “Yad Vashem”. I madh sa, nëse shkon në orët e pasdites nuk arrin ta shëtitësh e ta shikosh të tërën. I ngritur në rreth 450,000 m² është kompleks që përfshin muze, memoriale, qendra kërkimore dhe arkiva. Në oborrin e tij, haset edhe një falënderim për Shqipërinë, për mbrojtjen e hebrejve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Ndryshe prej Jerusalemit shumë fetar ku edhe fëmijët mbajnë “Kipa” (kapelë), sa për shkak të fesë aq edhe për shkak të identitetit, Tel-Avivi është rrëfim tjetër. Është prej qendrave më mikpritëse për komunitetin LGBTQ+, me plazh mahnitës, ndërtesa të mëdha e jetë nate. Natyrisht, për t'u dehur është “pak problem”. Një Vodka-Schweppes apo një Gin-Tonic kushton mbi 20 euro.

Mes shumë veprave, Tel-Avivi e Izraeli krenohen edhe me qendrën e inovacionit “Shimon Peres”.

Aty shfaqet çdo e zbulim izraelit ndër vite, dhjetëra inovacione që pritet të ndryshojnë botën e ndër të tjera, ciceronia me mburrje thotë se “së shpejti do të hani biftek nga printeri”.

Në Kosovë, klasa e varfër dhe ajo e mesme e varfëruar e ka të vështirë ta qerasë veten me biftek të vërtetë viçi, por ndoshta atë të printerit do ta ketë më të kapshëm.

Një dolli për më pak budallaki

Për Babadimirin që nuk ka më famë. Dhe, për gazetarin që do absurditet, për politikanin që gafat e kthejnë në fenomen, për stomatologun e gjashtësheve që klient ka VIP-at, dhe për berberin e rapsodin që bëhen yje me budallallëk



Besnik Krasniqi

Babadimir zbriti nga mali në qytet pas pesë vjetësh mungesë, pak para se dritat festive ta mbulojnë sheshin me shkëlqim. Borë ende nuk ka rënë, por fryma e ftohtë ia shpon faqet. Me njërin dorë mban thesin e kuq, të rëndë, përplot dhurata e sende të moçme të tij, e me tjetrën shkund kambanat që dikur mjaftonin për t'i mbledhur fëmijët rreth tij. Kambanat tingëllonin, por askush nuk i dëgjon më. Askush nuk kthen kokën nga ai.

Njerëzit kalojnë pranë pa e parë, kryesisht me sytë e ngulur në ekranet e celularëve që u ndriçojnë fytyrat me dritën e ftohtë blu. Gishtat u rrëshqasin me shpejtësi, sikur të jenë të komanduar nga një instinkt i ri.

Babadimir u ndal në mes të sheshit, mbi kalldrëmin e ftohtë, pikërisht aty ku dikur fëmijët vraponin drejt tij, i kapeshin për rroba, i numëronin dhuratat dhe i kërkonin edhe një fotografi.

Në një cep të sheshit, pak metra larg, një gazetar, me fytyrën që i shndriste nga entuziazmi profesional, mbante mikrofonin përballë një burri me rroba të përlyera, me flokë të shprishura, me mjekër edhe më të gjatë se të Babadimitrit dhe me sy zgurdulluar që digjnin nga zjarri i brendshëm. Burri fliste pa pushim. Herë sikur është Krishti, i moçëm 2026 vjet, herë si shkencëtar që ka zbuluar sekretet e universit, herë si president i Shteteve të Bashkuara. Ishte një nga ata të hutuarit të pastrehë, që bredhte poshtë e lartë sheshit, ndërsa bota e tij dhe realiteti nuk përputheshin prej kohësh.

Gazetari nuk e ndërpreu. Nuk i kërkonte sqarim. Nuk ia kërkonte as të vërtetën. Kërkonte sa më shumë absurditet. Sa më shumë çmenduri që mund të paketohej në pak sekonda videoje. Sepse, vetëm këto do ta kallnin rrjetin.

E, fjalët e burrit që po intervistohet, ishin bombë për tituj, ndërsa secila fjali përmbante potencial për të ndezur në rrjetet sociale.

Babadimir qëndroi pak më tutje, me thesin ende në shpinë, dhe ndjeu therje të ftohtë nga kuptimi që po i zbriste ngadalë. Brenda pesë vjetësh, pa e vizituar qytetin, gjithçka kishte ndërruar. Vëmendje më ai nuk merr. As dhuratat brenda thesit. Tani njerëzit kërkojnë diçka tjetër.

Ai vazhdoi rrugën, i hutuar, duke menduar se mos moshë e ka lënë pas kohës.

E për ta hequr dilemën, iu afrua një lokali ngjitur sheshit. Aroma e kafesë së freskët i doli përpara si ftesë e vjetër, nga ato që dikur i njihje mirë. U ndal pranë dritares. Brenda, disa të rinj rreth tavolinës, me filxhanët e kafesë anash e telefonat në qendër, si altarë të vegjël modernë. Gishtat u lëvizin shpejt, ndërsa fytyrat u ndizen herë nga e qeshura, herë nga habia, herë nga një lloj adhurimi i çuditshëm.

Babadimir nuk kishte nevojë të pyeste. Fjalët u dilnin vetë, të zhurmshe, të ngazëllëra, sepse po flisnin për heronj të një kohe të re.

Njëri prej tyre po tregonte videon e saposhpërndarë e me mijëra views. Në të kryepersonazh ishte kryetari i një komune të vogël, por tashmë i famshëm në të gjithë vendin, shkaku se bënte show në studio televizive. Fliste me gjuhë rruge, lëshonte ndonjë fjalë që shpërthente si bombë e bënte gafa sa herë përmendte emra, premtime apo synonte të tregonte diçka. Të tjerët qeshnin me të si me arushën. Ama jo me përbuzje, por me admirim.

Ky është fenomen, flisin me entuziazëm të rinjtë në kafene. S'e kishin fjalën për ndonjë shenjë në qeverisje, por për gafat që i ktheheshin në meme. Dhe, sa më shumë gabonte, aq më shumë e ftonin në televizione. Edhe njerëzit e ndalnin në rrugë për selfie, kurse fotografitë me të shpërndaheshin kudo. Pra, për të qenë pranë famës.

Babadimir ndjeu se thesi i tij tani rëndon mbi supe si peshë e panevojshme, në një botë ku vlera nuk matet më as nga dashuria, as nga puna apo përkushtimi, por nga klikimet, shpërndarjet dhe videot virale.

Një tjetër video u hap mbi tavolinë. Një yll botëror futbollit po ulej në karigën e ordinancës dentare që ndodhet në qytet. Pak më vonë, shfaqet tek buzëqesh me dhëmbët që i shkëlqejnë nga bardhësia. Në videon e radhës, një yll muzike. Në një tjetër, një tjetër VIP.. Ordinanca e vogël, dikur e zakonshme, ka marrë famë me videot në TikTok, Instagram dhe Facebook. Në to shfaqet edhe vetë stomatologu, zakonisht i heshtur dhe i qetë. Ai kishte qenë student i 6-sheve. Shokët e gjeneratës më shumë e kujtojnë si njeri që binte në sy për kohën e gjatë që e kalonte në kafenenë pranë fakultetit. Por, formulën e suksesit e gjeti te videot me yjet, që i shkonin flakë në rrjetet sociale, e me të cilat ushqente iluzionin te njerëzit e rëndomtë se mjaftonte t'i rregulloje dhëmbët aty për t'u ndier, qoftë edhe për pak çaste, si VIP.

Pak më vonë, një tjetër video u shfaq në një nga telefonat në tavolinën e rrethuar me të rinjtë në kafene. Këtë herë në fokus është karigëria e berberit. Aty nuk demonstrohet shkathtësi në prerjen e flokëve dhe as nuk ekspozohen modele prerjesh, por budallallëqet të berberit me klientë, që të xhiruara shpërthojnë në rrjet.

Mes zhurmës së videove që ndërrohen njëra pas tjetrës, në një nga celularët u shfaq edhe një rapsod. Për një çast, Babadimir u ndal. Iu duk se, më në fund, diçka e vjetër po gjen vend në këtë qytet e te këta të rinj në kafene. Se kënga rapsodike e kujtesa po mbahen gjallë. Të rinjtë u përkulën më afër ekraneve. Por, entuziazmi i Babadimitrit u shua shpejt. Nuk ishin vargjet, as kënga dhe as zëri që nxitën kureshtjen e të rinjve. Ishte momenti kur rapsodi, në kulmin e performancës, po ngrihej në dy gjunjë dhe po e thyen çiftelinë.

Babadimir uli shikimin dhe ndjeu boshllëkun që i kaloi rufe trupit. Shtrëngoi thesin e kuq, tashmë të rëndë nga dhuratat që askush nuk i kërkoj, dhe nisi të largohet me hapa të ngadalë sheshit të kalldrëmtë. Kambanat nuk i shkund më.

Ishte e qartë: Sot budallallëku mban kurorën e famës.

Kur la qytetin, Babadimir hapi thesin, nxori një gotë dhe e mbushi me verë, ktheu kokën pas dhe pëshpëriti me vete: “Një dolli, për më pak budallaki në 2026-n!”.



Në tetor të këtij viti në sheshin “Zahir Pajaziti”, në Prishtinë është mbajtur edicioni i tretë i Festivalit dhe Panairit të Librit për Fëmijë. Në festival, përveç prezantimit të librave të ndryshëm për fëmijë nga botuesit pjesëmarrës, janë mbajtur edhe punëtori, lexime të hapura, përrurime librash, aktivitete shkencore dhe lojëra kreative

KOLUMNË

Pse s’jemi si ata

Rekordi i Belgjikës pa qeveri funksionale për plot 541 ditë dhe rasti i Kosovës e kanë një ngjashmëri rastësore, por dallim të madh në substancë. Te njëra kriza mbeti veç e politikës, te tjetra u normalizua në kurriz të qytetarit



Nita Lleshi

Dikur kur i hapja dhe i mbyllja sytë përnatë me lajmet që e përshkonin botën – të cilën, si rubrikë, ne të ekipit të dikurshëm të gazetës e quanim “dynja” – pati ndodhur një vaki që rroku vëmendje ngado. Detajet u mundova që, ndër vite, të mos i arkivoj në mendje. Nejse, s’është se u mundova fort. E bëri të veten mosha. Por një tjetër vaki që u reprizua kush e di se sa herë këtë vit ma kristalizoi atë më të mocmen.

Qe 13 qershori i 2010-s. Qytetarë belgë që nga mëngjesi i asaj të diele fillimverë dolën para kutive të votimit për ta zgjedhur kastën që do ta udhëhiqte në vitet pasuese. Por rezultatit nuk qe konkret. Asnjëra parti nuk e mori shumicën.

Për pasojë, u bë i nevojshëm një koalicion i gjerë mes subjekteve të nuancave të ndryshme politike, gjuhësore e institucionale. Kompromisi doli të jetë i vështirë. Nuk u arrit për plot pesëqind e dyzet e një ditë. Krejt deri më 5 dhjetor të 2011-s. Kur, pas përplasjes e akuzash të ndërsjella të njerëzve të politikës, mbreti shpalli përbërjen e kabinetit qeverisës e kryeministrin e ri, dhe i dha fund paqartësisë së mbi një viti e gjysmë. Gjatë së cilës, as edhe për një ditë të vetme administrata nuk pushoi së funksionuari. Shërbimet publike nuk u ndalën. Ekonomia nuk u shemb. Shtyllat e shtetit nuk i lëkundën pazaret ditore të politikës. Shteti nuk u trajtua si pronë partish. Dhe kriza mbeti veç e politikës. S’e preku qytetarin.

Nja treqind e njëzet e kusur ditë (deri në momentin e shkrimit të kësaj kolumne) pa institucione funksionale i kaloi edhe Kosova që 2025-shin e nisi dhe e përmbylli me zgjedhje. Ato të parat, që u mbajtën më 9 shkurt, as këtu nuk e dhanë një fitues me shumicë komode. Pasoi krizë e inateve dhe e pazareve kryekëput të politikës. Ama ndryshe prej asaj të Belgjikës, kjo e Kosovës e preku secilën pore - nga qeverisja tek administrata, nga ekonomia e natyrshëm te xhepi i qytetarit, të cilit për pasojë ia lëkundti besimin te politika. Për këtë, arsye pati me bollëk.

Konstituimi i Kuvendit për muaj të tërë u mbajt peng i mungesës së konsensusit. Ata që i morën mandatet për t’ia dhënë qytetarit institucionet nxorën tyrlifarë tekesh... Janë apo s’janë legjitimë ligjvënësit e zgjedhur, munden apo s’munden t’i mbajnë njëkohësisht edhe postet ministrore, e edhe ato të deputetit. Bën apo s’bën ky a ai emër për kryetar Parlamentit. E çka jo tjetër... bllokadë, bojkot. E edhe pauza të imponuara. Në pritje të vendimeve që do t’i nxjerrë Gjykata Kushtetuese për t’i zgjidhur “enigmat” që dolën rrugës, e të cilave instanca të tjera s’u jepnin përgjigje.

Diku midis krejt këtyre e një seance konstituive prej vazhdimesh maratoni, një bllokadë u kapërcye. Kryeparlamentari më në fund u zgjodh, por kriza e politikës u lidh edhe më një. Lëmshi kësaj radhe u ngatërrua te nënkryetarët. Ai nga radhët e komunitetit serb nuk u zgjodh, pasi për të procedura e votimit u veçua prej asaj të nënkryetarit tjetër të komuniteteve joshumicë. Kryetari i ri i Kuvendit e shpalli seancën konstituive të mbyllur. Por saga vazhdoi. Çështja i shkoi prapë në derë Kushtetueses, që konstatoi se Kuvendi s’mund të konsiderohet i konstituuar pa u shterur të gjitha mundësitë për zgjedhjen e nënkryetarit.

Përbërja e legjislaturës së nëntë edhe u mbajt disi pas kësaj. Jo gjatë.

Presidentja e shpërndau Kuvendin, pasi përpjekjet e disahershme pasuese të partisë fituese për ta formuar qeverinë e re përfunduan secilën herë me dështim. Në fund, qytetarët dolën sërish në zgjedhje – të katërtat, pas atyre nacionale të fillimshkurtit e dy të tjerave për qeverisjet lokale.

Edhe këtë herë i zgjodhën udhëheqësit e rinj nga mesi i (në të shumtën e rasteve) atyre që morën paga e mëditje mijëra euroshe nga Kuvendi, pa e kryer as edhe një punë. Pa e marrë asnjë vendim në të mirë të qytetarit, që ndërkohë u varfërua me rritjen e çmimeve të rrymës, të ngrohjes, të produkteve ushqimore bazë...

Rekordi i Belgjikës pa qeveri funksionale dhe rasti i Kosovës jam e vetëdijshme që nuk krahasohen. As për nga përmasa, as historia e as pesha. Sepse dallojnë në substancë.

Derisa në Belgjikë kriza u menaxhua si problem i taborëve politikë, në Kosovë u shndërrua në barrë të qytetarit. Të cilit krizat iu shndërruan në normale. Sharjet e polemikat prej gjithfarë soji në sallë Kuvendi e nga mos tjetër, në përditshmëri. Zgjedhjet në procedura të mësuara përmendsh. Rezultatet në pritje për një fund. Atij që do të prodhojë dikur institucione të cilat do ta vënë atë në qendër.

Në këtë pritje të zgjatur e që mori ngjyrim të banales, u shpenzua jo veç një vit kalendarik, por edhe kapitali i durimit. Ngase kur krizat normalizohen, shteti pushon së qeni garanci. Shndërrohet në shpresë të largët. E qytetari mbetet veç numër.

Që ai të mos e paguajë krejt çmimin, krizat e politikës duhen mbajtur përbrenda mureve ku prodhohen.

Gëzuar për një vit në të cilin kriza pushon së qeni gjendje normale dhe qytetari vihet në qendër - jo si justifikim, por si përgjegjësi.

Kur mungon alternativa, fiton pushteti

Fitorja me gati 50 për qind e Lëvizjes Vetëvendosje mund të konsiderohet se ishte befasuese në shifra, por jo assesi në thelb. Kur ish-opozita dështon të ofrojë vizion, program dhe unitet, votuesi nuk ka shumë dilema. Në këto rrethana, vota për pushtetin bëhet më shumë një refuzim i kaosit sesa një miratim i qeverisjes



Driton Mehmeti

Zgjedhjet e 28 dhjetorit nuk ishin vetëm një test për Qeverinë Kurti, por mbi të gjitha një pasqyrë e zymtë e opozitës kosovare. Rezultati i tyre nuk duhet lexuar si entuziazëm i jashtëzakonshëm për qeverisjen aktuale, por si dështim i plotë për të ndërtuar një alternativë politike të besueshme.

Qëndrimi i LDK-së, nën udhëheqjen e Lumir Abdixhikut, për të refuzuar çdo bashkëpunim pas zgjedhjeve të 9 shkurtit – qoftë me fituesin e zgjedhjeve apo me partitë e tjera opozitare – u perceptua nga qytetarët si kokëfortësi e pakuptimtë. Ky refuzim nuk u shpjegua kurrë bindshëm dhe, për pasojë, u ndëshkua në mënyrën më demokratike të mundshme: me votë. Sot, pas këtij rezultati, edhe vet pozita e Abdixhikut në krye të Lidhjes Demokratike të Kosovës është seriozisht e lëkundur.

Fitorja me gati 50 për qind e Lëvizjes Vetëvendosje mund të konsiderohet se ishte befasuese në shifra, por jo assesi në thelb. Kur ish-opozita dështon të ofrojë vizion, program dhe unitet, votuesi nuk ka shumë dilema.

Në këto rrethana, vota për pushtetin bëhet më shumë një refuzim i kaosit sesa një miratim i qeverisjes.

Një rol të rëndësishëm në këtë epilog e pati diaspora. Mobilizimi i saj masiv në fund vit dhe përkrahja e qartë për Lëvizjen Vetëvendosje treguan se mërgata mbetet një faktor i fuqishëm elektoral në Kosovë. Frika e ish-opozitës nga ky mobilizim ishte e dukshme qysh në kundërshtimin për datën e zgjedhjeve, por frika nuk zëvendëson strategjinë politike.

Partitë ish-opozitare, siç duket, u ndëshkuan edhe për faktin se, ndonëse kishte mundësi reale për ta krijuar shumicën parlamentare, nuk arriti të koordinohej mes vete. Kjo i dha sërish shansin partisë së Albin Kurtit që të fitojë bindshëm dhe të formojë Qeverinë vetëm me votat e partive joserbe, duke siguruar edhe një mandat të ri katërvjeçar.

Opozita pagoi çmim edhe për sjelljen e saj bllokuese në Kuvend. Refuzimi për të votuar marrëveshje ndërkombëtare, buxhetin për Komunën e Prishtinës me të cilin udhëheq vetë Lidhja Demokratike e Kosovës, atë të Gjilanit dhe Zubin Potokut si dhe zgjidhjen e financimit për Televizionit Publik me sa duket u lexua nga qytetarët jo si qëndrim parimor, por si pengesë për funksionimin e shtetit. Në një vend me institucione ende të brishta siç është Kosova, kjo qasje mund të themi lirisht se u vërtetua që është politikisht vetëvrasëse.

Paradoksi më i madh i këtyre zgjedhjeve qëndron në faktin se Qeveria Kurti fitoi bindshëm, pavarësisht kritikave të forta për dështime në arsim, shëndetësi dhe sidomos në ekonomi, si dhe akuzave të shumta që pati për korrupsion e nepotizëm. Kjo tregon se votuesi kosovar shpesh nuk voton për performancën, por kundër pasigurisë politike dhe mungesës së alternativës.

Viti 2025 do të mbahet mend si viti i zgjedhjeve. Katër herë qytetarët i drejtuan kutive të votimit: më 9 shkurt në zgjedhjet e përgjithshme, më 12 tetor në zgjedhjet lokale, më 9 nëntor në balotazhin e zgjedhjeve lokale si dhe më 28 dhjetor në zgjedhjet e parakohshme dhe këto katër herë dhanë një mesazh se në nivel lokal mund të eksperimentohet, por pushtetin qendror qytetari nuk ia beson kujtdo, rëndësi të madhe këtu ka Lideri.

Megjithatë, një vijë e përbashkët i lidh të gjitha këto zgjedhje: përkundër kritikave dhe pakënaqësive, votuesi shpesh zgjedh vazhdimësinë përballë pasigurisë politike.

Për shembull: Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, dhe ai i Gjilanit, Alban Hyseni, ndonëse të kritikuar për mosrealizimin e një pjese të madhe të premtimeve të tyre, arritën të fitonin mandatet e dyta.

Mesazhi i këtyre zgjedhjeve mund të them lirisht se është i thjeshtë: sipas mendimit tim në Kosovë, pushteti nuk humb sepse dështon, por vetëm nëse përballë tij del dikush më i mirë.



Organizatat e shoqërisë civile, në qershor të 2025-tës kanë zhvilluar një aksion simbolik para ndërtesës së Kuvendit, me moton “Shteti në pauzë”. Ata mbajtën pankarta me mesazhe ironike si: A doni me shku në deti?”, “Deputetë, emri juaj është bllokadë”, “Karriget janë për punë, jo për pushtet”, “Cirku i Republikës së Kosovës”... Pjesëmarrësit kanë akuzuar deputetët për papërgjegjësi dhe për kthimin e parlamentit në një teatër politik. Aksioni është zhvilluar në ditën që po mbahej seanca e 37 për konstituimin e Kuvendit.

BLLOKADA POLITIKE MË SË SHUMTI U NDIE NË EKONOMI E NË RRAFSHIN DIPLOMATIK

Viti që i numërohen pasojat

Thuaje gjatë gjithë 2025-tës, Kosova qe e bllokuar politikisht dhe me disa institucione jofunksionale e të tjera me kompetenca të kufizuara. Pasojat e kësaj krize janë ndierë veçmas në ekonomi dhe në pozitën ndërkombëtare të shtetit

Valbona Bytyqi

PRISHTINË, DHJETOR – Kosovës do t'i duhet kohë për t'u rimëkëmbur nga pasojat e krizës politike që shënoi vitin 2025, vlerësojnë njohës të zhvillimeve politike.

Mungesa e vullnetit për bashkëpunim mes subjekteve politike, edhe pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, bëri që vendi të mbetet pa qeveri funksionale. Legjislatura e nëntë u konstitua shtatë muaj pas zgjedhjeve, për t'u shpërndarë vetëm 40 ditë më vonë.

Vullnet Bugačku, që është hulumtues në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), thotë se viti që lamë pas konsiderohet i dështuar në aspektin legjislativ, të mbikëqyrjes parlamentare dhe të reformave. Ai përmend mosrealizimin e vettingut, mosmiratimin e Kodit Civil e ligjet me të cilat është synuar reforma në sistemin e drejtësisë.

“Normalisht që kjo (bllokada institucionale v.j.) shkakton vonesa në implementimin e procesit të vettingut në Kosovë. Ky është një proces shumë i rëndësishëm sepse, siç e ka potencuar edhe Komisioni i Venecias, por edhe vetë Gjykata jonë Kushtetuese, Kosova ka nevojë për një proces të vettingut i cili vlerëson integritetin e krerëve të institucioneve të sistemit të drejtësisë, në atë mënyrë që të hapet rruga që të bëhet vlerësimi i performancës dhe i llogaridhënies për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë”, ka thënë ai.

Edhe Njomza Arifi, e cila e drejton Grupin për Studime Politike dhe Juridike (GLPS), ka numëruar pasojat e bllokadës në aspektin e pamundësisë për të miratuar shumë nisma legjislative.

“Përveç qeverisë me mandat të rregullt, nuk kemi as një kuvend funksional dhe shumë nisma legjislative të cilat janë bartur nga viti në vit tashmë kanë mbetur të bllokuara apo disa të tjera nuk janë nisur fare. Nisma të rëndësishme, siç është Ligji për të drejtat në punë, ligje të ndryshme që lidhen me aspektin e të drejtave shëndetësore apo shëndetësinë, shëndetin mendor, kodi civil dhe paralelisht me këto edhe kornizat strategjike të ndryshme të cilat janë hartuar, por që kanë mbetur peng i aprovimeve nga një qeveri me mandat të plotë apo të ratifikimit në një kuvend funksional siç është Strategjia kundër Korrupsionit e shumë strategji të tjera që janë thelbësore për Kosovën”, ka thënë ajo.

Ndërkaq, analisti politik Seb Bytyqi, konstatoi se dramat politike që i përjetoi Kosova përgjatë një viti, kanë pasojë edhe në fusha të ndjeshme.

“Bllokohet shtyrja e agjendave të brendshme për reforma ekonomike, për çfarëdo përpjekje që do të duhej të ekzistonte për forcimin e prodhimit vendor apo energjisë alternative, shtyrja e politikave publike të brendshme. E gjitha është suspenduar dhe kjo është më me rëndësi sesa për shembull humbja e mundësive për fondin nga BE-ja apo çështjet e ngjashme”, ka vlerësuar ai.

Listë pasojash

Pasojat e bllokadës institucionale nuk ndalen vetëm te reformat.

Hulumtuesi Bugačku ka paralajmëruar edhe bllokada në institucionet e pavarura, për shkak të skadimit të mandatit të anëtarëve të tyre, me theks të veçantë të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, meqë nuk ka kuvend funksional për t'i zëvendësuar.

“Mandati i Avokatit të Popullit ka skaduar, duhet zgjedhur një avokat i popullit i ri. Kemi dy gjyqtarë mungesë në Gjykatën Kushtetuese. Edhe këtu duhet zgjedhur gjyqtarë të ri të Gjykatës Kushtetuese. Ne rrezikojmë që edhe Gjykata



“Normalisht që kjo (bllokada institucionale v.j.) shkakton vonesa në implementimin e procesit të vettingut në Kosovë. Ky është një proces shumë i rëndësishëm sepse, siç e ka potencuar edhe Komisioni i Venecias, por edhe vetë Gjykata jonë Kushtetuese, Kosova ka nevojë për një proces të vettingut i cili vlerëson integritetin e krerëve të institucioneve të sistemit të drejtësisë, në atë mënyrë që të hapet rruga që të bëhet vlerësimi i performancës dhe i llogaridhënies për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë”, ka thënë Vullnet Bugačku, që është hulumtues në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI)

Kushtetuese të mbetet pa kuorum sepse së shpejti i skadon mandati edhe disa anëtarëve atje”, ka thënë ky hulumtues i KDI-së.

Përtej pasojave të brendshme, kriza politike në Kosovë ka reflektuar edhe jashtë kufijve.

Arifi ka konstatuar se bllokada institucionale e ka dobësuar pozicionin e vendit në një moment të ndjeshëm gjeopolitik, kur vëmendja ndërkombëtare ndaj rajonit është në rritje.

“Jostabiliteti politik në Kosovë, mungesa e një qeverie me kompetenca të plota, natyrisht që dëmton edhe imazhin ose kredibilitetin e Kosovës karshi miqve në Kosovë, por edhe në arenën ndërkombëtare. Si pasojë e kësaj krize ne jemi duke rrezikuar që të shfrytëzojmë dy momentume shumë të rëndësishme: e para është një administratë e re në SHBA dhe e dyta është një konstalacion krejt i ri i institucioneve të BE-së”, thotë drejtoresha në GLPS-së.

Sipas Arifit, kriza institucionale pengon Kosovën që të shfrytëzojë momentumin e krijuar edhe për kërkesën e saj për shqyrtimin e statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE, e në përfitim të milionave eurove nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian.

“Është vështirë të besohet se tani Kosova do të arrijë të përfitojë në tërësi shumën nga e cila në fakt Kosova përfiton më së shumti për kokë banori nga Plani i Rritjes i BE-së. Siç e dimë, jemi vonuar mjaft shumë në këtë aspekt, pikërisht si pasojë e mosratifikimit të marrëveshjeve në Kuvendin e Kosovës”, ka thënë Arifi.

E sipas Bytyqit, dramat politike që i përjetoi Kosova përgjatë një viti, kanë pasojë edhe regresin.

“Është njëfarë kthimi prapa sepse po humbet ajo perspektiva apo perceptimi që Kosova veç e ka përfunduar procesin e shtetndërtimit dhe është një shtet serioz. Kjo është një goditje e vetëshkakuar në këtë as-

pekt”, ka thënë ky analist politik.

Një nga çështjet më të ndjeshme që, sipas analistëve, rrezikohet drejtpërdrejt nga bllokada institucionale e vitit 2025 është edhe procesi i anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Në fokus të veçantë mbetet Këshilli i Evropës, anëtarësimi në të cilin konsiderohet hap kyç për konsolidimin ndërkombëtar të shtetit dhe avancimin e standardeve të të drejtave të njeriut.

“Vitin e ardhshëm potencialisht do të mund të shqyrtohet (anëtarësimi në KE) nëse në Kosovë do të arrihej një konsensus politik lidhur me këtë proces”, thotë Arifi.

E sipas Bugačku, përparimi i Kosovës drejt anëtarësimit në organizata ndërkombëtare lidhet drejtpërdrejt me miratimin e Kodit Civil, një dokument kyç që synon harmonizimin e legjislacionit vendor me standardet evropiane, por që ka mbetur i bllokuar për vite me radhë.

“Ky është një proces shumë i tejzgatur tashmë dhe Kosova ka një kohë të gjatë që po e sjell këtë dokumentin e Kodit Civil qoftë në qeveri, qoftë në parlament, si pasojë e moskonsensusit të deputetëve. Prandaj edhe nevojitet që sa më shpejt të kemi kuvend të konstituuar që ta miratojë edhe Kodin Civil në atë mënyrë që të hapet një rrugë, në atë mënyrë që Kosova të marrë një vlerësim sa i përket përmbytjes së standardeve në respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut”, ka thënë ai.

Pak shpresë

Por, nuk janë shprehur pritshmëri të larta për ndryshime të shpejta as në vitin e ri.

Njohësit e zhvillimeve politike i referohen kohës që i nevojitet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve të 28 dhjetorit, procedurave për

konstituimin e Kuvendit, zgjedhjes së Qeverisë së re, si dhe afatit kushtetues për përfundimin e mandatit të presidentes Vjosa Osmani.

Në këtë kontekst, hulumtuesi Bugačku paralajmëron se vendi rrezikon të humbasë edhe gjysmën e parë të vitit vetëm me procedura institucionale, duke mos përjashtuar mundësinë që Kosova të shkojë sërish në zgjedhje, për herë të katërt brenda një periudhe të shkurtër kohore, pas zgjedhjeve të përgjithshme të 9 shkurtit, atyre lokale të 12 tetorit dhe zgjedhjeve të parakohshme të 28 dhjetorit.

“Rrezikojmë që përsëri të përfundojmë në zgjedhje si pasojë që mbase nuk do të ketë gatishmëri dhe konsensus politik në Kuvend që të gjejnë një marrëveshje se si të zgjedhjet presidenti i ardhshëm i Kosovës. Kushtetuta e thotë qartë që duhet 30 ditë më herët të përfundohet procedura e zgjedhjes së presidentit të Kosovës, prandaj nëse nuk ka dhe nëse vazhdon kjo logjikë e funksionimit të këtyre partive politike, atëherë ne sinjersht vazhdojmë edhe vitin e ardhshëm me kësi lloj bllokadash”, ka thënë ai.

Pas muajsh të tërë bllokade institucionale dhe me rrezikun që kjo situatë të vazhdojë edhe gjatë vitit 2026, analistët paralajmërojnë se pasojat nuk do të mbeten vetëm në nivel institucional, por do të reflektohen drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve të Kosovës.

Për gjithë këta muaj bllokadë e rrezikun eventual për vazhdimin e saj edhe gjatë 2026, Bugačku thotë se pasojat do t'i vuajnë qytetarët e Kosovës “qoftë në aspektin ekonomik për shkak të rritjes së madhe të inflacionit” apo edhe për shkak të mosmbikëqyrjes parlamentare, si pasojë e së cilave “dikasteret qeveritare nuk po e luajnë tashmë rolin e tyre siç e kanë ose siç do të duhej ta kishin, sipas ligjeve në fuqi”.

Nëse pas zgjedhjeve të parakohshme të 28 dhjetorit nuk arrihet një formim i shpejtë i Qeverisë së re, pasojat, sipas analistit Bytyqi, do të jenë të menjëhershme dhe potencialisht më të rënda.

“Nëse ka pastaj probleme të tjera edhe me zgjedhjen e presidentit, me buxhetin e me themelimin e të gjitha institucioneve, atëherë pasojat veç çka do të rëndohen edhe më shumë dhe do të shihet në të gjitha aspektet por shpresoj që do të mbushin mend politikanët”, ka thënë Bytyqi.

Në anën tjetër, drejtoresha e GLPS-së, thekson pritshmëritë që ekzekutivi i ri të veprojë shpejt, veçanërisht në raport me përfaqësimin ndërkombëtar të Kosovës dhe obligimet ndaj BE-së.

“Natyrisht që pritet një kthim i menjëhershëm në tryezën e dialogut në nivel të lartë politik dhe e dyta është ratifikimi i marrëveshjes për Planin e Rritjes dhe implementimi i agjendës së reformave për të cilën jemi zotuar dhe mundësia për të përfutur nga fondet të cilat i janë dedikuar Kosovës. Kurse, brenda ka një sërë reformash të cilat kanë ngecur dhe të cilat kërkojnë vëmendje të menjëhershme e që lidhen direkt me, le të themi, këto që po quhen fundamentale të BE-së, siç janë: sundimi i ligjit, administrata publike, e një sërë reformash të tjera në shëndetësi, arsim dhe në aspekte që janë me rëndësi për ne”, ka thënë Arifi.

Në mungesë të zgjedhjes së qeverisë së re, shteti vazhdon të drejtohet nga udhëheqja aktuale, e konsoliduar afro pesë vjet më parë. Si qeveri në detyrë, ajo ka kompetenca të kufizuara, çka e ngushton hapësirën për vendimmarrje dhe e lë Kosovën në pritje të formimit të institucioneve të reja funksionale, pas zgjedhjeve që u mbajtën më 28 dhjetor.

BLLOKADA PARLAMENTARE DHE KOSTOJA E SAJ POLITIKE, EKONOMIKE DHE INSTITUCIONALE

Kokëfortësia politike që paralizoi shtetin

Nga fushata e fillimjanarit deri te zgjedhjet e reja të funddhjetorit, ngërçi institucional u kthye në temë qendrore në shtetin ku politikanët refuzuan të bëjnë kompromise politike. Në vend që zgjedhjet të hapnin një kapitull të ri institucional, ato e futën Kosovën në një cikël bllokadash që prodhuan jo pak pasoja për shtetin

Fitim Gashi

PRISHTINË, DHJETOR – Kosova përjetoi në 2025-n një prej krizave më të gjata politike e institucionale të pasluftës si rezultat i mungesës së kompromisit dhe interpretimeve të ngurta që subjektet politike i bënë normave për krijimin e institucioneve të reja. Ajo që filloi si proces i zakonshëm zgjedhor në fillim të vitit u shndërrua gradualisht në ngërç njëvjeçar, që e la shtetin pa institucione.

Pas zgjedhjeve, Kuvendi u kthye nga hapësirë zgjidhjeje në simbol të bllokadës.

Rrugëtimi nga fushata elektorale e fillimvitit e deri tek shpërndarja e Kuvendit dhe thirrja e zgjedhjeve të reja në fund të 2025-ës, pasqyroj jo vetëm krizën e numrave parlamentarë, por edhe krizën e vullnetit politik për të krijuar qeverinë e re.

Ngërçi që nisi në prill

Ngërçi institucional mori formë të qartë më 15 prill, kur u nisi seanca konstituive e Kuvendit. Që nga ajo ditë, “tempulli i demokracisë” u shndërrua në skenë bllokade me seancën më të gjatë që njeh Kosova, por në të cilën për muaj rresht nuk pati epilog.

Lëvizja Vetëvendosje (LVV), si subjekti më i madh parlamentar i dalë pas zgjedhjeve me 48 deputetë, insistoi për disa muaj në një propozim të vetëm për kryetare të Kuvendit – Albulena Haxhiu. Ky qëndrim u justifikua nga LVV-ja si e drejtë e fituar nga rezultati zgjedhor, ndërsa nga opozita u cilësua si kokëfortësi politike. Dhjetra vazhdimet e seancës nuk dhanë rezultat dhe e shndërruan Kuvendin në simbol të paralizës institucionale.

Vullneti për ndërtimin e një koalicioni qeverisës mbeti i mangët. Opozita refuzoi bashkëpunimin me kryetarin e LVV-së, Albin Kurti, duke ia përmendur faktin se pas mbylljes së kutive të votimit në mbrëmjen e 9 shkurtit atyre iu referua si “hajvanë”.

LVV-ja i drejtoi ftesë zyrtarisht për bashkëqeverisje vetëm Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), e cila e refuzoi atë, duke propozuar qeveri gjithëpërfshirëse si zgjidhje kalimtare.

Ky propozim nuk u përkrah nga LVV-ja, ndërsa hendeuku i dallimeve mes partive u thellua edhe më tej në organin ligjvënës, ku LVV-ja më pas tentoi ta ndryshojë mënyrën e votimit të kryeparlamentarit nga procedura e hapur në votim të fshehtë.

Nga 1 maji, kryesuesi Avni Dehari ndryshoi këtë formë votimi, duke anashkaluar votimin e hapur dhe duke propozuar formimin e një komisioni për mbikëqyrjen e votimit të fshehtë. Kjo u kundërshtua nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe (LS), të cilat refuzuan të propozonin anëtarë për komisionin.

Aktivizimi i Kushtetueses

Përgjatë kësaj situate, Gjykata Kushtetuese u sfidua disa herë nga partitë opozitare për të interpretuar bllokadën institucionale. Në tri aktgjykimet e saj, ajo konstatoi se zvarritja e konstituimit të Kuvendit cenonte rendin kushtetues dhe funksionimin demokratik të shtetit.

Fillimisht Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës iu drejtua Kushtetueses



Kostoja e ngërçit politik e institucional u reflektua drejtpërdrejt në jetën institucionale dhe ekonomike të vendit. Buxheti për vitin 2026 mbeti i pamiratur, duke krijuar pasiguri financiare për institucionet publike. Kosova humbi mundësinë për të përfituar në 2025-n nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian, për shkak të mosratifikimit të marrëveshjeve në Kuvend. U humbën 80 milionë euro nga totali i shumës prej mbi 800 milionë euro të zotuar nga BE-ja

për çështjen e ngërçit. Gjykata u përgjigj më 26 qershor duke thënë se votimi duhej të bëhej sipas praktikave të deriatëhershme. Ajo u dha deputetëve 30 ditë afat ta përmbyllnin procesin e konstituimit, por ky afat u shpërfill.

Më pas, PDK-ja dhe LDK-ja dorëzuan lëndë të ndara për çështjen e votimit të kryeparlamentarit. Kushtetuesja vendosi masë të përkohshme nga 27 qershori deri më 8 gusht duke ua ndaluar deputetëve që të ndërmermin vendime për konstituimin e Kuvendit.

Më 8 gusht, Kushtetuesja njoftoi për vendimin mbi dy lëndët e paraqitura përmes të cilit tha se ndryshimi i rendit të ditës nga ana e Kryesuesit Avni Dehari ishte shkelje, dhe e obligoi Kuvendin që t'i kthehet votimit të hapur dhe urdhëroi që një kandidat për kryeparlamentar të propozohet jo më shumë se tri herë.

Gjykata sugjeroi nevojën për kompromis politik, fleksibilitet në propozime dhe respektim të frymës së Kushtetutës për të garantuar funksionalitet institucional.

Vetëm pas aktgjykimit, Kuvendi arriti që më 26 gusht ta zgjedhë Dimal Bashën si Kryetar të Kuvendit, duke i dhënë fund kapitullit të gjatë të bllokadës. Ai u vendos në krye të Kuvendit edhe me votat e Partisë Demokratik, zgjidhje që erdhi si domosdoshmëri pas aktgjykimeve të Kushtetueses dhe nuk ishte produkt i një marrëveshjeje politike substanciale.

Problem politik u bë më pas edhe zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb.

Kushtetuesja u sfidua edhe nga Lista Serbe, meqë asnjë kandidat i saj nuknu zgjodh nënkryetar. Me votimin që ndryshe nga praktika e deritashme u nda, Emilija Rexhepi u zgjodh nënkryetare e Kuvendit

nga komuniteti jo shumicë jo serbe, ndërsa i propozuari serb, Slavko Simiq nuk arriti t'i sigurojë votat e nevojshme për pozitën e rezervuar për këtë minoritet. Meqë Lista Serbe refuzonte propozimin e kandidatëve tjerë, kryeparlamentari Basha vuri në funksion mekanizmin e shortit, ku u vunë në votim të tetë kandidatët e mbetur të Listës Serbe, por që s'morën votat e mjaftueshme. Vota nuk siguroi as Nenad Rashiq, i vetmi serb që fitoi një ulësë në Kuvendin e Kosovës pa qenë kandidat i Listës Serbe.

Por Kushtetuesja që vendosi mbi ankesën e Listës Serbe konstatoi se pa zgjedhjen e nënkryetarit nga radhët e komunitetit serb, Kuvendi nuk konsiderohet i konstituuar. Pas thirrjes së seancës u përsërit procedura e njëjtë, me ndryshimin ku Lista Serbe i propozoi të gjithë deputetët por asnjëri nuk i mori votat e domosdoshme. Pasi u shterën emrat nga ky subjekt, në votim u hodh Nenad Rashiq, i cili me votat e LVV-së dhe LDK-së u zgjodh nënkryetar. Lista Serbe e kontestoi këtë vendim dhe rasti është duke u trajtuar ende nga Kushtetuesja.

Megjithëse konstituimi u shpall i mbyllur, ai e la të hapur krizën e radhës, atë për formimin e qeverisë.

Përpjekja e parë për ta formuar kabinetin qeveritar dështoi kur Albin Kurti nuk arriti t'i siguronte 61 votat e nevojshme në Kuvend. Në seancën e 26 tetorit ai mori 56 vota për, 52 ishte kundër dhe 4 abstenuan. Edhe përpjekja e dytë, me mandatarin Glauk Konjufca, përfundoi pa sukses, duke e zhytur vendin në një cikël të përsëritur dështimesh politike. Konjufca u propozua për mandatar nga Vetëvendosja e subjektet tjera nuk propozuan mandatar, ndonëse për këtë u ftuan në konsultë nga presidentja Vjosa Osmani.

Pasojat e bllokadës

Kostoja e këtij ngërçi politik e institucional u reflektua drejtpërdrejt në jetën institucionale dhe ekonomike të vendit. Buxheti për vitin 2026 mbeti i pamiratur, duke krijuar pasiguri financiare për institucionet publike. Kosova humbi mundësinë për të përfituar në 2025-n nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian, për shkak të mosratifikimit të marrëveshjeve në Kuvend. U humbën 80 milion euro nga totali i shumës prej mbi 800 milionë euro të zotuar nga BE-ja.

Në fund të 2024-ës, Komisioni Evropian morri vendim për të mundësuar pagesat e para për vendet e Ballkanit Perëndimor nga Plani i Rritjes dhe reformave. Në takimin e 23 tetorit KE-ja miratoi agjendat e reformave për Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë.

Krahasuar për kokë banori Kosova do të jetë përfituesja më e madhe nga kjo paketë.

Sipas një dokumenti të Komisionit Evropian, mjetet nga Plani i Rritjes për Kosovën mes tjerash kanë ndikim direkt edhe në mirëqenien e qytetarëve, përmes fuqizimit ekonomik dhe uljes së papunësisë. Tek përmenden rezultatet e dobëta të nxënësve kosovarë në testin PISA, përmes fondeve të BE-së synohet ndryshimi i kësaj situate.

Bordet pa anëtarë

Po ashtu shumë borde të institucioneve publike mbetën pa anëtarë, pasi mandatet e tyre skaduan pa mundësi zëvendësimi, duke paralizuar vendimmarrjen në sektorë kyç.

Që nga 5 gushti vendime nuk mund të marrë Agjencia Kosovare e Privatizimit, pasi gjashtë prej tetë

anëtarëve të bordit u ka skaduar mandati. Prej muajsh pa bord funksional ka mbetur Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM), duke e lënë sektorin e mediave audiovizuale pa mbikëqyrje efektive, në kohën kur vendi përballlet me fushata të ashpra dezinformuese.


Po ashtu disa mandate përfunduan brenda këtij viti. Avokatit të Popullit i përfundoi mandati më 28 shtator derisa katër zëvendësavokatëve të Popullit u ka përfunduar mandati më 14 qershor. Pesëmbëdhjetë anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës u skadoi mandati në nëntor të këtij viti.

Gjykata Kushtetuese rrezikon të mbetet pa kuorum në rast të dorëheqjes ose shkarkimit të ndonjërit prej gjyqtarëve. Aktualisht Kushtetuesja i ka shtatë gjyqtarë aktivë dhe largimi eventual i ndonjërit prej tyre do ta pamundësonte kuorumin në vendimmarrje.

E njëri prej gjyqtarëve të këtij institucioni u bë shkak që presidentja ta tërheq kërkesën rreth konstituimit të Kuvendit, me arsyen se Radomir Laban paraqet rrezik për sigurinë kombëtare. Që nga fundi i 2024-ës Kushtetuesja mbeti pa dy gjyqtarë pasi iu skadoi mandati Gresa Caka-Nimanit (kryetare) dhe gjyqtarës Selvete Gërxhaliu-Krasniqi. Zgjedhja e anëtarëve të rinj bëhet nga Kuvendi.

Pas gati një viti të tërë bllokade, përplasjes e pamundësisë për ta zgjedhur qeverinë, rruga e vetme mbeti shpërndarja e Kuvendit nga ana e Presidentes Vjosa Osmani. Më 28 dhjetor, qytetarët iu drejtuan sërish kutive të votimit, me pritjen që ky cikël i ri zgjedhor do t'i japë fund një prej ngërçeve më të gjata institucionale që ka përjetuar vendi pas shpalljes së pavarësisë.





S'ka më kohë për të humbur: 2026-a të sjellë institucione funksionale e progres

Viti 2026 duhet të sjellë institucione funksionale dhe progres të vërtetë për Kosovën—progres në zhvillimin ekonomik, luftën kundër korrupsionit, arsimin, shëndetësinë dhe mbrojtjen e mjedisit. Mbetem optimist se ditët e fundit të vitit 2025 do të shënojnë një pikë kthese dhe uroj për një Vit të Ri me paqe, stabilitet dhe progres të prekshëm nga i cili përfitojnë të gjithë qytetarët e saj



Aivo Orav

Kur e shkrova op-ed-in tim të mëparshëm vitin e kaluar, isha ende i ri në Kosovë, me vetëm katër muaj në detyrë. Një vit më vonë, nuk e konsideroj më veten të ri. Viti që lame pas ka bërë që ta njohë më thellë Kosovën—historinë, kulturën e saj dhe, mbi të gjitha energjinë e jashtëzakonshme, qëndrimin pozitiv dhe qëndrueshmërinë e popullit të saj.

Gjatë gjithë vitit, angazhimi im nëpër komuna më çoi anëmbanë Kosovës. Duke udhëtuar nga një komunë në tjetrën, takova njerëz nga të gjitha komunitetet dhe dëgjova shqetësimet, aspiratat dhe sfidat e tyre të përditshme. Këto biseda ofruan një pasqyrë të vlefshme të dinamikave lokale, si dhe një përkushtim të fortë ndaj vlerave evropiane dhe dëshirën për një të ardhme më të mirë.

Në një kohë pasigurie të thellë globale, vlerat kanë më shumë rëndësi se kurrë.

Evropa po përjeton periudhën më sfiduese të këtij shekulli. Lufta e përvokuar e agresionit rus kundër Ukrainës ka shembur supozimet e kahershme për paqen në kontinentin tone duke na kujtuar se siguria, demokracia dhe liria nuk mund të merren kurrë si të mirëqena.

Duke qenë projekt paqeje që nga fillimi, Bashkimi Evropian është kthyer te parimet bazë të tij. I bashkuar në mbështetjen e Ukrainës, BE-ja qëndroi në drejtimin e vet, duke përshtatur politikat dhe instrumentet e saj ndaj sfidave më të gjera të sigurisë që burojnë nga agresioni i vazhdueshëm i Rusisë. I fortë në unitetin e tij, BE-ja dërgoi një mesazh të qartë: nuk do t'i nënshtrohemi frikësimit apo agresionit.

Në këtë mjedis gjeopolitik që po ndryshon, është inkurajuese të shohim Kosovën duke qëndruar fuqishëm në anën e duhur të historisë.

Përafrimi i Kosovës me politikën e jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian, përfshirë mbështetjen e plotë për sanksionet kundër Rusisë dhe Bjellorusisë, shkon përtej një qëndrimi thjesht politik. Ai pasqyron një përkushtim parimor ndaj BE-së dhe një gatishmëri të qartë për të kontribuar në sigurinë e Evropës. Kjo shënon gjithashtu përkushtimin ndaj vlerave evropiane në kohë të vështira, gjë që është thelbësore për ta paraqitur Kosovën si një partner të besueshëm në një kohë kur politikën e zgjerimit dhe integritetit gradual të BE-së kanë marrë një momentum të ri.

Ky momentum, së bashku me mbështetjen e vazhdueshme të BE-së për Kosovën, përfaqëson një mundësi që duhet shfrytëzuar.

Që nga viti 1999, Bashkimi Evropian ka investuar mbi 3.7 miliardë euro në Kosovë, duke e bërë atë partnerin më të fortë të Kosovës dhe ofruesin më të madh të ndihmës financiare. Këto investime, të cilat vazhdojnë të rriten nga viti në vit, tregojnë qartë se BE-ja e sheh Kosovën jo vetëm si partnere, por si pjesë integrale të procesit të integritetit evropian.

Me shpresë dhe inkurajim kemi parë zhvillime pozitive, përfshirë mbarëvajtjen e dukshme të zgjedhjeve parlamentare në shkurt dhe të zgjedhjeve komunale në tetor

dhe nëntor, të pasuara nga dorëzimi i qetë i pushtetit në katër komunat veriore. Kjo është kyçe për përfshirjen e të gjithë qytetarëve në jetën politike të Kosovës, pavarësisht përkatësisë etnike.

Këto zhvillime, nga ana tjetër, i mundësuan BE-së të fillojë heqjen graduale të masave të vendosura në vitin 2023, siç u bë e ditur nga Përfaqësuesja e Lartë Kallas gjatë vizitës së saj në Prishtinë në maj. Në margjinat e Samitit BE–Ballkani Perëndimor më 17 dhjetor, presidentja von der Leyen njoftoi se të gjitha fondet e mbetura do të lirohen deri në fillim të vitit të ardhshëm.

Megjithatë, Kosova ka ngelur prapa për shkak të ngërçit të tejzgjatur politik. Në shumë aspekte, viti 2025 ishte një vit i humbur. Paraliza politike dhe institucionale jo vetëm që i ngadalësoi reformat në vend, por gjithashtu kufizoi aftësinë e Kosovës për të përfutur plotësisht nga mbështetja e BE-së, përfshirë Planin e Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor, i cili ka paraparë 882 milionë euro për rritjen ekonomike dhe reformat e nevojshme në Kosovë.

Pavarësisht kësaj, mbetem optimist se ditët e fundit të vitit 2025 do të shënojnë një pikë kthese.

Besoj se zgjedhjet e 28 dhjetorit do të mundësojnë konstituimin e shpejtë të Kuvendit dhe formimin e një qeverie stabile. Kosova nuk e ka luksin një viti tjetër të stagnimit.

Kufijtë e Kushtetutës së Kosovës u testuan mjaftueshëm gjatë vitit 2025 dhe nuk kanë nevojë të testohen më tej. Respektimi i sundimit të ligjit, pavarësia e institucioneve të drejtësisë—përfshirë Këshillin Prokurorial të Kosovës—dhe vazhdimi i reformave në drejtësi mbeten thelbësore për zhvillimin demokratik dhe të ardhmen evropiane të Kosovës.

Po aq e rëndësishme është ruajtja e karakterit multietnik të Kosovës. Kushtetuta e Kosovës, e bazuar në Planin e Ahtisaarit, e njeh Kosovën si shoqëri multietnike dhe ofron mbrojtje të fortë për të drejtat e komuniteteve joshumicë, qeverisje të decentralizuar dhe mekanizma për pjesëmarrje politike. Përqafimi dhe zbatimi i plotë i kësaj kornize kushtetuese është në interes të të gjithëve që jetojnë në Kosovë.

Është jetike që Kosova të krijojë pa vonesë institucione plotësisht funksionale.

Bashkimi Evropian ka nevojë për një partner të qëndrueshëm dhe të besueshëm—një partner të aftë për të zbatuar reformat dhe për të respektuar angazhimet që Kosova ka marrë ndaj BE-së, përfshirë ato në kuadër të Dialogut të lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Përparimi në zbatimin e marrëveshjes së normalizimit mbetet kyç për avancimin e të dyja vendeve në rrugët e tyre evropiane.

Nuk ka më kohë për të humbur. Viti 2026 duhet të sjellë institucione funksionale dhe progres të vërtetë për Kosovën—progres në zhvillimin ekonomik, luftën kundër korrupsionit, arsimin, shëndetësinë dhe mbrojtjen e mjedisit. Në fund të fundit, këto reforma kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës së përditshme të njerëzve në mbarë Kosovën.

Mbështetja e BE-së në këtë përpjekje ka qenë e vazhdueshme që nga viti 1999 dhe do të vazhdojë. Me këtë në mendje, u uroj të gjithëve në Kosovë një Vit të Ri me paqe, stabilitet dhe progres të prekshëm nga i cili përfitojnë të gjithë qytetarët e saj.

Autori është Ambasador i BE-së në Kosovë

Dhjetë dëshirat e mia për vitin 2026

Viti 2025 ishte një vit i humbur për Kosovën. Viti 2026 është një mundësi për t'i siguruar si udhëheqësit politikë ashtu edhe ata të biznesit se ia vlen të investohet në Kosovë si një partnere dinamike në sigurinë dhe prosperitetin e përbashkët evropian



Jonathan Hargreaves

Kur isha shumë i ri, në Britani ekzistonte një traditë e vjetër sipas të cilës kushdo që gjente monedhën “gjashtëpensëshe” të fshehur në pudingun e tyre të Krishtlindjes mund të shprehte një dëshirë dhe ajo do t'i plotësohej. Këtë vit unë festova Krishtlindjen me familjen time këtu në Kosovë, dhe megjithëse nuk gjeta monedhën gjashtëpensëshe, shpreha dhjetë dëshira të rëndësishme për Kosovën për vitin 2026. Këto janë dëshira me rëndësi për Mbretërinë e Bashkuar, si edhe për popullin e Kosovës. Viti 2025 ishte një vit i humbur për Kosovën. Viti 2026 është një mundësi për t'i siguruar si udhëheqësit politikë ashtu edhe ata të biznesit se ia vlen të investohet në Kosovë si një partnere dinamike në sigurinë dhe prosperitetin e përbashkët evropian.

1. Qeveri vendimtare dhe stabile. Tani që kanë përfunduar zgjedhjet, Kosovës i nevojiten urgjentisht një Kuvend dhe një Qeveri sa më shpejt që të jetë e mundur, si dhe të zgjedhë një president/e pa pasur nevojë edhe për një palë zgjedhje të tjera. Politikanët duhet të kapërcejnë mosbesimet e ndërsjella dhe të përshtatin ambiciet e tyre personale. Buxheti i Kosovës dhe marrëveshjet kyç ndërkombëtare me vlerë qindra miliona euro duhet të miratohen urgjentisht. Një qeveri funksionale, që zbaton në praktikë Kushtetutën gjithëpërfshirëse dhe shumetnike, e cila mbetet baza e mbështetjes ndërkombëtare për shtetin e Kosovës, do t'u dërgonte sinjale të besueshmërisë dhe pjekurisë politike partnerëve dhe investitorëve.

2. Marrje e iniciativës për dialogun. Do të doja shumë të dëgjoja politikanët e Kosovës të premtojnë se do të bëjnë gjithçka që munden për të zbatuar marrëveshjet ekzistuese me Serbinë. Qeveria e re në Kosovë duhet të ketë guxim dhe mençuri politike për të marrë iniciativën dhe për të punuar nën lehtësimin e BE-së për të sjellë paqe të qëndrueshme me fqinjën e saj. Ne do vazhdojmë t'i bëjmë thirrje Serbisë që të bëjë të njëjtën gjë. Në vitin 2025, Mbretëria e Bashkuar konfirmoi angazhimin e saj në KFOR për të paktën deri në dhjetor 2028, duke vazhduar të vërë ushtarët e saj në shërbim të sigurisë së këtij rajoni. Por siguria e vërtetë – ajo lloj sigurie që një ditë do t'ua mundësojë ushtarëve tanë të kthehen në shtëpi – qëndron në një marrëdhënie të normalizuar dhe të qëndrueshme mes Kosovës dhe Serbisë.

3. Ripërtëritje e respektit për demokracinë. Gjykatat, mediat e larmishme, organet e pavarura si Komisioni i Pavarur i Mediave, të gjitha mund të forcojnë ekonominë e Kosovës, të drejtat themelore të njerëzve dhe rrugën drejt integritimit ndërkombëtar. Dhe ato janë mbrojtja më e mirë kundër atyre që ia duan të keqen. Në mbarë Evropën e vërteta, drejtësia dhe liria për të marrë vendime të informuara janë nën sulm. Ata që janë armiqësorë ndaj Kosovës do të shfrytëzojnë përçarjet e brendshme, gënjeshttrat, sulmet politike dhe përpjekjet për të minuar institucionet e pavarura. Kjo është beteja e sotme.

4. Anëtarësimi në Këshillin e Evropës. Nëse Qeveria e re e Kosovës ka vullnet, viti 2026 mund të jetë viti kur kjo më në fund do të ndodhë. Mbretëria e Bashkuar dëshiron që Kosova të jetë pjesë e institucioneve të fuqishme që forcojnë rendin juridik të Evropës, në një kohë kur modelet au-

toritare janë në rritje. Dhe ne duam të shohim Kosovën të përkushtuar ndaj komizës së saj ligjore dhe marrëveshjeve të aritura në Bruksel dhe Ohër, përfshirë edhe formimin e një asociacioni të komunave me shumicë serbe.

5. Një shtet, shumë komunitete. Kosova ka nevojë për sovranitet dhe siguri në tërë territorin e saj. Duhet të shohim drejtësi për krimet e kryera në territorin e saj në vitet e fundit, përfshirë sulmet në Banjskë dhe në “Ibër-Lepenc”. Sovraniteti i vërtetë nënkupton pëlqim: ndërtimin e një shteti të cilit duan t'i përkasin të gjitha komunitetet. Kohët e fundit vizitova dy nga kryetarët e rinj të komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës, si edhe kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut. Atyre u bëra thirrje që të punojnë së bashku me Qeverinë e Kosovës për të gjetur zgjidhje praktike në të mirë të të gjithë qytetarëve të tyre. Kjo do të thotë ofrim të shërbimeve në mënyrë transparente, pa diskriminim dhe me respektim të identitetit, projekte që përmirësojnë jetën e përditshme, si dhe siguri që garanton komunitete të sigurta për të gjithë.

6. Një diskutim i ri për NATO-n. Në vitin 2025 pata nderin të kaloja ca kohë me oficerë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilët trajnohen sipas standardeve të NATO-s, shumë prej të cilëve kanë shkëlqyer gjatë shkollimit të tyre në Mbretërinë e Bashkuar. Mbretëria e Bashkuar mbështet ambicien e Kosovës për anëtarësim të ardhshëm në NATO. Siguria e Kosovës është element thelbësor i sigurisë së Evropës. Kjo nuk do të ndodhë brenda natës dhe do të nevojiten vendime të vështira politike – mjaftueshëm të forta për t'ua ndryshuar mendjen atyre që ende nuk e njohin Kosovën.

7. Menaxhimi i flukseve të njerëzve. Në vitin 2025, gjatë Procesit të Berlinit të kryesuar nga Mbretëria e Bashkuar, Kosova u pajtua të punojë me vendet fqinje të Ballkanit Perëndimor në një Task Forcë të Përbashkët për Migracionin me Mbretërinë e Bashkuar. Bashkëpunimi në fushën e migracionit është pjesë e një partneriteti më të gjerë të sigurisë në Evropë: mbrojtja e rrugëve të ligjshme, ulja e shfrytëzimit të njerëzve dhe luftimi i grupeve të organizuara kriminale që dëmtojnë shoqëritë dhe ekonominë tona.

8. Biznesi me Mbretërinë e Bashkuar. Shpresoj që viti 2026 të jetë viti kur tregtia dhe investimet mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Kosovës do fillojnë të lulëzojnë. Së bashku mund të bëjmë shumë më tepër, veçanërisht për të shfrytëzuar potencialin e partneritetit mes Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar në fushën e teknologjisë dhe energjisë së ripërtërishme. Por investitorët tanë kanë nevojë për siguri dhe për një strategji të qartë për rritje dhe reforma. Ata nuk kanë nevojë as për dramë politike, as për gjecje.

9. Gratë në qendër të gjithçkaje. Asnjë nga këto gjëra nuk mund të arrihet pa përfshirjen aktive të gjysmës së popullsisë së Kosovës. Dua të shoh gratë të kenë mundësi të lënë fëmijët e tyre në qerdhe të shkëlqyeshme dhe të shkojnë në punë, qoftë në biznes ose si kryetare të ardhshme të komunave të tyre. Dua të shoh vajzat e sotme të bëhen udhëheqëset, sipërmarrëset, krijueset dhe profesionistet e së nesërme – nga policia dhe siguria te biznesi dhe financat, në sektorin publik dhe atë privat.

10. Lavdi në Kupën e Botës për Kosovën! Kam një ëndërr që në një ditë korriku do të shohim Kosovën duke luajtur kundër Anglisë ose Skocisë në Kupën e Botës. Ti mund t'ia dalësh, Kosovë!

Ndërsa ngre gotën me verë të gazuar angleze për Vitin e Ri, dua të uroj që viti 2026 të jetë më i mirë për Kosovën – sepse populli i saj e meriton dhe se kjo është ajo që i duhet edhe Mbretërisë së Bashkuar.

Autori është ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë

NJË HISTORI BOJKOTI E SHANTAZHI NGA SUBJEKTI KRYESOR QË PËRFAQËSON SERBËT NË KOSOVË

Lista Serbe – kronikë e një rikthimi të kontrolluar

Pas vitesh tensionesh, bojkotesh dhe përplasjesh që e kthyen veriun e Kosovës në epiqendër krizash të vazhdueshme, konstituimi i autoriteteve lokale në katër komunat veriore pas zgjedhjeve të tetorit u zhvillua në përputhje me rendin kushtetues të vendit. Por, për njohës të zhvillimeve politike, rikthimi i Listës Serbe në pushtetin lokal shënon më shumë ripozicionim të kontrolluar nga Beogradi zyrtar sesa integrim i sinqertë në institucionet e Kosovës. Kjo ka rikthyer dilemat për përfaqësimin real të komunitetit serb dhe për ciklin e vjetër të bojkotit dhe shantazhit politik që e ka karakterizuar këtë parti për më shumë se një dekadë

Fitim Gashi

PRISHTINË, DHJETOR – Për herë të parë pas vitesh krizash të vazhdueshme, procedurat e inaugurimit të autoriteteve të reja lokale në veriun e banuar kryesisht me serbë u zhvilluan pa drama politike, duke dëshmuar se rendi kushtetues i Kosovës funksionon edhe aty ku për vite me radhë është sfiduar hapur.

Konstituimi i kryetarëve dhe anëtarëve të kuvendeve komunale në Mitrovicë të Veriut, Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq kaloi pa incidente, pa tensione dhe në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Por, normaliteti procedural nuk e zbeh thelbin politik të këtij rikthimi. Njohës të zhvillimeve politike thonë se Lista Serbe që rimori pushtetin në këto komuna, është kthyer në pushtet jo si shprehje e një integrimi të ri, por si rezultat i një lëvizjeje të kalkuluar strategjikisht nga Beogradi.

Që nga themelimi i saj në vitin 2013, Lista Serbe ka funksionuar si instrument politik i Beogradit zyrtar në Kosovë, duke kaluar nga përfshirja formale në institucione, te tërheqja e koordinuar, bojkoti dhe rikthimet selektive, gjithmonë në përputhje me interesat e qeverisë serbe dhe jo me nevojat e komunitetit serb në Kosovë.

Pas zgjedhjeve të fundit lokale, Lista Serbe rifitoi pushtetin në katër komunat me shumicë serbe, duke i dhënë fund periudhës dyvjeçare e gjysmë kur këto komuna u udhëhoqën nga kryetarë shqiptarë të zgjedhur në procese elektorale që u bojkotuan nga komuniteti serb.

Veriu funksionoi institucionalisht pa pjesëmarrjen e Listës Serbe, zhvillim ky i shoqëruar edhe me shtrirje të autoritetit të shtetit dhe zbehje të ndikimit të strukturave paralele.

Gjatë kësaj periudhe, në bashkëpunim me qeverinë qendrore, komunat veriore kanë mbyllur një sërë strukturash paralele të Serbisë, kanë ndaluar përdorimin e dinarit dhe kanë integruar shërbimet bankare, postare dhe administrative.

Presidenti i Forumit për Marrëdhënie Etnike në Beograd, Dushan Janjiq, thotë se ky rikthim mund të prodhojë një “stabilitet të kufizuar”, por nuk përfaqëson një zgjidhje afatgjatë për krizën e përfaqësimit politik të serbëve në Kosovë.

“Situata është kthyer aty ku ishte para krizës së sigurisë dhe para ngjarjeve të Banjskës. Kemi një normalitet të ri: serbët fituan komunat e tyre, por shumë prej tyre janë nën presion, veçanërisht komunat që lidhen me Asociacionin. Një nga arsyet kryesore të rikthimit është presioni ndërkombëtar mbi Vuçiqin. Në Serbi, një pjesë e opinionit e konsideron tradhtar, sepse i tërhoqi serbët nga institucionet e Kosovës dhe i shtyu drejt bojkotit”, ka thënë Janjiq.

Sipas tij, Lista Serbe nuk posedon politikë të pavarur dhe as burime reale jashtë mbështetjes së Beogradit.

“Për sa kohë që ajo është nën kontroll të plotë nga Beogradi, nuk mund të jetë partner serioze për dialog dhe as për ndërtimin e statusit të ardhshëm të komunitetit serb në Kosovë”, ka theksuar ai.



Që nga themelimi i saj në vitin 2013, Lista Serbe ka funksionuar si instrument politik i Beogradit zyrtar në Kosovë, duke kaluar nga përfshirja formale në institucione, te tërheqja e koordinuar, bojkoti dhe rikthimet selektive, gjithmonë në përputhje me interesat e qeverisë serbe dhe jo me nevojat e komunitetit serb në Kosovë

Dy periudha

Aktiviteti i partive politike të serbëve të Kosovës ndahet në dy periudha kryesore. E para, nga viti 2000 deri në vitin 2013, kurse e dyta që ka filluar nga viti 2013, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit, dhe që vazhdon ende.

Periudha e parë u karakterizua kryesisht nga refuzimi politik i serbëve përmes përfaqësuesve të tyre politikë, për t'u integruar në institucionet e Kosovës. Ngjarjet e marsit 2004, shënuan fundin e pjesëmarrjes së partive politike serbe në jetën institucionale të Kosovës, me gjithë përpjekjet e ndërkombëtarëve që t'i përfshijnë ata.

Kjo çoi në bojkot të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2004 dhe 2007. Aktiviteti i partive serbe në Kosovë diktohej edhe nga zhvillimet në Beograd, ku gjatë kësaj periudhe kishte përçarje politike në bashkëqeverisjen me Boris Tadiqit dhe Vojislav Koshtunicës.

E politika e serbëve të veriut të Kosovës në këtë periudhë u zhvillua përmes strukturave paralele.

Një parti e ndërtuar mbi varësi

Lista Serbe u krijua në vitin 2013 pas Marrëveshjes së Brukselit mes Kosovës e Serbisë, e cila synonte shpërbërjen e strukturave paralele serbe dhe integrimin e tyre në sistemin kosovar. Themelimi i kësaj partie ishte parakusht që serbët të merrnin pjesë për herë të parë në zgjedhjet që do t'i organizonte Kosova në katër komunat e veriut, më 3 nëntor 2013.

Që nga fillimi, ajo u ndërtua si monopol politik i serbëve të Kosovës, edhe u mbështet financiarisht dhe politikisht nga Beogra-

di. Në zgjedhjet e para lokale të organizuara nga institucionet e Kosovës në nëntor 2013, Lista Serbe mori pjesë vetëm pas thirrjeve publike të qeverisë serbe dhe fitoi shumicën e komunave ku serbët dominojnë.

Ajo në vazhdimësi ka refuzuar të sillet si subjekt politik autonom. Betimi me simbolet e Kosovës, zbatimi i ligjeve shtetërore dhe pranimi i sovranitetit institucional shiheshin më shumë si koncesione të përkohshme sesa si obligime kushtetuese. Vendimmarrja lokale është diktuar shpesh nga direktivat e Beogradit, duke e kthyer pushtetin komunal në instrument politik të jashtëm.

Në zgjedhjet lokale të viteve 2013 dhe 2017, si dhe në tri cikle zgjedhore parlamentare, Lista Serbe e konsolidoi këtë dominim përmes presioneve sistematike. Partitë e tjera serbe u shkrinë, u marginalizuan ose u eliminuan përmes shantazheve politike dhe ekonomike.

Kryetari i parë i Listës Serbe ishte Aleksandar Jabllanović, aktualisht kryetar i Partisë Serbe të Kosovës dhe kundërshtar i subjektit që dikur i takonte. Jabllanović ishte shkarkuar nga posti i kryetarit në fund të vitit 2015. Pas tij, partia u drejtua nga Slavko Simiq deri në mes të vitit 2017.

Kjo parti ka kaluar edhe periudha përçarjesh të brendshme. Më seriozja ndodhi gjatë udhëheqjes së Simiqit kur përplasjet e brendshme për dominimin mes deputetëve nga jugu dhe veri u gati sa nuk e ndanë partinë. Megjithatë, ndarja nuk ndodhi në atë kohë dhe u vendos pothuajse një dominim absolut i të ashtuquajturave struktura veriore.

Në vitin 2013, pati presione ndaj votuesve për të marrë pjesë në zgjedhjet e Kosovës. Por edhe në çdo

cikël pasues zgjedhor, misione vendore e ndërkombëtare kanë evidentuar presione të Listës Serbe ndaj qytetarëve për të votuar për një subjekt të vetëm politik.

Po atë vit ndodhën disa incidente serioze, ku përfshihet edhe thyerja e kutive të votimit në ditën e zgjedhjeve dhe vrasja e njërit prej tre kandidatëve për kryetar të Mitrovicës së Veriut, në mes të fushatës zgjedhore, Dimitrije Janićevići. Në të njëjtën fushatë, nën akuzat për krime lufte nga autoritetet e Kosovës u arrestua kandidati tjetër, Oliver Ivanović. Ai kaloi tre vjet e gjysmë në burg dhe u vra më pak se një vit pasi u lirua me kusht, për të cilin krim një nga të dyshuarit kryesor është Milan Radoičiq, i cili ka qenë nënkryetar i Listës Serbe, post që e la pasi mori përgjegjësinë për sulmin terrorist në Banjskë.

Bojkoti si mjet presioni

Pas përfshirjes në institucione, Lista Serbe mori pjesë në të gjitha proceset zgjedhore deri më 2022, kur filloi një periudhë përshkallëzimi politik. Ajo kulmoi në nëntor 2022, kur përfaqësuesit serbë u tërhoqën masivisht nga institucionet e Kosovës – nga qeveria, policia dhe gjyqësori, duke e shndërruar bojkotin në armë politike. Vendimi u justifikua me çështjen e targave, por në thelb shërbeu për ta destabilizuar rendin institucional në veri.

Kulmi i kësaj politike tensioni ishte sulmi terrorist i 24 shtatorit 2023 në Banjskë, i udhëhequr nga Radoičiq. Sulmi, ku u vra rreshteri Afrim Bunjaku, e ekspozoi lidhjen e rrezikshme mes politikës, strukturave ilegale dhe dhunës së organizuar.

Shkaku i këtij zhvillimi, para tri palë zgjedhjeve të sivjetme, ka pa-

sur përpjekje për t'ia ndaluar pjesëmarrjen në garë këtij subjekti politik. Në zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës që u mbajtën në fillimvit, në ato lokale të vjeshtës, si dhe para zgjedhjeve të parakohshme të 28 dhjetorit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk e ka certifikuar këtë parti dhe kandidatët e saj, megjë anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë votuar kundër, ndërsa të tjerët kanë abstenuar, përjashtimisht anëtarit të Listës Serbe dhe kryesuesit të KQZ-së që kanë votuar për certifikim. Vendimet gjithherë janë apeluar dhe janë fituar nga Lista Serbe pas apelimit në Panelin Zgjedhor për Ankesa.

Pas zgjedhjeve të shkurtit, Lista Serbe fitoi 9 nga 10 vendet për serbët në Kuvend, ndërkah në zgjedhjet lokale fitoi në raundin e parë 9 prej 10 komunave me shumicë serbe. Fitoi edhe në kllokat ku shkoi në balotazh, pasi para zgjedhjeve kundërkandidati në garë aderoi në Listën Serbe.

Dushan Janjiq vlerëson se, pavarësisht rikthimit në pushtet, Lista Serbe sot është politikisht e konsumuar.

Ata janë aktorë në margjina. Nuk kanë më as fuqi, as ndikim, as kredibilitet. Kjo është e rrezikshme, jo vetëm për Kosovën, por edhe për vetë komunitetin serb”, ka thënë Janjiq.

Sipas tij, fati i Listës Serbe është i lidhur drejtpërdrejt me qëndrimin në pushtet të Aleksandër Vuçiqit. Ai shfaq shpresën që pasi presidenti aktual serb ta humbë pushtetin, edhe të ketë pluralizëm politik edhe mes serbëve të Kosovës, një potencial që ekziston, por që është shtypur për vite me radhë.

Mikpritja më e ngrohtë në vendin që i duhet urgjent një qeveri

Asnjëherë më parë nuk kam përjetuar një mikpritje më të ngrohtë si diplomat gjerman. Qoftë në takime zyrtare në Prishtinë, apo kur ndaloj për një makiato në një kafene në qytet. Por, sigurisht, unë dhe ekipi im nuk jemi dërguar këtu thjesht për të shijuar kafen e shkëlqyer. Jemi këtu për të punuar dhe do të përqendrohemi në tri fusha kryesore. Por, si fillim, Kosova ka nevojë urgjente për një qeveri me mandat të plotë



Rainer Rudolph

„Oh, ta kam zili!“ – Kështu reagoi ish-prori im në Konferencën e Sigurisë në Myhih, Ambasadori Wolfgang Ishinger, kur i tregova se do të marr detyrën e ambasadorit gjerman në Kosovë. Volfangu ka një lidhje të thellë me këtë vend, por ky një rrëfim për një herë tjetër. Pas pothuajse tre muajsh qëndrimi në Prishtinë, mund të them se kishte të drejtë: Asnjëherë më parë nuk kam përjetuar një mikpritje më të ngrohtë si diplomat gjerman. Qoftë në takime zyrtare në Prishtinë, apo kur ndaloj për një makiato në një kafene në qytet.

Lidhjet mes dy vendeve tona janë ndërtuar gjatë shumë viteve, shpesh të vështira, dhe sot mbështeten realisht nga qindra mijëra njerëz që ndihen të lidhur dhe të rrënjësor në të dy shtetet, Gjermani dhe Kosovë. Është një përvojë e mrekullueshme ta ndiesh këtë çdo ditë nga afër.

Por, sigurisht, unë dhe ekipi im nuk jemi dërguar këtu thjesht për të shijuar kafen e shkëlqyer. Jemi këtu për të punuar dhe do të përqendrohemi në tre fusha kryesore.

Së pari: Integrimi evropian i Kosovës. Kosova ka pritur për një kohë të gjatë njohjen e plotë ndërkombëtare dhe integrimin. Kudo ndiej lidhjen e thellë me vlerat dhe synimet evropiane në këtë demokraci dinamike. Por ky konsensus i gjerë duhet të kthehet në veprim – përmes aktorëve politikë këtu në Kosovë. Jam i vetëdijshëm se disa nga pengesat në këtë rrugë janë jashtë kontrollit të Kosovës. Dhe padyshim, ndërgjegjësimi për domosdoshmërinë gjeopolitike është rritur në shumë kryeqytete evropiane. Megjithatë, Kosova nuk mund të mbështetet vetëm mbi këtë: procesi ka qenë dhe mbetet i bazuar në meritë. Prandaj është edhe më e rëndësishme që Kosova të përqendrohet në hapat që mund t'i ndërmarrë vetë. Lajmi i fundit se Komisioni Evropian po ecën drejt heqjes së masave ndaj Kosovës pas transferimit paqësor të pushtetit lokal në veri në përfundim të zgjedhjeve të fundit është një zhvillim shumë pozitiv.

Duke rrezikuar të tingëlloj si një “disk i prishur”: Kosova ka nevojë urgjente për një qeveri me mandat të plotë, që të flasë për shtetin në arenën ndërkombëtare dhe të marrë e zbatojë vendime brenda vendit. Këto rreshta i shkruaj para zgjedhjeve të 28 dhjetorit, ndaj shpresoj që një qeveri të formohet shpejt në fillim të vitit 2026.

Ngërçi politik i këtij viti i kushtoi Kosovës humbje të fondeve ndërkombëtare që mund të ishin investuar në zhvillim. Edhe më shqetësuese është se kriza e zgjatur dëmtoi ndjeshëm reputacionin ndërkombëtar të vendit – një pasojë që nuk duket se vlerësohet sa duhet brenda vendit. Kosova nuk mund të lejojë të humbasë edhe një vit tjetër.

Nga një qeveri e re, presim angazhim të fortë në dialogun e normalizimit të udhëhequr nga BE. Zgjedhjet lokale të qeta dhe dorëzimi i administratave komunale tek kryetarët e rinj në veri ishin shenja inkurajuese. Në fund të fundit, të gjitha komunitetet në vend duhet të ndihen si në shtëpinë e tyre në një Kosovë multietnike.

Fusha e dytë e angazhimit tonë: Progresi

ekonomik i Kosovës. Marrëdhëniet ekonomike mes Gjermanisë dhe Kosovës janë të forta, por kanë potencial të madh të zhvillimit të mëtejshëm. Për shembull, tregtia jonë është larg ekuilibrit: importet nga Gjermania këtu tejkalojnë ndjeshëm eksportet e Kosovës drejt vendit tim. Do të doja të shihja më shumë prodhim të mallrave dhe shërbimeve inovative në Kosovë që të konkurrojnë në tregun gjerman. Ne jemi të gatshëm të bëjmë pjesën tonë për të nxitur investimet, për të forcuar kuadrin ligjor dypalësh dhe për të promovuar tregtinë. Në të njëjtën kohë, Kosova duhet të krijojë një mjedis tërheqës afatgjatë për investime – që përfshin infrastrukturë moderne, siguri ligjore dhe mirëprirjen e stafit të kualifikuar bashkë me familjet e tyre.

Kam takuar anëtarë të diasporës së madhe të Kosovës në Gjermani. Shpeshherë janë të rinj, të lindur e rritur në Gjermani, qytetarë gjermanë, por me një lidhje të fortë me vendin e origjinës së prindërve e gjyshërve. Dhe mos të harrojmë: me njohuri të gjuhës shqipe. Ku të kem mundësi, do të inkurajoj shkëmbime edhe më të forta – përtej pushimeve gjatë sezonit të verës: për të studiuar një apo dy vjet, për të punuar, për të investuar. Ata janë ura më e vlefshme që kemi mes dy vendeve tona.

Një pjesë e panoramës ekonomike është edhe ndihma jonë zyrtare. Si donatori më i madh dypalësh, ne mbështesim rrugën evropiane të Kosovës: I gjithë bashkëpunimi ynë është i orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës dhe përafrimit të saj me kuadrin ligjor dhe politikat e BE-së. Qoftë në investimin dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e energjisë së ripërtëritshme, në formim profesional apo në qeverisje të mirë – ne punojmë për rezultate konkrete nga të cilat përfitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës e të gjitha komuniteteve, dhe që ushqejnë një mjedis të shëndetshëm ekonomik e natyror.

Fusha e tretë që dua ta përmend është: Bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor. Në javët e fundit kam hasur ndjenja që variojnë nga mahnitja deri te zhgënjimi, për faktin se dy nga fqinjët e afërt të Kosovës – Shqipëria dhe Mali i Zi – tashmë konsiderohen si pararendës në procesin e anëtarësimit në BE. Dua të jem i qartë: asnjë vend nuk merr “pikë shtesë” vetëm pse fqinjët e tij ecin më shpejt. Koha e humbur është e vështirë të rikuperohet. Por integrimi evropian, në thelb, nënkupton edhe bashkëpunim të ngushtë me vendet fqinje – kështu nisi Gjermania dekada më parë. Në vitin 2026, Mali i Zi do të kryesojë Procesin e Berlinit dhe shpresoj që vitin e ardhshëm të arrihet përparim i prekshëm për rajonin.

Në fjalimin tim të parë këtu në Prishtinë, thashë se përtej bisedave politike mezi po prisja të eksploroj vendin. Gjatë javëve të mia të para këtu, kam filluar ta njoh vendin: duke vrapuar të dielën në Parkun e Gërmisë, duke shëtitur në qendër të Mitrovicës, duke marrë pjesë në një shërbesë në katedralen e Gjakovës, vizituar manastirin e mrekullueshëm të Deçanit dhe nderuar viktimat e masakrës së Krushës së Madhe. Me padurim pres shëtitjet malore në pranverë e verë.

Në vitin 2026, Kosova do të shënojë 18-vjetorin e pavarësisë dhe mezi pres të jem pjesë e festimeve. Me tërëmbëdhjetë vjetet e saj, Kosova është një histori e jashtëzakonshme suksesi evropian – një arritje të cilën duhet zgjeruar.

Autori është Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë.

2026: Më pak gënjeshtria online?

Në vitin 2026, le të jemi vigjilentë dhe kritikë: të lexojmë, të verifikojmë dhe të shpërndajmë më ngadalë për një informacion më të shëndetshëm. Lufta kundër dezinformimit nuk mbështetet vetëm te qeveritë apo platformat, por te praktikat tona të përditshme. Nuk duhet të kemi dyshime për gjithçka, por të kultivojmë një higjienë digjitale, ashtu siç kujdesemi për shëndetin tonë fizik apo për ushqimin



Olivier Guérot

Në fillim të çdo viti është zakoni të zotohemi: për gjëra që do të përpiqemi t'i bëjmë më mirë ose më shumë – të bëjmë më shumë sport, të takohemi më shpesh me miqtë, të kemi një higjienë më të mirë të jetesës, etj. Unë propozoj që të përpiqemi të kemi një higjienë më të mirë të informacionit dhe të rrjeteve sociale.

Sepse rrjetet sociale, videot online dhe platformat tona ku kalojmë shumë kohë, ku relaksohemi dhe kënaqemi, janë gjithashtu hapësira ku mund të jemi të vëzhguar, mashtruar ose të manipuluar.

Në vitin 2026, le të jemi vigjilentë dhe kritikë: të lexojmë, të verifikojmë dhe të shpërndajmë më ngadalë për një informacion më të shëndetshëm.

Lufta kundër dezinformimit nuk mbështetet vetëm te qeveritë apo platformat, por te praktikat tona të përditshme.

Nuk duhet të kemi dyshime për gjithçka, por të kultivojmë një higjienë digjitale, ashtu siç kujdesemi për shëndetin tonë fizik apo për ushqimin.

Sulmet në fushën e informacionit janë një dimension kyç i konflikteve dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Dezinformimi është bërë një armë lufte.

Manipulimet e informacionit nuk janë një fenomen i ri, por po industrializohen, pasi digjitalizimi ka transformuar thellësisht shtrirjen dhe ndikimin e tyre. Një studim i Massachusetts Institute of Technology (MIT) në vitin 2018 tregonte se, mesatarisht, një informacion i rremë qarkullonte gjashtë herë më shpejt se një informacion i besueshëm në Twitter. Ky fenomen nuk është ngadalësuar që atëherë. Sot është më e lehtë dhe më pak e kushtueshme se kurrë të zhvillohen fushata të sofistikuara dezinformimi.

Lufta informative përdor vazhdimisht teknika të reja për të dobësuar demokracitë tona. Mënyrat e veprimit bëhen gjithnjë e më komplekse, siç është evidentuar nga shërbimi teknik francez për mbrojtjen ndaj ndërhyrjeve digjitale të huaja: një seri llogarish false apo faqe interneti të rreme, për shembull.

Kufiri midis botës digjitale dhe realitetit është zhdukur. Kur një thashetheme qarkullon online, ajo mund të shndërrohet në protesta armiqësore ose dhunë.

Rusia nuk është aktori i vetëm i dezinformimit, por ajo mobilizon burime pa krahasueshëm me vendet e tjera. Ajo synon veçanërisht evropianët dhe Francën, duke zgjatur në hapësirën digjitale ofensivën e saj në Ukrainë.

Franca është një target kryesor i manipulimeve dhe ndërhyrjeve digjitale të huaja. Ajo është vendi i dytë më i shënjestruar pas Ukrainës në Evropë, sipas një raporti të Shërbimit Evropian të Veprimit. Në 2024, 152 sulme informative ishin drejtuar kundër Francës, kryesisht në kuadër të Lojërave Olimpike në Paris dhe zgjedhjeve legislative.

Kjo lidhet me dendësinë e lidhjeve të Francës me jashtë dhe mbështetjen e saj të vazhdueshme për një rend ndërkombëtar bazuar në ligj. Konkurrentët e saj e sulmojnë Francën, sepse ajo kundërshton brutalizimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe refuzon përdorimin e forcës pa kufij.

Aktualisht, një aktor i ri i rëndësishëm në sulmet informative ka dalë nga Shtetet e Bashkuara: përdorues dhe llogari online me shumë ndjekës që synojnë në mënyrë të koordinuar çdo zë që konsiderohet disonant. Fushatat aktuale kundër të ashtuquajturave pengesa ndaj lirisë së informacionit në Evropë janë një shembull kryesor. Këto sulme paraqesin një sfidë konkrete për demokracitë tona.

Strategjia e Francës ndaj manipulimeve të informacionit

Franca ka forcuar një sistem reagimi ndaj manipulimeve të informacionit: krijimi i një shërbimi për burime të hapura (Vigium) për të karakterizuar ndërhyrjet digjitale të huaja, sidomos gjatë zgjedhjeve; forcimi i mbrojtjes së operacioneve ushtarake jashtë vendit; përmirësimi i mekanizmave të alarmit dhe reagimit, përfshirë krijimin e një faqeje të quajtur FrenchResponse në X.

Franca mbështet gjithashtu ekosistemet mediatike dhe reziliencën e tyre. Qëllimi është i trefishtë: përmirësimi i mjedisit mediatik; mbështetja e prodhimit të informacionit të besueshëm dhe rrjeteve të verifikuesve të fakteve; forcimi i edukimit mediatik. Ne mbështesim partnerët tanë të besueshëm në Kosovë si dhe në vende të tjera.

Gjithashtu, duhet të mbikëqyrim rregullimin e platformave. Gjatë presidencës franceze të Bashkimit Evropian në 2021, Franca koordinoi miratimin e Digital Services Act (DSA). Ky ligj detyron platformat të pajisen me mjete për luftimin e dezinformimit, sidomos në zgjedhje, dhe të jenë më transparente për algoritmet e tyre. Franca ka denoncuar restriktionet e vizave nga SHBA-ja ndaj personaliteteve evropiane që punuan për këtë ligj. DSA u miratua në mënyrë demokratike në Evropë për ta bërë të paligjshme online atë që është e paligjshme offline. Ky rregull evropian mbron shtetin e së drejtës, debatet demokratike dhe të drejtat e qytetarëve. Ai nuk ka asnjë efekt ekstraterritorial dhe nuk synon ndonjë vend apo kompani specifike. Rregullat që zbatohen në hapësirën digjitale evropiane nuk duhet të përcaktohen jashtë Evropës.



Tollovia në rrugët e Prishtinës është shndërruar në problem kronik dhe me pak shanse që asaj t'i jepet zgjidhje institucionale. Në disa intervale të ditës, qytetarët ankohen se koha e lëvizjes së tyre me vetura e me autobus të Trafikut Urban nga një pikë në tjetër brenda qytetit të Prishtinës zgjat deri në një orë

VITI I RI 2026

Peshorja e Hagës mes luftës çlirimtare dhe akuzave për krime

Të katër ish-anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së janë të mbyllur qe pesë vjet dhe në të gjashtin e presin shpalljen e vendimit. Në njërën anë të peshores qëndrojnë akuzat e prokurorisë për persekutim, burgosje, torturë, vrasje, zhdukje e dhunshme, trajtim çnjerëzor, ndalim arbitrar dhe akte të tjera johumane, e në tjetrën pretendimi i Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit për luftë të drejtë dhe të pastër për liri

Rrezon Gashi

Prishtinë, dhjetor - Kur çekiçi i Charles Smithit do të rrahë, në këmbë, duke e dëgjuar verdiktin, do të jenë katër burra.

Të katërtit janë të mbyllur qe pesë vjet dhe në të gjashtin e presin shpalljen e vendimit.

Në njërën anë të peshores qëndrojnë akuzat e prokurorisë për persekutim, burgosje, torturë, vrasje, zhdukje e dhunshme, trajtim çnjerëzor, ndalim arbitrar dhe akte të tjera johumane, e në tjetrën pretendimi i Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit për luftë të drejtë dhe të pastër për liri.

Aktakuza e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, e konfirmuar më 26 tetor 2020, të katërtit i mban përgjegjës se si anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare dhe Qeverisë së Përkohshme të Kosovës kryen krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Ndonëse në paraburgim prej 5 nëntorit 2020, nisi vetëm më 3 prill 2023.

Artan Qerkini është avokat i akredituar nga Dhomat e Specializuara dhe konsideron që një nga të drejtat e të akuzuara është që të gjykohen në afat të arsyeshëm.

Për Qerkinin, kjo e drejtë është cenuar. “Procedura paraprake ka qenë e stërzgatur, i janë dashtë gjykatës dy vjet vetëm ta kalojë çështjen prej gjyqtarit të procedurës paraprake të trupi gjyqes, ajo ka qenë një kohë shumë e gjatë dhe në kundërshtim me disa parime të së drejtës ndërkombëtare, sepse, sipas tyre, nëse një person gjendet në paraburgim, procedura duhet të përshejtohet”, ka thënë ai.

Prej kur nisi gjykimi e deri në prill të këtij viti, prokuroria për t'i provuar pretendimet ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit i ka thirrur 125 dëshmitarë. Dëshmitari i 126-të, ndonëse ishte planifikuar, nuk u paraqit në gjykatë.

Shumica prej tyre dëshmuar në seanca të mbyllura. Informacioni i vetëm që ndahej me publikun ishte kodi i dëshmitarit, një shkronjë dhe pesë numra. S'u dhanë emra, data e as vende.

Dëshmitari 04500 qe i pari i 2025-tës. Dëshminë e ka dhënë më 14 janar, është betuar në shqip dhe prokurori Cezary Michalczuk ka dhënë një përmbledhje të shkurtër, pas së cilës seanca është mbyllur.

“Në 1999 dëshmitari (W04500) u arrestua nga anëtarë të armatosur të UÇK-së dhe u dërgua në një vend ndalimi ku është marrë në pyetje dhe është rrahur. Është mbajtur i ndaluar me disa persona të tjerë dhe më pas është zhvendosur me disa prej tyre në një vend të dytë ndalimi. Dëshmitari (W04500) u lirua pas rreth një muaji në ambientet e ndalimit”, ka deklaruar Michalczuk.

Avokati Qerkini këtë praktikë e sheh problematike, duke thënë se mungesa e transparencës e pamundëson vlerësimin e besueshmërisë së dëshmimeve nga opinioni publik.

“Opinionin nuk ka pasur mundësi ta vlerësojë vërtetësinë e deklarimeve, pra të gjithë ata që kanë qenë të interësuar nuk kanë pasur mundësi ta përcjellin procesin gjyqësor, sepse i njëjti për të krijuar një tablo të qartë se çka është duke ndodhur, duhet të përcillet në vazhdimësi dhe nuk mund ta krijosh një përshtypje për një dëshmitar, për vërtetësinë e deklaramit të tij, vetëm nëse ka, do të thotë vazhdimësi mund të bëjë një gjë e tillë”, është shprehur Qerkini.

Gjykata i ka arsyetuar masat me nevojën për mbrojtjen dhe sigurinë e dëshmitarëve.



Shtatë dëshmitarët që u ftuan nga mbrojtja ishin të gjithë të huaj, përfaqësues të organizatave e institucioneve ndërkombëtare që në kohën e luftës ishin në terren e në kontakt me të akuzuarit, por edhe patën pozita të rëndësishme në përpjekjet për t'i dhënë fund luftës në Kosovë. Dëshmitari i parë ishte James Rubin, këshilltar i lartë i sekretares amerikane Madeline Albright dhe zëdhënës i Departamentit Amerikan të Shtetit gjatë luftës në Kosovë dhe i fundit, Wesley Clarkut, që gjatë luftës mbante pozitën e ish-komandantit suprem të Forcave Aleate të NATO-s për Evropë

Megjithatë, gjatë vitit pati edhe dëshmitarë që dëshmuar në seanca publike, përfshirë ish-komandantin e përgjithshëm të UÇK-së, Sylejman Selimi, i thirrur nga prokuroria.

Ai, sikurse edhe shumë dëshmitarë të tjerë me pozita komanduese gjatë luftës, kishte statusin e të dyshuarit deri në ditën e dëshmisë.

Qerkini ishte avokati i tij gjatë dëshmisë së dhënë në shkurt. Ai ka thënë se gjatë procesit ka kundërshtuar atë që e quan lojëra procedurale të prokurorisë, lidhur me statusin e dëshmitarëve.

“Të drejtat e dëshmitarit në procedurë dhe të drejtat e të dyshuarit në procedurë nuk janë të njëjta. Për shembull, i dyshuari nuk përgjigjet edhe nëse nuk e flet vërtetën. Dëshmitari ka përgjegjësi penale nëse nuk e flet të vërtetën. Tash një person nuk mund të jetë edhe dëshmitar, edhe i dyshuar. Prandaj insistimi ka qenë që të sqarohet pozita procedurale e atij personi në mënyrë që të vazhdohet tutje me procedurën”, ka deklaruar ai.

Selimi, Sokol Bashota, Shukri Buja, Halil Çadraku e të tjerë ish-komandantë në UÇK, pasi kanë përfunduar dëshminë në Hagë, kanë dhënë njoftimin se hetimi ndaj tyre ka pushuar.

Profilin e lartë i dëshmitarëve të mbrojtjes

Më 15 prill, prokuroria ka njoftuar se ka mbyllur çështjen.

Gjatë verës, mbrojtja e të katër të akuzuara ka dorëzuar një parashtrësë në Gjykatë, me kërkesën që të gjitha krimet e pretenduara para majit 1998 dhe pas 20 qershorit 1999 të largohen nga aktakuza, pasi në atë periudhë nuk ka ekzistuar një konflikt i armatosur dhe rrjedhimisht të akuzuarit nuk mund të ndiqen për krime lufte.

Kryetari i trupit gjyqes, Charles Smith, më 14 korrik e ka rrëzuar këtë kërkesë duke vendosur që akuzat nuk mund të hiqen në fazë të procedurës, por duhet të shqyrtohen deri në fund të gjykimit për të parë nëse ato qëndrojnë apo jo.

Pasi është përmbyllur pushimi i verës, e pasi për dy vjet prokuroria ka shteruar të gjitha argumentet për ta vërtetuar aktakuzën, koha i erdhi

mbrojtjes t'i thërrasë dëshmitarët e t'i paraqesë provat që ua heqin Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit përgjegjësinë për krime lufte e krime kundër njerëzimit si ndërmarrje e përbashkët kriminale, ashtu siç pretendohet në aktakuzë.

Organi i akuzës pretendon se që të katër, bashkë me anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm dhe Qeverisë së Përkohshme të Kosovës - e krijuar pas Konferencës së Rambujesë, me qëllim marrjen e kontrollit dhe pushtetit kanë kryer krime në periudhën mars 1998-shtator 1999.

Prokuroria pandeh se katërshtja ka qenë e përfshirë drejtpërdrejt në disa krime, dhe gjithashtu mban përgjegjësi për krimet e tjera të kryera nga anëtarë të UÇK-së, për shkak të përgjegjësisë komanduese në Shtabin dhe Qeverinë e Përkohshme.

Por, shtatë dëshmitarët që u ftuan nga mbrojtja ishin të gjithë të huaj, përfaqësues të organizatave e institucioneve ndërkombëtare që në kohën e luftës ishin në terren e në kontakt me të akuzuarit, por edhe patën pozita të rëndësishme në përpjekjet për t'i dhënë fund luftës në Kosovë.

Dëshmitari i parë ishte James Rubin, këshilltar i lartë i sekretares amerikane Madeline Albright dhe zëdhënës i Departamentit Amerikan të Shtetit gjatë luftës në Kosovë. Pas tij dëshmoi Paul Williams, këshilltar i delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë, pastaj John Duncan, këshilltar i Wesley Clarkut, dhe James Covey, zëvendës shef i misionit të UNMIK-ut. Christopher Hill, ish-përfaqësues special i Shteteve të Bashkuara për Kosovë gjatë luftës, ishte dëshmitari i pestë, dhe dy të fundit ishin Michael Durkee, këshilltar për çështje ndërkombëtare i Wesley Clarkut - dëshmitar i fundit i mbrojtjes, që gjatë luftës mbante pozitën e ish-komandantit suprem të Forcave Aleate të NATO-s për Evropë.

Për avokatin Artan Qerkini, ky profil i dëshmitarëve tregon strategjinë e mbrojtjes që ata të ofrojnë edhe ekspertizë, për t'iu kundërvënë akuzave.

“Janë thirrur dëshmitarë me kredibilitet shumë të lartë si njerëz, profesional, po ashtu edhe kanë qenë kredibil edhe për shkak të peshave të pozitave të tyre që ata i kanë mbaj-

tur në kohën e luftës dhe ta zëmë është dëgjuar dëshmitar edhe zoti Wesley Clark. Ai nuk ka shërbyer vetëm si dëshmitar, po edhe si ekspert i çështjeve ushtarake, sepse një gjeneral i Forcave Ajrore të NATO-s nuk mund t'i thuash se nuk është ekspert i çështjeve ushtarake”, ka thënë Qerkini.

Në ditën e parë të dëshmisë së tij në Hagë, më 15 shtator, ish-zëdhënësi i DASH-it, James Rubin, ka deklaruar se nuk ka pasur kurrë informata për përfshirjen e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në krime lufte.

Dëshmitari i parë i propozuar nga mbrojtja ka thënë se nëse do të merre informata të tilla, mbështetja amerikane për Ushtrinë Çlirimtare dhe shqiptarët do të tërhiqej.

Ai tek ka dëshmuar për rolin e Thaçit gjatë Konferencës së Rambujesë dhe gjatë procesit të çarmatosjes së UÇK-së, ka deklaruar se ai ishte fytyra e gueriles, por vendimet merreshin në grup.

“Ai ishte një person që i ishte caktuar detyra të komunikonte me ne nga udhëheqja kosovare siç ishte asokohe. Ne nuk e kishim kuptuar mirë se si funksiononte struktura udhëheqëse, por e kishim të qartë se ai nuk kishte autoritet e as mundësi të diktonte asgjë, por thjesht pasqyronte vendimet që merreshin nga ajo zyra diku e fshehur, ajo zyra e udhëheqjes shqiptare që merrte vendime në grup dhe që nuk ishin gjithmonë të pranishëm, kështu që ai duhej ta merrte lejen prej tyre”, ka thënë Rubin.

E ish-komandanti suprem i Forcave Aleate të NATO-s për Evropë, Wesley Clark, në dëshminë e tij të dhënë më 17 nëntor ka deklaruar se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte e forcë e vetorganizuar dhe përbëhej prej grupeve lokale të armatosura të shqiptarëve, krijimi i të cilave është nxitur nga rritja e represionit të Serbisë.

“Nuk kishte shumë informacion, s'kishte shumë gjëra për të folur sa i takon komandës (së UÇK-së në verë dhe vjeshtë të 98-s v.j.). Me sa dinim ne, bëhej fjalë për grupe lokale të cilat ishin formuar pak a shumë në mënyrë spontane në përgjigje ndaj shtypjes serbe prej shumë e shumë vjetësh”, ka thënë Clark.

Për avokatin Qerkini, dëshmia e Rubinit, Clarkut dhe dëshmitarëve të

tjerë ilustron strategjinë e mbrojtjes: ajo nuk synonte të kontestonte çdo pretendim të aktakuzës, por të sfidonte veçanërisht pretendimin e prokurorisë se të akuzuarit dinin dhe duhej të dinin për krimet e pretenduara, si dhe se kishin kompetenca dhe përgjegjësi për to.

“Qëllimi i mbrojtjes ka qenë që të rrëzohen pikat e aktakuzës në lidhje me përgjegjësinë penale. Pra mbrojtja asnjëherë nuk ka pretenduar se nuk kanë ndodhur disa krime, por mbrojtja ka kundërshtuar gjithmonë përgjegjësinë penale dhe prokuroria ka pretenduar se forma e përgjegjësisë penale është ndërmarrja e përbashkët kriminale dhe përgjegjësia komanduese”, ka thënë Qerkini.

Fundi i një procesi maratonik që mund të shënojë edhe fundin e vetë Speciales

Me gjeneralin Clark mbrojtja ka përfunduar çështjen e saj. Kjo u hapi rrugë zhvillimeve të tjera procedurale, që e bën të parashikueshme edhe datën e shpalljes së aktgjykimit.

Trupi gjyqes ka caktuar datën 19 janar 2026 kur palët duhet t'i dorëzojnë dosjet gjyqësore përfundimtare, ndërsa mbrojtja e viktimave duhet ta deponojë deklaratën për ndikimin e krimeve të supozuara te 155 viktimat pjesëmarrëse në rast.

Fjala përfundimtare është caktuar të jepet nga 9 deri më 13 shkurt.

Pas kësaj gjyqtarët mbyllin çështjen dhe kanë kohë 90 ditë ta shpallin vendimin. Nëse rrethanat e kërkojnë, ky afat mund të zgjatet edhe për 60 ditë, e që nënkupton se më së largu në gjysmën e korrikut do të kumtohet veredikti i Gjykatës.

Ky është rasti më i madh i Speciales, por edhe çështja gjyqësore më e madhe në historinë e Kosovës. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë themeluar në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe janë pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por veprojnë me personel ndërkombëtar në Holandë.

Formimi i tyre u bë pas raportit të Dick Martyt për Këshillin e Evropës më 2010, i cili pretendonte për kryerjen e krimeve nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, duke përfshirë edhe akuzat për trafikim organesh. Hetimi i kryer nga prokurori amerikan Clint Williamson në vitin 2014 nuk e ka konfirmuar këtë pretendim, por ka evidentuar krime të tjera lufte.

Me rrahjen e çekiçit të Charles Smithit, dikur në gjysmën e parë të 2026-s, ai epilogun do t'ia japë edhe vetë Gjykatës. Për Qerkinin, mosngritja e aktakuzave të reja dhe pushimi i hetimeve janë tregues që me shpalljen e aktgjykimit ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi, ish-kryekuvendarëve Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi dhe ish-shefit të grupit parlamentar të Vetëvendosjes, Rexhep Selimi, Speciajla e përfundon mandatin, duke i llogaritur edhe shkallët e tjera, ku palët mund ta apelojnë vendimin.

Me mbylljen e këtij procesi maratonik, jo domosdoshmërisht do të shënohet edhe fundi i ekzistimit të Gjykatës Speciale. Sipas një përgjigjeje për KOHËN, mandati i Dhomave të Specializuara konsiderohet i përmbyllur vetëm kur Këshilli i Bashkim-it Evropian njofton zyrtarisht Kosovën për përfundimin e të gjitha procedurave. Kjo përfshin edhe fazën e apeleve, ku secila palë ka të drejtë të kundërshtojë verediktin.

Por para se Speciajla të përfundojë me mandatin e saj, katër burrat e akuzuar duhet të ngrihen në këmbë dhe të dëgjojnë verediktin.

PERISKOPI

Trëndafil i Rilkes

Si u bë një poet i hapësirës kozmike ikonë e pop-kulturës dhe idhull i të rinjve në kërkim të vetvetes? Shënime në 150-vjetorin e lindjes së poetit austriak Rainer Maria Rilke



Enver Robelli

Poeti i madh austriak Rainer Maria Rilke (u lind më 4 dhjetor 1874) ka qenë një udhëtar i madh. Më 1919 ai erdhi në Zvicër për të mbajtur një referat; arsyeja e vërtetë ishte se dëshironte të ikte nga atmosfera e zymtë që mbretëronte në Gjermani e Austri pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore.

Afër Zürichut ai njohu Nanny Wunderly-Volkart (1878–1962), një grua të pasur, bujare dhe të interesuar për kulturën. Ajo e mbështeti Rilken financiarisht nga viti 1919 deri në vdekje, i siguroi atij vende të këndshme për të shkruar dhe jetuar; natyrisht, këtu përfshihej edhe shërbimi i dëshiruar prej tij.

Raporti i Nanny Wunderly-Volkart me Rilken ishte plot besim dhe është dokumentuar edhe në letërkëmbimin e tyre, të botuar më 1977. Me kërkesën e Rilkes, zonja zvicerane mbështeti madje edhe të dashurën e tij, piktoresh Baladine Klossowska, një nënë e divorcuar dhe pa mjete financiare, e cila kishte dy fëmijë. Rilke jetoi disa vite në Zvicër, kryesisht në kantonin e Wallisit, ku vdiq më 29 dhjetor 1926 dhe u varros në fshatin Raron.

A ka qenë Rilke në Davos? Kjo ishte një pyetje që më shkrepri në mendje ndërsa, në fillim të muajit – më 4 dhjetor, në 150-vjetorin e lindjes së Rainer Maria Rilkes – bashkë me fotografën Visar Kryeziu po shkonim për të ecur në Davos, në këtë qendër të njohur të turizmit alpin helvetik. Përgjigjia është: jo, Rilke s'ka qenë në Davos.

Por kjo nuk është e vërteta e plotë. Rilke ka qenë në kantonin Graubünden, të cilit i përket Davosi. Ai qëndroi në fshatin Soglio, i zgjedhur më 2015 si fshati më i bukur i Zvicrës. Rilkes nuk iu duk ashtu. S'i pëlqeu aq. Profesori Manfred Koch, i cili ka shkruar një biografi gati 600-faqëshe të Rilkes, i tha së fundi një gazete të Zvicrës lindore se poetit nuk i pëlqeu peizazhi malor. Rilke ishte poet i hapësirës kozmike (Weltraumdichter) dhe preferonte vendet ku kishte shumë qiell mbi kokë. Malet e kantonit Graubünden i quajti “bjeshtë të marra, pengesa impozante, por jo më të mençura se ndonjë derë e mbyllur”.

Nuk është befasi e madhe që Rilke një pjesë të mirë të punës së tij poetike e ka kryer në Kalanë e Duinos, një

fshat afër Triestes, ku më 2 prill 1879 u lind aktori i ardhshëm i famshëm i botës gjermane, Aleksandër Moisiu, i cili qe me origjinë shqiptare. Nga ballkoni, ku Rilke shkroi disa nga Elegjitë e Duinos (ose Elegjitë duineze), pamja e detit të Adriatikut është impozante. Në fshatin zviceran Soglio, Rilke jetoi në Pallatin Salis, dikur rezidencë e familjes fisnike Salis. Rilke gjatë tërë jetës ishte i magjepsur me botën e fisnikërisë europiane. Në Palazzo Salis Rilke mund të shfrytëzonte bibliotekën e vjetër, një privilegj që edhe sot e kanë pak njerëz.

Elegjitë e Duinos janë kryevepra e tij poetike dhe një sfidë për pothuaj çdo lexues e lexuese. Ato janë të lidhura fort me tematikën e përjetësisë, vdekjes, zhdukjes dhe kuptimit të ekzistencës njerëzore në epokën moderne. Për t'i shkruar ato, Rilkes iu deshën dhjetë vjet. Frymëzimi i erdhi në fillim të vitit 1912, kur në Kalanë Duino dëgjoi “një zë”, i cili ia diktoi vargjet e para. Viti 1922 është mjaft i begatshëm sa i përket letërsisë: atë vit u botuan jo vetëm Elegjitë e Duinos të Rilkes, por edhe romani epokal Uliksi i James Joyce dhe kryevepra poetike Toka e shkretë e T. S. Eliot.

Rilke e kaloi jetën në kërkim të vazhdueshëm. Në Paris u ballafaqua me modernitetin dhe mjerimin. Aty u inspirua për romanin e tij të vetëm Shënimet e Malte Laurids Brigge. Në vëllimin me poezi Libri i Orëve Rilke zhvilloi një dialog me Zotin, duke e parë atë si një njësi që formohet dhe banon brenda nesh. Në vitet 1905/06 Rilke ishte sekretar i skulptorit francez Auguste Rodin. Njohja me piktorin moderne të Paul Cézanne ndikoi që Rilke ta shohë botën në thellësinë e saj. Nga ky shikim ai formuloi vargun e famshëm “Ti duhet ta ndryshosh jetën tënde” (te poezia “Torzo arkaik i Apolonit”). Sot Rilke është shndërruar në një ikonë të pop-kulturës dhe idhull i të rinjve në kërkim të vetvetes.

Në gurin e varrit të Rilkes është i gdhendur ky shënim: “Trëndafil, o kundërshti e pastër”. Lexues e kritikë letrarë me vite e dekada kanë spekuluar dhe figuruar se ku e ka burimin kjo porosi. Para disa vitesh është zbuluar sekreti. Në pullazin e Kalasë së Duinos janë gjetur ditarët e mikeshës së Rilkes, princeshës Marie von Thurn und Taxis. Aty ajo përshkruan debatet e ashpra me poetin, i cili në kalanë e saj shkruante Elegjitë e Duinos. Lartmadhërisë Marie von Thurn und Taxis nuk i pëlqente gjuha me lule në poezitë e Rilkes. “Vazhdimisht shfaqen lule në poezitë e tua”, i kishte thënë ajo Rilkes, “këtu një narcis, atje një kamelie dhe atje një trëndafil. Oh Rainer! Unë e kundërshtoj këtë!” Këtu e ka zanafillën shënimin në gurin e varrit të Rilkes: “Trëndafil, o kundërshti e pastër”!

Kur gjithçka mund të përmbysset – Një shënim për edukimin medial

Historia ofron mësim të vlefshme. Kur Finlanda fitoi pavarësinë në vitin 1917, ajo u përball me sfida të mëdha, por ajo bëri një zgjedhje strategjike që do të përcaktonte fatin e saj. Vendosi që njerëzit t'i trajtojë si potencialin e saj më të madh. Vendi investoi fuqishëm dhe në mënyrë të vazhdueshme në arsim, përgatitjen e mësuesve, aftësitë qytetare dhe të nxëniet gjatë gjithë jetës. Me kalimin e kohës, ky përkushtim e shndërroi Finlandën në një nga demokracitë më të qëndrueshme në botë



Evamari Laaksonen

Ndërsa dritat festive ndriçojnë bulevardin “Nënë Tereza”, viti 2025 po i afrohet fundit. Ky është një moment i përshtatshëm për reflektim, për të bërë bilancin e vitit që po lëmë pas dhe për të nxjerrë mësimet që ai ka ofruar. Për lexuesit e Koha Ditore, ky ka qenë pa dyshim një vit i ngarkuar në peizazhin mediatik, i shënuar si nga arritje ashtu edhe nga sfida. Për të gjithë ne si përdorues të mediave, tani është koha e duhur për të reflektuar mbi arsimimin medial, kompetenca mediatike dhe të menduarit kritik — aftësi që nuk janë më abstrakte apo “të buta”. Sot, ato përbëjnë themelin e qëndrueshmërisë kombëtare, stabilitetit demokratik dhe sigurisë afatgjatë.

Ky vit ka qenë gjithashtu një vit festimi. Finlanda ka shënuar 80-vjetorin e librave të dashur Moomin nga autorja finlandeze Tove Jansson. Jansson nisi t'i shkruante tregimet e Moomin gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur Evropa ishte thellësisht e trazuar dhe siguria e njerëzve të saj rëndë e kërcënuar. Shkrimi i mundësoi asaj të imagjinonte një botë më të mirë dhe më të sigurt. Moominët, ata trollë të bardhë, të ngjashëm me hipopotamë, që jetojnë në Luginën e Moominëve, formojnë një komunitet të larmishëm që jeton në paqe dhe e trajtojnë njëri-tjetrin si të barabartë. Në shumë aspekte, ata pasqyrojnë vlerat thelbësore të Finlandës: barazinë, përfshirjen dhe pranimin, me një nuancë të lehtë të tuhaflëkut finlandez. Në Moominpappa at Sea (1965), Jansson e përshkruan me qartësi goditëse absurditetin, ankthin dhe paparashikueshmërinë e jetës: “Sa emocionuese është të jesh gjallë,” mendoi Moominpappa. “Gjithçka mund të përmbysset për një çast — pa asnjë arsye”. Këto fjalë tingëllojnë fuqishëm edhe sot.

Gjatë gjithë vitit 2025, jetët tona janë formësuar përditë nga ajo që shohim,

ndajmë dhe besojmë. Informacioni ka lëvizur më shpejt se kurrë dhe narrativat kanë kapërcyer kufijtë brenda sekondash. Në epokën digjitale, siguria nuk përkufizohet më vetëm nga ushtritë, kufijtë apo sistemet e mbrojtjes. Gjithnjë e më shumë, ajo varet nga mënyra se si shoqëritë lundrojnë në xhunglën digjitale — nga mënyra se si qytetarët e interpretojnë informacionin, reagojnë ndaj narrativave dhe i rezistojnë manipulimit. Në momente të caktuara, ndjesia vërtet ka qenë e tillë sikur gjithçka mund të përmbysset për një çast.

Historia ofron mësim të vlefshme. Kur Finlanda fitoi pavarësinë në vitin 1917, ajo u përball me sfida të mëdha — faktorë që edhe sot e formësojnë vendin, përfshirë burime të kufizuara, një klimë të ashpër dhe një pozicion gjeopolitik të vështirë. E ardhmja dukej e pasigurt. Finlanda bëri një zgjedhje strategjike që do të përcaktonte fatin e saj. Vendosi që potenciali i saj më i madh qëndronte te njerëzit. Vendi investoi fuqishëm dhe në mënyrë të vazhdueshme në arsim, përgatitjen e mësuesve, aftësitë qytetare dhe të nxëniet gjatë gjithë jetës. Me kalimin e kohës, ky përkushtim e shndërroi Finlandën në një nga demokracitë më të qëndrueshme në botë.

Edukimi medial u bë pjesë qendrore e këtij vizioni. Në Finlandë, ai kurrë nuk është trajtuar si një lëndë periferike apo shtesë opsionale. Sot, ai është i integruar në të gjithë sistemin arsimor, nga fëmijëria e hershme deri te mësimi i të rriturve. Nxënësit mësojnë se si funksionojnë mediat, si ndërtohen narrativat dhe si të jenë konsumues edhe si krijues të përgjegjshëm të përmbajtjes. Ky investim afatgjatë ka dhënë fryte. Finlanda renditet vazhdimisht ndër vendet më rezistente në Evropë ndaj dezinformimit dhe ndikimit të huaj, jo sepse kufizon informacionin, por sepse qytetarët e saj janë të përgatitur se si të navigojnë në mënyrë kritike dhe me vetëbesim.

Në disa aspekte, Kosova gjendet në një udhëkryq të ngjashëm. Si një demokraci e re, ajo përballlet me sfida të konsiderueshme informative. Fushatat e dezinformimit, narrativat polarizuese dhe manipulimi digjital janë rreziqe të vazhdueshme. Të rinjtë, pjesa më e konektuar e shoqërisë, gjenden në qendër të këtij realiteti. Për Kosovën, vendin me një nga popullsitë më të reja në Evropë, kjo ndonjëherë paraqitet si një cenueshmëri.

Por, kjo mund të shihet edhe ndryshe - si diçka që në të vërtetë edhe është: një mundësi e fuqishme. Kosova zotëron një aset të paçmueshëm: një popullsi që është e aftë në aspektin digjital, është energjike dhe e përfshirë, si dhe e etur për të mësuar, për të marrë pjesë dhe për të formësuar të ardhmen. Të rinjtë sjellin kreativitet, përshtatshmëri dhe momentum: përbërësit thelbësorë për ndryshim kuptimplotë. Ka hapësirë që sistemi arsimor dhe diskursi publik ta njohin dhe ta mbështesin më tej këtë potencial. Investimi te njerëzit, veçanërisht te të rinjtë, sjell kthimin më të lartë që mund të bëjë çdo shoqëri.

Edukimi medial nuk ka të bëjë thjesht me demaskimin e lajmeve të gënjera apo identifikimin e videove të gënjera nga inteligjenca artificiale. Qëllimi i tij është shumë më ambicioz. Në Finlandë, synimi i promovimit të edukimit medial është mbrojtja e një demokracie funksionale, të shëndetshme dhe të qën-

drueshme. Aftësitë e forta mediale i bëjnë shoqëritë më të forta, më të përshtatshme dhe më kohezive. Është thelbësore: këto shkathtësi duhet të zhvillohen në kohë stabiliteti, në mënyrë që, kur të lindin kriza, qytetarët të jenë të përgatitur të reagojnë me maturi, t'i rezistojnë manipulimit dhe të navigojnë pasigurinë me vetëbesim.

Përvoja e Finlandës tregon se investimi te njerëzit mund ta riformësojë fatin e një kombi. Kosova ka sot të njëjtin mundësi: duke i dhënë përparësi edukimit medial, të menduarit kritik dhe fuqizimit të të rinjve, ajo mund të forcojë sigurinë, demokracinë dhe stabilitetin e saj afatgjatë. Kjo qasje përputhet me aspiratat demokratike të përbashkëta të Kosovës dhe Finlandës. Një demokraci e shëndetshme varet nga qytetarët të informuar, të cilët mund të marrin vendime të arsyetura, t'i mbajnë institucionet përgjegjëse dhe të angazhohen me respekt ndaj pikëpamjeve të ndryshme. Të rinjtë me edukim medial bëhen votues më të mirë, udhëheqës më të fortë të komunitetit dhe mendimtarë më inovativë.

Në vitin 2026, ky fokus i përbashkët do të çojë përpara bashkëpunimin praktik. Përmes projektit “Avancimi i edukimit medial dhe luftimi i dezinformimit dhe kërcënimeve të sigurisë së të dhënave me ekspertizë nordike në Kosovë”, Ambasadat e Finlandës dhe Suedisë, së bashku me Konsullatën e Përgjithshme Mbretërore të Nderit të Norvegjisë, do të punojnë me partnerë kosovarë për t'i forcuar aftësitë që e ndihmojnë shoqërinë për të qenë e qëndrueshme në një mjedis informativ të paqëndrueshëm. Projekti nis nga një vëzhgim i thjeshtë: dezinformimi dhe siguria e dobët digjitale ndikojnë shumë më tepër sesa vetëm politika apo mediat. Ato formësojnë besimin e përditshëm, kohezionin shoqëror dhe madje edhe besimin për të investuar dhe për të bërë biznes. Në vend që të ofrojnë zgjidhje të gatshme, iniciativa nxit shkëmbimin — duke bashkuar ekspertë nordikë dhe kosovarë për të ndarë përvoja dhe për t'i përshtatur mësimet me realitetet vendore.

Aktivitetet e planifikuara përfshijnë dy konferenca të nivelit të lartë mbi edukimin medial, dezinformimin dhe sigurinë digjitale, si dhe punë me shkollat në disa komuna, përfshirë jashtë kryeqytetit dhe në komunitetet pakicë. Nxënësit, arsimtarët, gazetarët, shoqëria civile, zyrtarët publikë dhe bizneset do të jenë të gjithë pjesë e diskutimit me ekspertë nordikë që do të kontribuojnë përmes ligjëratave dhe dialogut. Qëllimi është praktik: të arrihen rreth 700 pjesëmarrës, të thellohet kuptimi mbi mënyrën se si funksionon dezinformimi dhe të ndërtohet bashkëpunim që do të vazhdojë edhe përtej vitit 2026. Nëse edukimi medial është një investim afatgjatë në qëndrueshmërinë demokratike, ky projekt ka të bëjë me shndërrimin e vetëdijes në shprehje - dhe të besimit në diçka që mund të zgjasë.

Me këtë shpresë, u uroj të gjithë lexuesve të Koha Ditore një Vit të Ri të mbarë. Uroj që artikujt që lexoni të jenë të thelluar, përmbajtja që ndani të bazohet në fakte, dhe që paqja — si digjitale ashtu edhe reale — të shtrihet nga Ballkani deri në vendet nordike dhe në mbarë botën.

Autorja është Ambasadore e Re-publikës së Finlandës në Kosovë.



Posta e Kosovës në nëntor të vitit 2025 ka marrë kontrollin e objekteve në Graçanicë dhe Shtërpçë, ku operante Posta e Serbisë. Posta e Kosovës ka njoftuar se pas finalizimit të procedurave ligjore, këto prona, që ishin shfrytëzuar nga një operator ilegal, janë regjistruar si pronë e ligjshme e Postës së Kosovës. Ky objekt u mbyll në kuadër të një aksioni të gjerë për shuarjen e institucioneve në jug të Ibrit, që funksiononin sipas sistemit të Serbisë

VITI 2026

Fluturojnë, fluturojnë... çmimet

Të dhënat zyrtare dhe vlerësimi i ekonomistëve nxjerrin përfundimet sipas të cilave rritja e çmimeve në vitin 2025 nuk është vetëm fenomen inflacioni, por pasqyrim i dobësive strukturore të ekonomisë së Kosovës: varësia nga importi, mungesa e prodhimit vendor konkurrues, kostot e larta të energjisë dhe mungesa e instrumenteve për mbrojtjen e konsumatorit. Kosova vazhdon të mbetet prapa vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe larg mesatares së Bashkimit Evropian në shumicën e treguesve ekonomikë dhe socialë

Sanie Jusufi

Rritja e çmimeve u shndërrua në një nga shqetësimet kryesore të qytetarëve në vitin 2025, krahas krizës politike dhe mungesës së institucioneve funksionale. Inflacioni, i cili në janar ishte 1.5 për qind, arriti në 5.3 për qind në fund të vitit, duke reflektuar një rritje të fortë të çmimeve të ushqimeve, energjisë dhe shërbimeve bazike. Kjo rritje nuk u shoqërua me rritje proporcionale të të ardhurave, duke ushtruar presion mbi fuqinë blerëse të qytetarëve. Përveç rritjes së sasisë së mallrave të importuara e rritjes së çmimeve të produkteve vendore, rritja e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve bazë është shoqëruar edhe me dyshime serioze për abuzime nga tregtarët.

Vezët artikull “luksi”

Produktet ushqimore ishin ndër kontribuuesit kryesorë të inflacionit. Një nga shembujt më domethënës është rritja e çmimit të vezëve, të cilat për shumë familje u shndërruan në produkt “luksi”. Çmimi për 30 copë vezë u rrit nga 3.41 euro në fillim të vitit në 5.45 euro në dhjetor, një rritje prej rreth 60 për qind. Rritje gati dyshifrore u regjistruan edhe te vaji ushqimor, mishi i pulës dhe i gjedhit, si dhe te produktet e bukës.

Kjo rritje e çmimeve ka ndikuar drejtpërdrejt në standardin e jetesës, veçanërisht te pensionistët, familjet me asistencë sociale dhe punëtorët me paga të ulëta, të cilët detyrohen të reduktojnë cilësinë e ushqimit apo të heqin dorë nga shpenzime të tjera esenciale, si shëndetësia dhe arsimi.

Pamundësia e përballimit të kostos ka vënë në vështirësi një pjesë të konsideruar të qytetarëve.

“E kam një djalë që më ndihmon se sa për pension nuk kisha mundur t’i mbuloj se është shtrenjtuar gjithçka... 100 për qind kanë hipur çmimet krahasuar me vjet. Buka është shtrenjtuar 100 për qind, mielli. Në bukë kur na ka prek, po në tjerat”, thotë pensionisti Sabit Klinaku.

Me këtë kosto jetese, sipas qytetarit tjetër, Sokol Avdiut, pagat duhet të jenë minimum 1 mijë euro.

“Më lartë nuk e di se ku shkon më. Nuk e di ku po i marrin paratë. Për të jetuar, duhen së paku 1000 euro, për të jetuar qysh duhet. Nuk ka shanse të tubohen (para) edhe për të blerë diçka... krejt (çmimet) janë dyfishuar, trefishuar – pemë, perime e përpjetë. Këtu dola, prej aty e deri këtu i harxhova 50 euro, sikur me t’i marr dikush në xhep”, është shprehur Avdiu.

Dyshimet për abuzim nga tregtarët

Përveç faktorëve të jashtëm, rritja e çmimeve është shoqëruar edhe me dyshime serioze për abuzime nga tregtarët. Autoriteti i Konkurrencës ka evidentuar tendenca të rritjes së koordinuar të çmimeve për produkte të caktuara, përfshirë bukën, pemët, perimet dhe vajin ushqimor.

Megjithatë, mungesa e kuorimit të plotë në Komisionin e këtij Autoriteti dhe mosfunksionimi i Kuvendit që nga janari 2025 kanë pamundësuar marrjen e vendimeve ndëshkuese. Në praktikë, kjo ka lënë konsumatorët pa mbrojtje institucionale.

Inspektori i Autoritetit të Konkurrencës, Egzon Berisha, thotë se ndëshkimet dhe procesi i hetimeve për dyshimet mbi çrregullime të konkurrencës merren nga Komisioni i Autoritetit. Aktualisht sipas tij po monitorohen çmimet e 21 pro-



Foto: Driton Paçarada

Rritja e çmimeve lidhet ngushtë edhe me strukturën e ekonomisë së Kosovës, e cila mbetet e varur nga importi. Deri në nëntor 2025, importet arritën në mbi 6.3 miliardë euro, me rritje të ndjeshme nga vendet si Gjermania, Turqia dhe Kina. Veçanërisht importet nga Kina u rritën me mbi 85 për qind krahasuar me vitin 2021

dukteve bazë të shportës së konsumatorit. Referuar monitorimit, ai ka thënë se disa nga indikatorët tregojnë për abuzime me çmime nga rrjetet e marketeve.

“I caktojnë marzhat e fitimit, i caktojnë çmimet e shitjes, i caktojnë furnizimet dhe e krijojnë në pozitë dominuese në atë zonë, duke pamundësuar konkurrencën e lirë”, tha ai.

Berisha tregon se si janë vërejtur ndryshime të koordinuara të çmimit të bukës dhe produkteve tjera të miellit nëpër furra, gjatë një monitorimi të bërë në qershor.

“Përveç bukës, e cila ka pasur një rritje në të gjithë territorin e Kosovës, rritje të tillë kanë pasur edhe pemët e perimet, sidomos në periudhën e fundit, po ashtu edhe artikujt e shportës bazike, siç janë vaji ushqimor, kanë shënuar rritje të konsiderueshme në raport me vitin e kaluar”, deklaroi Berisha.

Në “tregun e lirë”, autoritetet shtetërore janë të kufizuar të ndër-marrin veprime rregullatore. Një përpjekje Qeveria e ka bërë më 22 tetor 2022 kur në Kuvend u miratua Ligji për çmimet tavan. Ligji parashihte të adresonte shqetësimin e qytetarëve për rritjen e paarsyeshme dhe të menjëhershme të të gjitha çmimeve. Ky ligj i kundërshtua nga partitë opozitare, dhe po nga to u dërgua për interpretim në Kushtetuese. Një vit e një muaj pas miratimit, Kushtetuesja e rrëzoi atë.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, subjekti i të cilit synon edhe një mandat qeverisje ka premtuar një pako të re “antiinflacioni” në vlerë prej 200 milionë eurosh. Mbështetja sipas tij, do të jetë e përnjëhershme për pensionistët, fëmijët që marrin shtesa, studentët dhe punëtorët e sektorit privat. Kjo masë ishte zbatuar edhe në fund të vitit të kaluar, në prag të fushatës për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit.

E si përgjigje kritike ndaj politikave pesëvjeçare të Qeverisë Kurti, partitë tjera politike kanë prezan-tuar të tjera zgjidhje. PDK-ja është zo-

tuar për uljen e tatimit për produkte esenciale dhe heqjen e TVSH-së për energji. Reduktim të TVSH-së për produktet bazë ka premtuar LDK-ja.

Importet mbi 6.3 miliardë euro, prodhimi vendor në rënie

Rritja e çmimeve lidhet ngushtë edhe me strukturën e ekonomisë së Kosovës, e cila mbetet e varur nga importi. Deri në nëntor 2025, importet arritën në mbi 6.3 miliardë euro, me rritje të ndjeshme nga vendet si Gjermania, Turqia dhe Kina. Veçanërisht importet nga Kina u rritën me mbi 85 për qind krahasuar me vitin 2021. Derisa në vitin 2021 importet nga ky shtet ishin 452 milionë euro, në vitin 2025 ato kanë arritur në 841 milionë euro. Kjo shumë tashmë ka tejkaluar vlerën e importeve nga vendet anëtare të CEFTA-s – Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnjë- Hercegovina dhe Moldavia – disa prej të cilave kanë qenë ndër partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës.

Në të njëjtën kohë, eksportet kosovare shënuan rënie prej rreth 30 milionë eurosh, duke dëshmuar dobësimin e prodhimit vendor. Rritja e çmimit të energjisë elektrike dhe dalja në treg të lirë të energjisë kanë rritur ndjeshëm kostot e prodhimit, duke e bërë sektorin vendor më pak konkurrues ndaj produkteve të importuara.

Sipas ekonomistëve, kjo ka krijuar “inflacion të brendshëm”, ku çmimet e prodhimit vendor rriten pavarësisht rënies së çmimeve të importeve në tregjet ndërkombëtare, kryesisht për shkak të kostove të larta të energjisë dhe pasigurisë politike. Për pasojë është shënuar edhe rënie e eksporteve prej afro 30 milionë euro.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, e “fajëson” daljen e detyruar të kompanive të mëdha në tregun e lirë të energjisë.

“Ne nuk po arrijmë as ta zgjerojmë tregun me produktet tona dhe as ta ulim importin. Këtë situatë e kemi

alarmuar herët. Kemi paralajmëruar se çmimi i energjisë elektrike do të ndikojë që produktet e huaja ta pushtojnë tregun e Kosovës, ndërsa prodhuesit vendorë nuk do të mund të mbijetojnë. Këtu shtohen edhe barrierat e tjera, mungesa e sigurisë politike dhe juridike, si dhe vështirësia për të gjetur partnerë të huaj”, thotë Rafuna.

Ekonomisti Edison Jakurti vlerëson se Kosova po përballet edhe me inflacion të prodhuar brenda vendit.

“Çmimet e importeve kanë rënë sidomos këtë vit, ndërsa çmimet e prodhimit janë rritur. Arsyeja kryesore është rritja e çmimit të energjisë elektrike”, thotë Jakurti.

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), çmimet e ushqimeve dhe të energjisë elektrike janë shtysa kryesore e inflacionit në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, ku përfshihet edhe Kosova.

Një hulumtim i kompanisë “Valicon” tregon se rreth 70 për qind e qytetarëve të Kosovës e konsiderojnë rritjen e kostos së jetesës si shqetësimin kryesor. Me rritjen e çmimeve, fuqia blerëse e qytetarëve ka rënë ndjeshëm.

Sipas një analize të ekonomistit Edison Jakurti, në vitin 2014, me 100 euro të vitit 2019 mund të bliheshin mallra dhe shërbime në vlerë prej rreth 105 euro. Ndërsa ajo që në vitin 2019 kushtonte 100 euro, më 2025 kushton rreth 128 euro.

Riinvest: Kosova 100 vjet prapa vendeve të BE-së për standard jetësor

Rritja e çmimeve nuk është ndjekur me të njëjtin ritëm edhe me rritjen e pagave. Pavarësisht rritjes solide të pagave në sektorin publik, të ardhurat e shumicës së qytetarëve, të punësuar në sektorin privat, mbeten të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet në rritje.

Paga mesatare bruto në Kosovë është 639 euro, dhe sipas dhënave të

Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) mbi 55 për qind e kësaj shume shpenzohet vetëm për konsum.

E të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), tregojnë se afro 45 për qind e të punësuarve kanë paga nga 350 deri në 600 euro.

“Kemi 177 mijë e 110 punëtorë që paguhen në nivel të njëjtë page, ndërsa 118 mijë të tjerë kanë paga mbi 800 euro”, ka thënë zëdhënësjja e ATK-së, Valentina Bytyçi-Sefa.

Për pensionistët, familjet me asistencë sociale dhe punëtorët me paga minimale, rritja e çmimeve përkthehet në heqje dorë nga nevojat tjera, ulje të cilësisë së ushqimit dhe shtyrje të shpenzimeve për shëndetësi dhe arsim.

Një studim i Institutit Riinvest për standardin e jetesës tregon se me trendin aktual, Kosovës do t’i duheshin rreth 100 vjet për të arritur mesataren e BE-së.

“Nga analiza e pesë viteve të fundit rezulton se Kosova qëndron pothuajse më keq në secilën fushë ekonomike. Me trendin aktual dhe pa ndonjë iniciativë të përsheptuar të integritimit, Kosovës do t’i duheshin rreth 100 vjet për të arritur mesataren e BE-së. Në arsim dhe infrastrukturë po ashtu po devijojmë nga rruga e përafrimit”, thekson drejtori i programeve në Riinvest, Visar Vokri.

Rritja e çmimeve ka ndikuar drejtpërdrejt në standardin e jetesës, mirëqenien dhe stabilitetin social.

Të dhënat zyrtare dhe vlerësimi i ekonomistëve nxjerrin përfundimet se rritja e çmimeve në vitin 2025 nuk është vetëm fenomen inflacioni, por pasqyrim i dobësive strukturore të ekonomisë së Kosovës: varësia nga importi, mungesa e prodhimit vendor konkurrues, kostot e larta të energjisë dhe boshllëqet institucionale në mbrojtjen e konsumatorit.

Kosova vazhdon të mbetet prapa vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe larg mesatares së Bashkimit Evropian në shumicën e treguesve ekonomikë dhe socialë.

© KOHA Ditore

Rruga e Kosovës drejt prosperitetit: roli i reformave strukturore

Sfida kryesore e politikave të Kosovës është nxitja e potencialit të saj të rritjes ekonomike. Përkundër një konvergjence të vërejtur viteve të fundit, të ardhurat për kokë banori në Kosovë janë rreth një e katërta e nivelit të BE-së. Ky hendek i madh pasqyron dobësi strukturore që kufizojnë rritjen potenciale: stok i ulët i kapitalit dhe zbrazëtira të mëdha infrastrukturore; produktivitet i dobët dhe i stagnuar, si dhe investime të kufizuara në kapitalin njerëzor dhe inovacion; dhe emigrim i fortë që çon në tkurrje të fuqisë punëtore dhe përkeqëson mungesën e shkathtësive



Sebastian Sosa

Viteve të fundit, Kosova ka treguar reziliencë mjaft të fortë, mbështetur nga stabiliteti makroekonomik dhe reformat. Prodhimi është rritur në mënyrë të qëndrueshme dhe tashmë ka kaluar trendet që ishin para pandemisë. Inflacioni ka shënuar rënie nga nivelet e pikut nga koha e krizës ndërkombëtare të energjisë. Papunësia është ulur ndjeshëm, shoqëruar me rritje të lartë të punësimit dhe pagave. Politika e kujdesshme fiskale ka ndikuar që financat publike të jenë në gjendje të mirë, ndërsa sistemi bankar është përgjithësisht i qëndrueshëm. Janë realizuar reforma të rëndësishme si në sektorin financiar, financat publike dhe sektorin e energjisë.

Përkundër ngërçit politik, parametrat makroekonomike vazhduan të kenë stabilitet në vitin 2025 por, perspektiva është duke u ndikuar gjithnjë e më shumë nga rreziqet. Këtë vit rritja ekonomike është ngadalësuar dhe inflacioni është rritur. Bllokada politike ka ngadalësuar zbatimin e reformave dhe ka vonuar ratifikimin e marrëveshjeve kyçe ndërkombëtare, duke rrezikuar financimin e jashtëm. Pasiguria politike mbetet rrezik kryesor për perspektivën afatshkurtë. Ngërçi i zgjatur politik jo vetëm që dobëson besimin e konsumatorëve dhe investitorëve, por edhe vonon miratimin e buxhetit të vitit 2026. Pa buxhet të miratuar, të gjitha pagesat e sektorit publik, përveç servisit të borxheve, do të pezulloheshin nga muaji mars, me pasoja potencialisht të rënda negative për rritjen ekonomike. Edhe rreziqet e jashtme janë nga ana negative. Pasiguria e zgjatur, tensionet gjeopolitike dhe paqëndrueshmëria e çmimeve të mallrave mund të ndikojnë negativisht kërkesën e jashtme, remitancat dhe investimet e huaja direkte. Nga ana pozitive, një zgjidhje e shpejtë e ngërçit politik dhe zbatimi i menjëhershëm i reformave, duke përfshirë agjendën vecëse të miratuar të reformave nga Plani i Rritjes i BE-së, mund të nxisin rritjen ekonomike.

Politikat afatshkurtra duhet të synojnë ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe financiar të fituar me vështirësi. Shmangia e një krize buxhetore është jetike për të garantuar stabilitet makrofinanciar. Gjithashtu, autoritetet duhet t'i japin përparësi ndërtimit të masave mbrojtëse të politikave dhe planifikimit të rezervave. Nevojiten përpjekje për të ringjallur hovin e reformave me qëllim të rritjes së mobilizimit të të hyrave, përmirësimit të efikasitetit të shpenzimeve publike, frenimit të shpenzimeve rrjedhëse dhe prioritizimit të investimeve kapitale. Në sistemin bankar, rritja e shpejtë e kreditimit kërkon monitorim të afërt të rreziqeve sistematike dhe, nëse është e nevojshme, masa makroprudenciale shtesë.

Megjithatë, sfida kryesore e politikave të Kosovës është nxitja e potencialit të saj të rritjes ekonomike. Përkundër një konvergjence të vërejtur viteve të fundit, të ardhurat për kokë banori në Kosovë janë rreth një e katërta e nivelit të BE-së. Ky hendek i madh pasqyron dobësi strukturore që kufizojnë rritjen potenciale: (i) stok i ulët i kapitalit dhe zbrazëtira të mëdha infrastrukturore; (ii) produktivitet i dobët dhe i stagnuar, si dhe investime të kufizuara në kapitalin njerëzor dhe inovacion; dhe (iii) emigrim i fortë që çon në tkurrje të fuqisë punëtore dhe përkeqëson mungesën e shkathtësive.

Reformat në tregun e punës dhe kapitalin njerëzor mund t'i zbusin efektet e emigrimit në rritjen ekonomike. Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës, veçanërisht ajo e grave mund të ndihmojë në këtë aspekt. Përmirësimi i cilësisë së arsimit, riorientimi i arsimit të lartë drejt nevojave të tregjeve moderne të punës dhe mbështetja e riartësimit të të rriturve do të ndihmonin në uljen e mospërpjethjes së shkathtësive. Politikat për të mbajtur dhe tërhequr punëtorë të rinj dhe të talentuar—përfshirë të huajt—si dhe për t'i rritur përfitimet ekonomike nga diaspora janë gjithashtu thelbësore. Këto politika mund t'i zbusin efektet negative të emigrimit, por vështirë se mund t'i kompensojnë plotësisht ato.

Për t'u ngjitur më lart në shkallët e të ardhurave, Kosova duhet ta mbyllë edhe hendekun në qeverisje, infrastrukturë dhe sidomos atë në produktivitet. Anëtarësimi në BE ofron mundësi historike për ta arritur këtë, duke siguruar qasje në Tregun e Vetëm, integrim

në strukturat e qeverisjes evropiane dhe, po aq me rëndësi, ankorim të fortë për reforma. Dëshmitë nga zgjerimet e mëparshme të BE-së janë inkurajuese. Një studim i kohëve të fundit i FMN-së tregon se shtetet anëtare të reja kanë përfituar rreth 30 për qind rritje të BPV-së për kokë banori brenda 15 vjetëve pas anëtarësimit, nxitur nga produktiviteti dhe investimet. Për Kosovën, përfitime të ngjashme mund të përgjysmojnë hendekun e të ardhurave me BE-në brenda një brezi. Megjithatë, këto përfitime nuk janë të garantuara. Ato kërkojnë zbatimin e një agjende ambicioze reformash.

Një fushë kyçe e reformave është qeverisja dhe institucionet. Kjo përfshin reforma për forcimin e sundimit të ligjit, pavarësi dhe efikasitet të gjyqësorit, luftim të korrupsionit dhe sigurim që institucionet publike u shërbejnë qytetarëve dhe bizneseve në mënyrë të drejtë dhe efikase. Trajtimi i hendeqeve në qeverisje do të përmirësonte klimën e biznesit dhe do të krijonte kushte të barabarta konkurrence. Kjo përfshin edhe reforma për forcimin e qeverisjes korporative dhe menaxhimit të ndërmarrjeve publike (NP), të cilat kanë peshë të madhe në sektorë kyç, siç është energjia. Reformat e NP-ve janë thelbësore për uljen e rreziqeve fiskale dhe për shndërrimin e këtyre entiteteve në ndërmarrje moderne që mund të kontribuojnë pozitivisht në rritjen ekonomike. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka shënuar përparim të mirë në avancimin e reformave institucionale dhe të qeverisjes në sektorin financiar, dhe këto përpjekje duhet të vazhdojnë.

Me rëndësi thelbësore është edhe adresimi i hendeqeve infrastrukturore të Kosovës. Zvogëlimi i këtyre hendeqeve do të rriste aftësinë e konkurrencës, investimet private dhe integrimin në zinxhirët rajonalë të vlerës. Meqenëse investimet publike kërkojnë burime të konsiderueshme buxhetore, për të siguruar qëndrueshmëri fiskale është jetike të ketë kuadër të fortë të menaxhimit të investimeve publike (MIP). Një menaxhim i fuqishëm i Investimeve publike mund të ndihmojë në përmirësimin e prioritizimit, rritjen e efikasitetit të shpenzimeve kapitale dhe përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës publike.

Prioritet janë edhe reformat për adresimin e informalitetit ende mjaft të përhapur në Kosovë. Informaliteti përbën pengesë të ndjeshme për të bërë biznes, krijon konkurrencë të padrejtë dhe rëndon burimet fiskale. Ai ndikon edhe në investime dhe produktivitet. Dëshmitë empirike tregojnë se ndërmarrjet që veprojnë informalisht, kanë prirje të investojnë më pak dhe të jenë më pak produktive sesa ato formale. Prandaj, rialokimi i burimeve nga sektori informal drejt atij formal do t'i rriste investimet dhe produktivitetin në tërësi.

Së fundi, avancimi i tranzicionit të gjelbër në Kosovë nuk është vetëm domosdoshmëri mjedisore, por edhe mundësi për të nxitur rritje më të lartë dhe më të qëndrueshme. Zbatimi i agjendës së gjelbër do të ndihmonte në uljen e emetimeve dhe ndotjes, duke forcuar njëkohësisht reziliencën e vendit ndaj goditjeve të ardhshme klimatike dhe energjetike. Reformat e zbatuara në kuadër të instrumentit të FMN-së për Reziliencë dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, i përmbyllur së fundmi, kanë qenë kyç në avancimin e planeve për rritjen e kapaciteteve të prodhimit nga burimet e ripërtëritshme, uljen e ndotjes, përmirësimin e eficiencës së energjisë dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal.

Avancimi i reformave strukturore nuk është i lehtë. Ai kërkon si ekspertizë teknike, edhe guxim politik. Kosova, sikurse vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, përballat me kapacitete të kufizuara administrative. FMN-ja ka ndihmuar përmes zhvillimit të kapaciteteve, duke trajnuar zyrtarë, forcuar institucione dhe mbështetur hartimin e politikave. Po ashtu, në plan është hapja e një qendre të asistencës teknike për Ballkanin Perëndimor dhe Moldavinë (SEETAC) për t'i ndihmuar këto vende në zbatimin e reformave strukturore. Thelbësor është edhe vullneti politik, jo vetëm sepse reformat e nevojshme përfshijnë disa fusha, përfshirë administratën publike, rregulloret e biznesit, tregun e punës dhe qeverisjen, por edhe sepse disa reforma me gjasë do të prekin interesat e gjera dhe, për pasojë, janë të vështira për t'u zbatuar.

Anëtarësimi në BE mund të shërbejë si katalizator i fuqishëm i reformave, duke ofruar si motivim ashtu edhe dinamikë për t'i kapërcyer interesat e ngushta dhe për të shtyrë përpara reforma të vështira, por të domosdoshme. Zbatimi efektiv i një agjende ambicioze reformash është thelbësor për t'i maksimizuar përfitimet nga procesi i anëtarësimit në BE dhe për të siguruar që ekonomia e Kosovës është e gatshme të konkurrojë në Tregun e Vetëm, përfshirë tregun unik të punës, kur të anëtarësohet në BE. Këto reforma do ta ndihmojnë Kosovën të bëhet ekonomi më dinamike, më produktive dhe e bazuar në shkathtësi, duke reduktuar emigrimin.

Autori është përfaqësues Rajonal i Fondit Monetar Ndërkombëtar për Ballkanin Perëndimor

Së bashku më të fortë për paqe

Misioni ynë është i pajisur mirë dhe i pozicionuar mirë për të adresuar çdo zhvillim të rëndësishëm të sigurisë. Dhe ne do të vazhdojmë të mbështesim dialogun politik për të ecur përpara. Në emër të misionit të KFOR-it të udhëhequr nga NATO-ja, ju shpreh urimet më të përzemërta për një Vit të Ri paqësor dhe të begatë



Özkan Ulutaş

Së pari, ndihem i privilegjuar dhe i nderuar të jem komandanti i parë i KFOR-it i cili merr përsipër një përgjegjësi kaq të rëndësishme për herë të dytë, në historinë e këtij misioni të rëndësishëm të NATO-s. Ky emërim jep një ndjenjë vazhdimësie dhe dëshmon përkushtimin e palëkundur të Aleancës së Atlantikut ndaj stabilitetit rajonal në një moment kaq historik për Kosovën dhe për Ballkanin Perëndimor në përgjithësi. Kjo gjithashtu pasqyron angazhimin afatgjatë të Turqisë ndaj misionit të KFOR-it, ndaj stabilitetit në rajon dhe ndaj sigurisë sonë të përbashkët euroatlantike.

KFOR: Një aktor i besueshëm dhe garantues i stabilitetit

KFOR-i është misioni më i gjatë dhe aktualisht më i madh i NATO-s. Ai ka një qëndrim të dukshëm, fleksibil, mirë të pajisur dhe agjil në gjithë Kosovën. Ka një mandat të qartë, të bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të vitit 1999, i cili informon të gjitha aktivitetet e tij të përditshme, duke filluar nga patrullimet, angazhimet me përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve lokale, deri të mbështetja e projekteve të zhvillimit ekonomik, vetëm për të dhënë disa shembuj. Për më shumë se 26 vjet, KFOR-i ka ndihmuar në krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi të qetë dhe të sigurt për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë, pa dallim etnie, feje apo përkatësie politike. Gjatë vitit 2025, situata e sigurisë ka vazhduar të jetë qetë. Megjithatë, ende është e brishtë për shkak të një numri çështjesh të pazgjidhura. Në këtë kontekst, KFOR-i ka vazhduar të kryejë misionin e tij, plotësisht, në mënyrë profesionale dhe të paanshme, dhe në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit (EULEX), në rolet e tyre përkatëse si përgjegjës për sigurinë.

Mbështetja e një zgjidhjeje politike të qëndrueshme

Përmes KFOR-it, NATO po ofron kontribute të rëndësishme ushtarake për stabilitetin në rajon. KFOR-i mbetet i fokusuar tërësisht në zbatimin e përditshëm të mandatit të tij të OKB-së. Kjo është ajo që burrat dhe gratë nën komandën time do të vazhdojnë të bëjnë, çdo ditë. Duke pasur parasysh këtë, siguria e qëndrueshme në Kosovë, dhe nëpërmjet saj stabiliteti në të gjithë rajonin, janë përfundimisht politike dhe varet nga të gjitha palët të zgjedhin dialogun dhe bashkëpunimin në vend të dhunës. Prandaj, NATO vazhdon të mbështesë fuqimisht dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës të lehtësuar nga BE për të adresuar çështjet e hapura dhe ndjekur zgjidhje të qëndrueshme që respektojnë të drejtat e të gjithë njerëzve dhe komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Unë dhe ekipi im kemi qenë në kontakt të ngushtë me Përfaqësuesin Special të BE-së për Dialogun Beograd-Prishtinë gjatë gjithë vitit. Përmes pranisë dhe aktivitetëve tona të përditshme, KFOR gjithashtu përpiqet të ruajë një kornizë sigurie në

mbështetje të përpjekjeve të rëndësishme dhe të vazhdueshme diplomatike. Tani është shumë e rëndësishme që Beogradi dhe Prishtina të tregojnë fleksibilitet dhe të bëjnë kompromiset e nevojshme për zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese. Kjo është e vetmja rrugë drejt sigurisë së qëndrueshme në Kosovë dhe stabilitetit rajonal, për të mirën e të gjitha komuniteteve.

Kontributi në një qasje gjithëpërfshirëse

KFOR-i aktualisht përbëhet nga më shumë se 5200 trupa që kontribuojnë nga 33 shtete, përfshirë aleatët dhe partnerët e NATO-s. Misioni ynë kështu pasqyron një përpjekje kolektive dhe shumëpalëshe. Përfundimisht, efektiviteti i KFOR-it është ndërtuar mbi bashkëpunimin e fortë që ka zhvilluar dhe vazhdon ta konsolidojë me shumë partnerë. Koordinimi ynë i ngushtë me EULEX-in, UNMIK-un dhe OSBE-në, si dhe me bashkësinë më të gjerë diplomatike në Kosovë, mbetet thelbësor për adresimin e sfidave dhe nxitjen e stabilitetit. Në të njëjtën kohë, KFOR-i mban bashkëpunim të mirë dhe shkëmbim me aleatët fqinjë dhe aktorë të tjerë në Ballkanin Perëndimor, si dhe përfiton nga ekspertiza e tyre e vlefshme rajonale. Për më tepër, ka zhvilluar një bashkëpunim të mirë me organizatat e sigurisë në Kosovë dhe Forcat e Armatosura Serbe. Në përgjithësi, kjo qasje gjithëpërfshirëse kontribuon në sigurinë në Kosovë dhe në stabilitetin në mbarë Ballkanin Perëndimor.

Së Bashku Më të Fortë për Paqe

Motoja e misionit tonë, “Së Bashku Më të Fortë për Paqe,” pasqyron thelbin e përpjekjes kolektive për të vendosur dhe ruajtur paqe e siguri afatgjatë në Kosovë dhe në gjithë rajonin. Kjo përfundimisht mbështet dëshirën që kanë njerëzit në të gjitha komunitetet: të jetojnë në paqe, të vazhdojnë jetën e tyre të përditshme dhe të planifikojnë një të ardhme të lirë nga paqartësitë dhe rreziqe e dhunës së përsëritur. Kjo është arsyeja pse ne jemi të vendosur të vazhdojmë të japim kontributet tona në të gjitha përpjekjet që synojnë të nxisin respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë dhe dialogun konstruktiv ndërmjet të gjitha komuniteteve.

Duke parë drejt vitit 2026

Ndërsa i afrohem vitit 2026, misioni i KFOR-it i udhëhequr nga NATO mbetet i përkushtuar ndaj mandatit të tij, bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të vitit 1999, për të kontribuar në një mjedis të sigurt për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë dhe linë e lëvizjes, në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme. Angazhimi ynë ka qenë i palëkundur për më shumë se dy dekada dhe është po aq i fortë sot. Progresi i arritur gjatë viteve nuk duhet të rrezikohet. Ai duhet të ruhet dhe të forcohet. Ne jemi të vendosur të vazhdojmë të luajmë rolin tonë për këtë qëllim. Misioni ynë është i pajisur mirë dhe i pozicionuar mirë për të adresuar çdo zhvillim të rëndësishëm të sigurisë. Dhe ne do të vazhdojmë të mbështesim dialogun politik për të ecur përpara. Në emër të misionit të KFOR-it të udhëhequr nga NATO, ju shpreh urimet më të përzemërta për një Vit të Ri paqësor dhe të begatë. Uroj që viti 2026 të sjellë shpresë, lidhje të forcuara dhe një angazhim të përbashkët për ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë për të gjithë.

Autori është Komandant i KFOR-it

KUNDËRLIGJSHMËRI NË PRAG TË HYRJES NË FUQI TË REFORMËS NË DREJTËSI

Lufta për pushtet në KPK

Viti 2025 e ka bërë të qartë luftën e pushtetit mes grupeve brenda sistemit prokurorial. Në fund të mandatit të tyre, pesë anëtarë kanë shkarkuar kundërligjshëm ushtruesin e detyrës së kryeprokurorit, Besim Kelmendi. Po ata, pas këtij shkarkimi, e ngarkuan për ta ushtruar detyrën e kryeprokurorit Agron Qalajn, ndërsa e bllokuan legjitimitimin e raportit që e konstaton zgjedhjen e anëtares së re të Këshillit, Elza Bajrami-Kastrati. E krejt këto ndodhën pak ditë para nisjes së 2026-s, kur duhet të hyjë në fuqi ligji i ri për Këshillin Prokurorial

Ardit Kika

PRISHTINË, DHJETOR - Qe një prej vendimeve më të kritikuara të 2025-tës ai që institucioni më i lartë vendimmarrës i sistemit prokurorial e mori në nëntor për ta shkarkuar ushtruesin e detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi.

Këtë vendim, organizata të shoqërisë civile e kualifikuan të kundërligjshëm dhe i fajësuan pesë anëtarë të Këshillit Prokurorial (KPK) se synojnë ta ruajnë strukturën e pushtetit që udhëhoqi me sistemin prej të paktën 10 vjetësh dhe se tentojnë ta bllokojnë reformën në drejtësi. Shkarkimi i Kelmendit u shpall i kundërligjshëm edhe nga Gjykata Supreme, e cila konstatoi se vendimi është marrë në mënyrë arbitrare dhe pa kuorum. Pas vendimit të Supremes, Kelmendi u tërhoq nga ushtrimi i detyrës.

Gzim Shala, hulumtues i lartë në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), thotë se vendimi i anëtarëve Ardian Hajdaraj, Jehona Grantolli, Ariana Shajkovci, Milot Krasniqi e Jetish Maloku është reflektim i tendencës për ta ruajtur strukturën aktuale të pushtetit në sistem.

“Diskutimet që kanë qenë në këtë këshill, nxjerrja e vendimit edhe në mungesë të kuorumit dhe po ashtu momentumi kur janë marrë këto veprime, që është pak para se reforma në Këshillin Prokurorial, efektet në kuptim të përbërjes së këtij institucioni, atëherë haptazi mund të themi se ka pasur tendencë të një grupi të anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës për ta ruajtur korporatizmin dhe për ta ruajtur shumicën edhe në përbërjen e re të Këshillit Prokurorial të Kosovës”, thekson ai.

Kelmendi u tërhoq nga detyra, pasi fitoi betejat ligjore për rastin e tij dhe pa dhënë shpjegime të hollësishme. E anëtari Veton Shabani shprehu dyshime se ai u vu nën presion.

Pas tërheqjes së Kelmendit, ushtrues detyre i kryeprokurorit, me gjashtë vota, u zgjodh Agon Qalaj. Kuorumin për Qalajn e bëri anëtari i KPK-së, Dardan Vuniqi, që bashkë me anëtarë të tjerë i pati braktisur mbledhjet për shkarkimin e Kelmendit. Qalaj e propozoi për zëvendës të tij Aleksandër Lumezin, i cili është përmendur në skandalin “Pronto”. Por ai, në funddhjetor e njoftoi Këshillin Prokurorial se nuk mund ta pranojë detyrën, shkaku i angazhimeve “profesionale” si prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe në Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve”.

Kritika rreth mënyrës së shkarkimit të Kelmendit, krahas organizatave të shoqërisë civile, janë shprehur edhe nga misioni i Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, si dhe nga Ambasada britanike. Vendimi u kualifikua për përpjekje për pengimin e reformës në drejtësi.

“E kuptoj që ka diskutime për dorëheqje të parakohshme të bashkërenduar të anëtarëve të Këshillit në mënyrë që të ruhet përbërja aktuale e çekuilibrar e Këshillit dhe të vonohet zbatimi i reformës. Po ashtu e kuptoj që ka diskutime lidhur me zëvendësimin e mundshëm të ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, para hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Është e qartë që këto nisma do të minonin qëllimin dhe efektivitetin e legjislationit të ri dhe rrjedhimisht të sundimit të ligjit”, pati thënë ambasadori i BE-së në Kosovë, Aivo Orav, më 28 maj.

Shkarkimi i Kelmendit u propozua nga zëvendëskryesuesja e KPK-së,

Foto: Driton Paçarada



Kritika rreth mënyrës së shkarkimit të Kelmendit, krahas organizatave të shoqërisë civile, janë shprehur edhe nga misioni i Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, si dhe nga Ambasada britanike. Vendimi u kualifikua për përpjekje për pengimin e reformës në drejtësi

Jehona Grantolli, pas raportimit në media se ai gjatë luftës ka bashkëpunuar me gjyqtaren serbe, Danica Marinkoviq, e cila e pati quajtur trillim masakrën e Reçakut.

“Çdo vendim i juaji nuk e prek vetëm një emër, një dosje apo një mandat, por e prek besimin e një kombi të tërë, aq më tepër që keni parë vetë se për çfarë po bëhet fjalë”, theksoi Grantolli tek e bëri propozimin për shkarkimin e Kelmendit, duke pretenduar se ai “ka shprehur publikisht qëndrim të njëanshëm, përfshirë deklaratimet e tij në takimet e Këshillit si dhe në pronocimet publike për media”.

Lidhur me masakrën e Reçakut, Kelmendi është intervistuar nga Prokuroria Speciale në cilësinë e dëshmitarit. E raportimin e medias e ka mohuar.

Dimensioni politik

Pak kohë pas shkarkimit, anëtari i KPK-së, Visar Krasniqi, pati nxjerrë akuzën se prapa gjithë këtij plani qëndron Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, të cilin presidentja Vjosa Osmani ka refuzuar ta dekretojë.

Deputetja e legjislaturës së shkuar, Ganimete Musliu, e cila është nga radhët e Partisë Demokratike (PDK), ka reaguar pas kësaj akuze, duke thënë se presidentja Osmani e ka mbajtur në detyrë Kelmendin teksa nuk e ka dekretuar Isufajn, pasi që ai është ish-ushtar i Ushtrisë Çlirimtare (UÇK).

“Besim Kelmendi, që prej tre vjetësh mban pozitën e ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, po qëndron aty falë një vendimi të pastër politik të presidentes Vjosa Osmani. Ajo refuzoi të dekretonte Blerim Isufajn, një ish-ushtar i UÇK-së, dhe zgjodhi të mbajë në krye të Prokurorisë një person me të kaluar të diskutueshme në raport me Reçakun”, pati reaguar Musliu.

E Osmani, e cila është zgjedhur presidente në kohën kur shumicën në Kuvend e ka pasur Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën partia e saj “Guxo” është në koalicion, ka thënë se do ta analizojë “tentim-shkarkimin” në bashkëpunim me aleatë ndërkom-bëtarë, ndërsa ka shtuar se ajo nuk

do të ndërhyjë në drejtësi.

Pretendimi i anëtarit Krasniqi për orkestrimin e ngjarjeve përbrenda KPK-së u mohua edhe nga Prokuroria Speciale.

“Çdo përpjekje për të përfshirë Prokurorinë Speciale në debate të brendshme të KPK-së, dëmton integritetin e sistemit prokurorial. Kryeprokurori z. Blerim Isufaj mbetet i përkushtuar që të ushtrojë mandatin në krye të Prokurorisë Speciale, duke përfshirë çdo pretendim për ushtrimin e ndonjë pozite tjetër; çka dëshmohej edhe me emërimin e një prokurori nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në pozitën e ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit”, thuhej në reagim.

Anëtarja që s’ e mori vulën e KPK-së

Pas emërimit për ushtrues detyre të kryeprokurorit, Qalaj e ka siguruar kuorumin prej gjashtë anëtarësh në mbledhjen e KPK-së, në të cilën u votua kundër raportit të komisionit zgjedhor që e nxori Elza Bajrami-Kastratin fituese të zgjedhjeve për anëtare Këshilli. Këtë situatë e pati paralajmëruar Kelmendi, kur tha se një pjesë e anëtarëve kanë për synim ta pamundësojnë zgjedhjen e saj.

Akuzën e kanë hedhur poshtë Hajdaraj dhe anëtarë të tjerë të KPK-së që votuan për shkarkimin e Kelmendit. Ata theksuan se zgjedhja e Bajrami-Kastratit nuk ka qenë e rregullt, ndërsa Rregulloja për zgjedhjen e anëtarëve ka qenë e kundërligjshme.

Këto pretendime, menaxherja e programeve në Lëvizjen FOL, Burbuqe Kastrati, i vlerësoi të paqëndrueshme.

“Mënyra se si u tentua të hidhet poshtë ai raport ishte jashtëzakonisht joligjore, sepse raporti ishte thjesht një procedurë shumë formale, që prezantohet para Këshillit, sepse vendimi, votat janë dhënë nga prokurorët. Përzgjedhja dhe votimi i anëtarit të ri, prokurores, në këtë rast të prokurorive themelore është vullnet i pastër i prokurorëve nga i gjithë vendi”, thotë ajo.

Para refuzimit të raportit, kryesuesi Hajdaraj e përmendi mesazhin “e një prokurori dërguar kryeprokurores së Pejës”, e në të cilin, sipas tij, dërguesi pretendon se anëtari Arian Gashi i

ushtroi ndikim për ta votuar “kandidaten e tij”. Ky mesazh u përdor si argument për ta refuzuar raportin.

Kastrati nga Lëvizja FOL vlerëson se leximi i mesazhit u bë veç për konsum publik.

“Nëse je prokuror dhe ke dëshmi se është bërë një akt, një vepër penale prej një kolegu dhe ti e shfrytëzon momentin e fundit dhe e hedh atë si një lajm para publikut dhe nuk merresh me hetimin e atij rasti, kjo me të vërtetë është për keqardhje”, thotë ajo.

Prokurori që e dërgoi mesazhin, Ramiz Buzhala, i çoi letër Këshillit me kritikë për leximin e porosisë për kryeprokuroren, Lumturije Vuçetaj. Ai mohoi se Gashi e ka kontaktuar për qëllim vote.

“Nëse do të kisha ndonjë kërkesë të tillë, presion eventual, rastin do ta kisha paraqitur tek institucionet kompetente për trajtim”, shkroi ai në letër.

Sytë kah gjykatat

Më 2026, gjyqësori do të marrë vendim për paditë kundër vendimmarrjeve të Këshillit Prokurorial. Gjykata Supreme veçse e ka nxjerrë një për padinë e prokurores Merita Kurtishi-Gaka, e cila e ka sfiduar refuzimin që KPK-ja ia ka bërë ankesës së saj rreth procesit zgjedhor për anëtare. Për këtë rast, Supremja konstatoi se me ndryshimet në ligjin për KPK-në nuk lejohen ankesa. Në trajtim është edhe Rregullorja për Zgjedhjen e Anëtarëve Prokurorë të KPK-së, pasi portali “Paparaci” ka ushtruar padi, me kërkesë për anulimin e saj. Në Gjykatën Themelore në Prishtinë është aprovuar kërkesa e prokurores Bajrami-Kastrati, me të cilën është pezulluar vendimi për ta refuzuar zgjedhjen e saj.

Zëdhënësja e Themelores, Mirlinda Gashi, tha se rasti do të trajtohet me prioritet.

“Gjykata lidhur me masën e sigurisë ka vendosur brenda afateve të parapara ligjore ndërsa në lidhje me padinë, të njëjtën gjykata do ta trajtojë me prioritet dhe do të vendoset për çështjen kryesore në pajtim edhe me dispozitën e nenit 100 paragrafi 11 të Ligjit Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative”, tha ajo.

Viti i reformës

Kryesuesit të KPK-së, Ardian Hajdaraj, zëvendëskryesueses Jehona Grantolli e anëtarëve Ariana Shajkovci, Veton Shabani e Jovo Radoviq u përfundon mandati më 1 janar të 2026-s, kur edhe hyjnë në fuqi ndryshimet në Ligjin për KPK-në. Sipas këtij ligji, numri i anëtarëve nuk do të jetë 13, por 7.

E në fillim të vitit, në këtë këshill do të jenë pesë anëtarë – Arian Gashi, Dardan Vuniqi, Visar Krasniqi, Milot Krasniqi dhe ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit, Qalaj – aq sa është minimumi për vendimmarrje.

Prej tyre, prokurori special Krasniqi e votoi shkarkimin e Kelmendit, Qalaj u zgjodh nga anëtarët që e zgjedhën Kelmendin, ndërsa Vuniqi e kundërshtoi shkarkimin e Kelmendit, por e mundësoi kuorumin për Qalajn.

Krejt zhvillimet që e përcollën KPK-në në 2025-tën, Burbuqe Kastrati e FOL-it i vlerësoi si një njollë e zezë për shtetin. Por shprehu pritjen për llogaridhënie më të madhe përbrenda KPK-së në 2026-n.

“Besoj se ky do të jetë momenti i fundit për ta përmbyllur këtë cikël, i cili ka qenë jashtëzakonisht jotransparent, jollogaridhënës dhe besoj që prej 1 janarit, me hyrjen në fuqi të ligjit, do të jetë një vendimmarrje e re në KPK, e cila nuk do t’i ketë më këto dinamika që i pamë deri më tash”, u shpreh ajo.

Korporatizmi, i konstatuar edhe nga Komisioni i Venedikut e ka dominuar udhëheqjen e KPK-së për një kohë të gjatë. E shpresën se kjo do të ndryshojë më 2026 e shprehu Shala i IKD-së.

“Shpresoj që anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës të punojnë në drejtim të rritjes së transparencës, llogaridhënies, integritetit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, të cilat parime këtij këshilli i kanë munguar tash e mbi një dekadë në mënyrë që ta shndërrojnë Këshillin Prokurorial të Kosovës në një institucion me besim të publikut e i cili u kontribuon çështjeve me interes publik”, thotë Shala.

Një urim optimisti

Duke pritur vitin e ri 1990 një plak në Dukagjin qante nga gëzimi duke parë rënien e Murit të Berlinit. Plaku nuk dinte gjë nga gjeopolitika, por dinte një të vërtetë të vjetër. Fatet e vendeve të vogla diktohen nga dinamikat që vendosën oqeanet dhe hemisferat larg tyre. Kështu sot edhe ne duke pritur vitin 2026 gëzohemi për të ardhmen që na pret



Demush Shasha

Përderisa i afrohem fundit të këtij viti me të drejtë sodisim për atë se çfarë ka ndodhur vitin e kaluar dhe çfarë na pret vitin tjetër. Janë shumë gjëra që na preokupojnë lidhur me zhvillimet në vendin tonë, por shpesh edhe më shumë na preokupojnë zhvillimet në botë. Ndoshta kjo është edhe një ves i vjetër ballkanik: të merremi më shumë me punët e botës se punët tona. Në filmin kult boshnjak “Tokë e Askujt” është një skenë e bukur ku në mes të një llogori gjatë luftimeve në mes ushtrisë boshnjake dhe serbe një ushtar është duke lexuar gazetat. Duke lexuar kështu lajmet nga bota ushtari rënkon “Ah, çfarë tmerri në Ruandë”. Skena kap bukur ironinë e jetës sonë ballkanike ku në mes gjithë telasheve tona ne merremi me punët e largëta të botës.

Por në këtë ironinë tonë ballkanase fshihet edhe një e vërtetë e vjetër sa bota. Fati i vendeve të vogla çdo herë është diktuar nga vullneti i vendeve të mëdha. Shpesh e tregoj një rrëfim që kap bukur thelbin e kësaj të vërtete. Në vitin 1989 diku thellë në rajonin e Dukagjinit një plak ishte duke parë pamjet e rrënitit të Murit të Berlinit. Duke i parë këto pamje plak filloi të qante nga gëzimi. Duke iu përgjigjur ftyrave të habitura që e rrethonin, ai tha: “Janë lot gëzimi. Kjo punë nuk ndalet më. Shumë shpejt liria do të vijë edhe në Kosovë”.

Ndonëse liria në Kosovë u vonua edhe dhjetë vjet të tjera, ky rrëfim apokrifik kap bukur thelbin e fatit të vendeve të vogla. Fatet e tyre diktohen nga dinamikat që vendosën oqeanet dhe hemisferat larg tyre. Dhe asnjë vend nuk ka diktuar kursin e historisë së re moderne më shumë se SHBA-ja. Kjo është edhe arsyeja përse sot jemi më të brengosur, ndonëse jo të alarmuar për fatin tonë. Sot zhvillimet në SHBA janë arsye për brengosje, por edhe për optimizëm.

Që nga ardhja në pushtet Trump ka sulmuar themelet e jetës demokratike amerikane. Ndryshe nga mandati i tij i parë, kësaj radhe Trump është duke përdorur levat e pushtetit me më shumë efikasitet dhe me më shumë zell revanshizmi.

Me ardhjen në pushtet Trump ka militarizuar si asnjëherë më parë institucionet amerikane. Sikur në traditën e vjetër ballkanike të “kapjes së shtetit” Trump ka mbushur institucionet kyçe amerikane me lojalistë politikë të tij dhe ka ndëshkuar të gjithë shërbyesit publikë të cilët kanë refuzuar të zbatojnë urdhrat e paligjshëm të tij. Pasi që kishte siguruar se kishte kapur institucionet e drejtësisë Trump urdhëroi ndjekjen politike të të gjithë kundërshtarëve të vet. Kështu në listën e të përndjekurve politikë u gjetën ish-presidenti Joe Biden, senatori Adam Schiff, senatori Mark Kelly, senatorja Elissa Slotkin, z. George Soros, filantrop, z. Jack Smith, ish-prokurori special, z. James Comey, ish-drejtor i FBI-së, z. John Bolton, ish-këshilltar i Sigurisë Nacionale, znj. Letitia James, ish-prokurore e shtetit të Nju-Jorkut, z. John Brennan, ish-drejtori i CIA-s, dhe shumë të tjerë. Të gjitha këto raste të përndjekjes politike u nisën mbi baza qartësisht politike dhe disa prej tyre - sikur në rastin e senatorit Schiff, z. Comey dhe znj. James - veçse janë refuzuar nga gjykatat.

Dhe Trump nuk u ndal vetëm me përndjekjen e kundërshtarëve politikë ndaj të cilëve ai synonte revanshizëm politik, ai vazhdoi të përdorë institucionet e kapura si mjet për të luftuar këdo që kundërshtonte agjendën e tij politike. Kësisoj ai drejtoi institucionet e drejtësisë kah mediat më të rëndësishme liberale siç janë “Wall Street Journal”, “The New York Times”, “ABC”, “CBS” dhe shumë të tjerë. Madje as universitetet prestigjioze sikur Harvard, Columbia dhe UCLA nuk u shpëtuan përndjekjes së Trumpit. Këtë javë duke komentuar përdorimin e institucioneve të drejtë-

sisë kundër kundërshtarëve politikë edhe vetë shefja e stafit të Shtëpisë së Bardhë, znj. Susie Wiles, pranoi se disa nga këto hetime “duken sikur revanshizëm politik”.

Dhe përveç militarizimit të institucioneve represive të drejtësisë Trump provoi të militarizojë politikisht edhe ushtrinë. Gjatë një mbledhjeje me krerët ushtarakë amerikanë Trump kërkoi nga ata që të “përgatiten të zbarkojnë në qytetet amerikane dhe t’i hapin luftë armikut të brendshëm”.

Të gjitha këto zhvillimet janë gjërat të cilat na bëjnë të brengosemi. Kapja e shtetit, keqpërdorimi i institucioneve publike, përndjekja e kundërshtarëve politikë, represion mbi media – të gjitha këto jemi mësuar t’i shohim në vendet sikur Rusia, Kina dhe Irani, por jo Amerika. Prandaj kur sot shohim çfarë po ndodh në Amerikë brengosemi për të ardhmen tonë.

Por jo çdo gjë është zi. Edhe gjatë mandatit të parë të Trumpit, por edhe sot, demokracia amerikane vazhdon të rezistojë dhe të luftojë përpjekjet e Trumpit për shkatërrimin e themeleve demokratike amerikane. Opozita amerikane vazhdon të jetë alternativë e respektueshme në sytë e popullit amerikan. Performansa e shkëlqyer e demokratëve në një numër të zgjedhjeve lokale të vitit 2025 tregoi se populli amerikan nuk toleron ngritjen e autokratëve në tokë amerikane. Sistemi gjyqësor vazhdoi të sanksionojë aktet joligjore të Trumpit. Pothuaj të gjitha përpjekjet e tij për ndjekje politike dhe sulmet mbi media dhe universitetet u sanksionuan. Ushtria amerikane ruajti profesionalizmin e vet të jashtëzakonshëm dhe refuzoi të instrumentalizohet për qëllime politike. Sistemi unik kushtetues amerikan po vazhdon të ofrojë “checks and balances” ndaj pushtetit të Trumpit me fuqinë e konsiderueshme që kanë ushtruar guvernatorët dhe kryetarët e qyteteve të mëdha sikur New York, Chicago dhe Los Angeles gjatë këtij viti. Shoqëria civile amerikane në përgjithësi përfshirë media, universitete, biznese, grupe avokimi – të gjithë u bashkuan për t’i shërbyer si mburojë demokratike traditës politike amerikane ndaj sulmeve të Trumpit.

Prandaj sot përderisa mendojmë për çfarë na pret në vitin 2026 kemi arsye që të jemi optimistë për vitin 2026. Sikur ai plak i Dukagjinit që gëzohej për rënien e Murit të Berlinit, ashtu edhe ne sot gëzohemi kur shohim se si demokracia amerikane vazhdon të qëndrojë e palëkundur nga sulmet e paprecedenta mbi vlerat më sublime demokratike. Benjamin Franklin do të ishte i gëzuar sot kur do të shihnte se populli i tij me të vërtetë qe i aftë ta ruajë republikën e vet. Dhe në gjithë këtë mes ka mësim edhe për ne. Ashtu sikur populli amerikan edhe ne kemi përgjegjësinë që ta ruajmë republikën tonë. Viti që është para nesh do të na ofrojë mjaft mundësi të tregojmë këtë aftësi. Uroj që do ta kalojmë testin.



Arben Qirezi

Siç e kam thënë edhe në njërën nga kolumnat e mëparme, viti që po e lëmë pas ka qenë viti më i mbrapshtë prej çlirimit e këtej. Për dikë, në planin personal mund të ketë qenë vit i mirë, i begatë e me plot gëzime. Mirëpo në planin e përgjithshëm, mos pafshim kurrë atë që e kemi dëshmuar në vitin që shkoi. Të mos merrem më shumë me marrinat e vitit 2025, kam vendosur të shkruaj se si do të doja ta shoh vitin që po vjen. Për këtë kam bërë një listë dëshirash, që në imagjinatën time do të duhej të ishin zhvillimet kryesore të vitit 2026, që prandaj në këtë kolumnë po e quaj vit imagjinar, sepse kam frikë që realiteti mund të jetë krejtësisht i ndryshëm nga ajo që imagjinoj për vitin që po vjen.

Nuk e di se cili do të jetë rezultati zgjedhor i 28 dhjetorit, sepse kolumna festive i dorëzohet redaksisë deri me datën 20 dhjetor. Ky rezultat mund të sjellë të pritura e të papritura për shumëkënd. Edhe pse në parim nuk parapëlqej të përqafoj njërin parti apo tjetrën pak para zgjedhjeve, shpresoj që në kohën e botimit të kësaj kolumnëje, më 30 dhjetor, të kenë dalë rezultatet zgjedhore dhe se peshorja politike në Kosovë të ketë rënduar në favor të ish-opozitës. Kjo për faktin se pushteti absolut i LVV-së dhe qasja e saj absolutiste kur i kishte 42 për qind të votave pas zgjedhjeve të 9 Shkurtit, treguan se nuk i sjellin Kosovës asgjë të mirë. Prandaj na nevojitet një rezultat zgjedhor i cili inkurajon bashkëpunimin dhe një koalicion qeverisës në mes të forcave që deri dje ishin në opozitë. Jo se jam kundër asaj që një parti politike të ketë shumicën në kuvend, por jam kundër që këtë shumicë ta ketë LVV-ja, për arsye se ajo nuk ka ditur se si ta përdorë këtë shumicë, ka qeverisur në mënyrë arrogante dhe ka hedhur para majtas e djathtas sa herë që i ka shkuar për shtati interesave të saj elektorale. Në zgjedhjet e fundit dhe në këto që do të mbahen më 28 dhjetor, po garon pa program qeverisës, me adutin kryesor karizmen populiste të liderit të saj, Albin Kurti. Për shembull, politikën e saj energjetike kanë sjellë një pasiguri të skajshme energjetike, për arsye se ajo refuzoi të ndërtonte kapacitete vendore për prodhimin e energjisë, refuzoi projektin e MCC-së për gazin amerikan hde e bëri Kosovën të varur nga tregtarët dubiozë me energji, me marrëveshje të dyshimta, nga të cilat nuk dijet saktësisht se kush do të përfitojë. Po të ishte në koalicion qeverisës me ndonjë parti tjetër politike, LVV-ja nuk do të mund t’i merrte të gjitha vendimet e dëmshme që i mori gjatë pesë vjetëve sa e qeverisi Kosovën, nga të cilat, viti i fundit, kur e kishte mandatin si qeveri kujdestare, ishte përlot me vendime joligjore.

Një lajm i mirë i këtij fundviti ishte heqja e sanksioneve të BE-së, nën të cilat Kosova ka qenë për afër tre vjet. Prandaj, balanca e re e forcave në ku-

Një vit i ri imagjinar

Kam bërë një listë dëshirash, që në imagjinatën time do të duhej të ishin zhvillimet kryesore të vitit 2026, që prandaj në këtë kolumnë po e quaj vit imagjinar, sepse kam frikë që realiteti mund të jetë krejtësisht i ndryshëm nga ajo që imagjinoj për vitin që po vjen

vend që mundëson marrëveshje parimore që partia ish-opozitare me më së shumti vota ta udhëheqë qeverinë, dhe krijimi sa më i shpejtë i qeverisë së re, zhbllokon edhe qindra milionat nga plani i rritjes i BE-së. Me një LVV në opozitë, Kosova do të mund të orientohej në mugën e integritimeve evropiane dhe të bëhet anëtare me të drejta të plota në Këshillin e Evropës dhe në organizata të tjera ndërkombëtare. Nëse Serbia nuk e respekton zotimin e saj se nuk do ta pengojë anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, le të merret me të BE-ja dhe SHBA-të. Në këtë pikë, nuk isha pajtuar me reciprocitetin si parim, sepse sistemi kushtetues i Kosovës i ka siguresat të cilat e mbrojnë sovranitetin dhe karakterin unitar të shtetit. Prandaj, dërgimi i draft-statutit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Gjykatën kushtetuese do t’i hapte shumë rrugë Kosovës dhe do të ndërpriste ciklin negativ të marrëdhënieve me BE-në dhe SHBA-të dhe të kërkojë me ngulm, si akter konstruktiv i rajonit, anëtarësimin në NATO. Edhe pse ne flasim shumë për këtë anëtarësim, që domosdo do ta zgjidhte problemin kryesor që e ka Kosova dhe rajoni-atë të sigurisë, anëtarësimi në NATO nuk mund të bëhet pa adresimin dhe përmbytjen e marrëveshjeve në kuadër të bisedimeve me Serbinë, të ndërmjetësuar nga BE-ja.

Një dëshirë të veçantë e kam lidhur me ish-krerët e UÇK-së që ndodhen në Hagë. Procesit gjyqësor po i vjen fundi dhe në muajt në vijim mund të kemi një vendim nga gjykata speciale. Ish-Presidenti Hashim Thaçi, ish-kryekuvendarët Jakup Krasniqi e Kadri Veseli si dhe ish-deputeti Rexhep Selimi po mbahen të burgosur për më shumë se pesë vjet. Nuk ka nevojë të thuhet se sa e padrejtë është mbajtja e tyre në burg për një kohë aq të gjatë. Ata, sikur edhe shumë të akuzuar të tjerë nga Gjykatat ndërkombëtare e vendore kanë mundur të mbrohen edhe në liri. Kështu, një pjesë të gjykimin të tij, ish-kryeministri Ramush Haraadinaj e ka kaluar në liri pranë familjes së tij. Prandaj është e paktueshme përse Thaçit, Veselit, Krasniqit e Selimit u është mohuar kjo e drejtë. Kujtoj se të drejtat e tyre janë shkelur në mënyrë serioze dhe se ata kanë të drejtë për shpagim, edhe pse jam i bindur se ata nuk do të kërkojnë shpagim material, sepse pas vendimit lirues të Gjykatës Speciale ata do të jenë fitues moral të një procesi, në të cilin përgjegjësia e tyre individuale nuk u dëshmuar nga prokuroria. Nuk do të merrem me frazat siç janë “gjykimi i UÇK-së” dhe të ngjashme, sepse më duken të jenë paksa sloganeshke. Me rëndësi është që në gjykatë u dëshmuar se në postet të cilat Thaçi, Veseli, Krasniqi e Selimi, i mbanin në UÇK, nuk mund të kishin përgjegjësi komanduese, duke qenë se, siç dëshmuar shumë njohës të rrethanave në Hagë, UÇK-ja nuk e kishte mundësinë praktike të jetë një forcë guerile me linje strikte hierarkike, ku zinxhiri komandues funksiononte dhe respektohej. Të mos e zgjas më tepër; uroj lirimin e Thaçit, Veselit, Krasniqit, Selimit e të tjerëve dhe kthim në gjirin familjar e në jetën publike të Kosovës, sepse besoj se ata kanë ende çka t’i japin vendit.

Dëshirat për një vit imagjinar janë të shumta. Në këtë kolumnë i përmbledha tri prej tyre që mendoj se janë të rëndësishme që Kosova të ecë përpara drejt vendit që i takon: anëtare e NATO-s dhe e BE-së. Në këtë frymë, gëzuar 2026!



Foto: Driton Paçarada

Hyrjet kryesore në Prishtinë në majin e këtij viti janë bllokuar nga kamionët e bizneseve të mëdha të Kosovës, të cilat kanë kundërshtuar daljen në tregun e lirë energjetik. Përfaqësues të bizneseve kanë kërkuar që të shtyhet ekzekutimi i vendimit meqë sipas tyre do të ketë pasoja të rënda për kompanitë dhe konsumatorët. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) pati marrë vendim që nga data 1 qershor të gjitha kompanitë e mëdha, konkretisht ato me mbi 50 të punësuar ose me qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro të kalojnë në tregun e hapur të energjisë





**SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS**

Pozita:	Zhvillues/e i/e aplikacioneve në Sharepoint (Zyrtar i lartë)
Grada:	P05
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë
Divizioni:	Për Menaxhimin e Databazave dhe Aplikacioneve
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit për Menaxhimin e Databazave dhe Aplikacioneve

Njoftim i rëndësishëm:

Afati për aplikim për këtë pozitë, i cili ka qenë i hapur deri më 26 dhjetor 2025, shtyhet edhe për pesë (5) ditë pune.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Projektimi dhe zhvillimi i aplikacioneve të personalizuar, duke përdorur Power Apps për të përmirësuar proceset e biznesit dhe përvojën e përdoruesve.
- Krijimi dhe mirëmbajtja e rrjedhave të automatizuara të punës me Power Automate për të reduktuar detyrat manuale dhe për të integruar sisteme si SharePoint dhe API-të e jashtme.
- Ndërtimi dhe menaxhimi i faqeve, librarive, listave dhe autorizimeve në SharePoint për të mbështetur bashkëpunimin dhe menaxhimin e dokumenteve.
- Integrimi i të dhënave nga burime të ndryshme, duke përfshirë Dataverse, databaza SQL dhe API-të e jashtme, duke siguruar saktësinë, sigurinë dhe pajtueshmërinë e të dhënave.
- Kryerja e testimeve, zgjidhja e problemeve dhe optimizimi i aplikacioneve, rrjedhave të punës dhe integriteteve të të dhënave për të zgjidhur çështjet dhe për të përmirësuar performancën.
- Bashkëpunimi me palët e interesit të biznesit për të mbledhur kërkesat, për të ofruar trajnime dhe për të dokumentuar zgjidhjet për mirëmbajtje të vazhdueshme.
- Qëndrimi i përditësuar me përditësimet e Microsoft Power Platform, praktikat më të mira dhe teknologjitë e reja për të rekomanduar përmirësime.
- Shkrimi i query-ve të avancuara për analizën e të dhënave dhe përpunimin e tyre sipas nevojave të biznesit.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë universitare (bachelor) në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës, ose një nga certifikimet e mëposhtme:
 - Microsoft Certified: Power Platform Fundamentals (PL-900);
 - Microsoft Certified: Power Platform Functional Consultant Associate (PL-200);
 - Microsoft Certified: Power Platform Developer Associate (PL-400);
 - Microsoft Certified: Power Platform Solution Architect Expert (PL-600).
- Së paku 3 vite përvojë pune në zhvillimin e zgjidhjeve me SharePoint, Power Apps dhe Power Automate.
- Gjuha angleze - e preferuar;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- **Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **09 janar 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Pozicija:	Programer/ka aplikacija SharePoint (Viši službenik)
Stepen:	P05
Trajanje zaposlenja:	na neodređeno vreme
Odeljenje:	Informacione tehnologije i bezbednosti
Odsek:	Za upravljanje bazama podataka i aplikacijama
Izveštava:	Rukovodiocu odseka za upravljanje bazama podataka i aplikacijama

Važno obaveštenje:

Rok za prijavu za ovu poziciju, koji je bio otvoren do 26. decembra 2025. godine, produžava se za dodatnih pet (5) radnih dana.

Dužnosti i odgovornosti:

- Dizajniranje i razvijanje personalizovanih aplikacija, koristeći Power Apps za poboljšanje poslovnih procesa i iskustava korisnika.
- Kreiranje i održavanje automatizovanih tokova rada pomoću Power Automate-a kako bi se smanjio broj manualnih zadataka i integrisanje sa sistemima kao što je SharePoint i eksterni API.
- Kreiranje i upravljanje stranicama, bibliotekama, listama i dozvolama u SharePoint-u radi podrške saradnji i upravljanju dokumentima.
- Integrisanje podataka iz različitih izvora, uključujući Dataverse, baze podataka SQL i eksterne API-je, obezbeđujući tačnost, bezbednost i usklađenost podataka.
- Sprovođenje testiranja, rešavanje problema i optimizacija aplikacija, tokova rada i integracija podataka radi rešavanja problema i poboljšanja performanse.
- Saradnja sa poslovnim zainteresovanim stranama radi prikupljanja zahteva, održavanja obuka i dokumentovanja rešenja za kontinuirano održavanje.
- Ostati ažuriran sa ažuriranjima Microsoft Power Platform, najboljim praksama i novim tehnologijama radi preporučivanja poboljšanja.
- Pisanje naprednih query-ja za analizu i obradu podataka shodno potrebama biznisa.

Kvalifikacije i potrebno iskustvo:

- Univerzitetska diploma osnovnih studija iz računarskih nauka, elektrotehnike ili matematike ili jedan od sledećih sertifikata:
 - Microsoft Certified: Power Platform Fundamentals (PL-900);
 - Microsoft Certified: Power Platform Functional Consultant Associate (PL-200);
 - Microsoft Certified: Power Platform Developer Associate (PL-400);
 - Microsoft Certified: Power Platform Solution Architect Expert (PL-600).
- Najmanje 3 godine iskustva u razvoju rešenja sa SharePoint-om, Power Apps-om i Power Automate-om.
- Poznavanje engleskog jezika - poželjno;

Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Motivaciono (propratno) pismo u kojem se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- **Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji služe za dokazivanje držane pozicije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka)
- **Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trust)** za relevantni period, ili poreska potvrda Poreske uprave (PAK) kada izveštaj Fonda nije pravno primenljiv;
- Kopije diploma, pri čemu diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koji služi kao dokaz o državljanstvu Kosova;

Procedura apliciranja:

- Zadnji rok za apliciranje je **09. januar 2026. godine.**
- Apliciranje se može obaviti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a. Drugi oblici apliciranja neće biti uzeti u obzir.



RRËFIMI I GRUAS QË SOLLI NË JETË DY FËMIJË GJATË LUFTËS NË GAZË

Dy jetë të reja në dy vjet lufte

Hadeel Al Gherbawi ka sjellë në jetë dy djem gjatë dy vjetëve të luftës në Rripin e Gazës, mes bombardimeve, zhvendosjeve të shpeshta dhe urisë ekstreme. Shtatzënitë e saj u shoqëruan me frikë, mungesë shërbimesh mjekësore dhe kushte çnjerëzore jetese. Ajo lindi një fëmijë në spital gjatë sulmeve dhe tjetrin në ambulancë, duke sakrifikuar ushqimin e vet për fëmijët. Rrëfimi i saj pasqyron vuajtjen e grave dhe familjeve civile në Gazë gjatë luftës

Rripi i Gazës, 22 dhjetor (The Guardian) - Hadeel Al Gherbawi ishte në muajin e shtatë të shtatzënisë kur filloi lufta në Rripin e Gazës, në tetor të vitit 2023. Deri në atë pikë, 26-vjeçarja ishte përgatitur me shumë kujdes për ardhjen në jetë të djalit të saj. Ajo vizitonte mjekun dy herë në muaj sepse shtatzënia ishte me rrezik të lartë, bënte ekografi të rregullta dhe merrte vitamina.

“Më pëlqejnë detajet”, ka rrëfyer ajo. Duke jetuar në anën lindore të Qytetit të Gazës, afër kufirit me Izraelin, dhe duke e ditur se shtatzënia do ta bënte të vështirë lëvizjen e shpejtë, ajo vendosi të shkonte te prindërit e saj në perëndim të Qytetit të Gazës që ditën e parë.

“Mendova se do të kalonin vetëm disa ditë dhe do të kthehesha”, ka thënë fillimisht ajo.

Familja ishte zhvendosur 13 herë që atëherë dhe shtëpia në të cilën jetonin ajo me burrin e saj është shkatërruar.

Në fund të tetorit, rreth pesë javë para datës së lindjes, Al Gherbawi ndodhej pranë një vendi kur ishte kryer një sulm masiv izraelit, në një ndërtesë banimi në Qytetin e Gazës. “Ndihej si një tërmet”, ka kujtuar Al Gherbawi.

Ajo kishte ikur në spitalin al-Shifa, në të cilin njerëzit e zhvendosur kishin mbushur çdo hapësirë. Përdorimi i banjës ishte pothuajse i pamundur.

“Nuk mund ta harroj tmerrin e asaj nate”, ka thënë ajo. Kishte një vend për trupa të pidentifikuar dhe një fuçi për pjesë trupash. Sulmi raportohet se kishte vrarë më shumë se 100 njerëz. Al Gherbawi e ka kujtuar erën e atyre momenteve. “Nuk mund ta duroja. Isha shtatzënë. Ndihesha keq... Zoti i mëshiroftë ata që u vranë”, ka thënë ajo.

Al Gherbawi dhe burri i saj vendosën se ishte më e sigurt të shkonin në jug për të lindur fëmijën e saj. Në kampet e zhvendosjes, përdorimi i banjës mbeti një makth.

Ajo zgjonte dikë që ta shoqëronte shpesh gjatë natës.

Shumë e frikësuar për të hyrë në lindje natyrshtë, sepse gjetja e transportit, veçanërisht gjatë natës, do të ishte e vështirë, ajo u kërkoj mjekëve në spitalin Nasser në qytetin e Khan Younis ta nxisnin lindjen.

Kur ndërtesa pranë u godit teksa ajo ishte në proces të lindjes, ajo kishte frikë se paniku dhe kaosi mund të çonin në përzierjen e foshnës së saj me një tjetër dhe i kërkoj

nënës së saj të bënte rojë. Ajo e ka cilësuar të padurueshme frikën që e ka përjetuar ato çaste.

Pasi erdhi në jetë Jawadi, Al Gherbawi u zhvendos në një apartament me qira, duke tjetur në një dhomë me 30 persona. Ajo nuk mundi të gjente qetësues dhimbjesh për qepjet që kishte nga lindja dhe duroi në heshtje dhimbjen natën që të mos i zgjonte të tjerët.

Ajo beson se kishte edhe depresion pas lindjes.

“Fytyra ime ishte e zbehtë, isha e dobët, e brishtë dhe flokët po më binin”, ka rrëfyer Al Gherbawi.

Disa muaj më vonë, ata u zhvendosën në një tendë.

“Ishte hera e parë që jetoja në një

tendë”, ka thënë ajo me kujtime të hidhura. “Rëra, insektet...” Ajo shqetësohej vazhdimisht se mos Jawad do të pickohej. E përfaqonte natën dhe zgjohej shpesh për të kontrolluar nëse ishte ende gjallë: kishte dëgjuar për të porsalindur që vdiqnin nga ngrija.

Shtatzënia tjetër

Pastaj, kur Jawad ishte nëntë muajsh, Al Gherbawi zbuloi se ishte përsëri shtatzënë.

“Në fillim u shokova dhe u mërzi-ta”, ka thënë ajo. “Si do të sjell një fëmijë tjetër në këtë botë teksa jetoja në një tendë?”.

Armëpushimi i janarit 2025 i kishte

sjellë shpresë të shkurtër.

“Nuk mund ta përshkruaj sa e lumtur isha”, ka kujtuar Al Gherbawi ndjenjat. Pavarësisht se ishte në tremujorin e parë të shtatzënisë dhe përkundër këshillës së të gjithëve, ajo këmbënguli të kthehej në veri drejt apartamentit të saj. Me burrin kaluan një natë të ftohtë duke qëndruar ulur në trotuarin e rrugës bregdetare duke pritur që të hapej pika e kontrollit. Më në fund, ata arritën në shtëpinë e tyre, me dhomën blu të Jawadit dhe dekorimet që ajo i kishte varur para luftës.

I kaluan gjashtë javë atje dhe filluan përgatitjet për lindjen e dytë. Më 18 mars, Izraeli shkeli armëpushimin dhe familja u detyrua të zhvendosej përsëri. Shtëpia e tyre më vonë u shkatërrua.

Shtatzënia e dytë rezultoi shumë më e vështirë se ajo e mëparshme. Të gjithë nëntë muajt kaluan tërësisht në luftë. Ajo ka kujtuar se në atë periudhë uria ishte më e keqja.

“Kishte ditë të tëra ku e vetmja gjë që kisha ishte një kastravec”, ka treguar ajo.

Al Gherbawi shqetësohej për foshnjën në bark dhe zemra i thyhej duke parë Jawadin të qante për ushqim. “Gjyshe, gjyshe”, thoshte ai, fjala e tij për ushqim. Sa herë që kishte ushqim, ajo i jepte pjesën e saj.

“Nuk kishte asgjë tjetër që mund të bëja”, ka kujtuar Al Gherbawi. “Sulmet, mungesa e sigurisë, mungesa e privatësisë, të qenit në një tendë - e gjithë kjo ishte e vështirë, por uria ishte gjëja më e vështirë. Duhej të flije dhe mund të qaje sepse ishe e uritur e nuk mund të gjeje asgjë për të ngrënë”.

Goditja nga uria

Kombet e Bashkuara kanë konstatuar se veprimet e Izraelit në Gazë, me viktima masive civile dhe kushte kërcënuese për jetën të imponuara qëllimisht, janë “në përputhje me karakteristikat e gjenocidit”, duke përfshirë “përdorimin e urisë si metodë lufte”.

Afër datës së lindjes, Al Gherbawi vendosi të kthehej te prindërit e saj, pranë një spitali me inkubatorë. Ajo kërkoj të kryente lindje cezariene si në herën e parë, por spitali ishte i mbingarkuar me raste urgjente dhe mjekët e siguruan se mund të lindte natyrshtë.

Një natë, filluan komplikimet. Duke mos dashur të shqetësonte të tjerët që

“nuk hëngrën gjithë ditën” dhe po flinin, ajo thirri një ambulancë para se të zgjonte nënën e saj. Burri i saj ishte në jug. Me dhimbjet që shtoheshin çdo pesë minuta, ajo zbriti pesë kate poshtë. Ndërtesa nuk kishte energji elektrike për ashen-sorin. Ajo solli në jetë një djalë në ambulancë disa minuta më vonë. Ia vuri emrin Fares. Faresi peshonte vetëm 2 kilogramë. Al Gherbawi ia ka atribuar këtë urisë dhe ka thënë se djali i ka mbetur i vogël edhe sot e kësaj dite.

Në spital, kishte gjak në shtratin e saj. Infermierja i pati thënë se nuk kishte anestezi, do të duhej ta qepnin pa të. Përfitoi sërisht dhimbje të cilat i quan të padurueshme.

Spitali kishte nevojë për shtratin. Al Gherbawi, e rraskapitur dhe me dhimbje, duhej të ulej në një karrige derisa të mbaronte periudha e vëzhgimit. Gjetja e transportit për në apartamentin e prindërve të saj doli e vështirë.

Më në fund kishin gjetur një autobus që mund t'i çonte në gjysmë të rrugës.

Pesë orë pas lindjes, Al Gherbawi kishte ecur përsëri në shtëpinë e prindërve të saj duke u ngjitur në pesë kate.

Një armëpushim tjetër është arritur për Gazën në vjeshtë dhe ai ka hyrë në fuqi më 10 tetor.

Armëpushimi është arritur bazuar në një plan 20-pikësh të presidentit amerikan, Donald Trump. Deri më tani është realizuar vetëm faza e parë e tij, ndonëse edhe kjo nuk ka kaluar pa rikthim të sulmeve nga ana izraelite, e cila akuzonte shpesh herë grupin militant Hamas për shkelje.

Gjatë fazës së parë të armëpushimit, parashihej lirimi i të gjitha pengjeve që Hamasi i kishte marrë në jug të Izraelit gjatë sulmit të 7 tetorit 2023. Pengjet e gjalla janë kthyer menjëherë të gjitha, ndërkaq ka mbetur vetëm edhe një trup pengu pa u kthyer. Hamasi thotë se nuk po arrin ta gjejë pavarësisht përpjekjeve, për shkak se trupi mund të jetë varrosur nën gërmadhat e shumta që janë shkatërruar në territor si pasojë e luftës.

Faza e tjetër e armëpushimit parasheh procese më të vështira, si administrimi i Gazës dhe çarmatosja e Hamasit.

Përktheu: Flutura Gashi-Mehmeti





Përsëritja e presidentit Donald Trump nga Baza Ajrore në Dover (Foto: AP)



Palestinezët kalojnë një rrugë të përmbytur pas shiut të rrëmbyeshëm në Khan Younis, në jug të Gazës, 11 dhjetor 2025. (Foto: AP)

NGJARJET QË SHËNUAN 2025-TËN

Bota në duart e Trumpit

Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, ishte personazhi kryesor në ngjarjet më të mëdha në vitin 2025. Me ndërmjetësimin e tij u arrit armëpushimi Izrael – Hamas, ndërsa ai i ka intensifikuar përpjekjet për arritjen e paqes mes Rusisë dhe Ukrainës. Por, Trump gjatë vitit u përkujdes edhe për t'i shkundur tregjet botërore me vendosje të tarifave

Flutura Gashi-Mehmeti

WASHINGTON, DHJETOR - Dora e presidentit amerikan Donald Trump ishte në shumicën e ngjarjeve më të mëdha në botë gjatë vitit 2025. Ndikimi i tij i madh është vërejtur që me vendimet e para të mandatit të dytë që ka nisur më 20 janar, përpjekjet dhe presionin e vazhdueshëm për fundin e luftërave në Gazë e Ukrainë, e deri te takimet historike e madje edhe të tensionuara me disa prej liderëve më aktualë në skenën ndërkombëtare. Çështja e Ukrainës, të cilën besonte se mund ta zgjidhte për 24 orë, i ka dalë të jetë problemi më i madh.

Arritja e armëpushimit në Gazë

Ngjarja kryesore që nisi vitin 2025 ishte arritja e armëpushimit ndërmjet Izraelit dhe Hamasit në luftën e Gazës, i cili hyri në fuqi më 19 janar. Palët ranë dakord t'i ndalojnë luftimet pas 15 muajsh lufte teksa shtyja kryesore për këtë u bë presidenti i sapozgjedhur amerikan, Donald Trump, i cili ende pa e marrë zyrtarisht mandatin e dytë, kërkoi ndaljen e luftimeve para se ai të inaugurohej, duke kërcënuar me “ferr” për Lindjen e Mesme.

Inaugurimi i Trumpit dhe 200 urdhrat e parë

Donald Trumpi ka bërë betimin e tij të dytë si president i SHBA-së, më 20 janar. Që në ditët e para të mandatit të tij të dytë, Trumpi tronditi të gjithë duke nënshkruar rreth 200 urdhra ekzekutivë për çështje të ndryshme, filluar nga imigracioni, klima e deri te faljet për të akuzuarit për sulmin në Kapitol. Ndër urdhrat

e parë ishin ata për shpalljen e emergjencës kombëtare në kufirin jugor me Meksikën, si dhe ai për t'i dhënë fund shtetësisë automatike për këdo që lind në Amerikë. Një nga vendimet që ka ngjallur reagim ndërkombëtar, ishte ai për tërheqje nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Trumpi po ashtu ka urdhëruar ushtrinë që t'i “mbyllë kufijtë”, ndërsa ka përmendur trafikimin e drogës, kontrabandën e qenieve njerëzore si dhe krime të tjera që ndërlidhen me kalimin ilegal të kufijve. SHBA-ja nën administratën “Trump 2” do të njohë vetëm “dy gjini, mashkull dhe femër”. Në grupin e parë të direktivave të nënshkruara nga Trumpi, përfshihet edhe tërheqja nga Marrëveshja e Parisit për klimën. Trumpi u tërhoq për herë të parë nga Marrëveshja e Parisit në vitin 2017, përpara se Joe Bideni ta rikthente SHBA-në në të në 2021-tën.

Zbulimi tronditës në Siri pas rënies së Assadit

Mbetjet mortore të dhjetëra viktimave të regjimit të Bashar al-Assadit janë gjetur në fund të janarit nga punonjësit e mbrojtjes civile siriane, në dy bodrume të ndryshme në një vend në periferi të Damaskut të Sirisë. Që nga rënia e qeverisë së Assadit në dhjetor 2024, janë gjetur disa varre masive. Qeveria e Assadit, e cila sundoi Sirinë për më shumë se dy dekada, përdori sulme ajrore në zonat civile, tortura, ekzekutime dhe burgosje masive, për ta mbajtur kontrollin mbi Sirinë dhe për t'i shtypur grupet opozitare gjatë luftës civile 13-vjeçare të vendit. Rënia e Assadit më 8 dhjetor nxiti qindra familje të vrapolnë drejt burgjeve dhe morgëve në kërkim të dëshpëruar për njerëzit e dashur.

Nisja e bisedimeve SHBA-Rusi për Ukrainën, pa Ukrainën

Presidenti amerikan, Donald Trump, ka tronditur diplomacinë ndërkombëtare në fund të muajit shkurt, duke çuar zyrtarë të lartë amerikanë në takim me disa prej zyrtarëve më të lartë rusë, në Arabinë Saudite. Në bisedimet për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë nuk ishte e ftuar vetë Ukraina. Asnjë zyrtar ukrainas nuk ishte i pranishëm në takim, i cili ndodhi teksa vendi po humbte terren kundër trupave më të shumta ruse, në një luftë të rëndë që ka nisur tre vjet më parë. Tensionet lindën mes presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky dhe Trumpit pas takimit SHBA-Rusi.

Takimi rrëqethës Trump-Zelensky

Me tensione të pazakonta është përcjellë takimi mes presidentit amerikan, Donald Trump, dhe atij ukrainas Volodymyr Zelensky, më 28 shkurt në Shtëpinë e Bardhë. Gjatë takimit Zelensky kishte planifikuar të nënshkruante marrëveshje të rëndësishme me SHBA-në. Por në vend të kësaj, lideri i Ukrainës doli nga Shtëpia e Bardhë i përzënë. Tensionet u shfaqën në 10 minutat e fundit të takimit gati 45-minutësh. Presidenti Trump dhe zëvendësi i tij JD Vance e akuzuan Zelenskyn se është mosmirënjohës e jofalënderues për ndihmat e ofruara nga SHBA-ja për luftën e Ukrainës. Kur udhëheqësi ukrainas paraqiti skepticizëm ndaj çdo premtimi të Putinit për t'i dhënë fund luftës, Vance e qortoi fuqishëm për shfaqjen e mosmarrëveshjeve me Trumpin në publik. Kjo ndryshoi menjëherë thelbin e bisedës teksa Zelensky nisi të mbrohej ndërkaf Trumpi dhe

zëvendësi i tij e quajtën atë mosmirënjohës dhe lëshuan paralajmërime të repta për mbështetjen e ardhshme amerikane.

CDU fiton zgjedhjet në Gjermani, e djathta ekstreme dyfishohet

CDU-ja doli e para në zgjedhjet e parakohshme nacionale në Gjermani, të mbajtura më 23 shkurt. E partia e ekstremit të djathtë “Alternativa për Gjermaninë” ka dyfishuar mbështetjen duke dalë e dyta. Befasia e këtyre zgjedhjeve ka qenë rezultati i lartë i partisë “Alternativa për Gjermaninë” e ekstremit të djathtë, e cila ka dalë e dyta me 20,8% të votave. E formuar si reagim kundër politikave të Eurozonës në vitin 2013, AfD-ja ishte mësuar të ishte në periferi të politikës gjermane, në një vend të dëmtuar prej të kaluarës naziste, ku çdo parti e ekstremit të djathtë është trajtuar me kujdes. E kreu i CDU-së, Friedrich Merz, u bë kancelar i ri i Gjermanisë në fillim të majit.

Rikthimi i luftës në Gazë

Izraeli riktheu sulmet në Gazë më 18 mars. Armëpushimi ra pas mosmarrëveshjeve të shfaqura mes Izraelit dhe Hamasit lidhur me kthimin e pengjeve. Sulmet u rikthyen si formë presioni ndaj Hamasit i cili nuk kishte pranuar zgjatje të fazës së parë të armëpushimit. Banorëve të Rripit të Gazës u kishte mbaruar qetësia e shkurtër që gëzuan, madje edhe në gërmadhat e shtëpive të shkatërruara nga lufta që nisi në tetor të vitit 2023. Vetëm në ditën e parë të rifillimit të sulmeve mbetën të vdekur më shumë se 400 palestinezë, një nga ditët më vdekjeprurëse të luftës.



Presidenti Donald Trump përshëndet presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, në Bazën Elmendorf-Richardson, Alaska, 15 gusht 2025. (Foto: AP)



Zëvendëspresidenti JD Vance duke u drejtuar presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky, në Zyrën Ovale në Shtëpinë e Bardhë, 28 shkurt 2025 (Foto: AP)



Njerëzit e mbledhur jashtë Bashkisë të Stambollit për të protestuar kundër arrestimit të Ekrem Imamoglu, 19 mars 2025. (Foto: AP)

Arrestohet rivali kryesor i Erdoganit

Pak ditë para se të shpallej kandidat i partisë më të madhe opozitare për president të Turqisë, më 19 mars autoritetet e kanë arrestuar kryebashkiakun e Stambollit, Ekrem Imamoglu. Imamoglu është rivali kyç i presidentit Recep Tayyip Erdogan dhe shihej si fitues potencial i zgjedhjeve presidenciale që pritet të mbahen në vitin 2028. Zyra e Prokurorit të Stambollit ka thënë se arrestimi është bërë si pjesë e hetimeve për korrupsion dhe bashkëpunim me një organizatë të cilën Turqia e konsideron terroriste. Ndalimi i Imamoglut ka nxitur protestat në Stamboll, ku mijëra qytetarë dolën në rrugë për ta kundërshtuar veprimin.

Trumpi “ndeç luftën tregtare”

Presidenti amerikan, Donald Trump, bëri një tronditje globale, kur më 3 prill shpalli tarifën e reja për importet amerikane. Duke e quajtur atë “Dita e Çlirimit” për Amerikën, Trumpi ka thënë se po vihej në radhë të parë interesi i popullit të tij. Tarifat kanë shkaktuar turbulenca në tregjet botërore dhe kanë nxitur dënimin nga liderët e tjerë që po përballen me fundin e një epoke të liberalizimit të tregtisë që ka formësuar rendin global për dekada. Trumpi kishte argumentuar se taksat e reja do të rrisnin prodhimin vendor në SHBA dhe po ashtu vendet e punës.

Vdekja e Papa Françeskut

Papa Françesku vdiq më 21 prill pasi kishte pësuar sulm në tru. Presidentë, anëtarë të familjeve mbretërore dhe qytetarë të shumtë i kanë dhënë lamtumirën atij në një ceremoni solemne gjatë të cilës, u bë thirrje që trashëgimia e Papës për kujdesin për emigrantët, të shtypurit dhe mjedisin të mbahej gjallë. Papa argjentinas, i cili udhëhoqi për 12 vjet, vdiq në moshën 88-vjeçare. Papa i parë nga Amerika Latine kishte bërë thirrje vazhdimisht për t'u dhënë fund konflikteve gjatë papatit të tij. Françesku, i cili ka shmanhur shumë nga madhështia dhe privilegji i papatit, kishte kërkuar që të varroset në Bazilikën e Shën Mërisë dhe jo në atë të Shën Pjetrit. Ishte hera e parë që një papë u varros jashtë Vatikanit në më shumë se një shekull.

Zgjedhja e papës së ri

Më shumë se 130 kardinalë arritën që më 8 maj ta zgjedhin papën e ri, në ditën e dytë të konklavës në Vatikan. Amerikani Robert Prevost u zgjodh papa i ri. Ai do të njihet si Papa Leoni XIV. Prejardhja dhe ideologjia e tij kanë ngritur pikëpyetje në mesin e teologëve dhe akademikëve. I lindur në Çikago, Robert Prevost, është zgjedhur si papa



Papa i sapozgjedhur Leoni XIV shfaqet në ballkonin e Bazilikës së Shën Pjetrit në Vatikan, 8 maj 2025. (Foto: AP)

i 267-të, duke kapërcyer shmangien tradicionale të zgjedhjes së një pape nga Shtetet e Bashkuara.

Takimi historik i Trumpit me liderin e Sirisë

Një takim historik ka ndodhur më 14 maj në Riad të Arabisë Saudite. Presidenti amerikan, Donald Trump, është përballur sy më sy me presidentin e përkohshëm të Sirisë, Ahmed al-Sharaa. Që takimi i parë mes liderëve të të dy vendeve, që prej vitit 2000. Një ditë para takimit, Trumpi, gjatë një fjalimi në Riad, në kuadër të turneut të tij katërditor në Lindjen e Mesme, njoftoi mbi vendimin për heqjen e sanksioneve rreth 40-vjeçare ndaj Sirisë. E presidentin Sharaa, personin për të cilin deri një vit më parë SHBA-ja ofronte 10 milionë dollarë për shkak të lidhjeve të tij në të kaluarën me Al-Qaeda, Trumpi e ka quajtur një djalë atraktiv dhe me të kaluar prej luftëtari.

Rrëzimi i aeroplanit në Indi pak pas ngritjes

Një avion pasagjerësh “Boeing 787” u rrëzua në Indi më 12 qershor, pak minuta pas ngritjes, me mbi 240 persona në bord. Avioni u rrëzua në qytetin veriperëndimor të Ahmedabad teksa vetëm një person ka arritur të mbi-jetojë. Një pjesë e aeroplanit ka rënë mbi një koleg mjekësor në Ahmedabad, duke çuar numrin e të vdekurve në total në 270. Ky ishte rrëzimi i parë fatal qëkur aeroplanit, i njohur edhe si Dreamliner, hyri në shërbim në vitin 2009, sipas bazës së të dhënave të Rrjetit të Sigurisë së Aviacionit.

SHBA-ja sulmon Iranin

Presidenti amerikan Donald Trump, i cili nuk është përballur me ndonjë krizë të madhe ndërkombëtare në mandatin e tij të parë, u përfshi në një të tillë vetëm gjashtë muaj pas fillimit të mandatit të tij të dytë. Më 21 qershor ai dha dritën e gjelbër që SHBA-ja ta godasë Iranin, duke u përfshirë në luftën Izrael-Iran. Miratimi është dhënë pasi më shumë se një javë sulmesh ajrore izraelite ndaj objekteve bërthamore dhe ushtarake të Iranit, kanë hapur rrugën që SHBA-ja të jepte goditjen potencialisht vendimtare. SHBA-ja ka goditur të shtunën e 21 qershorit tri objekte bërthamore iraniane: Fordoë, Natanz dhe Esfahan.

Takimi historik Trump-Putin

Samiti i shumëpritur dhe i shumëpërfolur mes presidentit amerikan Donald Trumpit dhe atij rus Vladimir Putinit më 16 gusht në Alaska nuk solli paqe në Ukrainë. Dy presidentët vlerësuan njëri-tjetrin dhe e quajtën takimin të suksesshëm, por nuk dhanë asnjë detaj se çka diskutuan për Ukrainën në takimin dyorësh.



Presidenti Donald Trump shtrëngon duart me presidentin e përkohshëm të Sirisë, Ahmad al-Sharaa, në Riad, Arabi Saudite, 14 maj 2025. (Foto: AP)

Trumpi e priti Putinin në një tepih të kuq të shtruar në pistën e bazës së përbashkët El-mendorf-Richardson. Të dy udhëheqësit shtrënguan duart me ngrohtësi dhe buzëqeshën. Ishte një moment i jashtëzakonshëm për Putinin - një udhëheqës i shmangur nga shumica e vendeve perëndimore që kur Moska nisi pushtimin e Ukrainës më 2022.

Plani i Trumpit i jep fund luftës në Gazë

Pak ditë para se të shënoheshin plot 2 vjet që kur kishte nisur lufta në Gazë, Izraeli dhe Hamasi iu përgjigjën pozitivisht një plani 20-pikësh të presidentit amerikan, Donald Trump për armëpushim. Sipas planit të Trumpit për paqe në Gazë, i cili hyri në fuqi më 10 tetor, Hamasi do të lironte 48 pengjet e mbetura, rreth 20 prej të cilëve ishin gjallë, brenda tri ditësh. Gjithashtu do të hiqte dorë nga pushteti dhe do të çarmatosej. Në këmbim Izraeli do të ndalonte ofensivën e tij dhe do të tërhiqej nga pjesa më e madhe e Gazës, do të lironte qindra të burgosur palestinezë dhe do të lejonte një fluks ndihmash humanitare dhe rindërtim përfundimtar. Deri më tani, as faza e parë nuk është përmbyllur pasi ka mbetur edhe një trup pengu izraelit pa u kthyer nga Hamasi.

Takimi Trump - Xi

Një takim mes presidentit amerikan, Donald Trump dhe atij kinez, Xi Jinping, më 30 nëntor në Kore të Jugut duket se ka shtensionuar pak marrëdhëniet, sidomos ato tregtare, mes dy vendeve. Mirëpo, përveç disa marrëveshjeve bazë, problemet rrënjësore të tensioneve tregtare nuk janë zgjidhur. Më bisedime munguan çështjet e mëdha të përmendura nga Trumpi kur ai shpalli tarifën e tij në prill - politikën industriale të Kinës, mbikapaciteti i prodhimit dhe modeli i saj i rritjes i udhëhequr nga eksporti. Por presidenti amerikan doli nga takimi i entuziazmuar, teksa njoftoi më pas se tarifën mbi importet kineze do të ulëshin në 47% nga rreth 57%. Ai tha se Xi do të punojë shumë fort për të ndaluar rrjedhën e kimikateve të përdorura për prodhimin e opioideve vdekjeprurës që është shkak kryesor i vdekjeve nga mbidoza në Amerikë.

Plani 28-pikësh i Trumpit për Ukrainën

Në javën e fundit të muajit nëntor, në media ka qarkulluar një plan të hartuar nga administrata Trump me të cilin synohet t'i jepet fund luftës në mes të Ukrainës dhe Rusisë. Sipas raportimeve, draftpropozimi i ri parasheh që Kievi të heqë dorë nga një pjesë e territorit e t'i zvogëlojë kapacitetet ushtarake. Plani 28-pikësh ka ngjallur reagimet e ukrainasve dhe evropianëve, pasi forma e tij fillestare kon-

siderohej se ishte në favor të kërkesave të Rusisë. Zyrtarët amerikanë kanë thënë se plani ende po përpilohet dhe se çfarëdo marrëveshje përfundimtare duhet të përfshijë lëshime nga të dyja palët, jo vetëm nga Ukraina. Disa runde takimesh janë zhvilluar deri më tani ndërmjet të dërguarve të Trumpit dhe palëve ukrainase e ruse, mirëpo nuk ka përparim të dukshëm. Ukraina bashkë me aleatët evropianë kanë përgatitur së fundmi një plan të ri, i cili sipas Zelenskijt, parasheh mundësinë e tërheqjes së trupave ukrainase nga rajoni lindor, me kushtin që të mbetet zonë e çmilitarizuar dhe e lirë ekonomike, nën mbikëqyrje ndërkombëtare.

Putini refuzon kompromisin për Ukrainën

Presidenti rus, Vladimir Putin, ka dhënë një sinjal të qartë në dhjetor se nuk do të bëjë kompromis me kërkesat e tij që Ukraina të lëshojë territor, pavarësisht përpjekjeve intensive të presidentit të SHBA-së, Donald Trump, për paqe. Në një fjalim të ashpër gjatë një takimi vjetor, ndërsa udhëheqësit amerikanë dhe evropianë po vazhdojnë përpjekjet e furishme diplomatike për të siguruar një marrëveshje paqeje, Putini sulmoi aleatët evropianë të Ukrainës dhe tha se Rusia do të merrte territor edhe me forcë nëse është e nevojshme. Çështja e territorit si dhe garancitë e sigurisë për Ukrainën po rezultojnë të jenë pjesët më të vështira për t'u zgjidhur gjatë bisedimeve të paqes. Rusia ka aneksuar në mënyrë të paligjshme rajonin Donbas të Ukrainës, por nuk e ka pushtuar plotësisht. Më 15 dhjetor, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se Kievi nuk do ta njohë pjesën e pushtuar përkohësisht të rajonit lindor të Donbasit si ligjërish, ose de facto, ruse. Trumpi ka qenë vazhdimisht optimist për perspektivën e arritjes së një marrëveshjeje paqeje, duke thënë gjatë dhjetorit se “jemi më afër tani sesa kemi qenë”. Mirëpo, gjatë vitit të parë të mandatit të tij, ai nuk ka arritur ta zgjidhë çështjen e Ukrainës, për të cilën besonte se do ta zgjidhte brenda 24 orëve.

Takimi i “progresit” mes Trumpit e Zelenskijt

Donald Trumpi dhe Volodymyr Zelensky kanë thënë se ishte bërë përparim për ti dhënë fund luftës në Ukrainë gjatë një takimi të fundit në Florida më 28 dhjetor, por udhëheqësi amerikan ka shtuar se megjithatë kanë mbetur edhe “një ose dy çështje shumë të vështira për t'u zgjidhur”. Trumpi ka thënë se një pikë ngërçi është çështja e territorit. Një ditë pas takimit, Zelensky u ka thënë gazetarëve se kishte kërkuar garanci sigurie nga SHBA-ja për 50 vjet, teksa sipas tij, plani amerikan i paqes parasheh garanci sigurie vetëm për 15 vjet.



Mbetjet e aeroplanit indian mbi ndërtesën ku u rrëzua pak pas ngritjes, 12 qershor 2025. (Foto: AP)



TRAGJEDIA E HESHTUR PAS VIJËS SË FRONTIT

Stigma e ushtarëve të harruar të Ukrainës që “vdiqën në mënyrën e gabuar”

Pas bilancit zyrtar të viktimave të luftës në Ukrainë qëndrojnë histori të padukshme dhimbjeje dhe heshtjeje. Ky tekst sjell në vëmendje një tragjedi të fshehur: ushtarë që nuk humbën jetën në betejë, por u thyen nga pasojat psikologjike të luftës. Përmes rrëfimeve të nënave dhe bashkëshorteve, zbulohet një realitet i rëndë i stigmës, mohimit dhe mungesës së drejtësisë. Familjet e tyre përballen jo vetëm me humbjen, por edhe me përjashtimin institucional. Teksti ngre pyetje të forta mbi përgjegjësinë e shtetit dhe trajtimin e shëndetit mendor në ushtri

DONETSK, DHJETOR (BBC) - Kateryna nuk arrin të flasë për djalin e saj, Orestin, pa shpërthyer në lot. Zëri i saj dridhet nga dhimbja dhe zemërimi teksa tregon momentin kur mori lajmin se ai kishte humbur jetën në vijën e frontit në rajonin lindor të Donetskut në Ukrainë, në vitin 2023.

Sipas hetimit zyrtar të ushtrisë, vdekja e tij u klasifikua si pasojë e një “plage të vetëshkakutuar”, një përfundim që Kateryna e ka shumë të vështirë ta pranojë dhe ta besojë. Kateryna ka kërkuar që ajo dhe djali i saj i ndjerë të mbeten anonimë, për shkak të stigmës së fortë që ende rrethon vetëvrasjen dhe shëndetin mendor në shoqërinë ukrainase.

Orest ishte një djalë i qetë, 25-vjeçar, që i adhuronte librat dhe ëndërronte të ndërtonte një karrierë akademike. Sipas nënës së tij, shikimi i dobët e kishte bërë fillimisht të papërshtatshëm për shërbim ushtarak në fillim të luftës.

Megjithatë, në vitin 2023, një pa-trullë rekrutimi e ndaloi në rrugë. Shikimi i tij u rishqyrtua dhe këtë herë ai u shpall i aftë për luftë. Pak kohë më pas, ai u dërgua në front si specialist komunikimi.

Ndërsa Ukraina mban zi kolektivisht për më shumë se 45 mijë ushtarë të vrarë që nga pushtimi i plotë rus në vitin 2022, një tragjedi më e heshtur po zhvillohet larg vëmendjes publike.

Nuk ekzistojnë statistika zyrtare për vetëvrasjet e ushtarëve. Zyrtarët i përshkruajnë këto raste si incidente të izoluar, por aktivistët të të drejtave të njeriut dhe familjarët e viktimave besojnë se numri real mund të jetë në qindra.

“Oresti u kap, nuk u thirr”, thotë Kateryna me hidhërim.

“Lufta e theu”

Qendra lokale e rekrutimit i mohoi akuzat për shkelje, duke deklaruar se shikimi i dëmtuar e bënte Orestin “pjesërisht të aftë” për shërbim gjatë kohës së luftës.

Pasi u vendos pranë Chasiv Yarit në Donetsk, Oresti u bë gjithnjë e më i tërhequr dhe ra në depresion, kujton Kateryna.

Ajo ende i shkruan letra djalit të saj çdo ditë - deri tani 650 e më shumë - ndërsa dhimbja e saj thellohet edhe më shumë nga fakti se në Ukrainë vetëvrasja klasifikohet si humbje joluftarake. Familjet e ushtarëve që i japin fund jetës nuk marrin kompensim, nderime ushtarake apo njohje publike.

“Në Ukrainë duket sikur jemi ndarë në dy kategori”, thotë Kateryna. “Disa kanë vdekur në mënyrën e duhur, ndërsa të tjerët në mënyrën e gabuar”.

“Shteti ma mori djalin, e dërgoi në luftë dhe ma ktheu në një arkivol. Kaq. Asnjë ndihmë, asnjë e vërtetë, asgjë”.

Për Mariyanën nga Kiev, historia është e ngjashme. Edhe ajo dëshiron ta ruajë anonimitetin e saj dhe të bashkëshortit të ndjerë.

Burri i saj, Anatoliy, doli vullnetar për të luftuar në vitin 2022. Fillimisht u refuzua për shkak të mungesës së përvojës ushtarake, por, sipas saj, “ai vazhdoi të kthehej derisa e pranuan”, thotë ajo me një buzëqeshje të zbehtë.

Anatoliy u dërgua pranë Bakhmutit, ku u zhvillua një nga betejat më të përgjakshme.

“Pas një misioni, më tha se rreth 50 djem ishin vrarë”, kujton Mariyana.

“Ai u kthye ndryshe; i heshtur dhe i largët”.

Pasi humbi një pjesë të krahut, Anatoliy u dërgua në spital. Një mbrëmje, pas një telefonate me gruan e tij, ai i dha fund jetës në oborrin e spitalit.

“Lufta e theu”, thotë ajo mes lotësh. “Ai nuk mundi të jetonte me ato që kishte parë”.

Për shkak se Anatoliy kreu vetëvrasje, autoritetet ia mohuan një varrim ushtarak.

“Kur qëndronte në vijën e frontit, ishte i dobishëm. Tani nuk është më hero”.

Mariyana ndihet e tradhtuar.

“Shteti më la në rrugë. Ua dhashë burrin tim dhe ata më lanë vetëm, pa asgjë”.

Ajo ka përjetuar gjithashtu stigmatizim nga vejusha të tjera.

Burimi i saj i vetëm i mbështetjes është një komunitet online me gra që ndajnë të njëjtin fat - vejusha të ushtarëve që kanë kryer vetëvrasje.

Ato kërkojnë që Qeveria ta ndryshojë ligjin, në mënyrë që familjet e tyre të kenë të njëjtat të drejta dhe të njëjtin respekt si të tjerët.

Dyshimet për vdekjen

Viktoria, të cilën ekipi i BBC-së e takoi në Lviv, ende nuk mund të flasë publikisht për vdekjen e bashkëshortit të saj, nga frika e gjykitimit dhe dënimit shoqëror.

Bashkëshorti i saj, Andriy, kishte një sëmundje të lindur të zemrës, por pavarësisht kësaj ai këmbënguli t'i bashkohej ushtrisë. U caktua si shofer në një njësi zbulimi dhe u bë dëshmitar i disa prej betejave më in-

tensive të luftës, përfshirë edhe çlirimin e Khersonit.

Në qershor të vitit 2023, Viktoria mori një telefonatë që do t'ia ndryshonte jetën përgjithmonë: i thanë se Andriy kishte kryer vetëvrasje.

“Ishte sikur bota u shemb”, thotë ajo.

Trupi i tij mbërriti dhjetë ditë më vonë, por Viktorias iu tha se nuk lejohet ta shihte.

Avokatja që ajo punësoi më vonë zbuloi mospërputhje serioze në hetimin e vdekjes së tij. Fotografite nga vendngjarja e bënë Viktorian të dyshonte në versionin zyrtar të vdekjes së bashkëshortit të saj. Më pas, ushtria ukrainase pranoi dështime në proces dhe ra dakord që hetimi të ri-hapej.

Tani ajo po lufton për rihapjen e plotë të çështjes.

“Po luftoj për emrin e tij. Ai nuk mund të mbrohet më vetë. Lufta ime nuk ka përfunduar”.

Oksana Borkun drejton një komunitet mbështetës për vejusha të ushtarëve të ndjerë.

Organizata e saj përfshin tashmë rreth 200 familje që kanë humbur të afërmit e tyre nga vetëvrasja.

“Nëse është vetëvrasje, atëherë ai nuk është hero - kështu mendojnë njerëzit”, thotë ajo. “Disa kisha refuzojnë të mbajnë funeralë. Disa qytete nuk pranojnë t'i vendosin fotografite e tyre në muret përkujtimore”.

Shumë prej këtyre familjeve dyshojnë në shpjegimet zyrtare të vdekjeve. “Disa raste mbyllen shumë shpejt”, shton ajo. “Dhe ka nëna që hapin arkivolin dhe gjejnë trupa të mbuluar me mavijosje”.

Prifti Borys Kutovyi thotë se që nga fillimi i pushtimit të plotë ka qenë dëshmitar i të paktën tri vetëvrasjeve në njësitë nën komandën e tij.

Por për të, edhe një e vetme është tepër.

“Çdo vetëvrasje do të thotë se diku kemi dështuar”, thotë ai.

Ai beson se shumë nga ushtarët e rekrutuar, ndryshe nga ushtarakët profesionistë, janë veçanërisht të pambrojtur psikologjikisht.

Si Oksana, ashtu edhe ati Borys, janë të mendimit se ata që kanë kryer vetëvrasje duhet të konsiderohen heronj.

Olha Reshetylova, komisionerja e Ukrainës për të Drejtat e Veteranëve, thotë se zyra e saj merr raporte për deri në katër vetëvrasje ushtarake në muaj dhe pranon se nuk po bëhet mjaftueshëm.

“Ata kanë parë ferrin. Edhe mendjet më të forta mund të thyhen”, thotë ajo.

Ajo shpjegon se institucioni që drejton po shtyn për reforma, por ngritja e një njësie të mirë psikologjike ushtarake mund të zgjasë me vite.

“Familjet kanë të drejtë ta dinë të vërtetën”, thotë ajo. “Ato nuk u besojnë hetuesve. Në disa raste, vetëvrasjet mund të mbulojnë vrasje”.

Sa i përket nderimit të këtyre ushtarëve si heronj, ajo thotë se preferon të shikojë drejt së ardhmes. “Këta njerëz ishin fqinjët tuaj, kolegët tuaj”, thotë Reshetylova. “Ata kanë kaluar nëpër ferr. Sa më ngrohtë t'i presim, aq më pak tragjedi do të ketë”.

Përktheu: Blerta Haxhiu



PROGRAMI FESTIV I KOHAVISIONIT

“Gëzuar me KOHËN!” për festë e traditë

Besartë Elshani

Kohavisioni qëndron me publikun në çdo moment. Ciklin e një viti tjetër me mbulime ngjarjesh në të gjitha fushat e kurorezojnë me program festiv me rastin e ndërrimeve të moteve. Festa, hareja e energjia e ngrohtë vjen nëpërmjet ekranit të KTV-së me kapitullin e radhës së të kremtes. Oferta e televizionit me traditë një çerek-shekull është e larmishme.

Maratona festive treditore nis që në mëngjesin e 31 dhjetorit me emisionin “Sot”. Emisioni “Dive me Crazy” sjell atmosferën e festës me këngëtarin Xhaner Gashi e emisioni muzikor “Top Koha Music” prezanton 25 hitet më të dëgjura të vitit, duke reflektuar pulsion muzikor të një viti të tërë.

Producentja ekzekutive e KTV-së, Rea Surroi, ka dhënë detaje për nisjen e maratonës festive në ekran.

“Shikuesit do të ‘zgjohen’ me festë, me programin e mëngjesit ‘Sot’, udhëhequr nga Agnesa Vitia dhe ekipi i mrekullueshëm i këtij emisioni. Të gjitha informacionet rreth shërbimeve publike, rrjedhshmëria e furnizimit me ujë, energji elektrike, transporti urban, të gjitha këto informacione do të kumtohen në kohë reale. Të shoqëruar me muzikë, do të zhvillohen biseda interesante, sa argëtuese po aq edhe informuese. Do të komentohet shporta mesatare e qytetarit të Kosovës dhe zgjedhja për të festuar në shtëpi apo restorant.

Gjithashtu lidhja direkte nga sheshi kryesor i kryeqytetit nuk do të mungojë”, ka bërë të ditur Surroi.

Ka thënë se siç tradicionalisht ndodh, “Kohavisioni edhe këtë fund-vitë përcjell atmosferë magjike, të ngrohtë e të hareshme përmes programit të përgatitur enkas për fund-vitë”.

Ngjyrat e festës së shumëfishtë dhe të trashëgimisë

Edicione festive të të gjitha emisioneve shikuesit do të mund të shijojnë më 31 dhjetor. Në “Rreth botës” do të mund të shihni ngjarjet që e kanë karakterizuar botën këtë vit, sikurse edhe të rikujtoni ngjarjet e vitit nga desku i lajmeve. Po ashtu gjatë kësaj dite do të transmetohet ceremonia e shpërblimeve “Rexhai Surroi” për letërsi dhe gazetar.

Zëvendësproducentja ekzekutive e Kohavisionit, Edona Bekteshi-Shala, ka thënë se ekipi i televizionit ka punuar për të sjellë tri ditë maratonë festive, të ekuilibruara midis argëtimit cilësor dhe përmbajtjes që bashkon publikun.

“Në një realitet ku diskursi publik dominohet nga politika, ne kemi zgjedhur të ruajmë ekuilibrin përmes argëtimit cilësor dhe përmbajtjes që bashkon publikun. Me këtë qëllim prej kohësh jemi përgatitur për një program të pasur festiv, i cili sjell në ekran një larmi artistësh të njohur të

skenës muzikore shqiptare, me këngë të reja dhe hite të pavdekshme, të shoqëruara nga performanca live e grupit muzikor “Kadencia”, është shprehur ajo.

Për televizionin me traditë 25-vjeçare, ky vit që jubilar, që shënoi plot një çerekshkull punë. Transmetimi i parë më 22 shtator të vitit 2000 do të vijonte me punën kolosale të një ekipi profesionist përherë në rritje, gjër më sot. Kështu edhe e vizualizoi informacionin. Ngase që nga viti 1997 me gazetën “Koha Ditore”, dallohej si hapësirë e gazetarisë së pavarur, e cila në qendër e vendosi profesionalizmin, etikën e interesin publik.

Ky rrugëtim do të shpalojë nëpërmjet dokumentarit “25”, prodhim i KTV-së, nën regjinë e producentes ekzekutive Rea Surroi.

“Viti 2025 ishte vit feste për Kohavisionin. Shënoi çerekshkullin e themelimit të tij. Prandaj përmes rrëfimeve të personave publikë, të cilët ishin të punësuar dikur dhe ata të cilët vazhdojnë të jenë pjesë e KTV-së, shoqëruar me materiale nga arkivi i televizionit, paraqitet ‘trashëgimia’ programore dhe pesha e saj në skenën mediale. Dokumentari ‘25’ përbën tri pjesë, të cilat do të transmetohen radhazi, më datën 1, 2 dhe 3 janar prej orës 17:15”, ka thënë Surroi.

Bekteshi-Shala e ka cilësuar vit të rëndësishëm 2025-tën për televizionin që nuk u nënshtrohet sfidave

të tregut medial.

“Po e përmbylлим një vit të rëndësishëm për ne si televizion, duke qenë se viti 2025 shënoi edhe 25-vjetorin e themelimit tonë. Viti 2025, pavarësisht sfidave të vazhdueshme të tregut medial, u dëshmuoi si një vit i qëndrueshmërisë, profesionalizmit dhe rritjes. Ky vit nuk na dobësoi, por na bëri edhe më të fortë dhe më të përkushtuar ndaj misionit tonë”, ka thënë ajo, duke shtuar se i njëjti ritëm e pret Kohavisionin edhe më 2026.

“Faleminderit shikuesve tanë për besimin dhe mbështetjen e vazhdueshme gjatë këtyre 25 vjetëve. Me të njëjtin përkushtim dhe energji, hyjmë në vitin e ri me synimin për të ofruar përmbajtje edhe më cilësore, më dinamike dhe më afër publikut”, ka thënë zëvendësproducentja ekzekutive e KTV-së, Edona Bekteshi-Shala.

Yjet në natën më të gjatë të vitit dhe surpriza të tjera

Programi qëndror festiv është kuruar me kujdes. Si përherë, televizioni vazhdon të promovojë vlerat e këngës shqipe. Kështu, derisa familjet shqiptare festojnë të bashkuar, argëtohen me këngët e emrave të shquar të skenës muzikore. Natën më të gjatë të vitit e bëjnë edhe më të bukur zërat e këngëtarëve: Sinan Vllasaliu, Linda Hakaj, Saranda Aliu, Faton Isufi, Neki Emra, Ar-

tan Bakija, Hysni Klinaku, e shumë të tjerë, shoqëruar nga grupit muzikor “Kadencia”.

“Nuk ka festë të ndërrimit të moteve pa këngën e çiftit simpatik të estradës sonë, Mhrije Braha dhe Naim Abazi. Gjithashtu, këngëtar i njohur Sinan Vllasaliu ‘ndriçoi’ skenën tonë”, ka thënë producentja ekzekutive, Rea Surroi, derisa ka dhënë detaje shtesë rreth programit qëndror festiv.

Këngëtarja Sinan Vllasaliu ka thënë se performuesit përherë e më shumë këndojnë me orkestër dhe se kështu po bëhen ndryshime.

“Mendoj se duhet të ketë orkestër live, ta shijojnë njerëzit emocionin e kësaj mbrëmjeje. Është ndërrimi i moteve dhe ka rëndësi të kënaqësitë e veta, por po duket pak më lehtë me ‘playback’, por besoj se me kohë do të ndryshojë. Ne sonte e kemi një orkestër të mirë dhe do të ketë program të mirë. Dhe këtu fillojnë ndryshimet. Gjithmonë ndryshimet fillojnë ngadalë, por kur janë të mira dhe të sigurta, më mirë vonë se hiç”, është shprehur ai.

Edhe këngëtarja Linda Hakaj ka thënë se ndër vite po ndryshojnë emisionet e Vitit të Ri, si rrjedhojë e interpretimeve live.

“Kam zgjedhur tri këngë të vjetra popullore. Shpresoj që publiku do t’i pëlqejë. Do të mundohem t’i sjell në mënyrën më të mirë bashkë me orkestrën dhe me gjithë kolegët tanë. Tash kemi mundësi t’i realizojmë më

E MËRKURË 31.12.2025			
07:00 SOT	18:30 Jeta	10:15 Dokumentar KTV 25 - r	09:00 Retro ARTA
08:15 Te Linda	18:50 Marketing	10:45 Top shop	09:30 Dokumentar: Prapaskenat e Inovacioneve të NASA-s ep.2
08:30 SOT– vazhdimi	19:00 Lajmet e mbrëmjes	11:00 Seri: Premtimi ep. 508 - r	10:15 Programi Fluturues i Fëmijëve – r
09:00 Koha e lajmeve	19:35 Moti	11:45 Top shop	10:45 Top shop
09:15 SOT – vazhdimi	19:40 Marketing	12:00 Koha e lajmeve	11:00 Seri: Premtimi ep. 510
11:00 Sofra gjakovare	20:00 Express festiv	12:15 Seri: Premtimi ep. 509- r	11:45 Top shop
12:00 Koha e lajmeve	21:30 Gëzuar me KOHËN 2026	13:00 Pikë me Veton Surroin – r	12:00 Koha e lajmeve
12:15 Express – r	22:30 Gëzuar me KOHËN 2026: Ardian Limanmera dhe Bohemët	14:20 Wildlife me Arian Mavriqin	12:15 Seri: Premtimi ep. 511
13:00 Çmimi “Rexhai Surroi 2025”	23:30 Sofra me Ajtene Dërgutin	14:40 Top shop	13:00 'Film artistik: Miq që kanë fëmijë (+14)
14:15 Kutia	01:00 Maratona e filmit	15:00 Koha e lajmeve	14:05 Nëpër fim – r
14:30 Top Koha Mesjava	E PREMTE 02.01.2026		14:40 Top shop
15:00 Koha e lajmeve	08:00 Ngjarjet e vitit – r	15:15 Top shop	15:00 Koha e lajmeve
15:15 Këngë për fëmijë	09:00 Dokumentari KTV 25 – r	15:40 Kutia	15:15 Top shop
16:00 Express	10:00 Tregimet sportive – r	16:00 PFF	15:40 Kutia
17:00 Koha e lajmeve – 60 minuta	11:00 PFF festive – r	16:30 Nëpër film	16:00 Top Koha Music
17:15 60 minuta	12:00 Koha e lajmeve	17:00 Koha e lajmeve	17:00 Koha e lajmeve
18:00 Drive me crazy festiv	12:15 Film artistik: Libraria (+10)	17:15 Dokumentari KTV 25	17:15 Fakte me Adnan Merovcin - r
18:50 Marketing	14:15 Jeta – r	18:00 Te Linda	18:25 Amerikania në Kosovë
19:00 Lajmet e mbrëmjes	15:00 Koha e lajmeve	19:00 Lajmet e mbrëmjes	18:50 Marketing
19:35 Moti	15:10 Rreth botës – r	19:35 Moti	19:00 Lajmet e mbrëmjes
19:40 Marketing	16:00 Nëpër film festiv	19:40 Marketing	19:35 Moti
20:10 Te Linda Festive	17:00 Koha e lajmeve	19:45 Sporti në KTV	19:45 Marketing
20:45 Gëzuar me KOHËN 2026	17:15 Dokumentari KTV 25	20:00 Betimi për drejtësi	20:00 Pikë me Veton Surroin
01:00 Maratona e filmit	18:00 Top Koha Music Festive	21:00 Fakte me Adnan Merovcin	21:20 Rreth botës
E ENJTE 01.01.2026			
08:00 Drive me crazy – r	18:50 Marketing	22:00 Koha e lajmeve	22:00 Koha e lajmeve
09:00 Këngë për fëmijë	19:00 Lajmet e mbrëmjes	22:10 Moti	22:10 Moti
10:00 Film artistik: Udhëtimi i një qeni (+10)	19:35 Moti	22:15 Sporti në KTV	22:15 Sporti total
12:00 Tregime sportive	19:40 Marketing	23:00 Film artistik: Jeta (+14)	00:00 Top Koha Music - r
13:00 Te Linda Festive – r	20:00 038	01:00 Betimi për drejtësi – r	01:00 Fakte me Adnan Merovcin - r
14:00 Rreth botës 2025	21:00 Koncert: Kohavision 25	01:40 Fakte me Adnan Merovcin – r	02:00 Rreth botës – r
15:00 Ngjarjet e vitit	22:00 Gëzuar me KOHËN 2026	03:00 Lajmet e mbrëmjes – r	02:20 Nëpër film – r
16:00 PFF festive	01:00 Maratona e filmit	03:30 Seri: Premtimi ep. 508 x 509– r	03:00 Lajmet e mbrëmjes – r
16:30 Kori i Fëmijëve – Okarina	06:00 Dokumentari KTV 25 – r	05:00 Pikë me Veton Surroin – r	03:30 Seri: Premtimi ep. 510 x ep. 511 – r
17:00 Koha e lajmeve	E SHTUNË 03.01.2026		05:00 Sporti Total – r
17:15 Dokumentari KTV 25	07:00 Express festiv - r	E DIEL 04.01.2026	
18:00 Rozë	08:00 SOT	07:00 038 – r	06:15 Lajme ARTA
	10:00 Koha e lajmeve	08:00 Dokumentari KTV 25 – r	
		08:45 Wildlife me Arian Mavriqin – r	

mirë, sepse kemi mundësi të këndojmë live. Më herët ka qenë mundësi e mangët, për arsye teknike. E mira e punës është që ajo dëshira që e kam pasur kaherë të këndoj gjithmonë live në emisionet e Vitit të Ri veç po më realizohet”, ka thënë ajo.

Këngëtarë Neki Emra, kënga e njerit prej të cilëve do të jehojë në programin qendror festiv të KTV-së, ka thënë se ai dhe kolegët e tij kanë zgjedhur program të bukur. E vetë programin e ka konsideruar edhe si organizimin e vetëm ku ata kanë mundësi të takohen.

“Ne gjithmonë mbledhemi për ata që janë nëpër shtëpitë e tyre të kënaqen, t’u ofrojmë një natë ndryshe. Normalisht të jemi bashkë në shtëpitë e secilit shqiptar. Xhirimet kanë shkuar mirë, edhe përzgjedhja e këngëve tek artistët ka qenë shumë, shumë e mirë këtë herë. Mendoj se do të pëlqehet nga njerëzit. Ka pasur potpuri, kam edhe këngë të miat, të cilat i kam kënduar, por do të këndojmë edhe live, që t’ua ofrojmë atmosferën që e bëjmë në shumicën e herëve, që të ketë kombinim nga të gjitha”, është shprehur Emra.

Këngëtarë Artan Bakija ka thënë se vitin 2025 e kanë karakterizuar ngjarjet e shumta në skenën kulturore.

“Ajo çfarë më ka pëlqyer në vitin 2025 ka qenë që ngjarjet kulturore kanë pasur një hov më të madh, në të njëjtën kohë kemi pasur më shumë koncerte dhe si rrjedhojë, edhe një herë e kam fituar festivalin ‘Zambaku i Prizrenit’, kësaj radhe në rolin e tekstshkruesit dhe kompozitorit të këngës, e cila mori vendin e parë”, ka thënë ai.

Programi qendror festiv është prezantuar nga Ardiana Dragusha dhe Urata Restelica.

Dragusha ka thënë se shikuesit i pret atmosferë e jashtëzakonshme.

“Këtë po na e sjellin artistët, që janë emra të mëdhenj që i kemi në vend. Andaj të gjithë shikuesit i ftoj të qëndrojnë me programin e KTV-së për programin qendror festiv. Është punë shumë e madhe e ekipit realizues, jo vetëm për ne si prezantues, por edhe për kolegët kameramanë, regjinë, montazhin. Të gjithë e bëjnë punën e jashtëzakonshme që të transmetohet në mënyrën më të mirë tek audienca”, ka thënë ajo.

Maratona vazhdon...

Pjesë e programit do të jetë edhe Ardian Limanmera & “Bohemët Sofra” të cilët do të sjellin potpuri të muzikës popullore në natën e 1 janarit.

Në “Express” festiv arti e kultura vijnë në një bisedë më ndryshe. Mysafirë të producentes Edona Binaku janë aktorët Dukagjin Podrimaj e Xhejlane Tërbusja, sopranoja Elikona Hysaj-Shala dhe Kushtrim Dushi, organizator i shumë ngjarjeve kulturore. Emisioni “Nëpër film” sjell bashkëbisedën midis producentes Edona Binaku dhe aktorit Kushtrim Hoxha. Receta festive vjen në kuadër të emisionit “Te Linda”, nën ritmet e muzikës.

Por këtyre emisioneve u paraprin edhe një tjetër kapitull.

“Kohavisioni është përkujdesur edhe për të vegjlit, duke përgatitur emision special me fëmijët në fermë. Qëllimi i këtij emisioni ishte t’i edukojmë brezat e vegjël për rëndësinë e krijimit të afërsisë me natyrën dhe kafshët, larg ekraneve të telefonave. ‘PFF’ në fermë do të transme-

tohet me 1 janar në orën 16:00”, ka thënë producentja ekzekutive, Rea Surroi.

Programi festiv përfshin edhe filma, sport me “Tregime sportive” e emisione informative.

Emisioni “Rozë” me Urata Restelicën sjell edicionin e parë, një prezantim special, që pasohet nga takimi i përjavshëm i publikut me lajmet, historitë dhe personazhet që bëjnë zhurmë në skenën publike.

E në episodin e parë “Rozë” sjell top pesë ngjarjet që shënuan vitin 2025 në botën e showbiz-it si hitet që dominuan skenën, fytyrat publike që u kthyen në fenomen, momentet që pushtuan rrjetet sociale dhe ngjarjet që lanë gjurmë të forta në opinionin publik.

“Cilat ishin lajmet më të përfollura në shoubizin vendor gjatë vitit 2025, do të kuptohen përmes emisionit më të ri për lajmet nga bota e artit, muzikës dhe yjeve, ‘Rozë’”, ka thënë Surroi.

Në shtator të këtij viti, kur Kohavisioni festoi 25 vjetët që nga themelimi, u organizua koncerti me grupin vokal “Zanat”, që sollën perlat e

këngës shqipe. Ky koncert do të transmetohet më 2 janar.

Edhe emisioni dedikuar kryeqytetit “038” ka përgatitur edicion të veçantë festiv.

“Ky edicion u është dedikuar ‘heronjve’ të kryeqytetit, punonjësve të shërbimeve publike. Protagonistë në këtë emision janë: një punëtor i kompanisë ‘Pastrimi’, një zjarrfikës dhe një punëtor i ‘Trafikut Urban’. Ata rrëfejnë sfidat me të cilat përballen, të panjohurat e dhe prapaskenat gjatë aktivitetit të tyre në punë. Gjithashtu do të na tregojë cili është ushqimi i preferuar i fëmijëve”, ka bërë të ditur Rea Surroi.

Programi festiv përfshin edhe filma, sport e emisione informative. “Si çdoherë, përzgjedhja e filmave është speciale, ku gjatë këtyre netëve do t’u servohen filmat kult të kinematografisë botërore”, ka thënë Surroi. Special është i tërë programi. Titullohet “Gëzuar me KOHËN!” Është ftesë për festë, me traditë e shije.

© KOHA Ditore



VITI I SOPRANOS NGA KOSOVA QË SHKËLQEN NË SKENAT E BOTËS

Marigona Qerkezi – ylli në ngritje të përherëshme

Kritika e çmon për aftësinë e saj për të përcjellë nota të larta e tone të forta, për teknikën perfekte, thellësinë emocionale e interpretimin mbresëlënës dramatik. Vlerësohet si yll në ngritje të përherëshme. Dhe me të drejtë. 2025-a është veç edhe një vit suksesesh për sopranon Marigona Qerkezi. Kulmoi edhe në “Royal Opera House”, e në skena në të katër anët e botës

Besartë Elshani

Ajo është vullkan në skenë. Roleve operistike ua vesh petkun e zërin e saj të fuqishëm, thellësinë emocionale e praninë e jashtëzakonshme në skenë. Teknika e përsosur e sopranos Marigona Qerkezi e gjen në skenë me vetëbesim absolut. Stoike. Çdo skenë, një kapitull i radhës i karrierës. Ka përjetuar magjinë e shtëpive më përrallore në botë. Ato për të cilat në Kosovë karriera e saj do të mbeste peng, por emrin e së cilës e merr kudo me vete. E, po aty ku zemra i rrah më fort, i dhuron publikut të saj emocione me mozaikun e veprave më të cilat ka kulumuar karriera e saj botërore.

Nëntë ditë prej paraqitjes së fundit të saj në shtëpinë prestigjioze operistike “Royal Opera House” në Londër, zbarkoi në Prishtinë. Në të parën ateroi si Leonora nga opera “Il Trovatore” e Verdit. Data shënjuese e karrierës së saj qe 9 korriku i 2025-s dhe tri prezantime të tjera. Një teatër opere e baleti me mbi dy mijë e dyqind ulëse, katër kate dhe përplot ballkone ku publiku mund të zërrë vend. Aty ku ajo, me atë që është një lloj gjuhe operistike, përkulet, puth dorën e saj para se ta prekë skenën.

Është një lloj pjese e performancës. Te sopranoja Qerkezi është ritual i pashmangshëm. Vjen përherë pas përshëndetjes me publikun në fund të secilës shfaqje teksa vijojnë ovacionet e gjata për të. Sekuencë që e përshkroi edhe koncertin e saj në Prishtinë në kushte krejt të tjera.

Momente që nuk kanë çmim

Ajo gëzon respekt të madh në botën operistike, por nuk e veçon ndonjë audiencë të një vendi të caktuar.

“Kjo është pyetje së cilës vështirë i përgjigjem me vetëm një emër apo vend kur ato kam interpretuar këtë vit, por jam e rrethuar me dashuri nga publiku anembanë botës, dhe kjo më bën tejet të lumtur, e sidomos kur ato duartrokitej vijnë nga shqiptarët, të cilët vërtet janë çdokund dhe gëzohem kur i kam edhe në publik në vende të ndryshme në botë”, thotë sopranoja.

Në skenë modeste, në një skaj rruge a parkingu pranë Bibliotekës Kombëtare, larg imazhit të një skene ku kishte interpretuar nja dhjetë ditë para se të dilte para publikut në Prishtinë, aty jehoi kënga e saj gjithsesi. Në kushte shumë më të mira solli magjinë e saj në Tiranë, më 12 qershor.

“Gala koncerti im recital në Teatrin e Operës në Tiranë si dhe pastaj koncerti recital ‘Opera Night’ në ‘Rame Lahaj International Opera Festival’ ishin performanca të cilat do të mbesin të paharrueshme për mua. Të performoja për publikut tim, të merrja aq shumë dashuri dhe të shihja aq shumë fytyra të lumtura dhe të emocionuara, më rikthyen momente të mrekullueshme që nuk kanë çmim”, shprehet Qerkezi në një bisedë me KOHËN. Në Prishtinë, përmbylli edhe 2024-n në skenë tok me tenorin e njohur botëror, Saimir Pirgu.

Këto janë momentet kur pjesa dërrmuese e artdashësve të saj mund ta shijojnë këndimin e saj dhe përtej. Zëri i saj është hyjnor. Vetë ajo hyjneshe e këngës lirike. Elegante në paraqitje, zotëruese e skenës të cilën e komandon. Aty nuk bën kompromise. Është emocionale, dramatike, e brishtë, e pafytyrshme.

Me art qysh në hapat e parë

Kritika e çmon për aftësinë e saj për të përcjellë nota të larta e tone të forta, për teknikën perfekte, thellësinë emocionale e interpretimin mbresëlënës dramatik. Vlerësohet si yll në ngritje të përherëshme.

Ajo u lind dhe u rrit në Kroaci. Si fëmijë zgjodhi të zhvillojë karrierë në



Marigona Qerkezi si Manon në operën “Manon Lescaut” nga Giacomo Puccini në “Teatro Petruzzelli” në Bari të Italisë, në shkurt të vitit 2025

skenë. Në moshën gjashtëvjeçare për herë të parë performoi në Lubjanë.

“Unë pata fatin të lind në familje artistike dhe jam rrethuar dhe ‘ushqyer’ me artin qysh prej hapave të mi të parë. Nga koncerti im i parë si këngëtare gjashtëvjeçare në Lubjanë, nuk jam ndalur duke interpretuar në skenë”, shprehet sopranoja e vlerësuar në botën operistike.

Debutimi si këngëtare profesioniste erdhi për të në moshë shumë të re.

“Debutimi im operistik ndodhi në ‘Royal Opera House Muscat’ me rol shumë sfidues si ai i Königin der nacht’ dhe nga ai moment kam interpretuar role kryesore në skena të rëndësishme në mbarë botën, dhe ky udhëtim i nisur me sukses po vazhdon edhe më fuqishëm dita-ditës. Jam shumë mirënjohëse për çdo gjë që kam arritur dhe për të cilat vazhdoj të punoj edhe më fort”, shprehet Qerkezi.

Qe viti 2015 kur ajo luajti si “Mbretëresha e Natës” në shtëpinë operistike në Oman me operën “Die Zauberflöte” nga Mozart. Në Teatrin Kombëtar të Operës në Tiranë luajti si Kontesha Almavina nga “Le nozze di Figaro”, po ashtu vepër e Mozartit.

Studimet në nivelin master i përfundoi në Prishtinë për flaut dhe këndim operistik. Pos kësaj, ajo ka një diplomë bachelor edhe për administrim biznesi nga “Staffordshire University” në Mbretërinë e Bashkuar.

Gjurmëve të së ëmës që shpërtheu e para

Ka interpretuar në katër anët e botës. Foletë e karrierës së saj janë krejt kontrasti me vendin prej nga vjen. Për të, nuk është aspak e lehtë të vish nga një vend ku niveli i operës, siç e thotë ajo me tonin e saj të butë, është tejet modest.

“Këtë vështirësi e ka pasur edhe më të theksuar nëna ime në kohën e saj, por megjithatë ajo ia doli ta vendosë Kosovën në hartën e shumë teatrove evropiane si këngëtarja e parë operistike nga Kosova me veprimtari ndërkombëtare. Unë po e vazhdoj rrugën e saj dhe, në shumë prej skenave ku kam interpretuar, kam qenë artistja e parë nga Kosova në historinë e atyre institucioneve. Kjo më bën jashtëzakonisht të lumtur dhe krenarë”, shprehet sopranoja Qerkezi.

Nëna e saj, mexosopranoja Merita Juniku, po ashtu ka zhvilluar karrierë

ndërkombëtare. Për soprano Qerkezi, ajo ka qenë roli model për profilin e saj profesional.

“Ajo është merita kryesore për atë që jam sot, si person dhe si artiste. Edhe pse fillimisht ka tentuar të ma ndryshojë mendjen për profesionin – thjesht duke e ditur nga përvoja e saj se sa e vështirë dhe plot sakrificë është kjo rrugë. Por duke e parë dashurinë time për këtë art, dhe vendosmërinë time, ajo më ka formuar me përkushtim dhe ekspertizë që nga fëmijëria, duke më udhëzuar dhe duke investuar pafund në mua”, shprehet ajo.

Derisa ajo është rritur e rrethuar me këngën lirike të nënës së saj, tash kjo e fundit magjepset me zërin e së bijës. E dashuria dhe arti i familjes e kanë shoqëruar edhe në skenë, me veshjet nga babai i saj.

“Familja ime ka dhënë gjithçka që unë të ndjek ëndrën time. Shumë prej fustaneve koncertale i kam pasur kreacione të babait tim, i cili ishte pjesë e repartit të kostumeve në Teatrin Kombëtar Slloven në Lubjanë. Ndërsa edhe sot, çdo vepër vazhdoj ta studioj me mamin. Ajo është e pranishme në shumë prej performancave të mia nëpër botë bashkë me motrën time, dhe për mua përfaqësojnë një shtytje dhe forcë jashtëzakonisht të madhe”, tregon sopranoja Qerkezi.

Zëri i Kosovës në të katër anët e botës

Mjeshtëria, dashuria e përkushtimi i saj, pos nëpërmjet kritikave pozitive është përkthyer edhe në çmime të shumta ndërkombëtare. Ajo është vlerësuar me çmimin e parë në Konkursin e Operës Leyla Gencer dhe një çmim special nga ‘Accademia Teatro alla Scala’, çmimin e parë në konkursin ndërkombëtar “Magda Olivero”, ka fituar në garën e 66-të ndërkombëtare për këngëtarë të rinj operistikë “AsLiCo” e çmimin special “Best under 25” në “Portofino International Opera Competition”.

Revista prestigjioze dedikuar operës “OperaWire” e renditi emrin e saj në mesin e top-dhjetë yjeve në ngritje për vitin 2023. Dëshmi për profesionalizëm në skenë ka qenë edhe nominimi për Këngëtarën më të Mirë të Re nga “The International Opera Awards”, vitin e kaluar.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Spanja, Anglia, Italia, Zvicra, Polonia, Belgjika, Franca, Finlanda janë veç

disa nga vendet ku ka aterruar sopranoja e shquar. Në shtator të vitit të kaluar, në “Dubai Opera” ka qenë kryesorja e kastës së operës “Aida” të Verdit e në po të njëjtën periudhë debutoi në “Theatro Municipal de Sao Paulo” si Abigeila nga “Nabucco” e Verdit. Me të njëjtin rol pati debutuar në festivalin njëshekullor “Savonlinna Opera Festival” në Finlandë.

Në të gjitha këto vende, Kosova është prezantuar tok me emrin e saj.

“Përveç kësaj, kam interpretuar dhe vazhdoj të interpretoj edhe në vende ku Kosova ende nuk njihet – si për shembull: Rusia, Spanja, Brazili etj. – por përmes performancave të mia, emri i Kosovës prezantohet fuqishëm bashkë me mua. Këto raste i përmend edhe si shtytje e motivim për gjeneratat e ardhshme”, thekson sopranoja Qerkezi.

Ajo njihet për zërin e saj të fuqishëm dhe të butë dhe repertorin e gjerë. Zëri i saj ka koloraturë të shkëlqyer. Çmohet për rolet e saj komplekse si Elvira, Macbeth e Norma. Kritika e konsideron si një prej figurave kryesore në produksione të mëdha operistike.

2025-a që kulmoi edhe me “Royal Opera House”

Këtë vit, që në janar ka nisur serinë e debutimeve. Fillimisht me operën “Manon Lescaut” nga Giacomo Puccini në “Teatro Petruzzelli” e më pas edhe me operën “Tosca” në Operën Mbretërore Daneze. Më tej në Operën e Frankfurtit dhe mbase kulmi i suksesit të vitit 2025, ai në “Royal Opera House” më 9 korrik dhe me paraqitje të tjera më datat 12, 16 e 19.

“Nuk mund të mos e përmend debutimin tim në ‘Royal Opera House’ në Londër me Leonora te ‘Il Trovatore’ (Verdi), performancën ‘jump in’ në ‘Deutsche Oper Berlin’ si Aida (Verdi) të cilën e riktheva pas performancave në Operën Shtetërore Polake në Varshavë, në ‘Opera de a Coruña’ dhe ‘Dubai Opera’, isha Norma (Bellini) pas debutimit në ‘Florida Palm Beach Opera’ edhe në Oper Frankfurt dhe Prague State Opera, debutimi i Lady Macbeth në Macbeth (Verdi) në ‘Theatro Municipal de Sao Paulo’ ku u riktheva pas ‘Nabuccos’ së vitit që shkoi, e plot performanca tjera”, shprehet Qerkezi teksa liston një numër të vogël aktivitetesh të këtij viti.

Shprehet se sa herë i kthen këtë kujtime, me to vijnë edhe emocionet e njëjta të paraqitjes së parë në ato ske-

na. Edhe ai në Operën Mbretërore në Londër, një prej momenteve më të bukurave dhe më të veçanta të karrierës së sopranos deri më tash.

“Royal Opera House” është në top-teatrot më të rëndësishme dhe prestigjioze në mbarë botën. Është nder dhe krenari e veçantë të kem interpretuar në atë skenë, e sidomos një rol aq të rëndësishëm dhe me shumë kërkesa interpretative siç është Leonora nga ‘Il Trovatore’. Këtë rol e kam interpretuar edhe në skena të ndryshme si për shembull në Festivalin prestigjioz Verdian në Parma dhe në Teatrin e Operës në Zagreb, dhe e riktheva në skenë në Covent Garden pas disa vjetësh. Çdo shfaqje në Londër ka shkuar me shumë sukses dhe kam gjetur pritje të jashtëzakonshme të publikut dhe kritikës”, shprehet sopranoja.

Për të, sukcesi i këtij viti, mbetet rritja e vazhdueshme profesionale e besimi nga shtëpitë operistike.

“Unë vazhdoj të studioj dhe të punoj me shumë intensitet, dhe çdo rezultat më motivon edhe më shumë. Po e përmbyll një vit jashtëzakonisht të pasur, me shumë projekte dhe përvoja të paharrueshme artistike. Për mua, sukcesi më i madh mbetet rritja e vazhdueshme profesionale dhe besimi që më japin shtëpitë prestigjioze operistike për interpretimin e roleve madhështore dhe sfiduese të repertorit operistik”, konsideron Marigona Qerkezi.

Ajo luan mahnitshëm edhe në flaut.

“Flauti është instrumenti im i zemrës dhe qysh prej fillimit të shkollimit tim në Zagreb, e kam pasur pjesë të jetës sime. Kam bërë edhe performancë unike që është vlerësuar në top-performancat e atij viti, në operën ‘Il Viaggio a Reims’ ku veç rolit operistik të Madama Cortese (të cilin e kam interpretuar ndër tjera edhe në ‘Gran Teatre del Liceu’ në Barcelonë dhe ‘Rossini Opera Festival Pesaro’) kam interpretuar në skenë pjesën solistike si solo-flautiste. Kjo performancë e imja e dyfishtë është vlerësuar tejet lartë nga kritika operistike. Është një eksperiencë e veçantë që rrallëherë ndodh”, shprehet sopranoja e skenave botërore të operës.

Sopranoja Marigona Qerkezi shkrihet në role operash duke ekzekutuar çdo pasazh opere me empatinë e jashtëzakonshme muzikore. 2025-a është vetëm edhe një vit suksesesh për yllin në ngritje të përherëshme.

BALERINA JETA MUSOLLI DHE NJË SHEMBULL PASIONI E SAKRIFICASH

Jeta e baletit

“Roli duhet të jetohet. Rolet i luaj me shpirt. Aty janë edhe interpretimi, edhe aktrimi. I jetoj. Sepse skena është jetë më vete”, thotë balerina e Baletit Kombëtar të Kosovës, Jeta Musolli. Gati çerek shekulli në skenë, rrugëtimi dhe rrëfimi i saj janë një lloj sinonimi i historisë së re të baletit në Kosovë. Ajo i takon gjeneratës së parë të BKK-së. Është Jeta e baletit. E baleti për të është vetë jeta. “Baleti, pastaj të tjerat”, thotë ajo

Besartë Elshani

Në një moshë kur baleti veçse do të duhej të perfeksionohej, po atëherë balerina Jeta Musolli nisi prej pikës zero. Këtë fat e patën të gjithë balerinët e gjeneratës së saj. Veç sa që hapur Dega e Baletit në shkollën e mesme “Prenk Jakova” nga ish-drejtori i Baletit Kombëtar të Kosovës, Ahmet Brahimaj. Kur nisi karrierën prej balerine profesionale që 13 vjeçe. Sot është njëra prej shtyllave të Baletit. Dashurinë për këtë art, çdo ditë ia sfidojnë kushtet.

Audicioni si pikënisje

Secila shfaqje është histori më vete. Në shumë prej tyre në role kryesore e edhe në të tjera, për balerinën Musolli secila është kapitull më vete. Jo veç kërcim, por edhe përjetim i karakterit, përfshirë aktrimin. Me këtë energji i ka sjellë të gjitha shfaqjet e Baletit, që nga viti 2002, kur iu bashkua Baletit Kombëtar. Përveç njërës, “Terminal”, të vitit të kaluar.

Në po të njëjtin vit që u regjistrua në shkollë të mesme në degën e Baletit, po atë vit edhe u bë pjesë e Baletit si soliste e parë e institucionit.

“Si fëmijë, si karakter dhe tip kam qenë e gjallë, më ka pëlqyer muzika, gjimnastika e patinazhi. Por për balet nuk është se e kam menduar sepse në atë kohë nuk flitej shumë për të. Ishte Ahmet Brahimaj, profesor i ynë i ndërë që bashkë me disa kishin hapur Degën e Baletit në shkollën ‘Prenk Jakova’. Mami ma propozoi dhe mua më pëlqeu. Më tha që ‘është një profesion i vështirë dhe ka sakrificë, por do të kënaqesh’. Shkova në audicion dhe menjëherë më pranuan. I përmusha kriteret”, kujton balerina Jeta Musolli.

Kishte nisur shkollimin e re, si pesëvjeçare. Andaj ishte një hap përpara gjeneratës së saj të shkollës. Jo si çdo balerinë në botë që shkollimi i parë për ta janë mësimet për balet, Musolli nisi kur trupi veçse ishte pjekur dhe duhej punuar fort. Meritat e asaj çfarë është sot ia atribuon profesorit Brahimaj.

“Për ne ka qenë shumë e çuditshme, sepse gjithçka ka nisur prej zëros. Balerinët ia nisin si fëmijë, por ne nuk e kemi pasur shkollën e ultë dhe direkt në shkollë të mesme, në një moshë që nuk përshatet shumë. Prandaj është dashur të punohet shumë, shumë disiplinë, sakrificë dhe përkushtim. Krejt këto i kemi mësuar nga Ahmet Brahimaj të cilin e kemi pasur si baba dhe ai na ka drejtuar në rrugën e drejtë që nëse do të merresh me këtë profesion duket të jesh shumë e fortë”, shprehet Musolli.

Prova me qirinj ku kulmonte entuziazmi

Shfaqja “Tranzicion” ishte e para paraqitje e saj si balerinë profesionale. Ajo kujton se ishte ende fëmijë, por në skenë i duhej të sillej si e rritur. Ishte privilegj, e po aq përgjegjësi.

“Gjithçka ka qenë e veçantë. Ende më kujtohet. Është një pikë e fillimit që nuk mund ta harrosh kurrë. Ke qenë fëmijë, por është dashur të sillesh si e rritur, se ke shumë eksperiencë, por në fakt nuk është se e ke pasur. Është dashur t’ia dalësh disi”, shprehet balerina Musolli.

Teatri ka qenë i zymtë atë kohë. Pa drita, pa ngrohje, pa të ardhura e nën kundërmim. Sfidat kanë qenë të llojllojshme.

“Kur kemi shkuar në Teatër për të parën herë paslufte, as rrymë nuk ka pasur, ka ndodhur që kemi mbajtur prova me qirinj, sepse provat kanë



Jeta Musolli në “Bolero dhe Bach la Orientale” me koreografi të Mehmet Balkanit, më 24 tetor 2025 në sallën “AMC” (Foto: Arben Llapashtica)

vazhduar për shfaqjet moderne që patëm nisur t’i bëjmë. Nuk ka pasur ngrohje, buxhet, shpesh as para për të ngrënë, por ia dilnim disi. Gjithçka ka qenë përvojë që mendoj se arsyeya pse jemi këtu ku jemi sot dhe pse vazhdojmë të funksionojmë është që i kemi kaluar krejt këto dhe veç na kanë bërë të fortë”, kujton Musolli.

Rikthimi në improvizime çerek shekulli pas

Kushte jo më të mira e përcjellin Baletin edhe sot, çerekshekulli pas. Për Musollin, ka përmirësim, ka përkrahje, ka publik, nuk ka paragjykime si në fillim, por ende mungon kushti elementar – hapësira e duhur për të performuar.

“Në sallat dhe në skenat që interpretojmë pas mbylljes së objektit të Teatrit, janë veç improvizim sa të bëjmë shfaqje dhe t’ia ofrojmë publikut për t’i kënaqur ata. Përndryshe asnjëra prej sallave në të cilat kemi interpretuar nuk i përmbushin kushtet për balet. Janë thjesht improvizime”, shprehet Musolli.

Të merresh me balet në Kosovë, sot, edhe para mbylljes së Teatrit, e veçmas tash, do të thotë sfidë, sakrificë, e një lloj barre e dy institucion-eve midis së cilave ka mbetur: ansamblit “Shota” ku Baleti bën provat dhe Teatrit Kombëtar në hapësirën e të cilit jep shfaqjet dhe me të cilin institucion ka stafin e përbashkët teknik.

Kontrasti me skenat e jashtme

E balerina Musolli me kolegë i gjen kushtet që i meriton veç kur udhëton jashtë vendit. Madje edhe në rajon.

“Aty e sheh çfarë respekti dhe çfarë përkrahjeje kanë balerinët në këto vende. Sesi trajtohemi ne si balerinë të Baletit Kombëtar të Kosovës kur paraqitemi diku jashtë. Ky është si motiv shtesë për të vazhduar sepse qëllimi ynë, gjatë tërë jetës, ka qenë të mos krijojmë karrierë individuale, që nëse të vjen mundësia, të dalësh jashtë. Por që t’ia bëjmë me dije botës që Kosova ka një balet duke punuar brenda këtyre kushteve

dhe duke mos u dorëzuar kurrë”, thotë Musolli.

Pos vendeve të rajonit ka performuar në Zvicër, Austri, Kore të Jugut, Gjermani, Francë, Finlandë, Turqi dhe jo vetëm.

Balerina flet me admirim për përvojën në një teatër të vërtetë. Së fundi trupa e Baletit është paraqitur në Venecia me shfaqjen “Carmina Burana”, në një teatër me traditë të gjatë, me arkitekturë klasike.

“E sheh një teatër që është me kate, ballkone, skena të mëdha, pastaj publiku pret në rend të futet brenda. Vjen dy orë më herët, blen biletat. Aty nuk ka familjarë që të thuhet se duartrokritjet vijnë për hatër. Kush e sheh se vlerësohesh në këtë mënyrë dhe ovacionet zgjasin me minuta, është një lloj ushqimi shpirtëror sepse ne punën e bëjmë për publik. Mundohemi ta bëjmë më të mirën”, shprehet ajo.

“Baleti, pastaj të tjerat”

Për të, jo të rralla janë momentet kur gjithçka bëhet e tepërt. “Sa u përket kushteve... ne do ta linim moti dhe të hiqim dorë duke vazhduar me profesionet tona”, thotë ajo. Të tilla momente e kanë përcjellë në afër 90 premiera në të cilat ka dhuruar magjinë e saj të baletit.

Musolli u lind më 2 shkurt të 1989-s në Prishtinë. Është soliste e parë e BKK-së që nga viti 2002. Nisur me “Tranzicion” si shfaqja e parë në të cilat ka luajtur, ka qenë edhe pjesë e shfaqjeve të tjera. Te “Mbrëmje e baletit klasik” ka luajtur si Medora, te “Bukuroshja e fjetur” si Zana e Kuqe dhe Kësulëkuqja, “Te Balloja e Diplomës” si Vajza e Dytë, te “Lidhja” si zonja Bregu, te “Don Kishoti” si Mercedes, te “Netët arabe” si Nouria, te “Le Corasire” si Gulnara, te “Giselle” edhe si Myrtha e te “Romeo dhe Zhulieta” si Infermierja.

I fundit rol klasik është Clara nga “Arrëthyesi” i Tchaikovskyt. E solli dy vjet më parë në fundvit. Edhe vitin e kaluar. Synohej të bëhej traditë, por sivjet për shkak të kushteve nuk u mbajt fare, ndonëse një gjë e tillë parashihej me programin vjetor të Baletit.

Pos këtij roli, balerina Jeta Musolli veçon edhe rolin titullar nga baleti “Carmen” dhe Aegina nga “Spartacus”.

“I fundit rol klasik është Clara. Një rol shumë i veçantë dhe i vështirë. Më ka pëlqyer shumë. I ka pasur vështirësitë e veta por mendoj se ia kam dalë. Më ka pëlqyer edhe Carmen sepse pak a shumë është karakter i imi, më e fortë, më e prerë, por në anën tjetër ka pasur anën sensuale dhe elegancën. Gjithashtu edhe Aegina, edhe pse ka qenë rol negativ te ‘Spartaku’, shprehet ajo.

Ka luajtur edhe në shfaqjet “S’po dëgjohet gongu”, “Kontrast”, “Performance”, “Kolazh baleti”, “Dashuria që vret”, “Kopelia”, “Lidhja”, “Kopelia”, “My stories, your story”, “Recomposed”, “O.Taka”, “New Born”, “Liria ime”, “Verdi: Aty drita bie”, “Fluturimi drejt dritës”, “Pushimi i kalorësve”, “Sisters”, “Exil”, “Tanzimminiaturen & Tangata”, “Untitled” e shumë të tjera.

Për të, Baleti ka qenë përherë pjesë shumë e rëndësishme e jetës së saj. Madje primare.

“Ka qenë baleti, pastaj të tjerat. Në secilën shfaqje, në secilin rol, mundo-hesh ta jetësosh atë dhe të të flejë ai personazh në trupin tënd. Ta luash më së miri. Kur të dalësh si ai personazh, të të duket se e luan më së miri në botë. Ka shumë sfida, të vjen shpirti në fyt, nuk mund të gënjej se është gjithçka lule. Ka momente kur thua po e lë krejt, se je lodhur”, shprehet ajo në rrëfimin e saj për KOHËN.

Musolli ka marrë pjesë është në shumë shfaqje teatrore. Në një të tillë edhe po punon aktualisht. Bashkë me balerinën Aulonë Nuhii, me koreografi të Sead Vuniqit, do të shfaqet në “Kabare 1999” nën regji të Zana Hoxhës, produksion i Teatrit të Gjilanit. Jepet premierë në janar.

Jeta është skenë më vete për të dhe secili duhet ta përjetojë.

“Roli duhet të jetohet. Rolet i luaj me shpirt. Aty janë edhe interpretimi, edhe aktrimi. I jetoj. Sepse skena është jetë më vete. Ne e kemi një shprehje që ‘sa herë del të vallëzosh në një shfaqje, duhet të vallëzosh sikur të jetë e fundit’. Sepse ajo është jeta jote në atë mo-

ment. Kam luajtur shumë role klasike dhe secili më ka pëlqyer”, shprehet balerina Musolli.

Është një lloj sakrifice të merresh me balet duke qenë profesion jetëshkurtër. Një lloj pensionimi i parakohshëm, ndonëse në Kosovë ende nuk është e rregulluar dhe pjesëtarët e trupës së Baletit pensionohet si çdo tjetër individ.

“Deshe e nuk deshe, kur i bën 50 vjet as nuk të ka hije dorën në zemër të kërcesh. Thua: ‘Po luftoj edhe pak, po përkushtohem edhe pak’. Sepse ajo ditë vjen shumë shpejt, siç kanë kaluar këto 25 vjet gati”, shprehet Musolli.

Ka qenë asistente e shumë koreografeve si vendorë e të huaj për shfaqjet e Baletit. Andaj vazhdimi i karrierës si koreografe nuk është larg mendsh për të.

Ka një çerek shekulli në skenë. Por ende, është një lloj adrenaline secila paraqitje. Edhe stres.

“Nuk kam lejuar asnjëherë që stresi të ma prishë punën që e kam bërë gjatë asaj kohe. Duhet të jesh e sigurt. Mund të rrëzohesh. Nga një ngritje e lartë, po të mos ketë koordinim, mund të biesh. Mund si të jesh në koncentrimin tënd e të të shfaqet një perde e zezë. Janë gjëra të natyrshme që i ndodhin çdo balerini e balerine. Sikurse edhe aktorëve, këngëtarëve, por esenca është që cili është plani B?”, thotë Musolli.

Për vite të tëra, skena ka qenë përjetim ndryshe për të duke qenë se vëllai i saj, balerini Kreshnik Musolli, ka qenë pjesë e trupës. Kanë kërcyer së bashku e në projekte të veçanta edhe në duet.

“Është eksperiencë e veçantë. Me Nikin jemi rritur bashkë dhe kemi qenë si binekë. Ai ka filluar baletin prej kur ka ardhur t’i shohë shfaqjet e Baletit në të cilat unë kam qenë pjesë. I ka pëlqyer dhe tash performojmë bashkë në shumë shfaqje. Është ndjenjë e veçantë dhe jam shumë e lumtur që e përjetoj këtë ndjenjë”, tregon Musolli.

Balerina Jeta Musolli shprehet se e jeton çdo moment të jetës me balet. Në esencë, baleti është vetë jeta për të.

BEATRICE GJERGJI DHE KOLË LACA PËRTEJ SKENËS

“Shkodra Elektronike” në lojë me zhurmat e përditshmërisë

Në një kohë kur gjithçka kërkon formë të qartë dhe mesazh të lexueshëm, dyshja zgjedh të mbetet në gjendje habie. “Jetojmë në kohna pezullimi, ku ashtë e zorshme me kuptu ku shkon njerëzia, Evropa, Shqipëria, Shkodra, dugajtë e reja, familja... shumë thjesht... kangët tona reflektojnë këtë ndjesi”, thotë dyshja e “Shkodrës Elektronike”, Beatrice Gjergji dhe Kolë Laca. “Zjerm” në “Eurovision” është vetëm një stacion i vitit 2025

Sinan Berisha

Nuk është thjesht një emër në skenë. “Shkodra Elektronike” është një projekt që ka lindur jashtë kufijve fizikë të Shkodrës, por që e bart atë në thelb të tingullit të vet. Është një duet ku elektronika bashkëjeton me traditën shqiptare, një përzierje e zhurmave moderne dhe kujtesës muzikore të një qyteti që nuk resht së punuari në gjuhë, ritëm dhe kujtim. Kjo mënyrë e të menduarit muzikor e ka bërë “Shkodrën Elektronike” një emër që shkon përtej shenjakëve të zakonshëm muzikorë, një folje që shpreh veprimin e të kaluarit mes botëve të ndryshme artistike.

Kolë Laca dhe Beatrice Gjergji e kanë mbjellë muzikën e tyre larg vendlindjes, në Itali, por kjo largësi nuk i ka zhveshur nga fryma e Shkodrës. Madje i ka shtyrë të kërkojnë mënyra jokonvencionale për ta sjellë atë në tingullin bashkëkohor. Në vend që të marrin nga repertori folklorik si relikte nostalgjie, ata i kanë ndarë këto elemente në grimca të vogla dhe i kanë shtyrë drejt një gjuhe që s’ka frikë të përballet me elektronikën dhe strukturat moderne të muzikës. Kjo përzierje midis kujtesës së qytetit dhe teknologjisë së sotme i jep qasje unike, ku tradita nuk është më maskë, por është gjuhë aktive.

Nuk është rastësi që ky projekt më 2025 ka përfunduar në “Eurovision” – një ndër skenat më të mëdha muzikore në Evropë – me këngën “Zjerm”. Nga festat lokale e deri te përfaqësimi kombëtar, përzgjedhja e tyre në Festivalin e Këngës të RTSH-së, si dhe renditja në vendin e tetë në finalen evropiane dëshmojnë se ajo që lindi si qejf eksperimentimi mund të gjejë jehonë edhe përtej kufijve gjeografikë dhe stileve të zakonshme. Performancat e tyre nuk janë vetëm paraqitje muzikore; janë një shprehje ku teknologjia takohet me kujtesën kolektive, një sintezë që sfidon pritshmëritë e publikut për atë që mund të quhet “folkloriku” i epokës së re.

Zanafilla dhe kuptimësia e “Shkodrës...”

Fillimi i “Shkodrës Elektronike” nuk lidhet me një vizion të artikuluar apo me një plan afatgjatë. Nuk ka pasur projekt në kuptimin klasik të fjalës, as ambicie për t’u pozicionuar në skenë, as pretendim për të ndërtuar një identitet të mbyllur muzikor. Zanafilla ka qenë shumë më e thjeshtë dhe, pikërisht për këtë arsye, më e sinkertë.

“Ka kenë vetëm një qef me eksperimentu me kangë shkodrane, kurrëgjja ma pak a ma tepër”, kanë thënë anëtarët e dyshes për KOHËN. Një qejf për të provuar. Një reagim që nuk kërkon legjitimitet dhe nuk i detyrohet askujt për shpjegim.

Eksperimentimi këtu nuk nënkupton shkatërrim apo provokim, por një liri fillestare e fakti që gjithçka nis si “qejf”, e zhvesh procesin nga serioziteti i imponuar dhe e vendos muzikën në një hapësirë loje. Kjo hapësirë nuk e mohan peshën e traditës, por refuzon ta trajtojë atë si barrë. Pikërisht këtu fillon të formësohet një qasje që më vonë do të lexohet si estetike e qëndrueshme.

Kështu e hedhin hapin e parë Beatrice Gjergji dhe Kolë Laca. Themeloi grup-projektin nën strehën “Shkodra Elektronike” më 2019 dhe në atë vit edhe i nisin performancat e para në disa ngjarje të rëndësishme italiane dhe shqiptare duke interpretuar rikrijime e përpunime të këngëve të repertorit shkodran. E para ka qenë me rastin e hapjes së Pavijonit të Kosovës dhe Shqipërisë në Bienalen e Venecias më 2019. Më pas, kjo nisje është thelluar në hapje të ekspozitës personale të artistit Adrian Paci në Tiranë.



“Shkodra Elektronike” me 17 maj të vitit 2025 me “Zjerm” në skenën e edicionit të 69-të të “Eurovisionit” në Bazeli (Foto: Associated Press)

Më 2020, kur kishte nisur pandemia COVID-19, kanë marrë pjesë në edicionin e katërt të “Za Fest”, duke kënduar këngë qytetare shkodrane të gërshetuara me tingujt elektronikë, në Kalanë e Rozafës në Shkodër.

Shkodra që hyn në muzikën e tyre nuk është qytet kartoline. Nuk është as vend i idealizuar, as hapësirë për rikthim sentimental. Shfaqet si peizazh akustik në fakt, i mbushur me zhurmë e me shtresa tingujsh që nuk kërkojnë të jenë të bukur apo të pastër.

“Në aspektin tingullor janë zhurmat e qytetit dhe zhurmat e mejhaneve, ndërsa në aspektin emocional, avujt e kazanit të rakisë na luhatin...”, thonë ata kur e përshkruajnë ndikimin e Shkodrës në frymëzimin e tyre, e cila nuk shfaqet si nostalgji.

Kjo zgjedhje e zhvendos fokusin nga melodia drejt ambientit. Imazhi i avujtë të kazanit të rakisë e thellon këtë raport me qytetin. Është një metaforë që bart mjegull, luhajtje dhe paqartësi, një gjendje që nuk fiksohet lehtë. Në këtë kuptim, Shkodra bëhet gjendje emocionale, jo vend, dhe muzika funksionon si refleksim i kësaj luhajtjeje të vazhdueshme.

Gjuha që këndohet në periudha pezullimi

Në vitin 2020 fillojnë t’i publikojnë këngët e para. Kënga origjinale “Ku e gjeta vedin” ishte fituese e çmimit special në festivalin “Luleborë” e më tej kishin nxjerrë edhe përpunime të tjera një vit më pas, si “Synin si qershia” e “Turtulleshë”. Kjo e fundit bëhet edhe pjesë e albumit EP “Live @ Uzina”, publikuar më 2022, krahas rikrijimit të këngëve “Kur perëndon dielli”, “Pranverë e bukur” dhe “Sa e kandshme vjollcë ti je”. Në dhjetor të vitit 2022, kishin ardhur në Prishtinë e në verën e vitit 2023 edhe në edicionin e katërt të “Autostrada Bienale” në Prizren.

Pavarësisht ndryshimeve në repertor dhe në formë, një element mbetet i pandryshuar në gjithë këtë fazë të parë të projektit: raporti me gjuhën. Shqiptimi nuk kërkon të jetë i veçantë, por i njohur; i afërt e i përdorur.

“Knojmë si flasim”, thonë ata. Kjo fjali e shkurtër e përmbledh një qasje të tërë ndaj gjuhës. Nuk është performancë, nuk është akt i ndërtuar për skenë, as ushtrim vokal për të

prodhuar emocion. Gjuha këndohet ashtu siç përdoret në përditshmëri, pa ngrije artificiale dhe pa kërkuar ngarkesë emocionale. Kjo e zhvendos theksin nga interpretimi drejt komunikimit.

Në këtë mënyrë, shqipja e tyre çlirohet nga roli i saj tradicional në këngë, ku shpesh bart një barrë emocionale të tepruar. Këndimi nuk e zbkuron fjalën, por e lë ashtu siç është, me gjithë ngurtësinë, thjeshtësinë dhe ritmin e saj të brendshëm.

Procesi krijues nuk nis nga një ide e qartë për balancë apo harmoni mes elementeve. Ai kalon përmes provës së vazhdueshme, ku materialet testohen pa garanci se do të mbijetojnë deri në fund.

“Provojmë dhe eksperimentojmë katërdhetë kangë dhe zgjedhim 10 me i performu live, nga të cilat 5/6 përfundojnë në albume”, thonë ata.

Në këtë proces, elektronika dhe elementi tradicional nuk bashkohen si dy botë të ndara që duhet të pajtohen. Futen në një hapësirë të përbashkët, shumica e materialit mbetet jashtë dhe vetëm një pjesë e vogël arrin të funksionojë si performancë live apo si këngë albumi. Ky përjashtim masiv nuk është humbje, por në fakt mjet filtrues.

Më shumë sesa ideja, është procesi që luan rolin e mbajtjes nën kontroll të raportit mes traditës dhe elektronikës. Rezultati nuk është kompromis, por përzgjedhje e atyre formave që e përballojnë provën e kohës dhe të skenës.

Pezullimi nuk shfaqet në muzikën e tyre si zgjedhje stilistike, por si gjendje e përjetuar. Këngët nuk synojnë kulm, sepse as koha në të cilën lindin nuk ofron orientim të qartë. Pa një drejtim të përcaktuar, pa një vijë narrative që të çon diku, muzika ndjek të njëjtin ritëm të pasigurt që përshkon jetën e përditshme.

“Jetojmë në kohna pezullimi, ku ashtë e zorshme me kuptu ku shkon njerëzia, Evropa, Shqipëria, Shkodra, dugajtë e reja, familja... shumë thjesht... kangët tona reflektojnë këtë ndjesi”, thonë anëtarët e dyshes “Shkodra Elektronike”, duke e përshkruar muzikën që bëjnë.

Kjo ndjesi pezullimi shtrihet nga individualja te kolektivja. Evropa, Shqipëria, qyteti, familja, të gjitha përmenden si një zinxhir referencash që nuk japin përgjigje, por shtojnë paqartësinë.

Refuzimi i kulmeve emocionale bëhet kështu një akt besnikërie ndaj përvojës. Muzika nuk dramatizon atë që është tashmë e ngarkuar, por e mban në një tension të ulët dhe të vazhdueshëm.

“Fëmijë të lumtun” me “Zjerm” deri në “Eurovision”

Në nëntor të vitit 2024, kur u bë e njohur lista e pjesëmarrësve garues në edicionin e 63-të të Festivalit të Këngës në RTSH, “Shkodra Elektronike” paraqitet në renditje me këngën “Zjerm”. Dallohej qartë nga formati i zakonshëm i garës. E ndërtuar mbi një estetikë të përbashkët dhe një shqipe të zhveshur nga patetika, kënga kishte nxitur reagime të menjëhershme të publikut, duke u shndërruar shpejt në një nga momentet më të komentuar të festivalit. Fitorja në finalen e Festivalit e ka vulosur këtë pritje, duke i hapur rrugë përfaqësimit të Shqipërisë në skenën evropiane.

Në muajt që kanë pasuar, dyshja ka qenë pjesë e disa ngjarjeve që organizohen nga fanatikët e “Eurovision-it” në qytete të ndryshme të Evropës, ku kënga është dëgjuar jashtë kontekstit vendor, përpara se projekti të mbërrinte në Bazeli të Zvicrës, ku u mbajt edicioni i 69-të i “Eurosongut”, në majin e vitit 2025. Kualifikimi në finale ka konfirmuar praninë përtej efektit të momentit, ndërsa rezultati përfundimtar, vendi i tetë, e ka shënuar këtë pjesëmarrje si një nga paraqitjet më të suksesshme të Shqipërisë në vitet e fundit.

Përballja me një skenë si “Eurovisionin” nuk ka ardhur si moment për t’u riformatuar. Nuk ka pasur përpjekje për ta përshtatur estetikën me kërkesat e televizionit, as për ta zmadhuar gjestin artistik për t’iu përgjigjur logjikës së spektaklit. Prania e tyre në këtë skenë mbetet vazhdim i asaj që kanë bërë gjithmonë, pa kalkulum dhe pa strategji adaptimi.

“Na thjesht kena pru estetikën tonë, pa e menu gjatë a i adaptohet apo jo televizionit”, shprehin komentin e tyre ndaj skenës evropiane.

Ky qëndrim e zhvendos “Eurovisionin” nga një qendër në një kontekst. Ai nuk shfaqet si kulm i rugëtimit, por si hapësirë ku një estetikë ekzistuese vendoset përballë një formati të madh pa u negociuar. Në vend që muzika të shndërron për t’u bërë e lexueshme,

ajo qëndron në formën e vet, duke pranuar rrezikun e mospërshtatjes.

Nuk kanë ndier aspak dilema e hezitime rreth mënyrës se si tingulli dhe shqipja e tyre do të priteshin në një skenë aq të madhe ndërkombëtare.

“Zero”, është përgjigjia e tyre.

Kjo përgjigje e vetme, e zhveshur nga çdo shpjegim, funksionon si qëndrim. Mungesa e hezitimit nuk vjen nga vetëbesimi spektakolar, por nga një raport i qartë me atë që bëhet. Kur muzika nuk ndërtohet për t’u pranuar, pritja e publikut nuk bëhet kriter.

Muzika e tyre funksionon si tekst që nuk e udhëzon lexuesin. Ajo nuk ofron çelësa interpretimi, as nuk kërkon konsensus. Refuzimi për ta shpjeguar veten nuk është mbyllje, por hapje ndaj një dëgjimi që nuk kërkon garanci kuptimi. Kjo e mban këngën të gjallë përtej momentit dhe jashtë nevojës për përkthim të menjëhershëm.

“Ne knojmë, nuk lexojmë... edhe pse mendojmë se jena libra t’hapun”, është përgjigjur dyshja.

Kjo përgjigje vendos një kufi të qartë mes këndimit dhe interpretimit racional. Muzika nuk prodhohet për t’u lexuar, as për t’u zbërthyer në kup-time të drejtpërdrejta. Ajo ekziston si veprim, si tingull, si prani.

“Eurovisioni” nuk shfaqet si pikë kthese krijuese, por si ngjarje që riorganizon rrethanat përreth projektit. Ndryshimi nuk prek thelbin e muzikës, por mënyrën se si ajo qarkullon. Kjo e mban rrefimin larg romantizimit dhe e përfundon harkun e skenës së madhe me një kthim të ftohtë, por të ndershmë, në realitet. “Ne shpresojmë të lajmë pas vullnetin e mirë... për sa i përket gjuhës dhe muzikës shqiptare, jena fëmijë t’lumtun t’surprizohena nga tradita”, mbyllin bisedën “Shkodra Elektronike”.

Mbyllja nuk vjen si deklaratë trashëgimie. Nuk ka pretendim për ndikim afatgjatë, as për pozicion historik. Ajo që mbetet artikullohet si vullnet i mirë, një gjurmë e lehtë, jo si shenjë e gdhendur.

Raporti me gjuhën dhe muzikën shqipe përshkruhet përmes habisë, jo përmes zotërimit. Të qenit “fëmijë të lumtun” e vendos projektin në një pozitë të përhershme mësimi, ku tradita nuk merret si kapital, por si burim i papritur.

Në këtë mënyrë, rrefimi mbyllet aty ku ka nisur, te qejfi, te loja, te mospërfundimi. Tradita nuk përmyllet, nuk arkivohet dhe nuk shpjegohet. Ajo vazhdon të befasojë. Dhe muzika, po ashtu, mbetet në lëvizje, pa premtuar më shumë sesa një dëgjim të ndershmë dhe një hapje ndaj asaj që ende nuk dihet.

Menjëherë pas kthimit nga Bazeli, “Shkodra Elektronike” ka publikuar albumin EP “Shndrit” me pesë këngë. Përveç këngës “Zjerm” dhe versionit të ripërpunuar të asaj kënge nga producenti dhe DJ italian Cristiano Crisci, i njohur si “Clap! Clap!”, albumi përfshin edhe këngët “E lirë”, “Askund”, si dhe “Deri n’fund”. Gjatë asaj kohe, ka pasur edhe performancë në Kosovë. Në qershor ka hapur edicionin e 13-të të festivalit “Fe-mArt” me një koncert në Prishtinë, ndërkaq në gusht ka performuar në kuadër të “DokuFestit”, në Prizren. Pas disa koncerteve të tjera në Shqipëri, dyshja ka publikuar në dhjetor këngën “Fosforon”, koncepti i së cilës lidhet me idenë e dritës që shfaqet në errësirë.

Në një kohë kur gjithçka kërkon formë të qartë dhe mesazh të lexueshëm, dyshja zgjedh të mbetet në gjendje habie. Të mos dijë gjithçka. Të mos e mbyllë traditën në definicion. Dhe ndoshta pikërisht për këtë, ajo tingëllon e vërtetë. Jo sepse thotë shumë, por sepse nuk shtiret se di më tepër sesa duhet.

FLAKA KOKOLLI, REGJISORJA PIONIERE E GJENERATËS SË RE TË FILMIT TË ANIMUAR

Bota e animuar për një sekondë deri në 24 skica

Produkti final duket një vepër krejt e thjeshtë, por prapa ka orë të tëra pune e përkushtimi. Përkthyer në shifra, duhen nja pesë muaj punë për pesë sekonda animacion. “I bie që për një sekondë mund të ketë 8 deri 12 vizatime. Mund të shkojë edhe 24 nëse është një arsye specifike, por mesatarja do të thosha është 8 deri 12 vizatime. I skicon karakteret dhe një herë e punon. Është shumë punë konsumuese, merr kohë, por vështirësia e vetme që e njoh është se çdo animator ka problem me shpinën”, thotë Flaka Kokolli, animatorja pioniere e gjeneratës së saj. Rrugëtimi i saj u ngjan skicave të animacionit

Besartë Elshani

Me themelimin e industrisë së filmit, paralelisht lindi edhe industria e filmave të animuar. Në Kosovën e pasluftës, vonë u realizua filmi i parë i animuar nga gjenerata e re, ani pse historia e këtij zhanri në këto anë njeh edhe vepra të tjera qysh në fillim të viteve '80 me “TV Dur” të Gjon Markut. Në vitin 2010, erdhi “Molla e kuqe” i metrazhit të shkurtër nga Mentor Berisha. Tek vitet e fundit vërtetë animohet filmi. Flaka Kokolli po plotëson opusin e saj me filma. Portreti i saj është një lloj sinonimi për skenën e tanishme të animacionit në vend, ndonëse ajo zgjerohet. Në kohë moderne, është ndër pionierët e filmit të animuar.

“Mardhë”, “Ninulla F”, “Këtu – Different Dreams” në bashkëpunim me Nora Jusufin e “Shpija” janë midis krijimeve të saj. I interesonte si fëmijë animacioni. Ajo i shihte filmat e animuar përtej asaj sesi i shihnin të tjerët. Nuk ka qenë thjesht një periudhë e ëndrrës për animacion. Për të as nuk ka pasur një moment specifik kur ka vendosur t'i japë kah karrierës drejt animacionit. Thjesht “ka vazhduar rrjedhshëm”.

Për Kokollin, asnjëherë animacioni nuk ka qenë i lidhur veç me fëmijëri.

“Më kanë pëlqyer shumë filmat, por ka qenë ndjenjë që e kam pasur të përbashkët me shokë e shoqe kur kemi qenë fëmijë. Duke u rritur, veç nuk ka pasur një tranzicion dhe nuk e kam pasur shumë të lidhur në kohë që filmi i animuar është i lidhur me fëmijëri. Nuk e kam pasur nevojën që, i kam bërë do vjet dhe po ndalem, s'po i shikoj. Ne si gjeneratë e kemi përparësinë e internetit që mund të përfundosh shumë thellë në detaje. Gjeja filma shumë të mirë që nuk ishin aspak për fëmijë dhe thjesht vazhdoi”, shprehet ajo.

Të preferuar e ka pasur “Spirited Away” të vitit 2001, shkruar e drejtuar nga japonezi Hayao Miyazaki. Ky film edhe është një prej kryeveprave të tij. “Atë e mbaj mend që më pati ‘goditur’ në një formë. Më pati mbetur në kokë edhe pse nuk e dija shumë mirë se çfarë po ndodh, sepse i kisha nja tetë vjet ndoshta. Edhe sot kur e shikoj ka shumë të të japë. E shoh që prapë aty jam, filmat dinë të jenë më të pjekur nganjëherë, por edhe ti kur je e pjekur i sheh ndryshe. Por ‘Spirited Away’ ka qenë i pari që më pati shokuar. E mbaj mend që me titullin e përkthyer në shqip u mundova ta gjej, por nuk mundja”, kujton Kokolli me nostalgji.

Zgjedhja e frikshme për të ardhmen

Në këtë kohë, ajo veçse ndau mendjen për rrugëtimin profesional të jetës së saj. S'u ndikua prej kujt. Ishte koha kur nuk kishte industri të animacionit. Kur, siç shprehet ajo, zgjedhja e saj ka qenë e frikshme për të ardhmen e saj.

“Animacioni ka qenë shumë i frikshëm për të dy prindërit për këtë pjesë. Por pati ndikuar pozitivisht fakti që jam lindur dhe rritur në Prishtinë, pa pasur lidhje me Pejën, por pa qenë ‘Anibari’...”, shprehet Kokolli. Vazhdon të shikojë filma të animuar nga fëmijëria. Tash thjesht i kupton më mirë detajet dhe punën prapa tyre.

“Kur i shikon të njëjtit si i rritur, veç i shijon më shumë sepse ke më shumë kapacitet t'i kuptosh. Vazhdoi t'i shikoj sepse e kam pjesë të jetës”, thekson Kokolli.

Ajo u lind më 7 tetor 1998 në Prishtinë, ku u rrit dhe përfundoi shkollimin deri në ato të nivelit



Flaka Kokolli po e plotëson opusin e saj me filma të animuar. Portreti i saj është një lloj sinonimi për skenën e tanishme të animacionit në vend, ndonëse ajo zgjerohet

akademik. Studimet universitare i ndoqi në “Metropolitan University” në Budapest duke qenë se në Kosovë ende nuk ofrohet animacioni si zgjedhje për studentë. Por qe festivali i animacionit “Anibar” ku ajo qe pjesë-marrëse dhe vullnetare për disa vjet.

Si 16-vjeçare mori pjesë në punëtoritë e Akademisë së Animacionit e më pas u bë anëtare e panelit përzgjedhës për programin “Kids and Teen”.

Në këtë kohë, ajo veçse kishte fletoret e mbushura me vizatime. Aty kishte kuptuar se të njëjtat punë mund të ktheheshin në karaktere të filmit të animuar.

“E kanë pasur një punëtori. Pata shkruar dhe thjesht, nuk kemi bërë ndonjë punë të madhe. Vizatimin e pata bërë për qejf dhe nuk ka qenë diçka konkrete. Aty u bë pak më konkrete, e pamë se bëhet animacion ai vizatim. Si fëmijë nuk e ke sensin e pasojave dhe thjesht nuk më dukej se mund të shkojë diçka gabim”, shprehet ajo.

Bashkëmoshatore e studentëve të vet

Flaka Kokolli aktualisht është tutore në Akademinë e Animacionit që zë vend në qytetin e Pejës. Në kohën kur nisi, qe thuaja në të njëjtën gjeneratë me studentët.

“Kam filluar tash e rreth gjashtë vjet duke punuar aty. Ka qenë viti i tretë i akademisë ndoshta. Kam qenë në moshë të afërt me studentët. Tash janë më të rinj dhe gjithë ata që kanë qenë studentë tash janë kolegë. Përdërisa nuk ka fakultet të animacionit, ka mbetur si mënyrë e mirë. Më duket shumë kualitativ si program. Kështu bëhet industria dhe ndihesh që je duke

dhënë, jo vetëm duke marrë. Tek e fundit, nesër nëse do ta bëj një film më të gjatë, krejt këta njerëz do të më duhen”, konsideron ajo.

Për të, animacioni po lulëzon duke qenë se ka shumë kërkesa për të ndjekur mësimet aty. Po aq sa kërkesa, aq edhe refuzime. Kokolli tregon se çdo vit aplikojnë midis 30 e 40 të interesuar, ndërsa ata nuk mund të zgjedhin më shumë se dhjetë.

Kokolli ka punuar dhe vazhdon të punojë për projekte të komisionuara, por “Shpija” ka qenë filmi i parë personal i saj. Flet me admirim për filmin teksa biseda e saj për anën profesionale në përgjithësi është tejet e sinqertë.

Filmi qe shfaqur premierë në vitin 2022 në festivalin ndërkombëtar të filmave dokumentarë dhe të shkurtër “DokuFest” në kategorinë e filmave kombëtarë, midis filmash të tjerë të shkurtër e me praninë e saj.

“Në momentin kur del, sheh plot gjëra që do t'i bëje ndryshe. I vëren ato gjëra tërë kohën, por kalon me kohën”, kujton Kokolli.

Ajo flet hapur për momentet kur është ndier e pasigurt. Si në rastin e filmit “Shpija”.

“Vështirësi është fakti që ne nuk e kemi pasur fatin të punojmë në një studio ekzistuese, që dalëngadalë ngjitesh në role të ndryshme, ke ‘feedback’ tërë kohën nga dikush që din dhe eventualisht mbërrin tek ideja që mund ta bësh një film vetëm”, shprehet ajo.

Të qenit pioniere në gjeneratën e re është privilegj për të, por jo përparësi.

“Ne nuk e kemi pasur këtë proces sepse nuk ke qenë kurrë duke punuar në një studio që e ka bërë më parë këtë punë. Ka pasur shumë privilegj fakti që e kemi këtë status si pionierë në sensin e filmit sepse si

teknikë ekziston, për reklama dhe plot të tjera. Në anën tjetër i bie të krijosh përvojë e të udhëheqësh kur nuk ke qenë kurrë e udhëhequr që ta kesh si shembull. Mungesa e shembujve, për gjithçka, mbase ka qenë pjesa më e vështirë”, thotë ajo.

“Shpija” e debutimit dhe “Mardhë” e luftës

Filmi “Shpija” në shtatë minuta rrëfen se si shtëpia dhe rehatia shpesh mund të gjenden në gjërat që na turpërojnë, na vënë në grackë e na dëmtojnë. Se si ta lësh shtëpinë mund të jetë e vështirë, por ta kesh atë si fantazmë që të ndjek, përherë del të jetë edhe më e vështirë.

Filmat e saj janë informues e edukativ. Për filmin “Shpija” ka marrë “Special Mention” në “Anibar” në vitin 2022, ndërsa në “DokuFest”, në të njëjtin vit, Çmimin e Distribuimit. Po ky film, u vlerësua si Filmi më i Mirë në Shqip, në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Tiranë. Po ashtu qe zgjedhur nga “Animation Nights New York” për të qenë pjesë e “Short Film Corner” në Festivalin e Cannes, tre vjet më parë.

“DokuFest” e ka vlerësuar edhe filmin e saj “Mardhë” më 2021 me “Special Mention”. Filmi katërminutësh trajton luftën në Kosovë. Ka në qendër një grua që bëhet me dhunë për në Bllacë bashkë me familjen me familjen. Kjo vepër e saj, është edhe një lloj prove se animacioni nuk korrespondon me fëmijët. E sipas saj, ky paragjykim po zbehet.

“Tërë kohën ka pasur filma të animuar që janë tema shumë serioze, që nuk bën t'i shohim fëmijët. Në filma të animuar ka edhe dokumentarë për luftën, për njerëz të

vdekur, për përdhunim, për vrasje. Në përgjithësi mendimi i njerëzve është ky, por nuk më pengon sepse e di prej nga vjen. Nuk vjen me ndonjë qëllim negativ, prej ndonjë nënçmimi, por për shkak se për shumë njerëz asocimi i animacionit me fëmijëri është veç një e vërtetë e jetës, por po më duket që po ndërrohet”, vlerëson animatorja Kokolli.

Sipas saj, insistimi për të shënjestruar fëmijët me animacion, e ka ndërruar komplet industrinë.

“Animacioni në fillim nuk ka nisur për fëmijë edhe aq shumë. Në Evropë është punuar goxha herët. Është përdorur edhe për propagandë nga Bashkimi Sovjetik, por ka qenë edhe për qëllime artistike, jo të lidhura me fëmijët. Një prej besimeve të përgjithshme të animatorëve, edhe të miat, ‘Disney’ ka punuar gjëra shumë të mira dhe në atë proces kanë qenë shumë të fokusuar në shitje në animacion si industri profitabile”, thotë Flaka Kokolli.

Por se ky paragjykim, sipas saj, “i bën pak dëm sepse është vështirë t'i bësh njerëzit ta marrin seriozisht”. Ka theksuar se paragjytime të tilla nuk gjenden te institucionet e kulturës, e veçmas festivalet, që përherë i mirëpresin filmat e saj.

Në “DokuFest”, sivjet ajo gjithashtu ka marrë çmimin “Euro Connection” në Forumin e Filmit të Shkurtër me projektin e saj “I still haven't cried” të cilin tash ka vendosur ta zhvillojë me animatoren Elsa Talla. Për këtë film ka bërë të ditur se do të punojë gjithë vitin në ardhje, ndërsa premierën parashihet ta ketë në vitin 2027.

“Vitin e ardhshëm, gjithë vitin, do të punoj vetëm në pre-produksion të filmit, domethënë vetën në skenarë, në storje, në ilustrimet e para. Jam duke shikuar ta bëj bashkëprodhim me Francën, Bullgarinë dhe Kroacinë. Jam në komunikim. Do të ishte e mrekullueshme nëse ndodh. Ky çmim është për të shkruar në Clermont-Ferrand dhe të kontaktoj me njerëz të tjerë për bashkëpunime. Besoj që tek në vitin 2027 do t'ua nisi ta punoj tamam”, bën me dije Kokolli.

Pesë muaj punë për pesë sekonda animacion

Se sa mund e përkushtim kërkon filmi i animuar, Flaka Kokolli me bashkëpunëtorë e patën hapur një eksperiment në korrikun e 2023-s në “Europe House” në Prishtinë. “Animated Worlds” rrëfente sfidat e animatorëve. Sesi pesë muaj punë zëbërthen në pesë sekonda animacion.

“Ne e vizatojmë çdo skicë. Çdo sekondë i ka 24 ose 25 ‘frame’, por jo secilën duhet ta vizatosh, shumicën e kohës e vizatojmë çdo të dytën. I bie që për një sekondë mund të ketë 8 deri 12 vizatime. Mund të shkojë edhe 24 nëse është një arsye specifike, por mesatarja do të thosha është 8 deri 12 vizatime. I skicon karakteret dhe një herë e punon. Është shumë punë konsumuese, merr kohë, por vështirësia e vetme që e njoh është se çdo animator ka problem me shpinën”, shpjegon Kokolli duke qeshur.

Për animatoren Flaka Kokolli, animacioni ka potencial e hapësirë. Ka vend për përmirësime. Të qenët pioniere në gjeneratën e saj ka privilegje e mangësi. Regjisorja e filmave të animuar shprehet se animacioni nuk është industri e shtypur. Por se e ka rrugën e hapur drejt lulëzimit në skenën kinematografike. Ajo tashmë është shembulli.

365 DITË E SKENËS KULTURORE

Kultura në ritëm suksesesh dhe dështimesh

Shaban Maxharraj

“Arti si shpëtim” do të mund të titullohej historia ku një piktor i shpëton policisë serbe nëpërmjet shkathtësisë së tij për të paraqitur në dërrasë të zezë portretin e peng-marrësit bashkë me talentin e të birit që këtë përvojë reale ta kthejë në film, i cili kishte premierën botërore në “Berlinale”. Lajmi se filmi i Alban Mujës, “Mua besoj më shpëtoj portreti”, që është dhënë në festivalin ndërkombëtar të Gjermanisë, që i pari i vitit 2025 që tregoi se rrëfimet vendore si projekte kulturore do të vazhdojnë të lidhin Kosovën me botën, e pos historisë do të tregojnë edhe talent.

Talenti e rrëfimet e Kosovës këtë vit pos Gjermanisë me film, art pamor e muzikë, kanë shkuar edhe në disa qytet italiane, në Poloni, Danimarkë, New York e deri në Tajlandë. Në planin e brendshëm shumë institucione kanë stagnuar me të madhe. Prej tyre edhe kanë degraduar. Kaosi institucional përtej atyre të kulturës, ka dalë në pah edhe midis nivelit lokal e atij qendror duke bërë që trashëgimia kulturore të shndërrohet në pretekst për përplasje të forta. Në këtë fushë ndërhyrjet emergjente kanë marrë miliona e funksionalizimi i aseteve është i barabartë me zero.

Viti 2025 që i fundit për alamet artistë vendorë e ndërkombëtarë. Krejt 12 muajt e këtij viti në kulturë mund të përshkruhen si histori suksesesh jo të vogla dhe dështimesh të po këtij niveli.

Premtimet vazhdojnë...

Premiera në një nga forumet e “Berlinales” i filmit të shkurtër dokumentar, “Mua besoj më shpëtoj portreti”, projektit i ka hapur rrugë në shumë festivale të mëdha të filmit gjatë vitit. Qe lajmi i parë me peshë në kulturë, por fillimviti shpejt u kaplua me fushatë zgjedhore. Zgjedhjeve të fillimshkurrit u parapriu një muaj fushatë nga partitë politike duke bërë thirrje që të votohen kandidatët e tyre për Kuvendin e Kosovës. Si tash e të paktën dy dekada, edhe asaj radhe janë prezantuar alamet projektesh të infrastrukturës kulturore. Renderë sallash e qendrash të kulturës janë parë gjithandëj. Më i madhi që ai i teatrit të operës dhe baletit. Në kushte ideale, projekt i bazuar në xhubletë – veshje që është pjesë e Listës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s – do rreth 15 muaj që të shndërrohet në projekt zbatues e sipas projektuesit Bjarke Ingels kërkon gjysmë dekadë që të finalizohet. U prezantua pak ditë para zgjedhjeve të shkurtit dhe ende s’ka ndonjë lajm të ri pas projektit ideor. Kurse projekti për sallën koncertale në kryeqytet është finalizuar por s’ka lëvizur gjë. 1.5 milionë eurot e dhëna për studion e arkitektit japonez Kengo Kuma dhe bashkëpunëtorët e tij nga Kosova, janë përkthyer në projekt që qëndron në zyrat e shtetit. Komuna e Prishtinës me arsyetimin se shkaku i masave të Bashkimit Evropian – që shumica janë hequr në dhjetor – s’mund të aplikojë për fonde, s’është marrë fare me këtë çështje. Fushata është kthyer në dhjetor pasi partitë politike s’kanë gjetur zgjidhje për formimin e Qeverisë dhe premtime janë rikthyer. Por pavarësisht infrastrukturës skena muzikore ka vazhduar me ritëm edhe më të lartë.

Harmonia muzikore dhe një skenë botërore

Filharmonia e Kosovës sivjet ka vazhduar e ritmin e saj. Pos koncerteve në vend, marsi e ka gjetur në Bernë të Zvicrës. Në kryeqendrën e Zvicrës, publiku vendas e ai shqiptar kanë mbushur sallën, ndërsa figura

të shquara të muzikës e kanë vlerësuar kapacitetin e institucionit e të solistëve. Më pas Kori i këtij institucioni ka mbajtur dy koncerte në Gjermani. Një në Hamburg e tjetrin në Düsseldorf. Në raport me lëvizjet jashtë vendit, Filharmonia vitin e ka mbyllur në Romë. Oratoriumi “La Tempesta sul Lago” i Domeniko Bartolucci është interpretuar në kuadër të Jubileut të Selisë së Shenjtë. Përcjell mesazhe paqeje në kohë stuhish. Në Bazilikën Santa Maria in Aracoeli në Romë ka jehuar me rrëfimin që ka lënë aty Kosova, e cila çerekshkulli më parë kërkonte paqen.

Sa i përket muzikës klasike emrin e talentet e Kosovës ka vazhduar t’i promovojë edhe kori “Siparantum”. Me paraqitje në Filharmoninë e Berlinit e në Danimarkë, ky formacion koral ka mbajtur nivelin e pjesëmarrjes në festivale e gara. Kurse interpretimi në Bangkok të Tajlandës bashkë me Medaljen e Artë dhe Çmimin special për rrëfim muzikor, e ka rikonfirmuar “Siparantum” si ambasador të muzikës korale ndër shqiptarë.

Ndërkohë festivalet tradicionale të muzikës klasike si “ReMusica”, “Chopin Piano Fest” e “KamerFest” kanë vazhduar me ritmin e tyre duke sjellë në skenë e Prishtinës emra të njohur solistësh. Festivali ndërkombëtar i operës, “Ramë Lahaj” ka mbledhur edhe më 2025 interpretues me nam të operave në Prishtinë. Por festivalit të operës edhe këtë vit, të pestin me radhë i kanë munguar operat. Ndjesi të skenave botërore ka sjellë ylli shqiptar, Ermonela Jaho në koncertin e organizuar nga Opera e Kosovës. Përtej talentit, Jaho me ka dhënë edhe mesazhe të fuqishme. Të njëjtën gjë e ka bërë edhe kur në fund të vitit është kthyer në Gjakovë. Sopranot e Kosovës e kanë vazhduar karrierën e tyre bujshëm si Elbenita Kajtazi në Gjermani e Marigona Kerkezi në disa teatro nëpër botë. Opera e Kosovës që funksionon si agjenci e cila angazhon ansamble me projekte ka

inskenuar edhe të famshmen “Carmen”. Përtej kësaj ka bërë edhe disa eksperimente, përfshirë inskenimin e “Maria de Buenos Aires” një projekt që pos telasheve të vënies në skenë, proceduralisht nuk ka përfillur as aspektet ligjore.

Në muzikë jehonën më të madhe vendit ia ka dhënë festivali “Sunny Hill”. Për tri net Prishtina ishte adresë e të rinjve nga vende të ndryshme të Evropës. Ylli i këtij edicioni që Dua Lipa me “Radical Optimism” ku për dy orë e bëri Kosovën skenën kryesore të pop- muzikës në Kontinentin e Vjetër.

Prapaskena teatrore

Por për dallim prej muzikës, skena institucionale e teatrit ka probleme të mëdha. Ato nisin në krye, në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Me disa shfaqje në vendet e rajonit e një në Opolë të Polonisë, TKK-ja gjendet në ditë e veta të vështira. Vitin e nisi me grevën e aktorë të ansambllit rezident që nisi në nëntor të 2024-s për të vazhduar për më shumë se tre muaj. Por edhe pas daljes nga greva shkaku i koeficienteve të pagës, institucioni nuk është kthjellur. Fundviti e ka gjetur pak më mirë i dhënë zor që të nxirren në skenë shfaqje e punë më përmbajtjesore. Sivjet që edhe nikoqir i festivalit mbarëkombëtar të teatrit “Moisiu” pasi vitin e kaluar nuk u mbajt shkaku i grevës. Edicioni i tretë me radhë i mbajtur në Prishtinë u vlerësua si i suksesshëm. Shfaqet mysafire ashtu sikurse ato të TKK-së janë dhënë në Amfiteatrin e Pallatit të Rinisë. Shkak është restaurimi që po i bëhet ndërtesës së TKK-së. Pas mbylljes në korrik të 2022-s, puna nisi në shtatorin e vjetër. Planet ishin që punimet të përfundonin për një vit. Por tash s’ka një afat të dytë. Janë kontraktuar punë shtesë përtej vlerës prej afro 7 milionë eurosh.

Në të njëjtën hapësirë shfaqjet i jep edhe Baleti Kombëtar i Kosovës. Me ushtrime e prova te “Shota”, Baleti gjatë vitit ka interpretuar në New

York e më pas në Venecia e Potenza të Italisë. Por pak pas kthimit nga udhëtimi matanë Adriatikut, ministri në detyrë i Kulturës ka ndërruar drejtuesin e institucionit. Sinan Kajtazi pas tre vjetëve mandat, e tetë muajve si ushtrues detyre është larguar për ta emëruar Kreshnik Mollin ushtrues detyre. Kajtazi që numëron 25 vjet në BKK dhe ishte solisti kryesor, s’ka marrë kurrfarë arsyetimi dhe as nuk është njoftuar paraprakisht për vendimin e ministrit në detyrë të kulturës.

Arti i ushtrimit të detyrës

Problemet në institucionet e kulturës në disa prej tyre kanë emëruet të përbashkët funksionimin me ushtrues detyre. Galeria Kombëtare e Kosovës ka hyrë në vitin e 6-të me ushtrues detyrë të drejtorit, pa drejtor me mandat funksionojnë edhe Muzeu i Artit Bashkëkohor, Filharmonia e Kosovës, Opera e Kosovës, ansambli “Shota” e Baleti Kombëtar i Kosovës. Galeria Kombëtare e Kosovës është zhvendosur në atë që ishte Galeria e Ministrisë së Kulturës shkaku i restaurimit të ndërtesës së institucionit. GKK-ja më 2025 kishte program brenda mundësive që ka shkaku i hapësirës dhe e ka përcjellë dështimi me peshë 400 mijë eurosh pasi pavarësisht që zhvilloi proces nuk finalizoi blerjet direkte të veprave nga artistët për të pasuruar fondit e vet. Në anën tjetër, Muzeu i Artit Bashkëkohor është “funksional” me staf dhe vull. S’ka seli dhe vitin e ka përmbyllur me një thirrje për humtime që zor se do t’i hynte në punë. QKK-ja me krejt vonesat e telasht, më 2025 i është kthyer subvencionit të rregullt të filmave përderisa as këtë vit s’ka pasur kandidat për nominim për “Oscar”. Është viti i tretë me radhë që Kosova s’ka kandidat dhe kjo për një pjesë të filmbërësve është ogur aspak i mirë. Te filmi “DokuFest” me temën “Lakmi, Pafund Çmendi, Boshllëk” ka protestuar për kthim në realitet.

Festivali edhe më 2025 mbledhi në Prizren rrëfime e fimbërës me peshë botërore. Tashmë edhe festival që selekton filma të cilët shkojnë deri te nominimet për “Oscar”. “Anibar” në anën tjetër ka mbajtur ritmin si festival i animacionit në Pejë. Në të dyja festivalet u shfaqen filma të ndryshëm, nga rajoni, Evropa e bota. Por pak më tej, në Mal të Zi nacionalistët u çuan kundër shfaqjes së filmit “Lejleku” të Isa Qosjes që shpërfaq se si po braktiset Vuthaj. U bë goxha zhurmë, u anulua shfaqja e më pas shteti ndërhyri duke e dhënë edhe në televizionin publik.

Fluturimi i teatrit

Kosova nuk ka telashe me përmbajtjet artistike. Por më 2024 dhe me të madhe më 2025, Turqisë i doli punë me përmbajtjet artistike të Kosovës që jepen në vend e rajon. Më 2024 shteti turk nëpërmjet Ambasadës në Prishtinë u mundua të ndalte premierën e shfaqjes “Të gjashtë kundër Turqisë”, produksion i qendrës “Multimedia”. Ministria e Kulturës nuk ra në presion. Por më 2025 Komuna e Prizrenit u nënshkrua presionit. Anuloi dhënien e shfaqjes disa herë me pretekste të ndryshme, por arsyja bazike ishte presioni i shtetit turk se gjoja shfaqja kritikon mënyrën e qeverisjes së Turqisë së sotme. Turqia bëri alamet zhurmë edhe para dhënies së shfaqjes në Teatrin Kombëtar të Sarajevës. Por ky institucion doli qartë me qëndrimin: s’njohim censurë. “Negotiating Peace” e po kësaj qendre “Multimedia” u dha në disa vende të Evropës, kurse “Fluturimi mbi Teatrin e Kosovës” u sabotua nga autoritetet lokale në Ferizaj, por teatri i qytetit “Adriana” s’hoqi dorë. “Multimedia” më 2025 realizoi edhe shfaqjen “Nën hijen e një peme u ula dhe qava” nëpërmjet të cilës i takoi në teatër faljen e gjaqeve në Kosovë dhe pajtimin në Afrikë të Jugut. E njëjta do të udhëtojë në Afrikë, në shumë qytete evropiane e deri në New York.

Shpërthimet artistike

Pos teatrit edhe arti pamor ka krijuar ndërthurje të rëndësishme me botën gjatë vitit. Artisti i njohur Sisley Xhafa ka mbledhur një numër të kolegëve nga Kosova me një ekspozitë në Paris. Kosova e ka vazhduar traditën e përfaqësimit në Bienalen e arkitekturës në Paris. Kësaj radhe me veprën “Lulebora nuk çel më. Asamble në shpërfaqje”, një instalacion ndijor i arkitektes Erzë Dinarama. Në Prizren “Autostrada Biennale” ka rrymuar trashëgiminë me art bashkëkohor me edicion të suksesshëm nën kurimin e Erzen Shkolollit. E Syrigana e Skenderajt u bë nikoqire e një opere që mbledhi artistë të ndryshëm vendas e të huaj. Petrit Halilaj kësaj radhe iu kthye Kosovës me operën “Syrigana” e në bashkëpunim me Filharmoninë e Kosovës, ringjalli shumë legjenda të asaj zone duke i bërë material për ekspozitën e tij personale “Një operë në tejkohësi” në “Hamburger Bahnhof”. Pak pas kësaj ngjarjeje, artisti kosovar më i njohur në botë, është shpallur laureat i çmimit prestigjioz për skulpturë “Nasher”. Arsyetimet e jurisë janë një varg zbërthimesh të veprës dhe artit të tij që nuk i shkëputet Kosovës, luftës, por që ka fuqinë e transformimit në ndjenjë e kërkim lirie. Shkaku i peshës së çmimit lajmi është dhënë edhe nga mediat më prestigjioze në botë, përfshirë edhe “The New York Times”. Trashëgiminë e festoi edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës që më 2025 shënoi gjysmëshekullin e Kohavisioni shënoi 25-vjetorin duke ritheksuar peshën e fjalës, sikurse u ritheksua në ceremoninë e shpërblimeve “Rexhai Surroi” për letërsi e gazetari.

Trashëgimia e shkatërrimit

Përderisa trashëgimia kulturore e Kosovës promovohet gjithandej nga Petrit Halilaj, sidomos ajo e vendlindjes së tij, Runikut, një pllakë betoni u vendos pa leje afër atij monamenti me qëllim ndërtimi dyqanesh. U ndalën punimet shpejt, por zallamahia vazhdoi në të tjera anë të vendit.

Ish-“Kino Rinia” në Prishtinë e harruar prej vitesh u dogj në pritje të ringjalljes. Pak më tej Komuna nisi punime pa leje për sheshin “Xhorxh Bush” edhe pse hapësira është midis monumenteve dhe e përfshirë në kuadër të zonës së mbrojtura të Qendrës Historike të Prishtinës. Historia për këtë rast ende vazhdon. Kontrata nëpërmjet së cilës ka hyrë në detyrime Komuna peshon mbi 18 milionë euro. E brenda saj veç zhvendosja dhe rivendosja e shtatorës së Ibrahim Rugovës është caktuar të kushtojë 18 mijë euro. Komuna e Prishtinës është në sherr me institucionet e trashëgimisë kulturore edhe në dy raste të tjera. E institucionet e trashëgimisë kulturore diku me vonesa administrative e diku me mbyllje të syve kanë mundësuar ndërtimin e një shumëkatësheje ngjitur me Kishën Katolike që është monument në Pejë. Për shkatërrimin e kompleksit monumental nën mbrojtje të përherëshme “Saraji i Vjetër” në Prizren, Prokuroria ngriti aktakuzë për dy zyrtarë dhe dëmi ndaj trashëgimisë llogaritet rreth 16 milionë euro. Shteti është në proces të kontraktimit të punëve për ta impelmentuar masterplanin për lokalitetin arkeologjik me mozaikë unik në Dresnik për afro 2.5 milionë euro.

Përtej Kosovës, edhe bota sivjet u përball me një rast të rëndë. Në pikë të ditës u bë vjedhje në muzeun e “Louvreit” duke bërë jehonë të madhe dhe duke ngritur pyetje për sigurinë e thesarit më të madh që njeh njerëzimi.

Humbja e kolosëve

Viti 2025 është përshkuar edhe me shumë humbje të mëdha në fusha të ndryshme si në vend ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Kosova mbeti pa akademik Minir Dushin, si pionier të shkencës së xehetarisë. Gjatë këtij viti vdiq shkrimtari Muhamed Kërveshi më pas Mire Lajçi, ikona që njihej si burrnësja e fundit e Kosovës. Alban Bujari, fotoreporteri i “Kohës Ditore” që dokumentoi krimet serbe në Kosovë gjatë luftës së fundit, vdiq në shkurt duke lënë prapa një trashëgimi të madhe historike. Shoqëria shqiptare humbi Lulzim Rexhën, aktorin energjik e plot humor, Margarita Xhepën, ikonën e filmit, Dhimitër Anagnostin, korifeun e kinematografisë, Enver Petrovcin, aktorin e pedagogun ikonë që ishte sharm i jetës dhe skenës e po ashtu edhe këngëtarin Shemsi Krasniqi – Shemi, që ishte zëri i “Ilirëve”. Prishtina ngeli edhe pa Martin Hajdarin, ikonën urbane që mbante kafenenë ku bashkoheshin ngjyrat e kryeqytetit “Te Martini”.

Bota në këtë vit mbeti pa John Sykes, kitaristin e “Whitesnake”, Roberta Flack, ikonën e muzikës soul dhe R&B, Mario Vargas Llosan, gjigantin e letërsisë që u bë edhe zë i Kosovës, Filip Davidin, shkrimtarin e luftëtarin e paqes, Cleo Laine, damën e jazzit me zërin e pakufishëm e Terry Reid, muzikantin e grupeve legjendare. U shua edhe Ozzy Osbourne, vokalisti i “Black Sabbath” i cilësuar si “Princi i errësirës” që i dha dritë “heavy metalit”. Në listën e humbjeve për këtë vit midis të tjerësh janë edhe Claudia Cardinale, aktorja ikonë midis realitetit dhe fantazisë, legjenda Diane Keaton, John Lodge, figura unike e “The Moody Blues” dhe Tom Stoppard, ylli i dramaturgjisë e afirmuesi i teatrit, sikurse edhe Chris Rean, zërin unik të rockut dhe bluesit e ikonën e filmit francez, Brigitte Bardot.

© KOHA Ditore

OPINION

Matrica e ndryshueshme e knusit*

Prej kandidat të artistit, fluturimi i knusit nuk asht metafore, asht përditshmëri. Ai ik’ se hapsina që i asht caktu nuk e mban. Asht e njëjta logjikë pse shumë artistë nuk gjejnë vend brenda strukturave tona: nuk ikin prej vendit, por prej sistemit që nuk punon

Driton Selmani

Kanihere metaforat ma t’sakta dalin prej skenave ma të thjeshta t’jetës. Para pak ditësh, gjatë një dreke familjare, mami nisi me kallxu për një knus të ri që s’po i del oborri.

Çdo mëngjes, sapo hapej koqaku, ai dilte me hez, t’u fluturu mbi gardh e t’u humb napër sokaqe e shpi t’mahallës, t’ue e detyrue mamin me ba rrethe t’tana për me e kapë. Mas shumë tentativave të dështueme, asaj iu desht me ia shkurtrua pak krahët, një ndërhyrje e vogël, shtëpiake, që ruen rregullin, por ia mohon knusit t’ri pikërisht atë që e përkufizon: fluturimin.

Ka një paralele absurde ndërmjet këtij knusi dhe ndjenjës me qenë artist në këtë “buffering” gjeografi. Të dy enden në një hapësinë që s’u mjafton. Të dy kërkojnë me i ikë kufinit. E, të dy kujtohen si problem pikërisht në çastin kur provojnë me kapërcye gardhin që u asht caktu.

Në shoqni që vuajnë nga një amnezi kulturore, fluturimi i artistit shihet si çrregullim, jo si nevojë për horizont. Sistemi don stabilitet; artisti don ngritje. E, ai ekuilibër zhduket në çastin kur institucioni merret me prerjen e krahëve, e jo me krijimin e hapësinës së fluturimit.

N’ket kontekst, mu kujtun pyetjet e Haruki Murakamit në “Underground”, që marrin një peshë tjetër krejt të fortë kur ai pyet: “A mos ia keni dhënë rastësisht një pjesë të identitetit tuej dikujt apo diçkaje dhe marrë në këmbim një ‘histori’? A mos ia keni besu naj pjesë t’personalitetit tuej ndonji rendi apo sistemi? N’qoftë ashtu, a nuk jua ka kërkuë ai sistem, n’nji moment të caktuem, ndonji ‘marrëzi’? A ju ka çue fuqia juej e vetëpërcaktimit në ndonji nivel konsensi t’brendshëm? Historia që ju tanimë keni, a asht përnjiment e jueja? A janë vertet tuejat andrrat që i shihni?”

A mos janë rastësisht andrrat e dikujt tjetër, që n’nji pikë të caktueme do të shndërrohen në ankth të absurdit?”

Kto dilema janë t’njohuna për artistin: ai jep copza prej vetes në një sistem që nuk i përpunon e as nuk i mban mend. Institucionet janë të kujdesshme në procedura, por shpesh krejtësisht të pavendosuna në kujtesë.

Në këtë boshllëk t’interpretimit, vlen me rikujtue mendimin e Umberto Ecos, i cili do ta quante knusin “një shenjë që del jashtë funksionit të vet



Driton Selmani – “Mbi Pamundësinë e Fluturimit I”, 2025, qymyr në letër të ricikluar, dimensione të ndryshme. Me mirësjellje të artistit ©

kulturore”, prandaj sistemi e përjeton si shqetësim. Artistët që s’rrijnë në rolin e dekorit a folklorit institucional, papritmas shihen si devijim, por s’janë devijim, janë alarm për hapësinë.

Në anën tjetër, Virginia Woolf, shumë përpara se me folë për kulturen periferike, kërkonte për artistin një “dhomë më vete”, një hapësinë ku ai mos me u ndërpre prej zhurmës, burokracisë e kërkesave të panevojshme. Kur kjo dhomë mungon, artisti ban atë që ban edhe knusi: ikë. Edhe nëse duhet me ikë disa herë, edhe nëse rrezikon me hup bash n’qato rrugicat e mahallës.

Kjo po ma çon mendjen te artisti belg, Panamarenko e veçanërisht te vepra e tij “Raven’s Variable Matrix” – një makineri fluturimi e pasigurt, e hapun, e çuditshme, e paqëndrueshme, po qi këmbëngul për m’u ngrit. Asht metaforë e pastër për artistin në këto hapësina: një trup që kërkon qiell, edhe kur qielli s’është strukturë, por vetëm dëshirë e pakëtueme si premtim.

Në një dimension tjetër, Édouard Glissant do të këmbëngulte në “të

drejten e opacitetit”, të drejtën e artistit me mos u ba i lexueshëm sipas skemave të sistemit, por me ndjekë ritmin e vet, errësinë e vet, të pakapshmen që e ban artin art. Por institucionet tona shpesh e shohin këtë opacitet si gabim teknik, jo si kusht të domosdoshëm të lirisë krijuese.

Prandaj me qenë artist kërkon seriozitet. Kërkon një aftësi të pashpjegueshme me fluturua, qoftë edhe kur je si një dodo** (Raphus cucullatus) një zog që fizikisht s’ngrihet kurr’ ma, por qi n’shpiet e man t’njëjtën nevojë për lartsi. Ky paradoks, me u ngritë edhe kur s’të ngre askush, asht vetë territori ku artisti i jep shprehje nevojave t’shoqnis për me ndërtu raport me vet’ botën.

N’anën tjetër, mosqasja politikave institucionale nuk krijon thjesht pezullim apo shkurtim t’krahve, ajo krijon pamundsi reale për pun’. Projektet ngecin jo pse jan’ t’dobta, po pse sistemi nuk ka strukture për me i mbajt. Idete tkurren se harxhohen në pritje, e në aprovimet që s’kane as horizont as pergjegjësi. Çdo tentativë për fluturim shihet si

rrezik, jo si nevojë’.

E kjo ndodh për një arsye të thjeshte: institucionet nuk e dojn naltsin’; nuk dinë se çka me ba me te. Prej kandidat të artistit, fluturimi i knusit nuk asht metafore, asht përditshmëri. Ai ik’ se hapsina që i asht caktu nuk e mban. Asht e njëjta logjikë pse shumë artistë nuk gjejnë vend brenda strukturave tona: nuk ikin prej vendit, por prej sistemit që nuk punon.

Prandaj s’mjafton me prit’ me fluturua knusi, por duhet me krijuë vet’ qiellin ku fluturimi kuptohet si nevojë, e artisti si ai që tregon sa i ulët asht gardhi që pret me u çue ma nalt.

E vërteta asht edhe ma e randë: kur politika kulturore reduktohet n’menaxhim të ditës, prodhimi artistik kthehet në dekor, jo n’strukturë. Skena e artit trajtohet si një kockë e lehtë (jadec)*** për me përbë, një hapësinë e brishtë që përdoret për prestigj, për statistikë, për raportime, por jo për zhvillim. Krahët e artistëve përmenden nëpër fjalime, por shkurohen nëpër procedura.

Prandaj çashtja nuk asht metaforike, por krejt politike: skena e jonë e artit s’dështon prej mungesës se talentit, por prej mungesës së kushteve. Problemi nuk jane artistët që duan me fluturu, po qielli që institucionet përkatëse kurrë s’e kanë ndërtu.


* Knus — Term i përdorun në zharqonin e Kosovës për me iu referu gjelit të shtëpisë. Në këtë tekst mban edhe ngarkesë metaforike: liria, instinkti i fluturimit dhe kufizimi hapësinor.

** Dodo (Raphus cucullatus) – Zog i zhdukuri prej ishullit Mauricius, i njohun për paaftësinë me fluturua. Në diskurs kulturor përdoret si metaforë për krijesat e pambrojtuna prej sistemit dhe potencialin që shuhet jo prej natyrës, por prej rrethanave.

*** “Jadec” / kocka e pulës si lojë popullore – Në shumë zona të Kosovës, kocka trekëndore e pulës (e quajtur shpesh “jadec”) përdoret si lojë fatit ose parashikimi, zakonisht mes fëmijëve. Dy veta e theyejnë bashkë: ai që merr pjesën ma të madhe, “fiton” simbolikisht. Në përdorim metaforik, “me ta dhanë jadecin” nënkupton një gjest të vogël, të pavlerë, një mbetje që ta qesin për ta mbyllë bisedën – një aluzion për mos-seriozitet institucional, për gjestet kozmetike që mbulojnë mungesën e strukturës reale.

© KOHA Ditore

Driton Selmani – “Mbi Pamundësinë e Fluturimit II”, 2025, qymyr në letër të ricikluar, dimensione të ndryshme. Me mirësjellje të artistit ©





“HOLLYWOODI” U NDËRTUA MBI YJET, POR A PO NDËRTON AI-JA RREGULLIN E RI?

A është i gatshëm “Hollywoodi” t’ua hapë dyert videove me AI

Përgjatë dekadave, “Hollywoodi” ka qenë sinonim i yjesisë. Emra të mëdhenj, fytyra ikonike dhe zëra të dallueshëm kanë ndërtuar jo vetëm filma, por edhe mite kulturore. Ylli i filmit ka qenë zemra e industrisë, një aktor i famshëm ka pasur fuqinë të garantojë suksesin financiar të një projekti dhe të tërheqë audienca globale. Por në vitet e fundit, ky model i njohur po vihet në pikëpyetje nga një forcë e re dhe e paparashikueshme: inteligjenca artificiale (AI).

LOS ANGELES, DHJETOR - Në botën e yjeve të showbizit apo siç njihet më gjerësisht “Hollywoodi”, ndryshimet e fundit kanë qenë aq të shpejta dhe të thella, sa jo vetëm fansat dhe vetë aktorët, por ndoshta edhe arkitektët e inteligjencës artificiale janë habitur nga drejtimi që ka marrë industria.

Revista prestigjioze “TIME”, kur e shpalli inteligjencën artificiale “personazhi i vitit 2025”, e përshkroi atë si një forcë që tashmë nuk qëndron më në prapaskenë, por po ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si krijohet, prodhohet dhe konsumohet kultura.

AI-ja ka filluar gradualisht të trokasë në derën e çdo departamenti të filmit, nga fazat e hershme të produksionit e deri te post-produksioni.

Ajo po përdoret për t’i ulur kostot e krijimit të filmave, për t’i përshpejtuar proceset teknike dhe për t’i zgjeruar mundësitë në efektet vizuale, duke bërë të mundur skena që më parë kërkonin buxhete marra-mendëse.

Mjete të bazuara në inteligjencën artificiale për përmirësimin dhe përforcimin e zërit janë përdorur edhe në filma që janë nominuar për çmimet më prestigjioze të industrisë, përfshirë “Oscarët”.

Filma si “The Brutalist” dhe “Emilia Perez” janë përmendur gjerësisht në këtë kontekst.

Në rastin e “The Brutalist”, teknologjia e AI-së është përdorur për ta përmirësuar theksin hungarez të aktorit Adrien Brody, ndërhyrje që i ndihmoi performancës së tij të perceptohej si më autentike.

Brody fitoi çmimin “Aktori më i mirë”, fakt që ndezi debat të fortë mbi pyetjen: Ku mbaron aftësia njerëzore dhe ku fillon ndihma teknologjike?

Në zemër të “Hollywoodit” që nga epoka e artë e kinemasë, ideja e yllit të filmit ka qenë jo vetëm një simbol kulture, por edhe themeli ekonomik i industrisë.

Studio të mëdha kanë investuar shuma marramendëse në projekte të ndërtuara rreth një emri të vetëm, ndërsa sistemi promocional e ka bërë famën personale të aktorit thuajse të barabartë me suksesin e filmit.

Por sot, kjo formulë po përballet me një sfidë që rrezikon ta ndryshojë rrënjësisht: inteligjencën artificiale.

Sipas “Los Angeles Times”, ajo që mund të sjellë revolucion, por edhe krizë identiteti për industrinë e filmit, është pikërisht mënyra se si AI-ja po i ndryshon rregullat e lojës.

Nga krijimi i imazheve dhe zërave të personazheve, deri te koncepti i aktorëve të rinj tërësisht digjitalë, “Hollywoodi” po hyn në një territor të panjohur.

Tilly Norwood, “aktorja” që ngjalli frikë në “Hollywood”

Në fund të vitit 2025, një krijim i ri i inteligjencës artificiale, e quajtur Tilly Norwood, u prezantua si “aktore” digjitale me pamje jashtëzakonisht reale.

Aq bindëse ishte paraqitja e saj, sa disa agjenci talentesh në “Hollywood” shprehën interes për ta përfshirë në projekte tradicionale filmike dhe televizive.

Ky moment u pa nga shumë kritikë si një pikëkthetë. Për herë të parë, ideja e një aktori pa pasur trup, pa histori personale dhe pa përvojë jetësore po merrej seriozisht si alternativë ndaj aktorëve njerëzorë.

Ngjarja ndezi debat të fortë mes krijuesve të filmave, aktorëve dhe sindikatave, të cilët paralajmëruan se përdorimi i figurave të tilla pa pëlqim ose pa kompensim të drejtë mund të rrezikojë themelin e punës njerëzore në industrinë e filmit.

Kjo çështje kishte qenë prej kohësh në qendër të diskutimeve në “Hollywood” dhe ishte një nga arsyt kryesorë që çuan në grevat e mëparshme

të sindikatave, përfshirë SAG-AFTRA.

Kritika kryesore është se aktorët sintetikë nuk janë thjesht mjete teknike, por produkte digjitale që mund ta zëvendësojnë yjësinë tradicionale në një kohë kur fama dhe vëmendja publike janë tashmë të shpërndara mes platformave të shumta digjitale.

Frika e humbjes së punës, sindikatat dhe reagimi i aktorëve

Sindikatat kryesore të industrisë, së bashku me aktorë të njohur, kanë ngritur zërin kundër përdorimit të AI-së për të krijuar përfaqësime digjitale që mund ta zëvendësojnë punën njerëzore pa kompensim adekuat.

Sipas “Los Angeles Times”, debati nuk është thjesht teknik, por thellësisht ligjor dhe etik.

Pyetjet kryesore janë të drejtpërdrejta: Kush i zotëron të drejtat mbi imazhin dhe zërin e një aktori? Çfarë ndodh kur këto elemente përdoren nga inteligjenca artificiale pa pëlqimin e tij?

Një nga shqetësimet më të mëdha është se modelet e AI-së trajnohen me sasi të mëdha materiale nga arkiva filmike dhe media, shpesh pa transparencë dhe pa kompensim për krijuesit origjinalë. Sipas “UnderstandingAI.org”, kjo praktikë po shihet nga shumë profesionistë jo vetëm si joetike, por edhe si një formë e re e “vjedhjes së performancës”.

Krijimi i “Koalicionit të Artistëve për AI”

Përballë këtyre sfidave, një grup i njohur aktorësh, regjisorësh dhe krijuesish filmash ka njoftuar krijimin e “Creators Coalition on AI”. Kjo organizatë synon t’i mbrojtë të drejtat e krijuesve në epokën e inteligjencës

artificiale dhe të vendosë kufij të qartë mbi përdorimin e teknologjisë.

Sipas “Los Angeles Times”, ky koalicion përfaqëson hap konkret drejt dialogut mes artit dhe teknologjisë, duke kërkuar rregulla të qarta, transparencë dhe mbrojtje ligjore për artistët, pa e ndalur zhvillimin teknologjik.

AI si mjet kreativ, jo domosdoshmërisht zëvendësues

Përkundër frikës dhe polemikave, jo të gjithë e shohin AI-në si kërcënim.

Disa ekspertë dhe krijues e konsiderojnë atë si mjet që mund t’i zgjerojë mundësitë kreative.

“Forbes” ka shkruar se inteligjenca artificiale mund të ndihmojë në automatizimin e punëve teknike dhe të lodhshme, si efektet vizuale ose modifikimi i zërit, duke u lënë artistëve njerëzorë më shumë hapësirë për kreativitet.

Në këtë këndvështrim, AI-ja nuk është zëvendësuese e performancës njerëzore, por instrument që mund ta përmirësojë dhe ta thellojë procesin e produksionit, nëse përdoret me përgjegjësi.

“Forbes” ka theksuar se ndjeshmëria dhe përvoja njerëzore, që janë thelbësore për një performancë aktimi, mbeten elemente që teknologjia ende nuk mund t’i imitojë plotësisht.

Rregullat e reja të lojës, ligji, etika dhe e ardhmja e yjesisë

Teksa “Hollywoodi” përballet me realitetin e inteligjencës artificiale, një nga sfidat kryesore mbetet ndërtimi i një kornize ligjore dhe etike që përcakton qartë se si dhe kur mund të përdoret kjo teknologji.

“UnderstandingAI.org” ka rapor-

tuar se sindikatat dhe ligjvënësit në Shtetet e Bashkuara kanë nisur diskutime për rregullore që synojnë t’i mbrojnë artistët nga përdorimi i paautorizuar i imazhit dhe zërit të tyre.

Në të njëjtën kohë, disa studio dhe prodhues kanë filluar të hartojnë politika të brendshme që kërkojnë miratim të qartë nga aktorët për çdo përdorim të AI-së në manipulimin ose rikrijimin e performancave.

Kjo shihet si hap drejt balancimit mes inovacionit teknologjik dhe respektit për krijimtarinë njerëzore.

A po i ndryshon AI-ja rregullat e “Hollywoodit”?

Industria e filmit ndodhet në një pikë kthetë historike.

Sipas “Los Angeles Times”, inteligjenca artificiale nuk po sfidon vetëm mjetet teknike të produksionit, por edhe vetë konceptin klasik të yllit të filmit si figurë qendrore e narrativës dhe marketingut.

Pyetjet që ngre AI-ja janë më të thella se sa zëvendësimi i një aktori.

Ato prekin identitetin e artit, të drejtat e individit dhe rolin kulturor të “Hollywoodit” në një botë gjithnjë e më digjitale.

Në thelb të këtij debati qëndron një parim i thjeshtë, audienca lidhet me njerëzit, jo me kodet.

Se si do të formësohet e ardhmja e “Hollywoodit”, me aktorë njerëz, me krijesa digjitale apo me një bashkëpunim mes të dyjave, mbetet çështje diskutimi dhe negociimi.

Ajo që është e sigurt, sipas “Los Angeles Times”, është se AI-ja tashmë po i ndryshon rregullat e lojës dhe “Hollywoodi” duhet të përshtatet me mençuri, jo me nxitim, në këtë epokë të re teknologjike.

Përgatiti: Vita Abrashi-Kajtazi

FUSTANI “I PADUKSHËM” QË VË NË PIEDESTAL KËDO QË DËSHIRON VËMENDJE

2025-ta, viti i fustanit transparent

Duket sikur nuk ekziston, por pikërisht për këtë arsye është kudo. Fustani transparent, me pëlhura aq të holla sa mezi dallohen, është shndërruar në simbolin më të debatuar të modës së fundit. Nga tepihët e kuq te pasaretat dhe rrjetet sociale, ai po sfidon kufirin mes veshjes dhe zhveshjes, mes lirisë personale dhe mënyrës së vështrimit publik. Për disa është një shprehje guximi dhe vetëbesimi, për të tjerë një provokim i panevojshëm. Por një gjë është e sigurt: fustani transparent nuk kalon kurrë pa u vënë re.

DHJETOR, (CNN) - Trendi më i madh i vitit ishte pothuajse i padukshëm. Ai u shfaq mbi trupin e aktoreve të njohura të Hollywoodit, si: Margot Robbie, në fije të holla rruazash dhe gurësh vezullues; e “mbuloi” trupin e Julia Foxit, në stilin e artistit të njohur italian të Rilindjes, Sandro Botticellit; dhe, përmes një shtrese transparente rrjete të bardhë, ka zbuluar shtatzëninë e re të aktorese Sienna Miller përpara gjithë botës.

Bëhet fjalë për fustanin transparent. Gjatë vitit 2025, aktore, muzikante dhe influencuese të panumërta u shfaqën në tepih të kuq me fustane transparente, veshje me materiale aq të tejdukshme ose minimale sa krijojnë iluzionin sikur nuk ke veshur asgjë, apo fustane të dizajnuara për të mashtruar syrin dhe për të imituar lakuriqësinë.

Pse kaq shumë disenjatorë i krijuan këto fustane këtë vit dhe pse të famshmet vazhdojnë t'i zgjedhin?

Sipas stilistëve, këto fustane janë shprehje lirie dhe reflektim i marrëdhënies njerëzore në ndryshim me trupin dhe lakuriqësinë.

Kritikët, nga ana tjetër, i shohin si një lloj kënaqje për “këndvështrimin mashkullor”. A janë fustanet transparente versioni modern i “rrobave të reja të perandorit”, apo ëndërr e realizuar për pozitivitetin trupor?

Liri, barazi, lakuriqësi?

“Çdo stil që hyn në modë është i mbingarkuar nga shumë shkaqe, për të përdorur një term psikoanalitik”, ka thënë Valerie Steele, drejtoreshë dhe kuratore kryesore e Muzeut në Institutin e Teknologjisë së Modës (FIT) në New York.

Për këtë, nuk ka vetëm një arsye, nuk është as një klimë konservatore politike e as formë e re e çlirimit seksual.

“Ngjarjet e mëdha historike shpesh janë në sfond, ashtu si edhe individë të veçantë, për shembull një aktore e caktuar. Por katalizatorët e vërtetë të ndryshimeve në modë gjenden

diku në mes, në botën e artizanatit dhe stilit të jetesës”, ka thënë Steele. Sipas saj, disenjatorët vëzhgojnë vazhdimisht njëri-tjetrin, duke parë se çfarë krijojnë vëmendje dhe publicitet. Dhe këtë vit, asgjë nuk garantonte viralitet më shumë se fustani transparent.

Disenjatorët që qëndrojnë pas versioneve më të komentuar të këtij trendi thonë se synimi i tyre është të festojnë fuqinë e gruas brenda atij fustani, sado i hollë apo transparent të jetë ai.

“Fustani transparent, për mua, nuk ka pasur asnjëherë të bëjë me ekspozimin, por me çlirimin. Ka të bëjë me një grua që zgjedh të paraqitet saktësisht ashtu siç dëshiron, me kontroll të plotë mbi praninë e saj. Kur dizajnoj veshje që zbulojnë trupin, mendoj për vetëbesimin si energji, jo si shfaqje”, ka thënë disenjatori i pavarur amerikan LaQuan Smith.

Në ngjarjen më të madhe të modës në botë, ku mbledhen fonde për Institutin e Kostumeve në Muzeun Metropolitan të Artit në New York, “Met Gala”, Smith ka krijuar për aktoren Halle Berry shiritat me rruaza të zeza, që dukeshin sikur të ishin të lëngët, dhe rrjetë transparente që përfundonin në një bisht të gjatë dramatik, ndërsa për këngëtareshen Ciara vendosi kristale mes mëndafshit të zi mat, duke theksuar siluetën. Gratë nuk dukeshin as të brishta, as të pambrojtura.

Marcelo Gaia, themelues i brendit “Mirror Palais”, i cili në vitin 2019 prezantoi formën moderne të fustanit transparent, i sheh këto krijime si festim të feminitetit.

“Trupi i gruas është jashtëzakonisht i bukur. Është krijimi më i përsosur. Nëse do të krijosh diçka të bukur, nuk ke nevojë të bësh shumë, thjesht tregon atë që ekziston”, ka thënë ai.

Provokimi, sipas disenjatorëve, është pjesë e qëllimit.

Fustani me kristale i disenjatorit britanik, Christian Cowan, i veshur nga aktorja Sydney Sweeney në një ngjarje të revistës “Variety” në muajin

tetor, ka shkaktuar debat të madh në rrjete sociale. Disa e quajtën pamjen vulgare.

“Më pëlqeu që ishte pak kontrovers dhe nxiti diskutime. Çdo gjë me vlerë i shqetëson disa njerëz. Ai shton se gratë vishen për mënyrën se si ndihen vetë, jo për vështrimin mashkullor. Cili vështrim mashkullor? Shumicën e rasteve, gratë nuk vishen për burrat”, ka thënë Cowan.

Edhe kur ky vështrim ekziston, ai mund të jetë i pakëndshëm.

Këngëtarja Lily Allen u shfaq me një fustan transparent në ceremoninë e ndarjes së çmimeve “CFDA”, në kulmin e suksesit të albumit të saj të ri, që trajton ndarjen nga bashkëshorti David Harbour.

Panja e saj përcillte mesazh sfidues dhe vetëbesim të plotë: ajo po tregonte se ishte mirë, më e fortë se kurrë. Shkrimtarja Tish Weinstock, e cila u martua me një fustan transparent “vintage” të disenjatorit të famshëm John Galliano, thotë se nuk ndihej aspak e zhveshur.

“Nuk ndihem lakuriq, sepse në fakt jam e veshur me rroba, dhe jo çfarëdo rrobash, por pjesëza historike shumë të bukura. Mua, ky fustan, më bën të ndihem si një figurë mistike, jo si dikush pa rroba”, ka thënë Weinstock.

Sipas Cowan, këto veshje sfidojnë tabutë rreth trupit të gruas.

“Pse duhet të jetë tabu? Trupi i një gruaje duhet të jetë vendimi i saj dhe të tjerët duhet ta pranojnë këtë”, ka thënë ai.

“Perandoria” e re dhe GLP-1, (ilaçet e diabetit që po përdoren për humbje peshe)

Sigurisht, ajo që e vesh, admiruesit e saj besnikë apo ish-partneri nuk janë të vetmit që e shohin fustanin transparent, dhe, sipas Steele, asnjë fustan i vetëm nuk e ka vetëm një kuptim të fiksuar.

“Nuk mund t’i japësh një interpretim të vetëm, sepse i njëjti stil mund të nënkuptojë gjëra krejt të ndryshme

te persona të ndryshëm. Kuptimi nuk është i natyrshëm në fustan. Ai krijohet dhe rikrijohet çdo herë nga ajo që e vesh, disenjatori, stilisti dhe publiku, teksa të gjithë përpigën të kuptojnë se çfarë do të thotë”, ka thënë ajo.

Steele sjell si shembull mbretëreshën e fundit të Francës, Marie Antoinetten, e cila në shekullin XVI-II e bëri të famshëm fustanin “chemise”, përgjigjja e asaj kohe ndaj fustanit transparent.

“Kjo u ndikua pjesërisht nga rënia e regjimit të vjetër dhe revolucionit, por edhe nga disponueshmëria e re e pambukut, falë zgjerimit të tregtisë së skllëvërve amerikanë, si dhe nga interesi në rritje për fustanet greke, që promovonin lirinë si vlerë shoqërore”, ka thënë ajo.

Megjithatë, është e pamundur të shihet rritja e famës së fustanit transparent pa e lidhur atë me përhapjen masive të barnave GLP-1, që janë ilaçe të diabetit por që po përdoren për humbje peshe, edhe nëse disenjatorë si Allen, Gaia, Smith, Cowan dhe Dilara Findikoglu, krijuesja e fustanit “Botticelli” të Foxit, i kanë dizajnuar këto veshje që në kulmin e lëvizjes së pozitivitetit trupor, tre vjet më parë.

Fustanet moderne që ngjiten për trup u shfaqën fillimisht në vitet 1920 dhe 1930, kur disenjatore si Madeleine Vionnet dhe Coco Chanel krijuan fustane të prera në diagonale që theksonin siluetën trupore, me funde më të shkurtra që nxirrnin në pah këmbët.

Në të njëjtën kohë, në sfond, fashizmi po ngrihej në Evropë dhe shtypja e vlerave liberale shoqërohej me fokus të ri te trupi i hollë dhe i disiplinuar fizikisht.

Ndërkohë që ideat konservatore po rikthehen dhe trupat e të famshmeve po duken gjithnjë e më të hollë, ekziston rreziku që vetë trupi të shndërrohet në një trend mode, më vete, dhe jo thjesht një stil apo siluete veshjeje.

Ani pse shumë disenjatorë të fustanit transparent përfshijnë trupa të

ndryshëm në krijimet e tyre, dhe disa prej tyre janë ndër të paktët që ende mbeten të përkushtuar ndaj diversitetit trupor në pasarella, ato që i veshin më shpesh këto fustane janë zakonisht gra shumë të holla.

Sipas Gaia, përdorimi i trupave të hollë në këto veshje nuk lidhet vetëm me përdorimin e barnave GLP-1, por edhe për shkak të kostos së lartë të krijimit dhe të marketingut të veshjeve për masa të mëdha, përfshirë provat dhe imazhet për shitje online. (Brendi e tij ofron masa deri në 18/20.)

“Është shumë e ndërlikuar dhe nuk është vetëm Ozempic që luan rol. Pa diskutim, supremacia e bardhë, adhurimi i trupit të hollë dhe gjithçka që lidhet me të kanë ndikim. Por, në fund, gjithçka lidhet edhe me paratë”, ka thënë ai.

Se a do të mbetet në trend fustani transparent, ndoshta kjo varet nga mënyra se si interpretohet fustani më ekstrem i vitit: copëza transparente e najlonit që Bianca Censori, gruaja e reperit Kanye West, e veshi në tepihun e kuq të ceremonisë së ndarjes së çmimeve “Grammy” në muajin shkurt. Duhet përqendrim i fortë për të dalluar vijat e fustanit dhe pothuajse çdo media publikoi fotografi të saj të mjegulluara.

“Lakuriqësia relative e trupit të gruas mund të perceptohet, ose të synohet, sikur çlirim, por mund të shihet edhe si objektivizim. Kur shikon disa nga partneret e burrave të famshëm që shfaqen gjysmë të zhveshura pranë tyre në tapetin e kuq, mendoj se ato po e paraqesin veten si objekte seksuale për partnerët. Në raste të tjera, mendoj se ato janë plotësisht në kontroll të asaj që po bëjnë”, ka thënë Steele.

A ishte Censori thjesht një objekt seksual për një publik të etur për lakuriqësi femërore, ndërkohë që pretendon se e urren atë? Apo ishte plotësisht nën kontroll? E vërteta e zhveshur mund të jetë të dyja njëkohësisht.

Përgatiti: Vita Abrashi-Kajtazi



Margot Robbie në tepihun e kuq të premierës së filmit, “Big Bald and Beautiful Journey”



Mbretëresha e fundit e Francës, Marie Antoinette me fustanin “Chemise”



Bianca Censori në tepihun e kuq në “Grammy 2025”



INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË ROLIN E KUJDESTARES SË PËRDITSHME TË SHËNDETTIT TË NJERIUT

Shëndetësia e personalizuar

Në vitin 2025, inteligjenca artificiale nuk qe më koncept abstrakt apo një teknologji e largët që u përket vetëm laboratorëve kërkimorë dhe kompanive të mëdha teknologjike. Ajo është bërë pjesë e përditshmërisë njerëzore, duke ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si njerëzit kujdesen për shëndetin, si e kuptojnë trupin dhe mendjen, dhe si e konceptojnë mirëqenien personale. Nga spitalet më të avancuara deri te telefonat inteligjentë dhe orët që njerëzit i mbajnë në dorë, AI-ja po e zhvendos fokusin e kujdesit shëndetësor nga reagimi ndaj sëmundjes, drejt parashikimit, parandalimit dhe trajtimit të personalizuar.

Mediat prestigjioze botërore gjatë tërë vitit 2025 kanë raportuar gjerësisht se transformimi që po ndodh nga inteligjenca artificiale po shënon kthesë historike në shëndetësi dhe në stilin e jetesës.

“The New York Times”, 2025-tën e ka përshkruar si momentin kur “kujdesi shëndetësor fillon të ndodhë përpara se pacienti të ndihet i sëmurë”, ndërkohë që “The Economist” ka vënë në dukje se inteligjenca artificiale po e zhvendos mjekësinë nga një sistem i përgjithshëm, në një sistem të ndërtuar rreth individit.

Nga këshillat për ushqim dhe aktivitetet fizike, te diagnostikimi i herëshëm i sëmundjeve serioze, AI-ja po ndërton një ekosistem të ri ku shëndeti nuk menaxhohet vetëm në zyrën e mjekut, por 24 orë në ditë, në jetën reale të njerëzve.

Fundi i këshillave të përgjithshme

Për dekada me radhë, këshillat për shëndetin kanë qenë të përgjithshme: hani shëndetshëm, bëni aktivitet fizik, flini mjaftueshëm.

Por raportimet e fundit nga BBC dhe “The Guardian” theksojnë se kjo qasje po konsiderohet gjithnjë e më e pamjaftueshme. Trupi i njeriut nuk është një model i vetëm, dhe ajo që funksionon për njërin, mund të mos funksionojë për tjetrin.

Në vitin 2025, inteligjenca artificiale u përdor për të analizuar të dhëna personale si gjenetika, historia mjekësore, niveli i stresit, cilësia e gjumit, ritmi i zemrës dhe aktiviteti fizik, për të ofruar këshilla të personalizuara.

Këto të dhëna mbledhen kryesisht përmes pajisjeve si orët inteligjente,

unazat biometrike dhe sensorët e shëndetit, të cilat tashmë janë bërë pjesë e jetës së përditshme për miliona njerëz.

Sipas “Financial Times”, kjo ka çuar në lindjen e një koncepti të ri: mirëqenia e drejtuar nga të dhënat. Nuk bëhet më fjalë për një dietë universale apo një plan standard ushtrimesh, por për rekomandime që ndryshojnë nga dita në ditë, bazuar në gjendjen reale të trupit.

Mjeku që nuk fle kurrë

Një nga zhvillimet më të rëndësishme të vitit 2025 është përhapja e asistentëve personalë të shëndetit të bazuar në AI.

“The New York Times” dhe “Forbes” kanë raportuar se këta asistentë digjitalë po shndërrohen në “bashkëjetues të padukshëm” të shëndetit të njerëzve.

Këta asistentë funksionojnë 24 orë në ditë, duke analizuar të dhëna nga kartelat mjekësore, analizat laboratorike dhe pajisjet e bartshme.

Asistentët mund të paralajmërojnë për rritje të rrezikshme të tensionit të gjakut, ndryshime në ritmin e zemrës apo shenja të hershme të lodhjes kronike.

Për njerëzit që vuajnë nga sëmundje kronike si diabeti apo hipertensioni, këto sisteme po shihen si një ndihmë e vazhdueshme që redukton nevojën për vizita të shpeshta në spital.

“Forbes” ka theksuar se këta asistentë nuk e zëvendësojnë mjekun, por e plotësojnë rolin e tij, duke ofruar kujdes të vazhdueshëm mes vizitave mjekësore.

Në shumë raste, ata dërgojnë sinjale

paralajmëruese që i lejojnë pacientët dhe mjekët të veprojnë më herët, përpara se situata të përkeqësohet.

Fundi i dietave të përgjithshme

Një tjetër fushë ku AI-ja po sjell ndryshime të mëdha është ushqyerja.

“The Guardian” dhe “The Economist” kanë raportuar se dietat standarde po humbin besueshmërinë, ndërsa po rritet interesi për plane ushqimore të ndërtuara mbi të dhëna biologjike individuale.

Aplikacione të reja përdorin inteligjencën artificiale për të krijuar plane ushqimore bazuar në analizat e gjakut, mikrobiomën e zorrëve, nivelin e sheqerit në gjak dhe stilin e jetesës.

Disa prej tyre integrohen me monitorë të vazhdueshëm të sheqerit, duke treguar në kohë reale se si një ushqim i caktuar ndikon në trup.

Sipas raportimeve të fundit të “Nature”, kjo qasje po ndihmon veçanërisht personat me diabet, mbipeshë ose probleme metabolike, duke i bërë zgjedhjet ushqimore më të informuara dhe më të sigurta.

Trajneri që përshtatet me trupin

Në botën e fitnesit, AI-ja po ndryshon mënyrën se si njerëzit bëjnë ushtrime.

Platforma dhe pajisje të avancuara analizojnë ritmin e zemrës, nivelin e lodhjes dhe rikuperimin muskullor për të përshtatur programet e ushtrimeve në kohë reale.

“Forbes” ka raportuar se këto sisteme po u ndihmojnë njerëzve të

shmangin dëmtimet dhe të arrijnë rezultate më të qëndrueshme.

Në vend të planeve fikse, ushtrimet bëhen dinamike. Nëse trupi është i lodhur, programi ndryshon. Nëse rikuperimi është i shpejtë, intensiteti rritet.

Kjo qasje po shihet si më e sigurt dhe më efektive, sidomos për njerëzit që nuk janë sportistë profesionistë.

Mbështetje pa stigmatizim

Një nga fushat më të ndjeshme ku AI-ja po luan rol në rritje është shëndeti mendor.

Media si BBC dhe “The New York Times” kanë raportuar se chatbotët e shëndetit mendor po përdoren gjithnjë e më shumë për të ofruar mbështetje të menjëhershme për stresin, ankthin dhe lodhjen emocionale.

Këto sisteme përdorin teknika të terapisë njohëse të sjelljeve dhe ofrojnë biseda të strukturuar, ushtrime frymëmarrjeje dhe teknika për menaxhimin e emocioneve.

Ato nuk e zëvendësojnë terapinë tradicionale, por për shumë njerëz shërbejnë si hap i parë, sidomos për ata që kanë frikë nga stigma ose nuk kanë qasje të lehtë te një profesionist.

Zbulimi i mëhershëm

Në spitalet dhe klinikat moderne, AI-ja po përdoret për të përmirësuar diagnostikimin.

Sipas “Nature” dhe “Financial Times”, algoritmet e inteligjencës artificiale tashmë janë në gjendje të analizojnë imazhe mjekësore si rezonanca magnetike dhe skanerët CT me

saktësi shumë të lartë.

Kjo ka çuar në zbulimin më të hershëm të sëmundjeve si kanceri, sëmundjet e zemrës dhe çrregullimet neurologjike.

Në shumë raste, AI-ja identifikon ndryshime që syri i njeriut mund t'i humbasë, duke ulur rrezikun e gabimeve diagnostikuese.

“Spitali në shtëpi”

Një tjetër trend i rëndësishëm është monitorimi i pacientëve në distancë.

Pajisjet e lidhura me AI-në u mundësojnë mjekëve të ndjekin gjendjen e pacientëve nga shtëpia, duke hequr nevojën për shtrime të panevojshme në spital.

“The Economist” e ka përshkruar këtë si “spitali që zhvendoset në shtëpi”.

Sfida, privatësia dhe roli i njeriut


Pavarësisht potencialit të madh, ka mjaft sfida.

Mediat prestigjioze kanë ngritur shqetësime për privatësinë e të dhënave, paragjykimet algoritmike dhe nevojën për mbikëqyrje njerëzore.

Ekspertët bien dakord se e ardhmja e shëndetit nuk është botë e drejtuar vetëm nga makinat, por bashkëpunim mes teknologjisë dhe profesionistëve të shëndetit.

Sipas tyre, bazuar në të dhënat e vitit 2025, inteligjenca artificiale nuk po e zëvendëson njeriun, por po e defiton shoqërinë ta rishikojë marrëdhënien me shëndetin.

Kujdesi shëndetësor po bëhet më parashikues, më personal dhe më i pranishëm në jetën e përditshme.



DOMINIMI I TEKNOLOGJISË

Nga çipat te chatbot-et: Si e përcaktoi Inteligjenca Artificiale vitin 2025

Nga investimet rekorde në çipa dhe qendrat e reja të të dhënave, te chatbot-et dhe robotët, Inteligjenca Artificiale në shumë mënyra ka përcaktuar vitin 2025. Storia në vazhdim ofron një vështrim se si tregjet, qeveritë dhe konsumatorët ndryshuan nga përparimi i shpejtë i AI-së dhe se çfarë do të thotë kjo në praktikë

DHJETOR 2025 - Besimi i investitorëve në inteligjencën artificiale përcaktoi rendin për tregjet globale që nga fillimi i këtij viti, duke i shtyrë aksionet e teknologjisë drejt kryesimit të indekseve globale.

“DeepSeek”, një model kinez me kosto të ulët i zhvilluar nga një ekip më i vogël me qëllim të zhvillimit të modeleve të mëdha të gjuhës (LLM), fitoi vëmendjen botërore fillimisht për përputhjen e performancës së sistemeve më të mëdha me çmime më të ulëta.

Pas kësaj konkurrence fshihej pyetja më e gjerë, se si kompanitë duhet të zgjerojnë dhe mbështesin infrastrukturën që e bën të mundur AI-në.

Robotët mjekësorë dhe industrialë të shfaqur në konferencën e teknologjisë “Vivatech” në Paris ilustruan fuqinë e procesorëve të rinj të aftë për të analizuar imazhe dhe të dhëna në kohë reale. Performanca e tyre mbështetet në çipat e projektuar nga Nvidia, që dominoi historinë teknologjike dhe financiare të vitit.

Vlera e tregut të Nvidias kaloi tre trilionë dollarë, duke e bërë atë një nga kompanitë më të vlefshme në histori dhe një shenjë se sa qendrore ishte bërë Inteligjenca Artificiale në ekonominë globale.

Hardueri i saj është i integruar në një gamë të gjerë teknologjish, nga laboratorët kërkimorë deri tek automjetet vetëdrejtuese, duke e shndërruar projektimin e çipave dhe ruajtjen e të dhënave në industri strategjike po aq jetësore sa energjia ose transporti.

Qeveritë reagues me investime dhe rregullore.

Në Britani, Nvidia premtoi miliarda për startup-e të reja të AI-së. Në të gjithë Evropën, politikëbërësit diskutuan përdorimin e energjisë, qasjen në të dhëna dhe koston mjedisore të gjeneratës së ardhshme të informatikës.

“Në të gjithë Evropën do të duhet të ndërtoni infrastrukturë të inteligjencës artificiale për të mbështetur startup-et dhe universitetet tuaja”, ka thënë Jensen Huang, themelues i “Nvidias”.

Kjo nevojë për kapacitet ishte e dukshme në të gjithë botën. Irlanda zgjeroi rrjetin e qendrave të të dhënave që u shërbejnë ofruesve globalë të cloudit dhe inteligjencës artificiale, ndërsa qeveritë, duke nisur nga Londra e deri në Seul futën rregulla të reja mbi furnizimin me energji, sistemet e ftohjes dhe kufizimet mjedisore.

Zgjerimi i industrisë i tërhoqi qeveritë në konkurrencë gjeopolitike.

Më 12 korrik 2025, presidenti Donald Trump rriti tarifatat për importet e gjysmëpërcësuesve të nivelit të lartë dhe teknologjive të tjera në 15 për qind, si pjesë e një përpjekjeje për të nxitur prodhimin vendas dhe për të zvogëluar varësinë nga furnizuesit e huaj.

Në përgjigje, prodhuesit e çipave në Japoni, Korenë e Jugut dhe Tajvan njoftuan plane për të zgjeruar prodhimin rajonal, ndërsa Kina rriti fondet për procesorët e vet për të zvogëluar varësinë nga furnizuesit e huaj.

Investimi në harduer ishte vetëm njëra anë e garës globale të inteligjencës artificiale. Tjetra ishte softueri: sistemet e projektuara për të shfrytëzuar atë fuqi.

OpenAI lansoi një sistem të aftë për të kryer kërkime të hollësishme dhe për të gjeneruar raporte të shkruara duke u mbështetur në tekst, imazhe dhe informacione online. Përderisa aftësitë u zgjeruan, inteligjenca artificiale u bë gjithashtu më personale.

“Është hera e parë që bota e jashtme përdor modelin tonë me O3. Dhe mund të shfletojë uebin, të skanojë tekst, imazhe, PDF shumë më tepër, t'i sintetizojë këto, të veprojë mbi to dhe të përgatisë një raport për ju”, ka thënë Sam Altman, themelues i “OpenAI”.

Sistemet e monitorimit të shëndetit përdorën gjithashtu inteligjencën artificiale për të matur presionin e gjakut dhe nivelet e oksigjenit.

E në tregti, ndihma e inteligjencës artificiale u tregua e dobishme edhe në luftën kundër falsifikimeve.

HOROSKOPI

Horoskopi Vjetor 2026

Një vit kthesash të fuqishme dhe fillimesh të reja

Horoskopi i vitit 2026 shënon një vit ndryshimesh të mëdha, përballjesh personale dhe përparimesh të shumëpritura për çdo shenjë të zodiakut.

Eklipsët, retrogradët dhe lëvizjet e rëndësishme planetare ju ftojnë t'i lini pas identitete të vjetra, të jetoni të vërtetën tuaj dhe të merreni me atë që ka vërtet rëndësi për ju.

2026-a nuk është një vit për nxitim, por për hapa të vetëdijshëm, rritje dhe ndërtimin e një të ardhmeje që ndihet thellësisht e përputhur me shpirtin tuaj.



Dashi (21.03 – 19.04)

Ky është viti juaj i qartësisë së plotë mendore dhe emocionale, si edhe i marrjes së kontrollit mbi jetën tuaj. Bashkimi i Saturnit me Neptunin largon iluzionet dhe ju ndihmon të shihni qartë çfarë ju ka penguar deri tani: histori të vjetra, modele toksike apo edhe njerëz që nuk ju shërbejnë më. Hëna blu e majit ju jep një shans të dytë për një kurs apo një udhëtim që dikur nuk mund ta përballoni. Në tetor, retrogradi i Venusit zgjon intuitën dhe fuqinë tuaj psikike. Nëse mund ta ëndërroni, mund ta realizoni më 2026.



Demi (20.04 – 20.05)

Ky është viti juaj i shërimit të thellë dhe i mençurisë së fituar. Ju keni kaluar stuhi të forta dhe tani Urani bën daljen e tij përfundimtare nga shenja juaj në prill, duke u lënë me drejtim dhe fokus të qartë. Një kthesë e fuqishme vjen në qershor, kur Chironi hyn në shenjën tuaj. Ajo pjesë e vetes që e keni fshehur ose e keni menduar si të “thyer”, tani po shërohet me forcë dhe guxim të ri.



Binjakët (21.05 – 20.06)

Ky është viti juaj i lidhjeve familjare dhe i ngritjes së zërit. Janarin e nisni duke u ndier të kufizuar nga role dhe detyrime të vjetra që nuk ju lejojnë të shpreheni plotësisht. Në prill, Urani sjell lehtësim dhe liri, duke ju ndihmuar ta rimerrni pavarësinë dhe të jetoni sipas rregullave tuaja. Me hyrjen e Jupiterit në zonën e komunikimit gjatë mesit të vitit, fjala juaj bëhet e fuqishme. Ju flisni për atë që ju prek shpirtin dhe të tjerët ju dëgjojnë - madje ju respektojnë.



Gaforria (21.06 – 22.07)

Ky është viti juaj i dijes dhe i eksplorimit sensual. Merkuri zgjeron horizontet tuaja dhe ju shtyn drejt udhëtiveve, por ju kërkoni më shumë sesa thjesht eksperiencë sipërfaqësore. Ju ushqeni mendjen përmes librave dhe kurseve. Jupiteri ju mbron dhe ju sjell rritje gjatë gjysmës së parë të vitit. Kur largohet në mes të vitit, ju merrni me vete pak nga fati i tij. Me vetëbesim të ri, ju merrni rreziqe më të mëdha dhe e shijoni këtë ndjesi.



Luani (23.07 – 22.08)

Ky është viti juaj i mundësive të arta dhe i realizimit të potencialit tuaj. Në qershor, Jupiteri hyn në shenjën tuaj për herë të parë pas 12 vjetësh, duke sjellë një nga ndryshimet më të mëdha të dekadës. Mundësitë shtohen, ju e keni në dorë fatin dhe dyert hapen. Por mos u rehato shumë. Jupiteri shpërblen guximin, ndaj dilni përpara, shkëlqeni dhe udhëhiqni. Retrogradi i dhjetorit ju ndihmon të planifikoni hapin tuaj të radhës.



Virgjëresha (23.08 – 22.09)

Ky është viti juaj i transformimit. Eklipsi hënor në shenjën tuaj sjell një transformim të plotë të imazhit. Ju ndryshoni stilin personal, por edhe do ta ndryshoni veten. Vetja juaj autentike po rrezaton nga brenda. Mënyra se si prezantoheni - qoftë ju apo marka juaj - bëhet magnet për suksesin që ju pret në 2026.



Peshorja (23.09 – 22.10)

Ky është viti juaj i rritjes personale dhe i festimeve. Muajt e parë kalojnë qetë, sikur gjithçka ecën vetë. Në prill, hëna e plotë sjell festime për një arritje apo një pasion të ri emocionues. Magjia dhe praktikat mistike mund të bëhen pjesë e jetës suaj. Në nëntor, Venusi ju dhuron bukuri dhe shkëlqim, por transformimi kërkon edhe pak pushim paraprakisht. Në dhjetor, jeni gati të ndriçoni.



Akrepi (23.10 – 21.11)

Ky është viti juaj i kërkimit shpirtëror dhe thellësisë emocionale. Jupiteri në gjysmën e parë të vitit ju largon nga njerëzit sipërfaqësorë dhe shpërqendrimet boshe. Ju kërkoni kuptim të vërtetë. Në tetor, Merkuri ju drejton drejt një pasioni të ri emocionues. Magjia dhe praktikat mistike mund të bëhen pjesë e jetës suaj. Në nëntor, Venusi ju dhuron bukuri dhe shkëlqim, por transformimi kërkon edhe pak pushim paraprakisht. Në dhjetor, jeni gati të ndriçoni.



Shigjetari (22.11 – 21.12)

Ky është viti juaj i urtësisë dhe i shanseve të dyta. Eklipsi i shkurtit ju mbush mendjen me ide brilante. Retrogradi i Plutonit nxjerr në dritë një sekret, por çlirimi vjen nga e vërteta. Hëna blu e majit ringjall sfida të vjetra me imazhin trupor, por këtë herë ju bëni paqe me veten. Jupiteri në gjysmën e dytë të vitit ju çon në një aventurë ëndërrash ose në një udhëtim përmes librave dhe dijes. Jeta bëhet më e bukur.



Bricjapi (22.12 – 19.01)

Ky është viti juaj i rilindjes. Saturni ju mëson se heshtja dhe vetmia janë forca juaj e fshehtë. Ju përpunoni mësimet e vitit të kaluar dhe vendosni drejtimin e ri. Shkrimi i ditarit bëhet terapeutik ndërsa tabelat e vizionit shndërrohen në plan veprimi. Hëna blu e majit ju gjen larg stresit, pranë natyrës. Në fund të vitit, ju dilni të ndriçuar dhe të fokusuar si kur- rë më parë.



Ujori (20.01 – 18.02)

Ky është viti juaj i dorëzimit dhe i ndjekjes së rrugës së vërtetë të jetës suaj. Shkurti mund t'ju bëjë të ndiheni sikur po flisni, por zëri juaj nuk dëgjohet ende. Prisni deri në prill, kur Hëna e re do t'ju japë fuqinë dhe guximin për ta shprehur atë që ndieni. Eklipsi në shenjën tuaj sjell fillime të rëndësishme dhe fatlume, duke shembur gjithçka që nuk funksionon më në jetën tuaj, dhe duke hapur rrugën për të rindërtuar një bazë të fortë dhe të qëndrueshme. Nga korriku, busulla juaj e brendshme ose drejtimi i vërtetë i jetës suaj do ta ndriçojë rrugën, duke ju udhëhequr drejt vendimeve dhe mundësive që janë në përputhje me shpirtin dhe qëllimet tuaja. Lejoni që kjo rrugë t'ju udhëheqë me besim, edhe nëse nuk shihni që gjitha shenjat menjëherë.



Peshqit (19.02 – 20.03)

Ky është viti juaj i guximit dhe i korrigjimit të kursit. Eklipsi në shenjën tuaj ju jep fokus të fortë mbi të ardhmen. Hëna e re e marsit sjell një fillim të freskët dhe rindërton vetëbesimin tuaj. Mund të lëkundeni pak, por ecni me hapa të vegjël dhe besoni intuitës suaj, veçanërisht në shtator. Në dhjetor, jeni saktësisht aty ku dëshironi të jeni.

VITI I FUTBOLLIT

Nuk ka asnjë dilemë që 2025-ta ishte vit i futbollit, përkatësisht i përfaqësueses së Kosovës në futboll.

Ka shumë arsye për këtë.

Me dy fitoret ndaj Islandës në mars, “Dardanët” avancuan nga Liga C në Ligën B të Ligës së Kombeve. Kosova për herë të parë do të garojë në Ligën B, që është niveli i dytë i Ligës

së Kombeve të UEFA-s.

Në vjeshtë, Kosova fitoi dy herë ndaj Suedisë, ndërsa me Slloveninë kishte një fitore e një barazim. Barazim i mori edhe Zvicrës dhe falë 11 pikëve përfundoi e dyta në Grupin B të kualifikimeve të rregullta për Kupën e Botës 2026.

Ishte ky sukses historik, përkatësisht bindshëm më i madhi deri më tani. Kosova e siguroi paraqit-

jen në plejofin kualifikues për Botëror. Më 26 mars në gjysmëfinale përballet me Sllovakinë.

Vitin 2025, Kosova e nisi në pozitën e 99-të në ranglistën e FIFA-s. E përfundoi në pozitën e 80-të, që është më e mira ndonjëherë.

Dhe përparimi prej plot 19 pozitave është më i madhi që ndonjë përfaqësuese e ka bërë gjatë vitit 2025.

Shqipëria e mposhti Serbinë në Leskovc, dhe njëjtë si Kosova, ka siguruar për herë të parë plejofin për kualifikim në Botëror.

Drita e Gjilanit dhe Shkëndija e Tetovës kanë siguruar avancimin nga faza e ligës në fazën nokaut të Ligës së Konferencës.

Ka edhe plot arsye të tjera që vitin 2025 e bëjnë VIT TË FUTBOLLIT.



Arkitekti Foda tregon sekretet e suksesit të Kosovës

Arsim Maxhera

PRISHTINË, DHJETOR - Franco Foda e di se për suksesin e një ekipi të futbollit duhet të plotësohen shumë kushte.

Por përfundimisht Foda është prej arsyeve kryesore që përfaqësuesja e Kosovës në futboll po e kalon momentin më të mirë të saj.

Gjermani Foda e mori drejtimin e Kosovës më 17 shkurt të vitit 2024. Pas periudhës testuese, 59-vjeçari e vendosi ekipin në “binarët e duhur”. Dhe sukseesi i Kosovës nuk ka të ndalur.

Viti 2025 ishte bindshëm më i miri i Kosovës deri më tani. Foda ka gjetur “kodin” për sukses, ka kontrollin mbi ekip, ka përkrahjen e plotë të opinionit, federatës e lojtarëve dhe rezultati është ai që synohet.

Në një intervistë për KOHËN, Franco Foda ka treguar se i ka besuar potencialit të përfaqësueses së Kosovës. Por ai e di që vetëm potenciali nuk mjafton.

“Paraprakisht e kam studiuar plotësisht ekipin nacional të Kosovës dhe isha i bindur për potencialin e madh. Megjithatë aftësitë teknike dhe taktike nuk janë të mjaftueshme për sukses. Intensiteti, hierarkia, forca mentale, entuziazmi, komunikimi i qartë dhe korrekt, shpirti ekipor dhe mentaliteti fitues janë faktorë vendimtarë për sukses. Sukseesi vjen kur plani i lojës, tipi i lojtarëve dhe karakteri i ekipit përputhen. Detyra jonë ishte të gjejmë lojtarët e duhur për idetë tona dhe për ekipin”, ka thënë Foda.

Hierarkia e duhur vlerësohet se ka munguar në të kaluarën. Komunikimi i qartë dhe korrekt po ashtu. Foda mori disa vendime, disa goxha të vështira – si ai për dënimin e tre prej lojtarëve kryesorë – që sollën disiplinën dhe atmosferën e duhur te Kosova.

Ai ishte njoftuar paraprakisht për cilësinë, mentalitetin, shpirtin e ekipit dhe strukturën e ekipit po ashtu. Para se të pranonte që ta drejtojë Kosovën, Foda mori informacion të rëndësishëm edhe për mjedisin e punës dhe kulturën.

I pyetur se cili ishte momenti vendimtar që ktheu përfaqësuesen në rrugën e suksesit, Foda u përgjigj: “Ne i shfrytëzuam ndeshjet miqësore



si mjet zhvillimi jo si ngjarje të bazuar në rezultate. Ju mund të njihni lojtarët vërtetë vetëm në stërvitje dhe ndeshje. Ne i analizuam ndeshjet miqësore në faza të ndryshme të lojës dhe nxorëm përfundime prej kësaj. Pastaj krijuam qartësi brenda ekipit kombëtar. Çdo lojtar duhet ta dijë se çka presim prej tij. Lojtari duhet ta dijë rolin dhe përgjegjësinë brenda ekipit kombëtar dhe duhet të respektojë rregullat. Qartësia dhe guximi për të thënë të vërtetën janë gjithashtu zhvillim. Ne mund të kemi sukses vetëm së bashku”.

Prej fitoreve të shumta, Foda i veçon tri.

“Në Murcia të Spanjës kundër Is-

landës, ne e përmbysemë rezultatit pasi ishim në disavantazh dhe siguruam fitoren 3:1. Kështu e siguruam ngjitjen në Ligën B të Ligës së Kombeve. Fitorja 2:0 në shtëpi kundër Suedisë ishte shumë e rëndësishme. Sidomos pas humbjes në Zvicër, ekipi tregoi karakter, shpirt dhe forcë mendore. Ekipi dëshmoi se mund ta përballojmë një humbje pa pasur dyshime në vetvete. Fitorja 2:0 në Slloveni përmes të cilës arritëm finalen e plejofit. Ekipi tregoi që mund të përballojë presionin që sjellin pritjet dhe rezultatet po ashtu”.

Me sukseset e arritura sidomos në vjeshtë, përfaqësuesja solli entuziazëm të madh në vend. Interesimi për lojtarët dhe për përfaqësuesen është

shumë i madh.

Foda është i vetëdijshëm për këtë. “Ekipi nacional nuk impresionoi vetëm në fushë gjatë vitit 2025. Solli edhe emocione të forta, si në fushë ashtu edhe në tribuna. Unë dhe i gjithë vendi mund të jemi vërtetë krenarë me këtë ekip nacional”, thotë Foda.

Ai e vlerëson shumë edhe përkrahjen e tifozëve.

Në fakt përfaqësuesja ka pasur përkrahje të madhe në çdo vend ku luajti. Sidomos në Lubjanë, ku dukej që Kosova ishte vendase e jo Sllovenia.

“Ne jemi shumë krenarë me tifozët tanë. Atmosfera në stadiume është e pabesueshme. Ndihet që po luajmë

vetëm ndeshje në shtëpi. Kur ekipi dhe tifozët qëndrojnë të bashkuar, diçka vërtet e veçantë mund të ndodhë”, ka shtuar përzgjedhësi Foda.

Kosova më 26 mars luan ndaj Sllovakisë në gjysmëfinale të plejofit për kualifikim në Botëror. Foda, natyrisht, ka nisur punën për ta përgatitur atë ndeshje. Puna e gjermanit dhe stafit të tij ka nisur menjëherë pas tërheqjes së shortit.

“Natyrisht ne tashmë kemi shikuar Sllovakinë. Shumë detaje të vogla në aspektin tekniko-taktik, të standardeve, të forcës mendore, shpirtit ekipor dhe qasjes do të luajnë rol të madh”, ka vlerësuar Foda.

© KOHA Ditore

Lëndimi që “solli” formacionin e historisë

Arsim Maxhera

PRISHTINË, DHJETOR - Kosova i nisi si më keq kualifikimet e rregullta për Kupën e Botës 2026. Më 5 shtator në Basel, “Dardanët” pësuan 4:0 nga Zvicra.

Në atë ndeshje, Kosova luajti me formacion goxha ofenziv. Por doli që mungoi balanci i duhur dhe Zvicra shënoi katër gola që në pjesën e parë për fitore bindëse në fund.

Ndeshjen e dytë Kosova e zhvilloi menjëherë më 8 shtator. Në “Fadil Vokrri” e mposhti Suedinë e mbushur me yje, me rezultatin 2:0.

Dhe një ndryshim i papritur në formacion, pak pa nisur ajo ndeshje, kishte ndikim jo të vogël në gjithë kampanjën.

Përzgjedhësi gjerman, Franco Foda, vendosi fillimisht për formacionin që u paraqit si 4-4-2. Mërgim Vojvoda, Lumbardh Dellova, Fidan Aliti e Dion Gallapeni u caktuan në mbrojtje, Leon Avdullahu e Elvis Rexhbeçaj në mesfushë, kurse Baton Zabërgja e Florent Muslija në krahë. Vedat Muriqi e Albion Rrahmani ishin në qendër të sulmit.

Një lëndim i Zabërgjës, në minutat e fundit para se të niste ndeshja, bëri që formacioni të ndryshonte. Në vend të Zabërgjës, Foda nuk aktivizoi sulmues tjetër krah. Por vendosi për mbrojtësin Ilir Krasniqi. Dhe kështu renditja në fushë në vend se 4-4-2 u bë 5-3-2 që në sulm shndërrohej në 3-5-2.



Befasi apo jo, formacioni më nuk ndryshoi. Kosova më nuk u mposht dhe kampanja kualifikuese për Botërorin 2026 u shndërrua në më të mirën ndonjëherë të Kosovës. Në grup “të vdekjes”, Kosova përfundoi e dyta dhe u kualifikua në plejof. Vendin në Botëror do ta kërkojë në mars.

“Pas lëndimit të Zabërgjës, selektori e ftoi Ermal Krasniqin që të ngrohej. Nuk ishte momenti më i lehtë për shtabin teknik. Dhe ndërkohë Foda, pasi u konsultua me ndihmësit e tij, vendosi për Ilir Krasniqin. Dhe ky ndryshim doli i qëlluar, përkatësisht

fitues”, ka thënë një burim i KOHËS brenda përfaqësueses.

Pas fitores ndaj Suedisë, Kosova më 10 tetor e priti Slloveninë në “Fadil Vokrri”. Sërish luajti me pesë lojtarë në vijën e fundit. Pati telashe për Kosovën, por ndeshja megjithatë përfundoi 0:0. Duke iu përmbytur vendosjes së njëjtë, Kosova fitoi 1:0 ndaj Suedisë në Goteborg më 13 tetor dhe ndaj Sllovenisë, 2:0, në Lubjanë më 15 nëntor. Ndërkohë në mbyllje të kampanjës kualifikuese, Kosova luajti 1:1 me Zvicrën në Prishtinë.

Zabërgja më nuk u kthye në përbërjen startuese, por mbetet lojtar i

rëndësishëm te Kosova.

Foda pritet t’iu përmbahet vendosjes së njëjtë edhe më 26 mars ndaj Sllovakisë në Bratislavë, në gjysmëfinale të plejofit kualifikues për Botëror. Prej parimeve kryesore në futboll është që ekipi fitues, në këtë rast sistemi, nuk ndryshohet.

Nëse të gjithë janë në dispozicion, gjasat janë të mëdha që Kosova të startojë me Aro Muriqin në portë, me Mërgim Vojvodën, Lumbardh Dellovën, Amir Rrahmanin, Albion Hajdarin e Dion Gallapenin në mbrojtje, Elvis Rexhbeçajn e Leon Avdullahun në qendër të mesfushës, Florent

Muslijen më të avancuar dhe Vedat Muriqin e Fisnik Asllanin në qendër të sulmit. Me këtë vendosje, përgjegjësi shtesë kanë Vojvoda e Gallapeni, që duhet të kujdesen për të mbuluar krahët kur ekipi është në mbrojtje, dhe të hedhen në sulm, po nga krahët, kur ekipi sulmon.

Megjithatë, kthimi i Edon Zhegrovës e ndonjë tjetri në formë, mund të sfidojë Fodën për të bërë ndonjë modifikim në formacion. Por gjasat për ndryshime të mëdha janë të vogla.

“Ne nuk po i dominojmë kundërshtarët, po mbrohemi fort dhe kemi tranzicion shumë të rrezikshëm. Mund të them që për herë të parë e kemi një identitet të lojës. Formacioni me të cilën po luan trajneri, 3-5-2, që po shndërrohet në 5-3-2, e ndonjëherë edhe në 5-4-1, po del i suksesshëm. Kemi krijuar një identitet të lojës dhe kjo po sjell sukses”, ka thënë Ismet Munishi, njëri prej trajnerëve më të vlerësuar në vend.

Natyrisht, sukseesi erdhi edhe për arsye të tjera, shumë më të mëdha. Ndër të tjera edhe për kontributin e të gjithë lojtarëve, rritjen e profesionalizmit në përfaqësuese e po ashtu për ardhjet e reja e cilësore si ato të Leon Avdullahut, Albion Hajdarit e Veldin Hoxhës.

Por ai ndryshim i papritur në formacion mbetet moment i rëndësishëm në rrugëtimin më të mirë të Kosovës deri më tani.

© KOHA Ditore

Majlinda e kërkuar edhe si trajnere, refuzon ofertë të majme nga Emiratet Arabe

Arsim Maxhera

PEJË, DHJETOR - Ekipi i trajnerëve të Kosovës në xhudo është rritur shumë. Pos në numër, ekipi i kryemjeshtrit Driton Kuka është rritur hovshëm edhe në cilësi. Pjesë e tij tashmë janë edhe dy kampione olimpike, Majlinda Kelmendi e Nora Gjakova.

Majlinda e Nora po marrin gjithnjë e më shumë përgjegjësi. Dhe po e përcjellin te të rinjtë përvojën e jashtëzakonshme që kanë në xhudo.

Majlinda ka nisur si trajnere pak muaj pasi i dha fund karrierës si xhudiste, në verën e vitit 2021. Tashmë ka përvojë disavjeçare, ndërsa puna e saj çmohet nga kryemjeshtri Kuka dhe xhudistët. Por jo vetëm në Kosovë, Majlinda si trajnere, vlerësohet. Ajo ka treguar se tashmë ka oferta për të punuar si trajnere e xhudos edhe në vende të tjera.

Majlinda është legjendë e xhudos dhe e sportit kosovar në përgjithësi. Kampionia olimpike nga “Rio 2016”, kishte oferta për të përfaqësuar vende të tjera edhe sa ishte xhudiste. Kishte refuzuar ofertë të majme nga Azerbajxhani.

Te trajnerët, lëvizjet janë më të zakonshme. Por Majlinda ka vendosur që të punojë në Kosovë.

Ajo ka treguar në një bisedë për KOHËN se si trajnere është pritur shumë mirë në botën e xhudos.

“Mirë shumë. Në fillim ka qenë vështirë derisa e kam gjetur rrugën si trajnere sepse është komplet punë tjetër. Pavarësisht që jam duke bërë xhudo, është krejt diçka tjetër të jesh trajnere e tjetër garuese. Mirëpo, në përgjithësi më kanë pritur mirë. Dhe si trajnere tani kam goxha respekt, kudo që shkoj. Ndoshta këtë e dëshmon fakti që edhe si trajnere kam oferta serioze prej shteteve të ndryshme. Një ndër to është edhe oferta prej Emirateve të Bashkuara Arabe. Realisht atje janë rrogat e ma-



jme. Rrogat shkojnë diku deri në 10-15 mijë euro. Por unë as nuk e kam diskutuar, as nuk kam dashur ta mendoj. Toni ka nevojë për mua, ka fëmijë këtu me të cilët jam e lidhur dhe kam dëshirë që ata të bëjnë rezultate”, ka treguar Majlinda.

Ajo ka edhe një arsye tjetër për të vazhduar të punojë në Kosovë.

“Në anën tjetër i kam edhe prindërit që kanë bërë vite dhe që si garuese nuk kam pasur shumë kohë të kalojë me ta. Kështu që, kam vendosur që edhe si trajnere të mbetem në Kosovë. Të ardhmes nuk i dihet por që tash jam këtu”, ka shtuar Majlinda.

Ajo ka bërë histori si xhudiste. Vlerësohet se ka hapur shumë dyer, ndërsa sukseset e saj kanë ndikuar

shumë që Kosova të pranohet në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar dhe në asociacionet tjera të sportit.

Që në debutim të Kosovës në Lojëra Olimpike, Majlinda fitoi medalje të artë. Ka edhe dy tituj të botës dhe një medalje të bronzitë botërore. Ndonëse është sfiduar seriozisht nga lëndimet, dhe atë për kohë të gjatë, Majlinda i ka edhe katër tituj të Evropës dhe shumë e shumë medalje nga ngjarjet e mëdha të xhudos.

Si trajnere, Majlinda ka përgjegjësi tjetër. Dhe ajo jo gjithnjë është e kënaqur me përkushtimin e të rinjve. Madje është kritike ndaj tyre.

“Po, është komplet ndjenjë ndryshe. Është përgjegjësi edhe kështu edhe si garuese. Ndoshta si

garuese e kam pasur më të lehtë sepse kam qenë shumë punëtore dhe e kam pasur një cak, një qëllim. Dhe për atë kam punuar. Ndërsa si trajnere, ndoshta në momente të caktuara kam vullnet më shumë unë sesa vetë garuesit, çka nuk është normale. Por tash, në këtë kohë që po jetojmë, edhe me fëmijët që kemi punë, është goxha vështirë për ta nxjerrë maksimumin nga ta. Është bërë njëfarë standardi i mirë i jetës në Kosovë, pavarësisht se ne vetëm ankohemi, dhe tash fëmijët i kanë të gjitha kushtet. Kanë çdo gjë dhe po t'i mundojmë pak më shumë, po ikin. Kështu që na duhet ta gjejmë njëfarë mënyre ndoshta t'i bëjmë 100 gjëra, për ta nxjerrë maksimumin në stërvitje

prej një fëmije. Kështu që, vështirë shumë, por jam shumë me fat. E kam thënë disa herë që kam prej kujt të mësoj. Jam shumë me fat që Toni është këtu dhe po të mos ishte Toni, do të ishte shumë, shumë më e vështirë”, ka theksuar Majlinda Kelmendi.

Ajo ndien se të rinjtë nuk e kanë përkushtimin e duhur për sukses në sport. Thotë se përkushtimi i sportistëve të rinj nuk mund të krahasohen me përkushtimin që e kishte ajo, dhe që e kanë ende Distria Krasniqi, kampionia tjetër olimpike, dhe Akil Gjakova, kampioni evropian.

Majlinda megjithatë i beson sistemit të punës dhe pret që Kosova të vazhdojë të prodhojë xhudistë cilësorë, me gjithë sfidat.

“Kjo sigurisht e bën punën tonë edhe më të vështirë. Por, rezultatet sigurisht që pas një kohe vijnë, si rezultat i sistemit të punës. Toni e di saktësisht çfarë dhe si ta bëj. Kështu që, me sistem të mirë të punës, nuk ka rrugë tjetër pos që pas disa vitesh të dalë diçka. Por realisht është goxha e vështirë, siç e thashë edhe më herët, edhe t'i motivosh fëmijët. Ka disa që vijnë këtu dhe janë shumë të talentuar, që ne llogarisim në ta, por që ata ndoshta nuk e dinë as vetë a duan sport apo shkollë. Apo asnjërin. Por ne nuk ndalemi. Toni nuk është që gjithë garuesit i ka pasur punëtorë. Ka pasur edhe garues që nuk kanë pasur talent, që nuk kanë qenë punëtorë aspak, dhe prej tyre ka nxjerrë sportistë kulminantë. Kështu që do të thotë se e kemi çelësin drejt suksesit”, ka thënë Majlinda Kelmendi.

Legjenda e xhudos nuk është e para që shpreh brenga për vendosmërinë e të rinjve që të merren seriozisht me sport. Por vlerësimi i saj ka peshë të madhe dhe duhet të merret seriozisht.

© KOHA Ditore

Me gjithë sfidat, xhudoja kosovare e mban nivelin superior

Arsim Maxhera

PRISHTINË, DHJETOR - Të arrihet niveli i lartë në sport është goxha sfidë. Por të mbahet niveli i lartë, dhe atë për kohë shumë të gjatë, është edhe më e vështirë. Ky parim nuk ndryshon asnjëherë.

Dhe xhudoja kosovare ka prekur majën dhe po qëndron atje. Ka qëndruar edhe gjatë vitit 2025, ndonëse sfidat nuk ishin të pakta.

Xhudistët, përkatësisht nxënësit e kryemjeshtrit Driton Kuka, kanë fituar edhe gjatë këtij viti medalje në ngjarjet më të mëdha. Kanë fituar medalje në Kampionat Botëror, në Kampionat Evropian, në garat Grand Slam e Grand Prix të xhudos dhe në garat e tjera. Dhe si shumë herë deri më tani, kanë fituar edhe medaljet e vetme për Kosovën në ngjarjet shumësportëshe.

Pse 2025-a ishte vit sfidues për xhudo?

Nora Gjakova, njëra prej sportisteve më të mira shqiptare në histori, garoi vetëm në fillim të vitit dhe më pas iu bashkua ekipit të trajnerëve. Laura Fazliu gjatë vitit ka pasur telashe me lëndime. Lëndime kishte edhe Akil Gjakova, por edhe xhudistët e tjerë, që nuk kanë prekur ende nivelin e Laurës dhe Akilit.

Kampionia olimpike, Distria Krasniqi, është dalluar edhe këtë vit. Ajo, ndër të tjera, fitoi medalje të argjendtë botërore dhe tjetër titull të Evropës. Për herë të parë në karrierë, Distria u paraqit në finale të Kampionatit Botëror për të rritur. Vitin e përfundoi e para në ranglistën botërore të kategorisë deri 52 kilogramë. Dhe është e dyta në ranglistën e të gjithë



xhudistëve dhe xhudisteve në botë. Distria mori pjesë në gjashtë ngjarje të mëdha dhe në të gjitha fitoi medalje.

“Ka qenë një vit shumë i mirë për mua. Është hera e parë që kam hyrë në një finale të Kampionatit Botëror për seniorë. E kam përsëritur për herë të tretë titullin e kampiones evropiane. Ka qenë një vit i mirë dhe shpresoj që edhe viti i ardhshëm të jetë kështu, edhe pse gjithmonë synimi im është të shpallej kampione botërore dhe evropiane. Të shohim. Ka qenë vit i mirë sepse në çdo garë që kam marrë pjesë, kam qenë medaliste, në podium, kështu që, jam e kënaqur”, ka thënë Distria për KOHËN.

Ajo për herë të gjashtë është shpallur nga KOHA si sportistja më e mirë në Kosovë.

Distrinë e dallon motivi i madh për suksese të reja kulmore. Në vitin 2026 e nis “sulmin” e vërtetë për medaljen e tretë olimpike, që do të ishte e jashtëzakonshme. Lojërat e ardhshme Olimpike Verore mbahen në vitin 2028 në Los Angeles.

“Prej vitit të ardhshëm, në mos

gaboj nga maji apo qershori, fillojnë të numërohen pikët olimpike, për normën olimpike ‘LA 2028’. Kështu që, normalisht, i marrim shumë më seriozisht garat, po ashtu edhe përgatitjet. Përgatitimi më fort dhe më specifikisht për çdo kundërshtarë. Kështu që është një vit shumë me rëndësi, jam duke ushtruar mirë, po përgatitem mirë dhe shpresoj pa lëndime. Dhe e di që do të kem performancë të mirë”, ka vazhduar Krasniqi.

Laura Fazliu ka garuar më pak këtë vit. Por po ashtu ka pasur sukses kulmor. Ishte e treta në Kampionatin Botëror që u mbajt në Budapest të Hungarisë në qershor. Fitoi medalje bronz edhe në Grand Prix të Austrisë në mars, ndërsa në Grand Slamin në Abu Dabi ishte e pesta. Por medalja botërore e bën të suksesshëm 2025-tën për Laurën.

Akil Gjakova nuk ka garuar që nga Botërori në qershor. Në garën më të famshme të xhudos, në Grand Slamin e Parisit, u rendit i dyti. Në Evropian ishte i shtati.

Nora Gjakova në Grand Slamin e Parisit u rendit e treta. Më nuk garoi

dhe nuk pritet të garojë.

Shpati Zekaj ka bërë një lëvizje të rëndësishme para duke u renditur i treti në Kupën Evropiane në Shkup. Në Grand Prix në Zagreb ishte i shtati. Medalje të bronzitë në Kupë Evropiane, në Sarajevë, fitoi Flaka Loxha, që në Zagreb ishte e pesta. Dardan Cena, Fationa Kasapi dhe disa të tjerë më të rinj janë ende në kërkim të shpërthimit në nivelin e të rriturve.

Medaljet nuk kanë munguar as në grupmoshat e reja. Më të vlefshmen e fitoi Enise Zijade. Ajo u rendit e treta në Festivalin Olimpik Evropian Veror për të Rinj që u mbajt në Shkup. Ishte medalja e vetme e Kosovës në këtë ngjarje, ku u përfaqësua me shumë garues në sporte të ndryshme.

Zijade i fitoi edhe dy medalje në Kupat Evropiane për juniorë. E bronzitë ishte në Kupën Evropiane në Shkup, ndërsa e argjendtë në Kupën Evropiane në Podgoricë.

“Synimi im për vitin 2026 është të bëhem kampione evropiane, por edhe kampione e botës për juniore”, ka thënë Zijade.

Ajo është e lumtur që mund të mësojë nga kampionet olimpike, me të cilat e ndanë sallën e njëjtë.

“Po, ndihem shumë me fat, me Majlindën sidomos. Kemi çfarë të mësojmë. Është gjë e jashtëzakonshme sepse të mëson shtë gjë e jashtëzakonshme sepse të mëson çdo gjë shumë mirë”, ka shtuar xhudistja e re pejane.

KOHA e ka vlerësuar suksesin e Enise Zijades, duke ia ndarë asaj çmimin e rëndësishëm “Majlinda Kelmendi” që jepet për frymëzim në sport.

Kryemjeshtri Driton Kuka po ashtu është i kënaqur me sukseset që janë arritur gjatë vitit 2025. Ai gjatë këtij viti ishte i fokusuar që të zgjerojë bazën, përkatësisht që të rritë numrin e xhudistëve të rinj e cilësorë. Kjo po bëhet gjithnjë e më e vështirë.

Prej vitit të ardhshëm Kuka e kthen fokusin te sigurimi i normave olimpike për “Los Angeles 2028”. Por rëndësi do të kenë edhe ngjarjet e mëdha, sidomos Botërori e Evropiani. Me punën që bëhet nga Kuka dhe ndihmësit e tij, të tjera medalje të mëdha priten për Kosovën.

© KOHA Ditore

Nënkampioni botëror mezi iu kthye karatesë pas dënimit nga federata

Faton Polisi

PRISHTINË, DHJETOR - Islam Selmani flet me shumë krenari për medaljen më të çmuar të fituar nga karateja kosovare.

Në fund të muajit nëntor ai fitoi medaljen e argjendtë në kategorinë deri 60 kilogramë në Kampionat Botëror.

Për 20-vjeçarin ishte debutim në Botëror.

Karateisti i talentuar refuzon të flasë shumë për atë që ndodhi tre vjet më parë. Në heshtje pranon se kishte bërë gabim të madh.

Gabimi e la një vit pa gara. Ai ishte përjashtuar nga të gjitha aktivitetet vendore dhe ndërkombëtare nga Komisioni Disiplinor i Federatës së Karatesë së Kosovës.

“E kam lënë prapa atë periudhë. I kam harruar të gjitha që kanë ndodhur. Tash shikoj vetëm para”, ka thënë Selmani.

Dënimin e mori katër muaj pasi kishte fituar medalje të artë në Evropianin për kadetë, juniorë dhe

grupmoshën U21, që ishte mbajtur në Pragë të Çekisë.

Islam Selmani, Elhami Shabani, Arlind Selmanaj dhe Benjamin Shabani u dënuan pas një incidenti që ndodhi në turneun memorial “Zahir Pajaziti”, të mbajtur më 18 shtator 2022 në Prishtinë.

Komisioni i federatës atëbotë kishte vlerësuar se dënimi për Islam Selmanin ishte minimal. Komisioni kishte marrë parasysh shumë rrethana lehtësuese duke pasur parasysh edhe formën e lartë sportive si dhe rezultatet e deriatëhershme, moshën e sportistit, sjelljet e tij të mëhershme në garat vendore dhe ndërkombëtare.

Karateisti me potencial kishte pranuar se kishte poseduar “brisk” të vogël në atë ngjarje.

Pas dënimit mezi ishte bindur t’u kthehej stërvitjeve në karate. Refuzimin e Selmanit që të kthehej në stërvitje e tregon sa herë që pyetet Isak Curri, trajner i tij.

“Këta e dënuan dhe ai ka vendosur ta lërë karatenë”, kishte thënë Cur-

ri më 3 nëntor të vitit 2022.

“Ajo tërheqje ka qenë motiv dhe shtytje për të punuar dy herë më shumë se që kam ushtruar atëherë. Shpallja kampion i Evropës më ka shtyrë para për të mos u ndalur”, thekson karateisti.

Bëri mirë që nuk u ndal. Selmani, i cili është anëtar i klubit AS-Prishtina nga Bardhoshi, është vlerësuar “sensation” i Botërorit. Ai arriti në finale të një kategorie shumë konkurruese, ndonëse në renditje ishte vetëm i 113-i. Ndër të tjera e mposhti karateistin numër një në ranglistën botërore.

“Rrugëtimi im deri te shpallja nënkampion bote ka qenë me sakrificë dhe mund shumë të madh. Nuk ka qenë e lehtë, pasi janë 32 më të mirët e kategorisë dhe jam krenar që kam arritur ta sjell këtë sukses në Kosovë. Në këtë vend të vogël të arrij ta sjell këtë sukses kaq të madh për mua është nder dhe krenari”.

Pas dy vjetësh karateisti i ri synon të bëhet kampion i botës.

“Për mua do të jetë motiv shtesë për

të ardhmen. Se ndoshta po ta merrja vendin e parë, nuk do të vazhdonim tutje. Për mua vendi i dytë është motiv për të vazhduar drejt medaljes së artë në Botëror. Ëndrra ime është të bëhem kampion bote. Synimi im është që pas dy vjetësh të bëhem kampion bote”, ka theksuar Selmani.

Ai tregon se ushtron nga dy herë në ditë për një garë të rëndësishme. Por premton se do ta rrisë edhe më shumë intensitetin e punës në të ardhmen.

“Deshëm apo nuk deshëm ne duhet ta rrisim intensitetin e punës, sepse kam qenë i 100-ti në ranglistë, kurse pas suksesit në renditjen botërore jam në vendin e 14-të. Tash na marrin më seriozisht kundërshtarët dhe kanë fokusin më shumë se që e kanë pasur”.

Selmani është i kënaqur me arritjet e deritashme. Por synon më shumë.

“I kënaqur jam pasi ka disa garues që kanë nisur herët karrierën por e kanë përfunduar pa arritur suksesin



tim. Jam vetëm 20-vjeçar dhe në botërorin e parë kam arritur në finale është krenari dhe sukses i madh”, ka thënë Islam Selmani.

Vite më parë medalje të bronzta për seniorë kanë fituar Herolind Nishevcu në Botëror dhe Elhami Shabani në Evropian. Por medalja e fituar nga Selmani në Egjipt mbetet arritja më e madhe ndonjëherë në sportin e karatesë.

Ronaldo e Zidane të Superligës së Kosovës

Dilaver Polisi

PRISHTINË, DHJETOR - Ronaldo Chacon ka pasur rastin që ta ndajë fushën me emra të mëdhenj të futbollit.

Në Kampionatin U20 të Amerikës së Jugut ku luajti me Venezuelën para nëntë vjetësh, është përballur me lojtarë si Lautaro Martinez i Argjentinës, Rodrigo Bentancur i Uruguait dhe Richarlison, David Neres, Gabriel Magalhaes, Douglas Luiz e Lucas Paqueta të Brazilit.

Ronaldo Chacon ka pasur rastin të përballtet edhe me Zidanen. Por jo legjendën franceze, Zinedine Zidane.

Ben Zidane është futbollisti që bën karrierë te Drita. Kurse Ronaldo Chacon është pjesë e Drenicës.

Të dy mbajnë emra legjendash të futbollit.

“Pasi kam luajtur me Përfaqësuesen U20 të Venezuelës, jam përballur me lojtarë që tani janë yje globalë dhe këtë e vlerësoj jashtëzakonisht shumë. Këto kujtime i mbaj me vete dhe më mbushin me krenari. Ndonjëherë, kur shoh ndeshje të mëdha me shoqëri, më kujtohet që e kam ndarë



të njëjtën fushë me shumë prej atyre lojtarëve dhe ma kujton gjithë rrugëtimin dhe përpjekjet që kam bërë”, ka thënë Ronaldo i Drenicës për KOHËN.

Më pas, me disponim të mirë e ka kujtuar edhe duelin me Zidanen e Dritës.

“Sa i përket duelit ‘Ronaldo vs Zidane’, ishte shumë i veçantë dhe argëtues. Kur i kam lexuar komentet e tifozëve me bashkëlojtarët, nuk mundeshim t’i ndalnim të qeshurat. Këto janë gjëra të vogla që e bëjnë futbollin kaq të bukur dhe ta kujtojnë pse e duam kaq shumë këtë sport – për pasionin e tifozëve dhe për momentet unike që i përjeton brenda dhe jashtë

fushës”, është shprehur 27-vjeçari.

Më 29 tetor, Drenica fitoi 3:1 ndaj Dritës. Ronaldo i realizoi dy golat dhe e përgatiti të tretin. Ben Zidane luajti te Drita, por pa lënë gjurmë.

Ronaldo dhe Zidane e kanë një të veçantë të përbashkët. Baballarët e tyre janë tifozë të mëdhenj të futbollit dhe të këtyre dy legjendave veçanërisht.

“Disa njerëz befasohen shumë që emri im është Zidane. Shpeshherë mendojnë se është nofkë. Por babai im ka qenë tifoz i madh i Real Madridit dhe i dashuruar në Zidanen në kohët kur ai luante futboll”, thotë mesfushori i Dritës, që është nga Bregu i Fildishtë.



Fjalë të ngjashme tha edhe Ronaldo.

“Kur u lindi, emri Ronaldo ishte shumë i njohur në atë kohë për shkak të legjendës botërore të futbollit, brazilianit Ronaldo Nazario. Babai im, i cili gjithmonë ka qenë tifoz i madh i futbollit, më ka emëruar për shkak të admirimit të madh që kishte për të. Për mua, është nder të kem emër kaq të rëndësishëm dhe çdo ditë më jep motivimin për ta dhënë më të mirën”.

Ronaldo Chacon iu bashkua “kuqezinjve” të Drenicës në verën e vitit 2025, ndërsa kontrata i skadon në qershorin e vitit tjetër.

Edhe Ben Zidane u transferua te Drita nga Bastia e Francës në verën e

2025-ës, me kontratë deri në vitin 2028.

“Nga ajo që më kanë thënë bashkëlojtarët, njerëzit në Skenderaj kanë folur shumë për arritjen time. Qëkur iu bashkova klubit, tifozët kanë qenë jashtëzakonisht të mirë me mua. Kur ecë nëpër rrugë, shumë njerëz vijnë dhe më përshëndetin, e madje edhe e thirrin emrin tim me zë të lartë. Kjo më bën të ndihem shumë mirë dhe e ndiej përkrahjen”, ka theksuar Ronaldo Chacon.

Ronaldo i Superligës karrierë ka bërë kryesisht në skuadra të Venezuelës. Jashtë shtetit të tij të lindjes ka luajtur vetëm edhe në Sllovaki.

Ardhjet e vitit

Endrit Makolli

PRISHTINË, DHJETOR - “Rritja” e Kosovës është realizuar edhe falë futbollistëve që erdhën gjatë vitit 2025 dhe sollën më shumë cilësi në ekip.

Janë mesfushori, Leon Avdullahu, dhe mbrojtësi i qendrës, Albjan Hajdari, që vlerësohen ardhje të vitit. Të dy lanë Zvicrën për t’iu bashkuar Kosovës.

Hajdari 22-vjeçar tashmë ka debu-

tuar për Zvicrën. Por pasi nuk luajti ndeshje garuese, e kishte të drejtën e ndryshimit të përfaqësueses. E shfrytëzoi këtë të drejtë, duke sjellë stabilitet shtesë në mbrojtjen “dardane”.

Ai debutoi te Kosova më 10 tetor, në barazimin pa gola me Slloveninë në Prishtinë. I komplotoi edhe ndeshjet që Kosova i fitoi me Suedinë dhe me Slloveninë në udhëtim. Ndërkohë përzgjedhësi Franco Foda e pushoi nga ndeshja e fundit me Zvicrën, nga

droja se do të ndëshkohej me karton të verdhë dhe kështu do të mbetej jashtë ndeshjes gjysmëfinale të plejofit.

Për arsye të njëjtë Foda e pushoi edhe mesfushorin Leon Avdullahu. 21-vjeçari luajti për të gjitha grupmoshat e Zvicrës dhe vlerësohej me potencial për ftesë te Zvicra A. Por vendosi për Kosovën.

Debutoi pikërisht ndaj Zvicrës, më 5 shtator në Basel, në humbjen 4:0 të Kosovës. Më pas komplotoi dy ndeshjet me Suedinë dhe dy të tjerat me Slloveninë. Avdullahu është i pazëvendësueshëm në mesfushë, bashkë me Elvis Rexhbeçajn, një tjetër ardhje cilësore, por e vitit 2024.

Ardhja gjatë vitit 2025 te Kosova dhe e kaluara te Zvicra nuk janë të përbashkëtat e vetme të Hajdarit e Avdullahut. Ata janë po ashtu në një skuadër – te Hoffenheimi i Bundesligës gjermane. Te kjo skuadër me shumë sukses luan edhe Fisnik Asllani, tashmë partner i Vedat Muriqit në sulm e Kosovës. Asllani ka debutuar te Kosova në vitin 2024.

Ardhje tjetër e rëndësishme gjatë vitit 2025 te Kosova është ajo e Veldin Hoxhës, që ishte pjesë e të rinjve të



Kroacisë. Ky mesfushor 23-vjeçar bën karrierë te Rubin Kazani në Rusi. Në hierarki të mesfushës është prapa

Rexhbeçajt e Avdullahut, por vlerësohet i rëndësishëm për ekipin përfaqësues.

Shpërthimi i vitit

“Llafet” që mund të vendosë për Shqipërinë, e afruan edhe më shumë Dion Gallapenin me përfaqësuesen e Kosovës në futboll. Dhe ai shpërtheu gjatë vitit 2025. Ishte lojtari që bëri përparimin më të madh nga të gjithë reprezentuesit. Ende vetëm 21-vjeçar, Gallapeni tashmë shihet i pakonkurrencë në pozitën e mbrojtësit të majtë. Ka treguar stabilitet, ndërsa merr pjesë edhe në lojën në sulm. Debutoi ndaj Islandës më 23 mars, kur fitoi pak minuta. Luajti pak edhe ndaj Armenisë e Komoreve në qershor, ndërsa ndaj Zvicrës më 5 shtator u aktivizua nga fillimi i pjesës së dytë.

Në pesë ndeshjet e tjera kualifikuese ishte titullar i padiskutueshëm, ndërsa shkëlqimi dhe ndikimi i tij ishte gjithnjë e më i madh.

Gallapeni realizoi lëvizje të rëndësishme edhe në nivel klubes. Në verë nga Prishtina u transferua te skuadra polake, Widzew Lodz. Por me paraqitjet aktuale, Lodzi mund të jetë vetëm stacion i përkohshëm për yllin e ri të Kosovës.

“Për ty babë” - rrëfimi i Berishajt, sportistja më e mirë në Malin e Zi

Arsim Maxhera

PRISHTINË, DHJETOR – Të shpallesh sportistja më e mirë e një qyteti apo e një federate është mburrje e madhe. Por të shpallesh më e mira e një shteti, madje me sport goxha të zhvilluar, është e veçantë.

Dhe 18-vjeçarja Andrea Berishaj është zyrtarisht sportistja më e mirë e Malit të Zi për vitin 2025. Është hera e parë që një shqiptare shpallet sportistja më e mirë e vitit në Malin e Zi. Ajo u shpall më e mira nga Komiteti Olimpik i Malit të Zi.

Berishaj merret me taekwondo dhe kishte tri rezultate kulmore gjatë vitit 2025.

“Nëse dikush do të më thoshte në fillim të vitit se do të shpallem sportistja më e mirë në Mal të Zi, do të qeshja sikur të thoshte ndonjë humor të mirë. Mirëpo gjatë vitit vazhdimisht nëpër garat ndërkombëtare G1, të vlefshme për renditje botërore, kam pasur rezultate të mira. Fitova medalje të artë në turneun G1 në Zvicër dhe fillova të fitoja vetëbesim”, ka thënë Andrea Berishaj në një bisedë për KOHËN.

Në tetor ajo mori pjesë në Botërorin e të rriturve dhe u rendit e nënta. Ai rezultat e motivoi edhe më shumë.

“Mezi prita që të marr pjesë në Kampionatin Evropian për seniorë në Zvicër, duke shpresuar se kësaj here mund të arrij deri te medalja. Dhe kështu edhe ndodhi, arrita në gjysmëfinale dhe fitova medalje të bronzit. Ishte realizim i ëndrrës dhe kalim i presionit që e kisha. Më e qetë i prita garat e radhës, por sërish me vullnet dhe dëshirë që të jap maksimumin. Erdhën edhe dy suksese madhështore. Fillimisht në Keni u rendita e treta në Botërorin U21 e më pas në Prishtinë fitova tjetër medalje të bronzit në Evropianin U21. Këto suksese erdhën pas shumë sakrificave dhe punës së madhe shumëvjeçare, duke derdhur gjak e djersë. Dhe pas këtyre sukseseve kam pritur që të shpallem më e mira”, ka pranuar Berishaj.

Familja Berishaj është nga Malësia, ndërsa jeton në Tuz. Në qytetin shqiptar në Mal të Zi edhe kanë nisur karrierën motrat Berishaj. Fillimisht ishin te klubi Besa, ndërsa tani janë në një klub nga Podgorica.

Andrea nuk është e madhja nga motrat. Para saj me taekwondo nisi Angjela Berishaj, që po ashtu kishte suksese kulmore. Në vitin 2022 ishte sportistja e re më e mirë në Malin e Zi, falë vendit të dytë në botë për juniore. Por Angjela ka pësuar një lëndim të rëndë të gjurit dhe është duke e sanuar atë.

Andrea Berishaj është e kënaqur

me sukseset e deritashme. Por thotë se ky është vetëm fillimi i rrugëtimit.

“Nuk dëshiroj që të ndalem këtu. Qëllimi im është që të vazhdoj me punë edhe në të ardhmen. E di që duhen shumë punë, sakrificë, djersë. Shpresoj që nga fillimi i vitit 2026 do të më bashkohet edhe motra, Angjela, e cila ishte idoli im. Ajo e hapi rrugën e sukseseve duke u shpallur nënkampione botërore për juniore. Fatkeqësisht ajo vitin e kaluar pati një lëndim të rëndë dhe tani është në rrugën drejt kthimit. Ajo tregon vullnet të jashtëzakonshëm që të kthehet aty ku e ka vendin, në elitën botërore të taekwondos. Vullneti i saj më jep fuqi edhe mua. Më shtyn përpara. E pres momentin kur së bashku do të sulmojmë nivelet më të larta të sportit. Edhe motra e vogël, Adriana, po e nis rrugën e saj në konkurrencën e junioreve”, ka treguar Andrea Berishaj.

Motrat Berishaj e kanë përkrahjen maksimale të familjes, përkatësisht të prindërve. Edhe shpenzimet, që nuk janë të vogla, deri më tani kryesisht janë mbuluar nga familja.

Andrea tregon se në Evropianin U21 në Prishtinë ka kaluar shumë mirë. Ajo ka bashkëpunim me disa prej taekwondistëve të Kosovës, ndërsa thotë se Evropiani u organizua shumë mirë.

Garuesja e re ndien se taekwondoja nuk e ka respektin që si sport olimpik e meriton në opinionin sportiv. Por shpreson se kjo do të ndryshojë ndërkohë.

Pos në tatami, Andrea dallohet edhe në shkollë. Ka treguar që është nxënëse e shkëlqyer në vitin e katërt në gjimnaz, ndërsa pos taekwondos, planifikon të vazhdojë edhe shkollimin.

Lojërat olimpike “Los Angeles 2028” janë synim për shumicën e sportistëve në botë.

“Po, do t’i shihni motrat Berisha në lojërat olimpike “LA 2028”. Është rruga jonë të cilën duam ta shkelim. I lutem Zotit të kemi shëndetin, të na ruajë nga lëndimet, kurse puna, sakrifica, djersa, gjaku nuk do të mungojnë”, ka premtuar Berishaj.

Ajo thotë se është ndjenjë e mirë të jesh pjesë e një familjeje me plot taekwondistë. Garat, sfidat, pajisjet, stërvitjet, kundërshtarët janë temë e përditshme në familjen Berishaj.

“Mendoj se Tuzi dhe e gjithë Malësia krenohen me sukseset tona. Ndoshta në fillim në raste edhe nuk na morën shumë seriozisht, mirëpo kur filluan sukseset në nivel evropian e botëror atëherë të gjithë e kuptuan se sukseset tona kanë kuptim më të madh. Malësia ndoshta është e vogël, por gjithnjë në histori ka qenë

e madhe. Djemtë dhe vajzat e Malësisë me krenari e rrisin emrin e regjionit nëpër botë. Besoj që edhe çdo fitore e jona i bënë bashkëvendësit tanë krenarë me ne”.

Babai i motrave Berishaj e shfaq me krenari një brez të taekwondos, ku shkruan “për ty babë!”. Andrea e ka edhe një tatuazh në dorë me këtë shkrim.

“Shkrimi ‘për ty babë!’ në brezin tim i kushtohet gjithë tim, të cilin me motrat dhe vëllai i vogël, e kemi thirrë ‘babë’. Ai ndërroi jetë para dy vjetësh. Ai është kujdesur shumë që të na ruajë neve si fëmijë dhe na ka ofruar dashuri të madhe në çdo hap të fëmijërisë sonë. Çdo përqafim i tij, çdo buzëqeshje, çdo fjalë me plot ngrohtësi, na rriti dhe na drejtoi në jetë. U kujdes që të mos na mungonte asgjë. Çdo fitore e jona është për ta nderuar emrin e tij. ‘Për ty babë!’, e shkrova vjet para fillimit të luftës finale në Grand Prix, që ishte më e madhja deri atëherë. Fitova dhe fitoren ia kushtova gjithë tim ndjerë. Më vonë këtë fjalë e bëra tatuazh në dorë, që të mos e harroj kurrë se kush jam dhe mbesa e kujt jam. Ne mbesat e Nikollë Dokë Berishajt do të jemi në Lojërat Olimpike. Dhe ne do të luftojmë në skenën më të madhe për të”, ka thënë sportistja më e mirë e Malit të Zi.



Granit Xhaka ishte prej lojtarëve kryesorë të Bayer Leverkuseni. Papritmas, në pranverë nisën raportimet për largimin e tij nga nënkampioni gjerman. Për mesfushorin kishte interesim nga shumë vende, ndërsa Xhaka në verë vendosi për klubin e kthyer në Premier Leaguen e Anglisë, Sunderlandin. Doli të jetë lëvizje shumë e qëlluar – më e qëlluar e futbollistëve shqiptarë gjatë vitit 2025.

Xhaka e mori menjëherë shiritin e kapitenit të Sunderlandit, ndërsa në vjeshtë e udhëhoqi skuadrën në fushë drejt rezultateve shumë të mira. Shumë njohës të futbollit në Angli vlerësuan se kalimi i Xhakës të Sunderlandit ishte transferimi më i mirë i verës në Premier League. Në moshën 33-vjeçare, Graniti po paraqitet me shumë sukses në kampionatin shumë kërkuar të Anglisë.



Shqiponja e vitit

Më 11 tetor 2025, në Leskovc, Serbia e Shqipëria luajtën ndeshje vendimtare në kuadër të kualifikimeve për Kupën e Botës 2026 në futboll. Kugezinjtë fituan 1:0 në stadiumin “Duboçica”, për festë të madhe të shqiptarëve në gjithë botën. Skenat e festës së zjartrtë në çdo vend ku ka shqiptarë bënë bujë.

Golin e fitores madhështore e shënoi Rey Manaj në fund të pjesës së parë. Dhe Manaj, përnjëherë, nga lojtar i kritikuar dhe i fyer për shkak të humbjes së penaltisë në ndeshje me Serbinë në Tiranë, u shndërrua në hero të shqiptarëve. Ai festoi duke formuar figurën e shqiponjës me të dy duart.

Shqipëria, kryesisht falë asaj fitoreje, e siguroi plejofin për kualifikim në Botëror. Ndërkohë Serbia mbeti e treta në grup dhe jashtë Botërorit e jashtë plejofit.

PUBLIC



FTESË PËR OFERTË

– Shërbime për Matjen e Kënaqësisë së Stafit (eNPS) dhe Pulsit të Punonjësve –

Ref. RFO-057-12-2025

- I. Autoriteti kontraktues:** Banka për Biznes Sh. A.
- II. Lënda e kontratës:** “Shërbime për Matjen e Kënaqësisë së Stafit (eNPS) dhe Pulsit të Punonjësve”
- III. Procedura e përdorur:** E hapur
- IV. Kushtet e ofertimit:**
 - a) Afati kohor dhe vendi i dërgimit të ofertave:
 - Afati i fundit për dërgimin e ofertës është data **15 janar 2026** deri në ora **14:00**
 - Oferta duhet të dërgohet në formë elektronike në email adresën prokurimi@bpbbank.com

Vërejtje:

- Kompania ofertuese duhet të dërgoj dokumentacionin e nevojshëm ligjor – Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit, Çertifikatën e TVSH-së dhe Çertifikatën e Numrit Fiskal.
- Banka për Biznes është deklarues i TVSH-së. Të gjitha çmimet e ofruara nga ofertuesit të cilët janë deklarues të TVSH-së duhet që ta listojnë ndarësi vlerën e TVSH-së. ndërsa ofertuesit që nuk janë deklarues të TVSH-së (bëjnë shitje të përjashtuar nga TVSH-ja), nuk duhet të listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së.
- Për çmimet të cilat nuk e kanë të listuar TVSH-në ndarazi, do të nënkuptohet se vlera e TVSH-së është e përfshirë brenda çmimit.
- Çmimet duhet të kuotohen në Euro.
- Kompania ofertuese duhet të paraqesë referencat e saja për shërbime të ngjashme.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë katër muaj (120 ditë) nga dita e dërgimit.
- Oferta duhet të dërgohet në gjuhën shqipe.
- Banka për Biznes ka të drejtë që të anuloi tenderin dhe/ose të ndryshoj karakteristikat e tenderit dhe t’i ftoj sërish kompanitë që të i sjellin prapë ofertat tyre.
- Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

Dokumentet për aplikim mund të kërkohen nga data **30 dhjetor 2025** në email adresën prokurimi@bpbbank.com dhe atë çdo ditë pune gjatë orës 10:00-15:00.

2026

SHTOJCË: GRATË NË PASQYRË 2025



PËRGATITUR NGA:



NGA PASIGURIA GLOBALE TE INICIATIVAT QYTETARE: ÇFARË NA MËSOI 2025?



Shkruan: Brikena Berisha, Drejtore e
Hulumtimit, IKS

Vitin 2025, mund ta kujtojmë si një vit të gjatë, bazuar në peshën e ngjarjeve që e kanë formësuar atë që në ditët e para. Që në fillim të vitit, zhvillimet globale dhe ato lokale janë ndërlidhur në mënyrë të pandashme, duke krijuar një klimë pasigurie, reflektimi dhe ripozicionimi shoqëror. Krizat e vazhdueshme, ndryshimet politike, tensionet ekonomike dhe debatet mbi të drejtat themelore, kanë rikthyer pyetje thelbësore mbi barazinë, demokracinë dhe rolin e grave në shoqëri.

Në periudha të tilla ndryshimesh, pasojat sistemike nuk shpërndahen në mënyrë të barabartë. Ato bien në përmasa disproporcionale mbi grupet më të cenueshme të shoqërisë, nisur nga gratë, të cilat shpesh përballen njëkohësisht me pabarazi strukturore, pasiguri ekonomike dhe kufizim të hapësirës për pjesëmarrje aktive dhe vendimmarrje. Në këtë kontekst, ky shkrim redaktues e trajton vitin 2025 nga perspektiva e një analize kritike, duke rikthyer vëmendjen te zhvillimet kyçe dhe duke shqyrtuar se si ato po formësojnë realitetin aktual dhe po orientojnë drejtimitet e së ardhmes, si në plan global ashtu edhe në atë lokal.

Fundviti gjithmonë ofron një mundësi për të bërë bilanc më të gjerë dhe lejon të vlerësohen ndryshimet dhe intervenimet në fusha të ndryshme, duke ofruar një "skenim" të qartë dhe të mirëfilltë të realitetit aktual. Në këtë kontekst, Glass Ceiling Index (GCI) i The Economist paraqet një instrument kyç për të matur barazinë gjinore në tregun e punës, duke evidentuar sa janë reale mundësitë e grave për trajtim të barabartë në vendet e OECD-së. Të dhënat më të fundit tregojnë se progresi mbetet i pabarabartë: vendet nordike, me Suedinë në krye, vazhdojnë të jenë shembuj globalë falë kombinimit të arsimit të lartë për gratë, politikave gjithëpërfshirëse të lejes prindërore, fleksibilitetit në punë dhe përfaqësimit të lartë në pozita drejtuese. Ndërkaq, disa ekonomi të zhvilluara, si Japonia, Turqia dhe Koreja e Jugut, vazhdojnë të renditen në fund për shkak të normave shoqërore të ngulitura dhe pjesëmarrjes së ulët të grave në vendimmarrje. Në një nivel më të gjerë, GCI tregon se, pavarësisht përmirësimeve në pjesëmarrjen në tregun e punës dhe në përfaqësimin politik, hendeku i pagave dhe nën-përfaqësimi në menaxhim mbeten sfida strukturore. Kështu, indeksi nuk mat vetëm progresin e arritur, por gjithashtu nxjerr në pah kufijtë aktualë të barazisë gjinore, duke konfirmuar se "tavani i qelqtë" mbetet një fenomen i pranishëm në zhvillimet globale.

Në një situatë globale të tensionuar, të shënuar nga kriza politike dhe zhvendosje të vazhdueshme të prioritetëve, ka megjithatë edhe zhvillime pozitive, siç është në këtë rast Evropa. Edhe pse do të dukej e pabesueshme që në vitin 2025 ende të diskutohet për politika që kanë të bëjnë me trupin e gruas, vendimi i Parlamentit Evropian për të mbështetur të drejtën në abort të sigurt dhe ligjor dëshmon se çështjet e shëndetit riprodhues vazhdojnë të jenë pjesë e agjendës publike. Nisma qytetare My Voice, My Choice ofron një shembull konkret se si aktivizmi dhe angazhimi i shoqërisë civile mund të ndikojnë në diskutime politike dhe të krijojnë hapësirë për ndryshim edhe në rrethana sfiduese.

Në Kosovë, viti 2025, na gjen përballë një realiteti të dyfishtë: potencial i madh i grave për zhvillim ekonomik, social dhe demokratik, por edhe barriera strukturore që vazhdojnë t'i mbajnë ato jashtë vendimmarrjes, tregut të punës dhe hapësirës publike. Pikërisht në këtë kontekst, kjo shtojcë synon të krijojë një hapësirë reflektimi dhe dialogu. Ky artikull nuk mëton të paraqesë gjetje të reja apo informata për kontekstin e Kosovës, jo vetëm për shkak se ndryshimet nga vitet paraprake kanë qenë të kufizuara dhe situata është ndikuar edhe nga një vit pa qeveri funksionale, por, sepse analiza të detajuara gjenden në secilin prej artikujve vijues. Në shikim të parë, temat mund të duken të përsëritura, por secili shkrim trajton pasoja të ndryshme që burojnë nga i njëjti problem themelor: përfshirja e ulët e grave në punësim dhe pjesëmarrja e kufizuar e tyre në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Kur vendimet për gratë merren pa përfshirjen e tyre, sfidat strukturore vazhdojnë të mbeten të pazgjidhura.

Kur flasim për nismat dhe mirëqenien e qytetarëve, duhet theksuar se aktivizmi dhe organizatat e shoqërisë civile që ngrehin kauza kundrejt këtij funksioni, kanë luajtur historikisht një rol të rëndësishëm në nxitjen e ndryshimeve shoqërore dhe institucionale. Megjithatë, vitet e fundit është shënuar një turrje e dukshme e fondeve për këtë sektor, kryesisht si pasojë e zhvendosjes së prioritetëve globale dhe reduktimit të mbështetjes financiare, veçmas për projekte që adresojnë barazinë sociale dhe gjinore. Kjo situatë ka ndikuar drejtpërdrejt në kapacitetin e organizatave për të zhvilluar iniciativa afatgjata dhe për të mbajtur institucionet në një presion të qëndrueshëm.

Paralelisht me këtë, në diskursin publik është krijuar ndjesia se qeveria në Kosovë nuk e ka trajtuar shoqërinë civile dhe aktivistët si partnerë të barabartë në proceset e vendimmarrjes, por më shumë si aktorë periferikë. Në këtë kontekst, zhvillimet në nivel evropian shërbejnë si një rikujtim i qartë për rëndësinë e dialogut institucional me shoqërinë civile dhe për rolin thelbësor që ka aktivizmi i organizuar në formësimin e politikave publike. Rasti i nismave qytetare si My Voice, My Choice dëshmon se kur aktivizmi trajtohet me partneritet dhe jo si kundërshtim, mund të kontribuojë në politika më gjithëpërfshirëse dhe më të ndjeshme ndaj nevojave reale të qytetarëve.

Fatmirësisht, zhvillimet e fundit në Kosovë ende nuk kanë prodhuar

KUR RITJA EKONOMIKE NUK PËRKTHEHET NË JETË MË TË MIRË



Shkruan: Brikenë Hoxha, Drejtore
Ekzekutive, IKS

pasoja të menjëhershme dhe të dukshme në terren, por rreziku që ato të ndikojnë në ndërhyrje ndaj grupeve të cënueshme, veçanërisht grave, mbetet real. Mungesa e mbështetjes së qëndrueshme për shoqërinë civile dhe aktivizmin mund të çojë gradualisht në zbehjen e temave që prekin drejtpërdrejt jetën e grave nga diskursi publik, përfshirë punësimin, lejen e lehonisë dhe çështje të tjera të mirëqenies sociale. Në një perspektivë afatgjatë, kjo situatë mund të përkthehet në rritje të cënueshmërisë, dobësim të pavarësisë ekonomike të grave dhe në kufizim të mundësive të tyre për të arritur pozita kyçe të vendimarrjes, duke thelluar kështu pabarazitë ekzistuese.

Kjo shtojcë vjen si një pasqyrim dhe përmbledhje e opinioneve për vitin 2025, dhe për shkak të periudhës së publikimit, mund të lexohet edhe si një urim fundviti. Edhe pse nuk ka qenë një vit i lehtë, puna dhe angazhimi kanë vazhduar në secilën sferë, shpesh larg vëmendjes publike. Njëkohësisht, kjo shtojcë synon të hapë hapësirë për reflektim dhe veprim, duke rikujtuar se avancimi i pozitës së grave nuk mund të kufizohet në një sektor të vetëm, por kërkon angazhim të koordinuar në nivel politik, ekonomik, akademik dhe institucional, si dhe përkrahje të vazhdueshme të aktivizmit dhe shoqërisë civile. Në një kohë bombardimi me informata të shpejta dhe tekste të shkurtëra, ky botim i veçantë mbledh zëra të ndryshëm, nga ndërmarrësia dhe hulumtimi, por veçanërisht nga shoqëria civile dhe aktivistet gra që çdo ditë sfidojnë status quo-në dhe shtojnë kufijtë e asaj që konsiderohet e mundshme. Përmes analizës, përvojës dhe angazhimit qytetar, kjo shtojcë synon jo vetëm të dokumentojë realitetin e grave sot, por edhe të artikulojë vizionin për një të ardhme më të drejtë, më gjithëpërfshirëse dhe më të barabartë. Gëzuar dhe urime, 2026!

Gjatë dy viteve të fundit, rritja ekonomike në Kosovë ka qenë relativisht e qëndrueshme në nivel makro, me norma rreth tre deri në tre pikë pesë për qind sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar. Megjithatë, kjo rritje nuk është reflektuar në përmirësim të kushteve reale të jetesës për të rinjtë. Përkundrazi, shumica e treguesve që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre, si pagat reale, kostoja e jetesës, punësimi i qëndrueshëm dhe qasja në sigurime sociale, dëshmojnë për përkeqësim të dukshëm. Brenda këtij realiteti, gratë e reja mbeten ndër grupet më të ekspozuara ndaj pasigurisë ekonomike, për shkak të pozitës së tyre më të brishtë në tregun e punës dhe mungesës së mekanizmave mbrojtës.

Të dhënat zyrtare tregojnë se papunësia tek të rinjtë 15 deri në 24 vjeç është rritur nga 17.3 për qind në vitin 2023 në rreth 19.5 për qind në fund të vitit 2024. Megjithatë, papunësia si tregues nuk e pasqyron plotësisht realitetin. Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve që janë të punësuar mbeten në pasiguri ekonomike për shkak të punësimit informal dhe marrëdhënieve të paqëndrueshme të punës. Sipas studimeve të fundit, një në tre të rinj punon pa kontratë formale, ndërsa mbi 60 për qind paguhen pjesërisht ose tërësisht në para të gatshme. Kjo formë punësimi, e përhapur veçanërisht në sektorët ku dominojnë gratë e reja si gastronomia dhe shërbimet, i përjashton ato nga sigurimet shoqërore, nga mbrojtja ligjore dhe nga çdo siguri afatgjatë.

Në të njëjtën kohë, kostoja e jetesës është rritur ndjeshëm. Sipas vlerësimeve të platformave ndërkombëtare për koston e jetesës, një i ri që jeton vetëm në Prishtinë ka shpenzime mujore prej rreth 400 deri në 500 euro pa përfshirë qiranë, ndërsa me qira shpenzimet kalojnë 700 deri në 800 euro. Nëse përfshihen edhe transporti, ushqimi, energjia dhe shpenzimet shëndetësore, kostoja reale mujore mund të arrijë deri në 1,000 euro. Ndërkohë, paga minimale në Kosovë mbetet 264 euro, ndërsa paga mesatare neto për të rinjtë rrallë e kalon kufirin prej 450 deri në 550 euro. Për gratë e reja, të cilat shpesh marrin paga më të ulëta dhe punojnë me orar të pasigurt, hendeku mes të ardhurave dhe shpenzimeve është edhe më i thellë.

Ky realitet ekonomik nënkupton se shumë të rinj punojnë, por nuk arrijnë të dalin nga varfëria apo nga varësia familjare. Jetesa e pavarur shtyhet për vite, ndërsa vendimet për ndërtimin e jetës personale dhe profesionale mbeten të kushtëzuara nga pasiguria

financiare. Për gratë, kjo situatë shoqërohet shpesh me presion shtesë shoqëror dhe familjar, duke e bërë pabarazinë ekonomike edhe më të theksuar.

Një nga treguesit më kritikë të këtij realiteti është mungesa e plotë e sistemit të sigurimeve shëndetësore dhe sociale. Kosova vazhdon të mbetet i vetmi vend në rajon pa fond të sigurimeve shëndetësore, pa sigurim të papunësisë dhe me një skemë shumë të kufizuar të pensioneve kontributive. Kjo do të thotë se edhe kur të rinjtë janë të punësuar, ata nuk kanë asnjë mekanizëm që i mbron në rast sëmundjeje, aksidenti në punë, humbjeje të vendit të punës apo shtatzënie. Për gratë e reja, mungesa e këtyre mekanizmave e rrit ndjeshëm rrezikun ekonomik gjatë periudhave të ndërprerjes së punës.

Rritja e koston së jetesës pas vitit 2022 ka zhdukur çdo mundësi reale për kursime. Sipas raporteve të institucioneve ndërkombëtare, një pjesë e madhe e familjeve në Kosovë nuk arrijnë të kursejnë asgjë në fund të muajit, ndërsa tek të rinjtë kjo gjendje është edhe më e theksuar. Shumë prej tyre jetojnë muaj pas muaji, pa rezervë financiare dhe pa mbrojtje nga ngjarjet e papritura. Në mungesë të sigurimeve shoqërore, çdo krizë shëndetësore apo humbje e punës shndërrohet menjëherë në krizë ekonomike.

Pasiguria financiare e vazhdueshme ka pasojat e drejtpërdrejta në shëndetin mendor të të rinjve. Studime të ndryshme tregojnë rritje të ndjeshme të stresit, ankthit dhe lodhjes emocionale tek ata që hyjnë në tregun e punës. Shumë të rinj ndihen të lodhur dhe të pashpresë, sepse pavarësisht angazhimit të tyre në punë, nuk shohin perspektivë për përmirësim të jetës. Për gratë e reja, ky presion shpesh shoqërohet me barrë të dyfishtë mes punës dhe pritshmërive shoqërore, duke e thelluar ndjenjën e pasigurisë dhe të rraskapitjes emocionale.

Ky realitet nuk ndikon vetëm në individ, por edhe në tregun e punës dhe në shoqëri në tërësi. Në mjedise pune ku pasiguria dhe stresi janë të larta, produktiviteti bie, rritet rotacioni i punëtorëve dhe forcohet fenomeni i punësimit të përkohshëm pa perspektivë. Në afat të gjatë, kjo gjeneron një brez të të rinjve të arsimuar, por të demotivuar, të cilët e shohin emigrimin si rrugë të vetme drejt stabilitetit.

Në mungesë të një rrjeti minimal të sigurisë sociale, emigrimi nuk është thjesht zgjedhje ekonomike, por strategji mbijetese. Të rinjtë nuk largohen vetëm për paga më të larta, por për siguri, mbrojtje dhe dinjitet. Derisa Kosova të ndërtojë mekanizma bazikë të sigurimeve shoqërore, të formalizojë realisht tregun e punës dhe të lidhë pagat me koston reale të jetesës, rritja ekonomike do të mbetet statistikë pa përmbajtje sociale.

Një ekonomi që rritet pa garantuar siguri për të rinjtë, dhe veçanërisht për gratë e reja, nuk prodhon zhvillim të qëndrueshëm. Ajo prodhon pasiguri, pabarazi dhe largim. Dhe kjo është kostoja reale e një rritjeje që nuk përkthehet në jetë më të mirë.

NGA KUOTAT E REALITETI LOKAL: LEHONIA SI TEST I DEMOKRACISË GJITHËPËRFSHIRËSE



Shkruan: Saxhide Mustafa -
Zëvendës drejtoreshë Ekzekutive,
Institutin Riinvest dhe Koordinatorë,
Forumi Ekonomik i Grave të Kosovës

Pjesëmarrja e grave në politikë në Kosovë po avancohet me një ritëm të ngadalshëm, veçanërisht në nivelin lokal. Ndërkohë që në nivelin qendror gratë kanë arritur të sigurojnë përfaqësim mbi kuotën minimale prej 30 për qind në Kuvendin e Kosovës, ku ky nivel mbetet ende nën standardin e përcaktuar nga Ligji për Barazi Gjinore (Nr. 05/L-020), i cili parasheh përfaqësim të barabartë prej 50 për qind.

Të dhënat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2025 tregojnë se, edhe pse gratë përbëjnë rreth 30 për qind të përfaqësuesve në Kuvendin e Kosovës dhe në kuvendet komunale, ato vazhdojnë të jenë dukshëm të nën-përfaqësuar në pozita udhëheqëse dhe ekzekutive. Në nivel lokal, pozitat kyçe dominohen pothuajse tërësisht nga burrat: nuk ka asnjë kryetare komune, asnjë kryesuese të kuvendit komunal dhe vetëm një numër shumë i kufizuar në pozita udhëheqëse të drejtorive komunale. Kjo tregon se kuota gjinore zbatohet kryesisht si minimum ligjor, pa u shndërruar në pjesëmarrje reale dhe të qëndrueshme.

Kjo situatë reflektohet në përgjithësi në sektorin publik. Sipas Institutit Riinvest (2022), rreth një e treta e grave shprehin interes për të marrë pozita vendimmarrëse në sektorin publik. Megjithatë, ky interes nuk përkthehet në përfaqësim real, pasi vetëm 9.4 për qind e grave aktualisht mbajnë pozita vendimmarrëse. Një nga arsyt kryesore lidhet me perceptimin e ulët për gjasat e avancimit të tyre ku mbi gjysmën e grave në sektorin publik besojnë se nuk kanë mundësi reale për të arritur pozita udhëheqëse si rezultat i barrierave strukturore dhe norma tradicionale, të cilat bëhen edhe më të theksuara gjatë periudhave si shtatzënia dhe lehonja.

Hendeku mes kornizës ligjore për barazi gjinore dhe praktikës institucionale tregon se institucionet dhe partitë politike shpesh nuk krijojnë kushte për pjesëmarrje të qëndrueshme të grave, veçanërisht në momentet kur ato përballen me sfidën e balancimit ndërmjet përgjegjësisë profesionale dhe atyre familjare. Në këtë kontekst, lehonja shpesh perceptohet si një shkëputje nga angazhimi politik, duke ndikuar drejtpërdrejt në vazhdimësinë e rolit të grave në vendimmarrje.

Në nivel lokal, pjesëmarrja e grave në politikë mbetet e varur nga mënyra se si partitë ndërtojnë listat zgjedhore, nga kalkulimet elektorale dhe nga pozicionimi i kandidateve në lista. Përfshirja e grave shpesh është rezultat i kërkesave formale ligjore dhe jo i një vullneti të qartë për t'u dhënë atyre rol real dhe ndikues në vendimmarrje.

Në këtë realitet, nuk mungojnë shembujt e sakrificave personale. Sot jo vetëm në vendet e ndryshme nëpër botë por edhe tek ne, shohim asambleiste, deputete, madje edhe ministre që detyrohen të sjellin fëmijët me vete në aktivitete zyrtare, apo rrëfime si ai i një ambasadoreje që ishte e detyruar të marrë pjesë në një ngjarje vetëm katër ditë pas lindjes, sepse “puna nuk pret”. Këto raste nuk janë dëshmi vetëm të përgjegjësisë individuale të grave, por tregues të mungesës së mekanizmave mbështetës institucionalë.

Organizatat e shoqërisë civile kanë theksuar vazhdimisht se përkundër përmirësimeve në legjisllacion dhe zhvillimit të kapaciteteve të grave, normat patriarkale dhe mungesa e mbështetjes reale institucionale vazhdojnë të pengojnë avancimin e grave në politikë.

Raportet e National Democratic Institute (NDI) vazhdimisht potencojnë se ekziston një mungesë strukturore e mekanizmave mbështetës brenda sistemit politik për të akomoduar gratë gjatë periudhave personale dhe familjare, përfshirë lehoninë.

Në nivel rajonal, Raporti i Kvinna till Kvinna Foundation (2022) konstaton se barrierat institucionale dhe kulturore vazhdojnë të kufizojnë pjesëmarrjen e grave në politikë në Ballkanin Perëndimor, përfshirë diskriminimin, mungesën e mbështetjes nga partitë politike dhe zbatimin e dobët të kuotave gjinore. Këto barrierat janë të lidhura ngushtë me pritshmëritë gjinore dhe rolet tradicionale të kujdesit.

Në të njëjtën kohë, raportet e UNDP-së (2023) dhe të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (2023) tregojnë se barra e punës së papaguar dhe e kujdesit familjar bie kryesisht mbi gratë. Sistemi aktual i pushimit të lehonisë, i cili e ngarkon pothuajse ekskluzivisht gruan me kujdesin ndaj fëmijës, ndikon drejtpërdrejt në mundësinë e saj për angazhim të vazhdueshëm politik. Këto politika, të hartuara jashtë kontekstit të përfaqësimit politik, prodhojnë përjashtim indirekt të grave lehona nga proceset vendimmarrëse.

Për ta ndryshuar këtë realitet, nevojiten reforma politike dhe institucionale që shkojnë përtej kuotave gjinore. Në kuadër të projektit “Më shumë zgjedhje” mbështetur nga UNFPA dhe ADA kërkohet qeverisje gjithëpërfshirëse dhe balancimin punë jetë, ku përfaqësimi i qëndrueshëm i grave kërkon mekanizma konkretë mbështetës, si: leje prindërore, krijimi i zëvendësimeve të përkohshme gjatë lehonisë pa cenuar mandatin, funksionalizimi i pjesëmarrjes hibride në proceset vendimmarrëse, leje prindërore, dhe në mungesë të këtyre angazhimi i partive politike duhet të jetë mbështetje reale dhe jo vetëm simbolike. Politikat e balancimit

punë jetë nuk janë më kërkesa luksi, por domosdoshmëri për funksionimin e demokracisë. Politikat e përgjegjshme gjinore dhe vendet e punës miqësore për familjen janë gjithnjë e më të kërkuara, veçanërisht nga të rinjtë, dhe duhet të reflektohen qartë në kornizën ligjore të Kosovës, përfshirë Ligjin e Punës.

Institucionet dhe partitë politike duhet të pranojnë se barrierat gjinore nuk eliminohen vetëm me kuota por kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse që adreson realitetet kulturore, ekonomike dhe institucionale me të cilat përballen një grua gjatë gjithë ciklit të jetës politike, përfshirë lehoninë.

Vetëm kështu mund të thyhet narrativa që e sheh lehoninë si pengesë dhe pjesëmarrja e grave në politikë të bëhet e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

FUQIZIMI I LIDERSHIPIT TË GRAVE SI DOMOSDOSHMERË PËR ÇDO DEMOKRACI



Shkruajnë: Scott Bates, Drejtor Regjional
për Evropë dhe Euroazi, NDI, dhe
Nancy Soderberg, Drejtore e Lartë, NDI
Kosovë

Ndërsa po përmbysim çerekun e parë të shekullit të 21-të, shumë vende po përballen me stagnim në rritje ekonomike dhe thellim të pabarazive, polarizim politik të thelluar dhe të rinjë që po distancohen gjithnjë e më shumë nga vlerat themelore të demokracisë. Përderisa shkaktarët e këtyre trendeve shpesh i atribuohen pandemisë COVID-19, rritjes së pabarazisë në të ardhura dhe dështimeve në qeverisje, ekziston një faktor kyç sistematik që shumë shpesh anashkalohet: marginalizimi i grave në shumë segmente të shoqërisë. Progresi global varet nga adresimi i këtij problemi dhe vendosja e përfaqësimit të drejtë për gratë në qendër të ripërtëritjes ekonomike dhe demokratike.

Është koha të njihet lidhja jetike midis marginalizimit të grave në politikë dhe në ekonomi. Pavarësisht se shpesh i tejkalojnë burrat në shkallën e arsimimit, arritjet e tyre rrallë përkthehen në role udhëheqëse në strukturat e pushtetit. Ndonëse përfaqësimi i grave në parlamentet kombëtare është dyfishuar që nga viti 2000, megjithatë mbetet nën 27%. Gratë në krye të shteteve mbeten të rralla, me vetëm një të tretën që kanë pasur ndonjëherë një grua në krye të vendit dhe vetëm disa dhjetëra shtete që kishin një të tillë në vitin 2025, prej të cilave gjysma janë në Evropë. Në sektorin privat, situata mbetet gjithashtu sfiduese, me gratë që drejojnë afërsisht 10% të kompanive të listuara në renditjen Fortune 500. Ndërkohë që kanë nisur të ngriten në pozita drejtuese në biznes, ato përballen me pengesa të konsiderueshme në nivelet më të larta ekzekutive që njihet si C-Suite. Edhe më keq, studimet e fundit tregojnë se disa gra as nuk bëjnë përpjekje për ngritje në detyrë për shkak të pengesave sistematike.

Studimet kanë treguar prej kohësh se gratë ekonomikisht të pavarura janë në një pozicion më të mirë për të tejkaluar barrierat institucionale që lidhen me angazhimin politik. Naila Kabeer argumentoi që në vitin 1999 se sigurimi i burimeve ekonomike rrit aftësinë e grave për të vepruar dhe për të ushtruar ndikim në sferën politike. Ne e dimë se kur gratë janë në tryezë, rezultatet e politikave janë më të forta dhe më gjithëpërfshirëse. Megjithatë, një brez më vonë, ne nuk i kemi përputhur këto njohuri me veprime. Fuqizimi ekonomik i vetëm, nuk është i mjaftueshëm. Arritjet ekonomike të grave nuk përkthehen automatikisht në pushtet politik nëse nuk shoqërohen me reforma në institucionet politike dhe përmirësim të praktikave në parti të politike.

Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) në Kosovë ka ndërmarrë hulumtime të thelluara përfshirë studime të opinionit publik në të gjithë vendin, diskutime në grupe fokusi dhe intervista të drejtpërdrejta për të identifikuar shkaqet rrënjësore dhe për të propozuar zgjidhje. Me një popullsi të vogël, shumë të arsimuar, në një demokraci vibrante në ndërtim e sipër, ku pjesëmarrja formale e grave në fuqinë punëtore është vetëm 20 përqind, Kosova është një rast shumë i përshtatshëm studimi. Vendi ka zgjedhur dy presidente gra dhe ka emëruar dhjetëra gra si ministre apo zëvendëskryeministre. Pavarësisht këtyre rezultateve, gratë mbeten pa ndikim të mjaftueshëm në strukturat e pushtetit në të gjitha parti të politike, si dhe në akademi dhe në sektorin privat. Ndonëse gratë kanë tejkaluar kuotën prej 30% në zgjedhjet për parlament, ato mbeten ende larg barazisë, ndërkohë që nivelin lokal situata është edhe më e pafavorshme.

Pabarazitë e vazhdueshme për gratë në tregun e punës dhe përfaqësimin politik të Kosovës - pavarësisht legjislacionit progresiv dhe numrit të grave që i tejkalojnë burrat në aspektin e arsimimit, zbulojnë korrelacione kritike midis pjesëmarrjes ekonomike dhe pushtetit politik. Hulumtimet e NDI-së nxjerrin në pah barrierat sistematike, të tilla si diskriminimi në lidhje me shtatzëninë, barrën e punës së papaguar të kujdesit, infrastruktura e kufizuar e kujdesit për fëmijët dhe normat patriarkale. Këto sfida strukturore dhe ekonomike pengojnë drejtpërdrejt fuqizimin politik. Punësimi i ulët formal i grave zvogëlon numrin e grave ekonomikisht të pavarura që mund të kandidojnë në zgjedhje, duke formësuar kështu perceptimet e votuesve dhe partive politike për "përshtatshmërinë" e grave për udhëheqje. Për më tepër, pjesëmarrja politike e grave pengohet nga proceset joformale të nominimit, kostot e larta sociale dhe ekonomike për të kandiduar dhe zgjedhur për pozita publike dhe paragjykimet mediatike që përforcojnë stereotipet. Argumenti që sjell Laura Bates në librin e saj "Ne duhet ta rregullojmë sistemin, jo gratë" pasqyron përvojën e NDI-së në përballjen me barrierat sistematike për të çuar përpara pjesëmarrjen politike dhe ekonomike të grave. Përpjekjet tona për t'i pajisur gratë me shkathtësi dhe trajnime janë të nevojshme, por jo të mjaftueshme pa reforma sistematike që heqin barrierat strukturore.

Të dhënat tregojnë se rritja e punësimit formal dhe pavarësisht ekonomike të grave zgjeron ndikimin dhe pushtetin e tyre në sferën politike, por vetëm kur shoqërohet me reforma që hapin institucionet politike dhe sistemet partiake për gratë. Reformat në qeverisje që integrojnë politikat e punës dhe ato sociale me qëllime për barazinë, të mbështetura nga mekanizma të fortë zbatimi dhe llogaridhënieje, mund ta transformojnë politikën për të qenë më gjithëpërfshirëse. Lidhjet strategjike i pozicionojnë gratë, jo vetëm si pjesëmarrëse, por edhe si agjente të ndryshimit që formësojnë politikat dhe qeverisjen demokratike.

Hulumtimet dhe analiza e NDI-së vënë në pah tri tema të gjera që janë thelbësore për progresin në fuqizimin e grave në kryqëzimin e ekonomisë dhe qeverisjes: llogaridhënia, investimi dhe zhbërja e normave patriarkale përmes masave pozitive. Shoqëritë duhet t'i

ZHVILLIMI NUK FILLON NË BETON, POR NË KUJDES DHE QASJE!



Shkruan: Rezarta Delibashzade
Krasniqi, Drejtore Ekzekutive në D4D

mbajnë qeveritë, partitë politike dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese që synojnë sigurimin e përfaqësimit të drejtë, duke përfshirë mbrojtjen në punë. Qeveritë duhet të angazhohen me burime të mjaftueshme dhe politika afatgjata për të adresuar barrierat e grave në punësim, punën e kujdesit dhe pjesëmarrjen politike, duke përfshirë investime të qëndrueshme publike në sistemet e kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit dhe programe të synuara aktive të tregut të punës për gratë. Shoqëritë gjithashtu duhet të jenë të guximshme në sfidimin e normave patriarkale, stereotipeve gjinore dhe paragjyqimeve të pavetëdijshme përmes fushatave shumëplanëshe dhe angazhimit të palëve të ndryshme me ndikim, si fushatat që normalizojnë rolet e përbashkëta të kujdesit për burrat dhe gratë ose që përshpejtojnë procesin e grave në pozicione të dukshme udhëheqëse. Një ndërhyrje e tillë pozitive është kritike për ndryshimin e bazamentit të sistemit, i cili pengon fuqizimin e grave dhe kështu edhe përparimin shoqëror.

Suksesi në këtë drejtim kërkon një bashkëpunim shumësektorial, duke përfshirë subjektet politike, shoqërinë civile, biznesin dhe median për të ndryshuar normat dhe për të mundësuar një mjedis të favorshëm për fuqizimin e grave dhe përparimin shoqëror. Partitë politike duhet të miratojnë mekanizma inovativ rekrutimi dhe mbështetjeje për kandidatet gra, veçanërisht midis cikleve zgjedhore. Gazetarët dhe redaktorët në media duhet trajnuar për të qenë të vetëdijshëm për paragjykimet dhe për t'iu kundërvënë atyre, si dhe për të rritur prezencën dhe dukshmërinë e grave, veçanërisht në emisionet në kohën më të shikuar dhe në udhëheqjen editoriale. Sektori privat duhet gjithashtu të luajë një rol qendror duke promovuar paga të barabarta, praktika të drejta punësimi dhe promovimi, rregullim për punë fleksibile dhe programe lidhësi për gratë. Është gjithashtu thelbësore të avancohen gratë si pjesëmarrëse të barabarta në treg duke hequr barrierat ekonomike dhe sociale përmes sistemeve gjithëpërfshirëse të kujdesit për fëmijët, lejes së përshtatshme të lehonisë dhe prindërimit, qasjes në kujdes shëndetësor dhe zbatimit të fortë të ligjit kundër diskriminimit në punësim.

Një transformim i tillë kërkon një thirrje urgjente për veprim nga e gjithë shoqëria. Shtetet duhet t'i pranojnë gratë si udhëheqëse kyçe në ekonominë dhe qeverisjen e tyre, jo vetëm për rezultate më të mira në dobi të të gjithëve, por edhe si një gur themel i drejtësisë demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut. Edhe pse i vonuar, ky ndryshim është i domosdoshëm.

Një transformim i tillë kërkon një thirrje urgjente për veprim nga e gjithë shoqëria. Shtetet duhet t'i pranojnë gratë si udhëheqëse kyçe në ekonominë dhe qeverisjen e tyre, jo vetëm për rezultate më të mira në dobi të të gjithëve, por edhe si një gur themel i drejtësisë demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut. Edhe pse i vonuar, ky ndryshim është i domosdoshëm.

Diskutimet për zhvillimin ekonomik në Kosovë shpesh përqendrohen te investimet kapitale, autostradat dhe projektet e mëdha infrastrukturore. Megjithatë, përvoja ndërkombëtare dhe realiteti vendor tregojnë se zhvillimi i qëndrueshëm nuk fillon domosdoshmërisht me beton, por me investime sociale që krijojnë mundësi reale për pjesëmarrje ekonomike. Në këtë prizëm, dy nga politikat më të nënvlerësuara, por më transformuese për Kosovën, janë transporti publik funksional dhe qasja në kujdesin dhe edukimin e hershëm të fëmijëve.

Dokumenti i fundit i Institutit Demokraci për Zhvillim (D4D) e vendos këtë debat aty ku duhet: në jetën e përditshme të qytetarëve, veçanërisht në zonat rurale, ku mungesa e shërbimeve bazë po e ushqen shpopullimin, pabarazinë gjinore dhe stagnimin ekonomik[1]. Sot, zhvillimi në Kosovë nuk pengohet vetëm nga mungesa e investimeve, por nga mungesa e politikave që e lidhin ekonominë me realitetin social.

Zonat rurale po zbrazën me ritme alarmante. Të rinjtë largohen, gratë mbesin jashtë tregut të punës, ndërsa komunitetet humbin funksionin ekonomik dhe social. Në shumë fshatra, problemi nuk është mungesa e vullnetit për të punuar, por mungesa e kushteve për ta bërë këtë. Kur një grua nuk ka ku ta lërë fëmijën, ose kur një i ri nuk ka transport për të shkuar në punë apo trajnim, atëherë papunësia nuk është zgjedhje personale, por pasojë strukturore.

Mungesa e çerdheve dhe kopshteve publike në zonat rurale përbën një nga barrierat kryesore për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Në Kosovë, barra e kujdesit për fëmijët bie pothuajse tërësisht mbi gratë. Pa alternativa publike dhe të përballueshme, kjo barrë shndërrohet në përjashtim ekonomik. Nuk është rastësi që normat e punësimin të grave janë veçanërisht të ulëta pikërisht në zonat ku shërbimet e kujdesit mungojnë. Investimi në edukimin dhe kujdesin e hershëm nuk është vetëm politikë sociale, por është politikë ekonomike!

Studime të shumta tregojnë se çdo euro e investuar në këtë sektor kthehet shumëfish në ekonomi përmes rritjes së punësimin, produktivitetit dhe mirëqenies afatgjatë. Në rastin e Kosovës, ky investim ka edhe një dimension shtesë: ndalon ciklin e varfërisë dhe shpërnguljes në zonat rurale, duke i bërë ato vende ku jetohet, jo vetëm ku lindet.

PABARAZITË E HESHTURA



Shkruan: Nora Latifi Jashari,
Instituti GAP

Po aq kritik është edhe transporti publik. Për shumë banorë të zonave rurale, qasja në punë, arsim, shërbime shëndetësore apo trajnim profesional varet nga ekzistenca e një linje autobusi që funksionon rregullisht dhe me çmim të përballueshëm. Sot, në mungesë të subvencioneve dhe planifikimit publik, transporti rural shpesh është i rrallë, i shtrenjtë ose nuk ekziston fare. Kjo krijon izolim social dhe ekonomik, që në mënyrë të pashmangshme nxit migrimin.

Subvencionimi i transportit publik nuk është shpenzim, por investim në qasje dhe barazi. Kur qytetarët mund të lëvizin, ata mund të punojnë, të mësojnë dhe të kontribuojnë. Kur lëvizja kufizohet, kufizohet edhe zhvillimi. Për më tepër, transporti publik i organizuar mirë ul varësinë nga veturat private, redukton kostot për familjet dhe kontribuon në politika më të gjelbra urbane dhe rurale.

Nuk mjafton të hapësh vende pune, nëse njerëzit nuk kanë qasje fizike dhe sociale në to. Nuk mjafton të flasësh për fuqizim të grave, nëse infrastruktura publike vazhdon ta injorojë realitetin e tyre të përditshëm.

Në thelb, ky është një debat për prioritetet buxhetore dhe politike. Për vite me radhë, politikat publike në Kosovë janë dizajnuar më shumë për të reaguuar ndaj krizave sesa për t'i parandaluar ato. Investimi në kujdesin e hershëm dhe transportin publik është investim parandalues: parandalon papunësinë afatgjatë, varfërinë, shpërnguljen dhe pabarazinë gjinore.

Sigurisht, këto politika kërkojnë koordinim institucional, bashkëpunim mes nivelit qendror dhe atij lokal, si dhe vullnet politik për të parë përtej cikleve zgjedhore. Nëse Kosova synon zhvillim të balancuar dhe gjithëpërfshirës, atëherë duhet të fillojë nga bazat: nga kujdesi për fëmijët dhe nga mundësia për të lëvizur. Këto nuk janë politika dytësore, por parakushte për çdo reformë tjetër ekonomike.

[1] https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2025/10/2025-10-D4D_Main-Policy_WEB.pdf

Në Kosovë, gratë janë gjithnjë e më të arsimuara, më të pranishme në diskursin publik e në ndërmarrësi. Megjithatë, në krahasim me burrat, ato ende vazhdojnë të mbeten dukshëm të nënpërfaqësuar në këto sfera të jetës, në tregun e punës dhe në aktivitetin ekonomik formal. Kjo nuk është çështje mungese vullneti apo aftësish nga ana e grave, por pasojë e një kombinimi faktorësh strukturorë, ekonomikë dhe shoqërorë që vazhdojnë të ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme të grave. Një nga pengesat kryesore për gratë në Kosovë lidhet me ndarjen tradicionale të roleve gjinore. Barra e kujdesit familjar, qasja e kufizuar në shërbime dhe mbështetja e pamjaftueshme institucionale vazhdojnë t'i mbajnë shumë gra jashtë jetës ekonomike dhe me shkallën e pjesëmarrjes në tregun e punës ndër më të ulëta në Evropë. Këto përgjegjësi të pabarabarta përkthehen pastaj në orë të gjata pune të papaguar. Normat kulturore patriarkale vetëm që e forcojnë këtë ndarje, duke e 'normalizuar' atë dhe duke kufizuar ambiciet profesionale të grave e duke rritur varësinë e tyre ekonomike ndaj burrave.

Diskriminimi gjinor në tregun e punës në Kosovë mbetet një realitet i dukshëm, pavarësisht se në letër legjislacioni ynë garanton barazi të plotë mes grave dhe burrave. Të dhënat nga Agjencia e Punësimit tregojnë se në listat e punëkërkuësve ka shumë gra, çka dëshmon se interesimi për të punuar ekziston. Madje, gratë diplomojnë në përqindje më të lartë se burrat dhe përbëjnë shumicën e punëkërkuësve me arsim universitar. Megjithatë, ato mbeten më pak të punësuar. Problemi nuk është tek kualifikimi apo dëshira për punë, por tek barrierat diskriminuese me të cilat ato përballen në tregun e punës. Një ndër këta faktorë është edhe përmbajtja diskriminuese e konkurseve për vendet e lira të punës. Mënyra se si shkruhet titulli i vendit të punës dhe mënyra se si përshkruhen kualifikimet e kërkuara të kandidatëve potencial, ndikon në procesin e aplikimit për atë pozitë si dhe në vetë procesin e rekrutimit. Ky lloj komunikimi ndikon drejtpërdrejt në gatishmërinë e grave për të aplikuar, në mënyrën se si perceptohen gjatë procesit të rekrutimit dhe, njëkohësisht, e zvogëlon praninë e tyre në sektorët ku tradicionalisht dominojnë burrat, si inxhinieria, energjetika apo ndërtimtaria. Si rezultat, shumë gra përqendrohen në sektorë si arsimi, shëndetësia dhe administrata, duke krijuar një ndarje të tregut të punës sipas gjinisë.

Në tregun e punës, diskriminimi shfaqet edhe në forma të tjera si paga më të ulëta, mundësi më të kufizuara për avancim profesional dhe përfaqësim i ulët në pozita vendimmarrëse. Gjithashtu, qasja e kufizuar në shërbime të përballueshme të kujdesit për fëmijë dhe të

moshuar, mungesa e politikave të punës fleksibile dhe kostoja e pushimit të lehonisë për punëdhënësit shpesh i dekurajojnë kompanitë private që të punësojnë gra.

Migrimi i viteve të fundit, në Kosovë po vazhdon të shkaktojë mungesë të fuqisë punëtore në sektorë të rëndësishëm si ndërtimtaria, tregtia, gastronomia, hoteleria dhe prodhimi. Sipas hulumtimeve të Institutit GAP, deri në vitin 2023 rreth 22.6% e popullsisë së Kosovës është larguar nga vendi. Një pjesë e madhe e tyre janë persona në moshë pune, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në mungesën e fuqisë punëtore në këta sektorë. Kjo mungesë pritet të thellohet edhe më shumë në vitet e ardhshme. Zgjidhja më e qëndrueshme do të ishte aktivizimi i fuqisë punëtore jo-aktive brenda vendit, ku gratë përbëjnë potencialin më të madh të pashfrytëzuar. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, rreth 74% e grave konsiderohen ekonomikisht jo-aktive. Kjo tregon qartë se përfshirja e grave në tregun e punës nuk është vetëm çështje barazie gjinore, por edhe domosdoshmëri ekonomike.

Një tjetër dimension i rëndësishëm është ai i ndërmarrësisë së grave. Edhe pse vitet e fundit ka pasur rritje të numrit të bizneseve në pronësi të grave, ato mbeten kryesisht biznese mikro, të përqendruara në sektorë me vlerë të shtuar më të ulët dhe me mundësi të kufizuara zgjerimi. Gratë ndërmarrëse kanë treguar se mund të ndërtojnë biznese të qëndrueshme dhe të kontribuojnë në ekonomi, por përballen me pengesa serioze në qasje në financa dhe mbështetje institucionale.

Sipas një analize të Institutit GAP mbi mbështetjen financiare për bizneset në pronësi të grave, vetëm një pjesë e vogël e tyre kanë përfituar nga grantet apo subvencionet e dhëna nga institucionet publike apo organizatat e ndryshme. Shumica e bizneseve të grave mbështeten në kurse personale, ndërsa qasja në kredi apo skema mbështetëse mbetet e kufizuar, shpesh për shkak të mungesës së pronës në emër të grave ose procedurave të ndërlikuara administrative. Si pasojë, bizneset në pronësi të grave kanë dukshëm më pak hua dhe depozita krahasuar me ato në pronësi të burrave.

Gratë ndërmarrëse përballen me vështirësi në qasje në tregje dhe në rrjete profesionale. Pavarësisht rritjes së ndjeshme të pranisë digjitale pas pandemisë, shumë biznese në pronësi të grave hasin sfida në menaxhimin e aktiviteteve të tyre online, kryesisht për shkak të mungesës së trajnimeve adekuate dhe kufizimeve të kohës. Anëtarësimi në shoqata të bizneseve dhe oda ekonomike mbetet e rëndësishme për qasje në informacion dhe mundësi të mbështetjes, por pjesëmarrja e tyre është e ulët për shkak të tarifave të larta që shpesh janë të papërbalueshme për këto biznese.

Rritja e përfshirjes së grave në tregun e punës dhe në ekonomi nuk mund të arrihet vetëm përmes thirrjeve për barazi, por kërkon investime konkrete në shërbime të kujdesit, politika të punësimit, qasje më të lehtë në financa dhe mbështetje të synuar për

ndërmarrësinë e grave. Aktivizimi i grave nuk është vetëm çështje e drejtësisë sociale, por edhe një domosdoshmëri ekonomike për Kosovën.

Për të fuqizuar realisht gratë ndërmarrëse, është thelbësore të zgjerohet qasja në financa, të ofrohen trajnime cilësore, të krijohen skema mbështetëse të dedikuara dhe të forcohen rrjetet profesionale ku gratë mund të marrin mentorim dhe lidhje të reja biznesi. Vetëm kështu mund të ndërtojmë një ekosistem të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm për gratë që duan të zhvillojnë një biznes në Kosovë.

Përveç këtyre, është e domosdoshme të ofrohen shërbime të përballueshme dhe cilësore të kujdesit ditor për fëmijë. Po ashtu, promovimi i punës në distancë dhe i orarit të pjesshëm mund të ndihmojë balancimin mes punës dhe përgjegjësiwe familjare për gratë dhe burrat. Rritja e informimit për vendet e lira të punës është e domosdoshme, veçanërisht në sektorët me kërkesë të lartë, si dhe krijimi i rrjeteve mentorimi për të motivuar vajzat dhe gratë. Ndërkohë, për gratë ndërmarrëse, krijimi i skemave afirmative të granteve dhe subvencioneve, duke përfshirë edhe kuota të dedikuara për biznese në pronësi të grave do të ndihmonte zhvillimin dhe zgjerimin e bizneseve të tyre.

GRATË DHE BURRAT NË KOSOVË, A JEMI VËRTET TË BARABARTË? SHIFRAT FLASIN VETË.



Shkruajnë: Mirjeta Ademij dhe Elirjeta Beka, Rrjeti i Grave të Kosovës

Kosova ka shënuar përparim të rëndësishëm në ndërtimin e kornizës ligjore për barazi gjinore dhe mekanizmave për zbatim duke përfshirë Konventën e Stambollit në Kushtetutë, ndryshuar Kodin Penal, apo zotuar të zbatojë buxhetim të përgjegjshëm gjinor. Gjithashtu, ka miratuar ligje dhe strategji tjera kyçe. Megjithatë, zbatimi i kornizës ligjore dhe funksionimi efektiv i mekanizmave mbetet sfida. Monitorimet tona tregojnë se qasja gjinore ende nuk është plotësisht e integruar në praktikë, ndërsa boshllëqet në zbatim dhe kapacitetet institucionale vazhdojnë të ndikojnë drejtpërdrejt jetën e grave në edukim, punësim, transport dhe qasje në shërbime publike.

Edukimi që nuk sfidon pabarazinë

Le të fillojmë me edukimin në fëmijëri të hershme si niveli më përcaktues ku stereotipet gjinore ose përforcohen ose sfidohen. Në Kosovë, legjislacioni në fuqi siguron qasje të barabartë për vajzat dhe djemtë, mirëpo në praktikë kjo qasje nuk përkthehet me (ri)hartimin dhe zbatimin e kurrikulave, pedagogjisë dhe politikave për të transformuar stereotipet gjinore në të mirën e promovimit të barazisë gjinore. Përkundrazi, kurrikulat, tekstet mësimore dhe materialet tjera rrezikojnë t'i përforcojnë stereotipet dhe rolet tradicionale gjinore. Shume herë kemi parë dhe dëgjuar sesi shembujt në tekste shkollore i paraqesin vajzat si kujdestare ndërsa djemtë në profesione teknike. Mirëpo, shumë rrallë kemi parë prindërit/kujdestarët apo mësuesit t'i inkurajojnë djemtë e vegjël të luajnë me kukulla apo vajzat me vetura. Në fund të fundit, ndryshimi fillon gjithmonë nga gjërat e vogla.

Përkujdesje 24/7 por të papaguara

Deri më tani e kuptuam rëndësinë e edukimit të hershëm, në veçanti për fëmijët nën moshën 3 vjeçare, ku faktorët si të ardhurat familjare, vendbanimi dhe qasja në shërbime publike janë përcaktues. Kur këta fëmijë nuk janë pjesë e sistemit të edukimit, në shumicën e rasteve janë gratë ato që detyrohen të rrijnë në shtëpi dhe ofrojnë kujdes papaguesë. Shpesh këto gra detyrohen ta lënë vendin e punës apo shkollimin duke qenë se normat sociale automatikisht përcaktojnë që barra e kujdesit bie mbi to. Në anën tjetër baballarët, duke mos u angazhuar në

mënyrë të barabartë në kujdesin ndaj fëmijëve kalojnë më pak kohë kualitative me fëmijët e tyre, gjë e cila është shumë e rëndësishme për zhvillimin e hershëm të fëmijës.

Le të analizojmë tani edhe një perspektivë tjetër, atë të ofrimit të kujdesit për një kategori të ndjeshme siç janë personat me aftësi të kufizuara. Një hulumtim i ditëve të fundit tregon se 70% e asistentëve personal apo kujdestarëve janë gra; qoftë nënat apo një person tjetër i afërt. Kur u pyetën për sfidat e tyre gjatë ofrimit të kujdesit këto gra thanë se ato ofrojnë kujdes 13-24 orë në ditë, shtatë ditë në javë dhe kjo ndikon edhe në shëndetin e tyre fizik dhe mendor. Ato u shprehën se vuajnë nga dhimbjet e shpinës, lodhjes, mungesës së gjumit, stresit dhe izolimit shoqëror. Le ta theksojmë edhe njëherë që këto përvoja të këtyre grave vazhdojnë të mbesin të patrajtuara nga legjislacioni në fuqi, duke mos u paguar për punën që ofrojnë, apo duke mos pasë një sigurim shëndetësor, kështu duke i shkelur të drejtat e tyre të përcaktuara me ligj të Punës.

Dhuna me bazë gjinore, një alarm i vazhdueshëm; drejtësia vonon

Dhuna me bazë gjinore është njëra ndër format më serioze të cenimit të të drejtave të njeriut, e cila disproporcionalisht i prek më shumë gratë dhe vajzat. Të dhënat e një ankete të kryer nga OSBE në vitin 2019, thonë se 54% e grave në Kosovë kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga partneri intim që nga moshën 15 vjeçare, ndërsa gati 30% kanë përjetuar ngacmim seksual. Një e dhënë tjetër shqetësuese është se vetëm 2% e grave kanë raportuar rastet e dhunës në polici, gjë që tregon për një mosbesim të thellë ndaj institucioneve dhe frikë nga stigmatizimi shoqëror. Për më tepër, gjysma e grave në Kosovë (48%) e konsiderojnë dhunën, sidomos dhunën në familje, si çështje private. OSBE-ja ka gjetur se ekziston lidhje e qartë mes grave që kanë përjetuar dhunë dhe atyre që besojnë se dhuna në familje është "çështje e brendshme", apo se "gruaja duhet të jetë e bindur dhe nënshtruese".

Përballë kësaj situatë, pyetja më e natyrshme që dikush do ta bënte është cila është përgjigja institucionale. Të dhënat tregojnë se ka përmirësim mirëpo nuk është i mjaftueshëm. Si ilustrim, Policia e Kosovës, gjykatat dhe mbrojtësit e viktimave ende përballen me kuptim të limituar të natyrës së dhunës me bazë gjinore, fajësim të viktimave dhe besim që dhuna duhet të zgjidhet brenda familjes apo rrethit shoqëror. Përpjekjet tradicionale për "pajtim të çiftëve" me arsyetimin e "ruajtjes së familjes" vazhdojnë edhe përmes institucioneve. Për fund, një pyetje për reflektim për lexuesin/en mund të jetë se pse gratë dhe vajzat e reja janë vazhdimisht viktimat e dhunës me bazë gjinore. Përgjigja qëndron dikund në mes të asaj se stereotipet gjinore në vendin tonë e legjitimojnë që "burri" të ushtrojë kontrollë dhe dominim qoftë në familje, lidhje apo gjetiu. Dhe, në përforcimin e këtyre normave patriarkale të dëmshme gjinore rol kemi të gjithë ne si burrat ashtu edhe gratë, prandaj na takon të informohemi dhe edukohemi se si t'i parandalojmë ato.

Barazia në transport... nuk është e vërtetë

Megjithatë transporti shpesh paraqitet si shërbim neutral, të

dhënat tregojnë se ai funksionon ndryshe për gratë dhe burrat në Kosovë. Gratë përbëjnë vetëm 32% të mbajtësve të patentave të shoferit dhe zotërojnë vetëm 32% të automjeteve, krahasuar me 68% të burrave, duke i bërë ato shumë më të varura nga transporti publik. Megjithatë, ky transport shpesh është i pasigurt, i papërshtatshëm dhe i padisponueshëm, veçanërisht për gratë në zonat rurale, për gratë nga komunitetet joshumicë përfshirë gratë serbe, rome, ashkalie dhe egjiptianesi dhe për gratë me aftësi të kufizuara. Infrastruktura e transportit publik dhe hapësirat për këmbësorë perceptohen gjerësisht si të paarritshme, duke e kufizuar lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara dhe të prindërve me fëmijë. Ngacmimi seksual mbetet një problem serioz në autobusë bën që shumë gra të heqin dorë nga përdorimi i transportit publik pas përvojave të tilla. Pasojat janë të drejtpërdrejta dhe të matshme, 50% e grave kanë refuzuar mundësi punësimi për shkak të mungesës së transportit (krahasuar me 37% të burrave), 13% kanë ndërprerë arsimin dhe 26% janë dekurajuar nga pjesëmarrja politike. Këto shifra tregojnë qartë se pabarazia në transport nuk është vetëm çështje infrastrukture, por një pengesë strukturore që kufizon qasjen e grave në punë, shërbime, arsim dhe vendimarrje publike.

Puna joformale dhe bujqësia, pjesëmarrje pa siguri dhe pa pronësi
Në Kosovë, puna joformale dhe bujqësia përbëjnë një “ekonomi nën hije” të thellë gjinore, ku gratë janë të mbipërfaqësuar, ndërsa burrat përfitojnë më shumë nga formalizimi dhe pronësia. Megjithëse gratë përbëjnë rreth gjysmës së popullsisë, ato përbëjnë 65% të punëtorëve informalë, ndërsa burrat përbëjnë vetëm 35%, duke i bërë gratë gati dy herë më të prirura se burrat të punojnë pa kontratë, sigurim social apo mbrojtje ligjore. Ky rrezik është veçanërisht i lartë për gratë rurale dhe për gratë e moshës 46–64 vjeç, ndërsa burrat në të njëjtat zona kanë më shumë gjasa të jenë të regjistruar si fermerë apo të angazhuar në forma formale të punës. Në sektorin bujqësor, gratë përbëjnë 49% të fuqisë punëtore, por kryesisht si punëtore familjare të papaguara ose në forma joformale, ndërsa burrat dominojnë pozitat e pronësisë dhe vendimarrjes. Gratë zotërojnë vetëm 17% të pronës dhe vetëm 4.9% të tokës bujqësore, krahasuar me 83% të pronës dhe mbi 95% të tokës bujqësore të zotëruar nga burrat, dhe përbëjnë vetëm 5.8% të fermerëve të regjistruar, kundrejt 95.2% të burrave. Kjo pabarazi reflektohet edhe në mbështetjen publike: gratë përfitojnë vetëm rreth 17% të subvencioneve dhe granteve bujqësore, ndërsa bizneset në pronësi të burrave marrin shumicën dërrmuese të fondeve, deri në 25 herë më shumë. Këto pabarazi thellohen nga ndarja tradicionale e roleve gjinore gratë kryejnë mesatarisht 7.1 orë punë të papaguar të kujdesit në ditë, krahasuar me 2.3 orë nga burrat, duke kufizuar ndjeshëm mundësitë e tyre për punësim formal, siguri ekonomike dhe përfitime sociale afatgjata.

Për fund, të gjithë ne kemi rol në krijimin e një shoqërie ku gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë e rinjë, janë të barabartë, trajtohen njëjtë dhe kanë mundësi të barabarta. Leximi i këtij artikulli është një hap i rëndësishëm që lexuesi/ja po e bën për krijimin e një shoqërie të barabartë. Aplikimi i mësimave të nxjerra nga ky

artikull qoftë edhe minimal, pjesëmarrja në aktivitete ku diskutohet dhe kërkohet barazia gjinore në Kosovë, apo kontributi në formë donacioni sado i vogël, janë hapa shumë të rëndësishëm në formimin e një shoqërie të barabartë.

DISKRIMINIMI NË DERËN E PARË: ÇFARË ZBULON TESTIMI I SITUATAVE PËR PRAKTIKAT E PUNËSIMIT NË KOSOVË



Shkruajnë: Arbër Nuhiu,
Drejtor Ekzekutiv, CGSD dhe
Rajomnda Sylje, Drejtore e
Programave, CSGD

Qasja në punësim në Kosovë rregullohet formalisht nga një prej kornizave më gjithëpërfshirëse të barazisë në rajon. Kushtetuta, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji i Punës dhe Ligji për Barazinë Gjinore ndalojnë në mënyrë të përbashkët trajtimin e pabarabartë në bazë të gjinisë, etnisë, orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Megjithatë, provat se si këto garanci funksionojnë në praktikë, veçanërisht në fazën më të hershme të rekrutimit, kanë munguar kryesisht. Pikërisht këtu diskriminimi është më i vështirë për t’u vërejtur dhe më i lehtë për t’u mohuar.

Një studim i fundit mbi praktikën e punësimit në Kosovë e teston drejtpërdrejt këtë pikë të verbër. I zbatuar si pilot ndërmjet 13 dhe 30 nëntorit 2025, hulumtimi aplikoi testimin me çifte të përputhura (matched-pair testing) për të dokumentuar se si kompanitë reagojnë ndaj kandidatëve që janë të barabartë në kualifikime, përvojë dhe motivim, por që dallojnë vetëm për nga një karakteristikë e mbrojtur. Në vend se të mbështetej në ankesa ose përvoja të vetë-raportuara, studimi riprodhoi procese reale rekrutimi dhe regjistroi sjelljet e punëdhënësve teksa ato ndodhnin, duke kapur vendime që zakonisht nuk lënë gjurmë të dokumentuara dhe nuk arrijnë kurrë te institucionet.

Testimi përfshiu 18 kompani dhe 25 vende pune në Prishtinë, kryesisht në sektorët e hotelarisë, administratës, logjistikës dhe shërbimeve të pastrimit. Vendet e punës u përzgjedhën nga platformat online të punësimit dhe u kufizuan në pozita që lejonin aplikime të kontrolluara përmes emailit ose sistemeve online. Pozitat profesionale të nivelit të lartë u përjashtuan për të

shmangur paqartësitë ndërmjet diskriminimit dhe mospërputhjeve reale të kualifikimeve. Brenda këtyre parametrave, studimi përdori profile të bazuara në gjini, etni dhe orientim seksual ose identitet gjinor në nivele të ndryshme kualifikimi.

Nga ana metodologjike, hulumtimi ndoqi praktikën më të mira ndërkombëtare në testimin e diskriminimit. Çdo vend i lirë pune mori aplikime nga kandidatët të përputhur, CV-të, letrat motivuese dhe historitë e punës së të cilëve ishin të ngjashme në strukturë dhe cilësi. Dallimet u futën vetëm përmes indikatorëve të operacionalizuar me kujdes: emra dhe përemra për gjininë, adresa nga lagje romë ose angazhim në shoqërinë civile për etninë, si dhe referenca indirekte ndaj vullnetarizmit LGBTIQ+ ose aktiviteteve për barazi për orientimin seksual ose identitetin gjinor. Punëdhënësit nuk u informuan kurrë në mënyrë eksplicite për këto karakteristika; ato u shfaqën përmes sinjaleve që zakonisht janë të pranishme në aplikimet reale.

Gjetjet, ndonëse të bazuara në një mostër të kufizuar, zbulojnë modele të qëndrueshme të trajtimit të pabarabartë që nuk mund të shpjegohen vetëm me meritë. Gratë romë u përballën me barrierat më të dukshme gjatë intervistave. Në disa raste, intervistuesit vinin vazhdimisht në dyshim arsimin e tyre, ngrinin shqetësime për transportin ose i paraqisnin vështirësitë logjistike si pengesa, pavarësisht kualifikimeve identike ose më të forta se ato të kandidateve joromë. Në një rast ilustrues, një grua romë, më e kualifikuar se homologja e saj joromë, nuk iu ofrua pozita dhe u orientua drejt një vendi pune jashtë Prishtinës. Gruas joromë, që aplikoi për të njëjtin rol, iu ofrua punësim i menjëhershëm në qendër të qytetit, pa u ngritur asnjë shqetësim logjistik.

Pabarazitë e bazuara në gjini u shfaqën gjithashtu qartë. Kandidatët burra u orientuan më shpesh drejt roleve me paga më të larta ose me më shumë përgjegjësi, ndërsa gratë u drejtuan drejt pozitave me paga ose status më të ulët, edhe brenda të njëjtave kompani. Në një intervistë, kandidates grua iu bë pyetja nëse familja e saj do t'a "lejonte" të punonte, një pyetje krejtësisht e palidhur me kapacitetin profesional, ndërsa kandidatit burrë iu ofruan kushte më të mira dhe u inkurajua të diskutonte perspektivat afatgjata të punësimit. Këto ndërveprime pasqyrojnë supozime të thella për rolet gjinore që vazhdojnë të ndikojnë vendimet e punësimit.

Trajtimi i diferencuar në bazë të orientimit seksual ishte veçanërisht i theksuar te aplikantët burra. Burrat heteroseksualë morën përgjigje më të shpejta dhe oferta më konkrete pune, ndërsa burrat homoseksualë shpesh përjetuan intervista më të gjata që nuk u shndërruan në mundësi të barabarta. Te gratë, dallimet ishin më pak të hapura, por dukeshin të lidhura ngushtë me shprehjen gjinore. Aplikantët testues lezbike, të paraqitura në mënyrë stereotipike femërore, u trajtuan ngjashëm me gratë heteroseksuale, duke sugjeruar se konformiteti me normat

gjinore mund të zbusë, por jo të eliminojë, paragjykimin. Kjo gjetje tregon natyrën e shtresëzuar të diskriminimit, ku dukshmëria dhe shprehja ndërveprojnë me identitetin.

Përtej ndërveprimeve individuale, studimi nxori në pah edhe dobësi sistematike në praktikën e rekrutimit. Shumë kompani nuk iu përgjigjën fare aplikimeve, ndërsa ato që u përgjigjën shpesh anashkaluan kanalet formale të aplikimit, duke kontaktuar kandidatët drejtpërdrejt përmes telefonit ose aplikacioneve të mesazheve në vend të emailit. Pasi nisej kontakti, vendimet merreshin shpejt, me pak dëshmi të procedurave të standardizuara ose kritereve transparente. Këto praktika joformale rrisin rolin e gjykimit subjektiv dhe krijojnë terren të përshtatshëm për filtrime diskriminuese.

Edhe pse studimi nuk pretendon përfaqësim statistikor, përsëritja e sjelljeve të ngjashme në kompani dhe sektorë të ndryshëm sugjeron se këto nuk janë raste të izoluar. Përkundrazi, ato pasqyrojnë veçori strukturore të tregut të punës në Kosovë: mbikëqyrje të dobët në fazën e rekrutimit, praktika joformale të punësimit dhe stereotipe të vazhdueshme lidhur me gjininë, etninë dhe orientimin seksual. Gjetjet përputhen ngushtë me shqetësimet e ngritura në Raportet e Zgjerimit të BE-së dhe nga institucionet vendore, të cilat prej kohësh kanë theksuar hendekun ndërmjet angazhimeve ligjore të Kosovës dhe zbatimit të tyre.

Studimi thekson gjithashtu kufizimet e mekanizmave ekzistues të zbatimit. Inspektimi i punës zakonisht fillon pasi punësimi ka nisur, ndërsa organet kundër diskriminimit varen shumë nga ankesat, të cilat janë të vështira për t'u provuar kur përjashtimi ndodh në heshtje në fazën e aplikimit. Testimi i situatave, përkundrazi, prodhon prova në kohë reale të trajtimit të pabarabartë dhe u ofron institucioneve një bazë konkrete për ndërhyrje.

Nga gjetjet dalin disa rekomandime. Autoritetet publike duhet të forcojnë udhëzimet dhe mbikëqyrjen specifike lidhur me diskriminimin në fazën e rekrutimit, duke sqaruar detyrimet e punëdhënësve dhe duke integruar praktikën e punësimit në monitorimin e barazisë. Institucioni i Avokatit të Popullit mund të iniciojë hetime tematike mbi qasjen në punësim, duke përdorur testimin e situatave si mjet plotësues provues. Punëdhënësit, veçanërisht në sektorin privat, duhet të adoptojnë procedura të strukturuar dhe transparente të rekrutimit që reduktojnë diskrecionin dhe paragjykimin. Shoqëria civile dhe mediat kanë një rol thelbësor në mbajtjen gjallë të vëmendjes publike ndaj praktikave diskriminuese që përndryshe mbeten të padukshme.

Si pilot, rëndësia e studimit shkon përtej rezultateve të menjëhershme. Ai dëshmon se diskriminimi në punësim mund të dokumentohet në mënyrë rigorozë, etike dhe bindëse në kontekstin e Kosovës. Duke ndriçuar atë që ndodh në derën e parë të punësimit, hulumtimi ofron një bazë për cikle më të gjera testimi dhe për një përgjigje më të fortë, të bazuar në prova, ndaj pabarazisë në tregun e punës.

JO, NUK MUNGOJNË GRATË. MUNGOJN GAZETARIA QË I SHEH!



Shkruan: Naile Demaj, Nënkryetare e Bordit, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës

Kur e nder televizorin në orarin e debateve politike, në shumicën e rasteve e di paraprakisht çfarë do të shoh: një tavolinë me burra, një moderator dhe, në rastin më të mirë, një grua diku në skaj, shpesh e thirrur si “balancë”, rrallë si zë që udhëheq narrativën.

Ky imazh nuk është vetëm çështje estetike. Është pasqyra e një realiteti të thellë: gratë ekzistojnë në sistem, punojnë në media, raportojnë nga terreni, por rrallë shihen si protagoniste, vendimmarrëse apo eksperte. Një studim mbi gratë në media në Kosovë tregon se ato janë shumica e gazetarëve në terren dhe prezantueseve të lajmeve, por shumë pak shihen në panelet debatuese dhe pothuajse hiç në pozita menaxheriale.

Pra, gratë janë të dukshme, por jo gjithmonë të dëgjueshme. Dhe pikërisht këtu hyn në lojë gazetaria pozitive.

Në vitet e mia në studio, kam parë shumë skena si ajo që përshkruaj shpesh: një kandidat që sugjeron se pyetja ime është “emocionale”, një i ftuar tjetër që zgjedh t’u përgjigjet kolegëve burra edhe kur pyetjen ia drejtoj unë, një panel ku gratë ftohen vetëm kur flitet për “temat e grave”: familjen, edukimin, dhunën në baza gjinore. Sa herë flitet për buxhet, dialog, ekonomi, siguri, skena shndërrohet në odë burrash.

Dhe nuk është vetëm problem i mentalitetit, besoj se është edhe problem i mënyrës si bëjmë gazetari.

Nëse lajmet tona, panelet tona dhe zgjedhjet tona editoriale vazhdojnë të konfirmojnë një botë ku burrat janë gjithmonë në qendër dhe gratë në periferi, ne nuk mund të themi se jemi vetëm pasqyruese të realitetit, ne, me apo pa vetëdije, po e riprodhojmë atë. Nëse titujt tanë nxjerrin në plan të parë konfliktin, gjuhën e ashpër, skandalin dhe fytyrat e njëjta politike, ndërsa historitë e grave që ndërtojnë diçka ndryshuese mbeten diku poshtë në faqe të tretë, apo në fund të edicioneve të lajmeve, atëherë po e ushqejmë një demokraci që funksionon me gjysmën e zërit.

E pyes veten shpesh: çfarë do të ndodhte sikur të fillonim ta ushtronim sistematikisht gazetarinë pozitive, jo si rubrikë “story e mirë” në fund të edicionit, por si filozofi të përditshme redaksionale?

Gazetaria pozitive shpesh keqkuptohet. Disa mendojnë se do të thotë të mos flasim për probleme, të “zbusim” realitetin, të mbyllim sytë para korrupsionit, dhunës, dështimeve. Në fakt, është e kundërta.

Gazetaria pozitive do të thotë: ta vendosësh njeriun në qendër, jo vetëm konfliktin; ta tregosh problemin, por edhe njerëzit që po punojnë ose duhet të punojnë për ta zgjidhur; t’u japësh zë atyre që zakonisht nuk ftohen në studio: gra, të rinj, aktiviste lokale, eksperte, gra nga komunitetet e vogla që bëjnë ndryshim pa zhurmë; të mos e reduktosh gruan në rolin e viktimës, por ta tregosh edhe si aktore, udhëheqëse, profesionale.

Kur flasim për gazetarinë pozitive dhe përfaqësimin gjinor, nuk flasim vetëm për temat që zgjedhim, por edhe për njerëzit që i zgjedhim si burime.

Një redaksi që në lista të burimeve ka vetëm burra profesorë, analistë, drejtues institucionesh, ndërsa gratë i kujtohet t’i ftojë vetëm kur flitet për “tema të lehta”, po prodhon një realitet të rremë: sikur vetëm burrat kanë çfarë të thonë për ekonominë, ligjin, sigurinë, teknologjinë.

Natyrisht, të kërkosh gazetari pozitive në një ambient ku gazetaret janë të ekspozuara ndaj seksizmit, presionit dhe rrezikut, është e padrejtë nëse nuk flasim edhe për sigurinë e tyre. Raporti i AGK-së për pozitën dhe sigurinë e grave gazetare në Kosovë flet për një mjedis ku seksizmi është i përhapur dhe ku një pjesë e mirë e gazetarëve kanë përjetuar forma të ndryshme dhune apo ngacmimi, offline dhe online.

Nga ana tjetër, rrjete si SafeJournalists kanë miratuar së fundmi deklaratatë rajonale për mbrojtjen e grave gazetare në Ballkan, që parashohin mbështetje ligjore, psikologjike dhe publike ndaj tyre. Pra, nuk flasim për një terren steril, por për një fushë betejë ku gazetaria pozitive duhet të bashkohet me politika reale mbrojtëse dhe me redaksi që nuk e relativizojnë dhunën ndaj gazetarëve.

Një projekt i UN Women dhe AGK-së në Kosovë ka trajnuar gazetarë dhe studentë për raportimin e ndjeshëm gjinor dhe për rolin e mediave në promovimin e barazisë. Kjo tregon se terreni për ndryshim ekziston, por ka nevojë për vazhdimësi dhe për ta futur këtë logjikë jo vetëm në trajnime, por në rutina të përditshme redaksionale.

Ndonjëherë mjafton një ndryshim i vogël për të nisur një rrëfim të ri.

Imagjino një edicion lajmesh ku, në vend të një inserti të gjatë ku tre burra debatojnë se pse gratë “nuk hyjnë në politikë”, shfaqet një storie pozitive për një këshilltare komunale që ka arritur të shtyjë një vendim konkret për transportin e sigurt të vajzave në shkollë.

Imagjino një talk-show ku për reformën në drejtësi ftohen dy juriste që punojnë në terren, që shohin çdo ditë se si ligji funksionon (ose nuk funksionon) për gratë, në vend të një paneli të zakonshëm me figurat e njëjta partiake.

Imagjino një portal që, përveç kronikës së dhunës ndaj grave, ka edhe rubrikë të qëndrueshme ku tregohet se si është parandaluar dhuna falë një mekanizmi që ka funksionuar: një polici që ka reaguar si duhet, një gjykatë që ka trajtuar me prioritet rastin, një gazetari/eje që ka raportuar me etikë dhe i ka dhënë zë viktimës pa e zhveshur nga dinjiteti.

Kjo është gazetaria pozitive që unë e imagjinoj: jo e “ëmbël”, por e drejtë.

Ajo thotë: po, ka krizë, dhunë, pabarazi. Por ka edhe gra që po ndryshojnë komuna, institucione, profesione. Ka edhe shembuj sukse si që duhet të jenë lajme, jo rastësi. Ka edhe zëra të fuqishëm që duhet të ftohen jo një herë, por sistematikisht.

Në vendet me media të zhvilluara, gazetaria pozitive është bërë pjesë e dizajnit redaksional. Ajo është dëshmuar se rrit besimin publik, e zvogëlon cinizmin dhe e zgjeron hapësirën për përfshirje gjinore.

Kosova nuk mund të presë më!

PSE GRATË DUHET TË JENË NË TAVOLINËN E VENDIMMARRJES – JO NESËR, POR TANI!



Shkruan: Shkëndije Himaj, Drejtore Ekzekutive, Gratë në Borde - Kosova

Për një kohë shumë të gjatë në karrierën time profesionale, unë kam qenë gruaja e vetme në zyrat ku janë marrë vendime të rëndësishme. Kam qenë e vetmja grua në takime bordesh, në komitete strategjike dhe në diskutime ku përcaktohej drejtimi i institucioneve dhe organizatave. Kjo përvojë, përtej faktit që ishte e padrejtë në thelb, ka qenë edhe jashtëzakonisht e vështirë në praktikë. Jo për shkak të mungesës së kapaciteteve, por për shkak të peshës së padukshme që mbart izolimi profesional dhe përjashtimi strukturor.

Të jesh e vetmja grua në një tryezë vendimmarrëse do të thotë të jesh vazhdimisht nën vëzhgim, të ndjesh nevojën të provosh dyfish më shumë, të matësh çdo fjalë dhe të përballesh me pritshmëri që rrallë u imponohen kolegëve meshkuj. Në këto ambiente, zëri i gruas shpesh perceptohet si përjashtim, jo si pjesë integrale e procesit. Dhe kjo nuk është vetëm çështje ndjesish personale; është një realitet që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e vendimmarrjes.

Mungesa e grave në pozitë vendimmarrëse nuk është thjesht çështje barazie apo përfaqësimi simbolik. Është çështje efektiviteti, qëndrueshmërie dhe drejtësie institucionale. Vendimet që merren në ambiente homogjene, ku dominojnë perspektiva të ngjashme, rrezikojnë të jenë të njëanshme dhe të shkëputura nga realiteti kompleks i shoqërisë. Gratë sjellin përvoja të ndryshme jetësore, mënyra të tjera të të menduarit dhe një ndjeshmëri më të gjerë ndaj ndikimit social të vendimeve.

Nga përvoja ime, kam parë se sa shpesh vendimet e rëndësishme janë marrë pa u konsideruar plotësisht pasojat për gjysmën e popullsisë. Kur gratë nuk janë pjesë e procesit vendimmarrës, ne nuk mungojmë vetëm fizikisht; mungon edhe zëri ynë, përvoja jonë dhe njohuria jonë mbi realitete që shpesh mbeten të padukshme për ata që nuk i përjetojnë.

Pjesëmarrja e grave në pozitë vendimmarrëse nuk duhet parë si favor apo privilegj. Ajo është rezultat i meritës, profesionalizmit dhe nevojës reale për vendime më të mira. Megjithatë, për shumë gra, rruga drejt këtyre pozicioneve është më e gjatë dhe më e vështirë. Barrierat nuk janë gjithmonë të shkruara në rregullore apo ligje,

perkundrazi Kosova ka ligjet më të avancuara që sigurojnë barazinë gjinore por që në praktikë asnjëherë nuk është realizuar, të marrim shembull Ligjin për Organizata Biznesore që ka të përcaktuar kuotën që asnjëherë nuk është realizuar. Kështu barrierat janë të heshtura, të ngulitura në kultura organizative, në rrjete informale dhe të rrënjosura thellë në stereotipe.

Të qenit e vetmja grua në një bord do të thotë shpesh të mos kesh aleatë natyralë, të mos jesh pjesë e rrjeteve të vendimmarrjes informale dhe të përballësh me dyshime të vazhdueshme mbi kompetencën tënde, edhe kur përvoja dhe kualifikimet flasin vetë. Kjo krijon një lodhje të vazhdueshme profesionale dhe emocionale, e cila shpesh nuk njihet dhe nuk merret parasysh.

Megjithatë, përkundër këtyre sfidave, përvoja ime më ka bindur edhe për një të vërtetë tjetër: kur gratë janë të pranishme në tryezat e vendimmarrjes, dinamika ndryshon. Diskutimet bëhen gjithëpërfshirëse, pyetjet më të thella dhe vendimet më të balancuara. Nuk është rastësi që studime të shumta tregojnë se institucionet dhe kompanitë me përfaqësim më të madh të grave në borde dhe menaxhment kanë performancë më të mirë, menaxhim më të kujdesshëm të rrezikut dhe besueshmëri më të lartë publike. Rëndësia e pjesëmarrjes së grave në pozitat vendimmarrëse është veçanërisht e madhe në sektorë si financa, politika publike dhe qeverisja korporative, ku vendimet kanë ndikim afatgjatë në zhvillimin ekonomik dhe social. Kur gratë përjashtohen nga këto procese, humbet një potencial i madh zhvillimor. Shoqëritë që nuk e shfrytëzojnë këtë potencial, në fakt po kufizojnë vetveten.

Është e rëndësishme të kuptohet se përfshirja e grave nuk do të thotë përjashtim i burrave. Përkundrazi, do të thotë ndërtim i një kulture vendimmarrjeje më të drejtë, më transparente dhe më të përgjegjshme. Diversiteti nuk dobëson institucionet; i forcon ato. Ai krijon ekuilibër, rrit cilësinë e debatit dhe ul rrezikun e vendimeve të gabuara. Sot, më shumë se kurrë, kemi nevojë për gra në pozitat vendimmarrëse jo vetëm si pjesëmarrëse, por si udhëheqëse. Kemi nevojë që prania e grave në borde dhe komitete të mos jetë përjashtim, por normë. Kemi nevojë që vajzat e reja të mos rriten me idenë se dhomat ku merren vendimet nuk janë për to.

Përvoja ime më ka mësuar se ndryshimi nuk vjen vetvetiu. Ai kërkon vullnet institucional, politika të qarta, mentorim, rrjetëzim dhe mbi të gjitha, guxim për të sfiduar status quo-në. Por mbi të gjitha, kërkon që gratë të mos heshtin dhe të mos tërhiqen, edhe kur rruga bëhet e vështirë.

Gjithashtu, kjo përvojë më ka treguar se problemi nuk është mungesa e grave të përgatitura. Problemi është mungesa e mekanizmave që i sjellin ato në tryezë. Gratë ekzistojnë, ekspertiza ekziston, përvoja ekziston. Ajo që mungon është qasja.

Pikërisht kjo përvojë e të qenit vazhdimisht e vetmja grua në dhomat ku merren vendimet dhe nevoja imediate për ndryshim real, jo deklarativ, ka qenë shtysa kryesore që unë të themeloj organizatën “Gratë në Borde - Kosova”. Kjo organizatë nuk ka lindur si ide abstrakte, por si përgjigje konkrete ndaj një problemi real dhe urgjent.

“Gratë në Borde - Kosova” ka mandat të qartë dhe vepron mbi tri shtylla themelore:

Së pari, ngritja e kapaciteteve të grave për të marrë përsipër pozita vendimmarrëse. Kjo nënkupton përgatitje profesionale të targetuar për role bordesh dhe menaxhmente, njohuri mbi qeverisjen korporative, menaxhimin e rrezikut, financat, strategjinë dhe përgjegjësitë ligjore që vijnë me këto pozita. Nuk mjafton të thuhet se gratë duhet të jenë në borde; ato duhet të pajisen me mjetet e duhura për të qenë efektive dhe me ndikim.

Së dyti, mentorimi i grave gjatë ushtrimit të këtyre pozitave. Hyrja në një bord është vetëm hapi i parë. Gratë shpesh gjenden sërisht të vetme në këto struktura dhe përballen me dinamika të vështira pushteti. Mentorimi i vazhdueshëm është kyç për të ndërtuar vetëbesim, për të menaxhuar sfidat dhe për të siguruar që prania e tyre të mos jetë formale, por substanciale.

Së treti, ndërlidhja e grave të përgatitura me kompani dhe organizata të gatshme për t'i pranuar në pozita vendimmarrëse. Ky është një element kritik, sepse shumë procese emërimi ndodhin përmes rrjeteve informale nga të cilat gratë shpesh janë të përjashtuara. “Gratë në Borde - Kosova” synon të krijojë ura konkrete mes ofertës dhe kërkesës, mes grave të kualifikuara dhe institucioneve që kanë nevojë për qeverisje më të mirë. Puna e organizatës nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojë përgjegjësinë institucionale. Nevojiten politika të qarta, udhëzime rregullative dhe angazhim serioz nga qeveria, rregullatorët dhe sektori privat për të vendosur objektiva minimale për përfaqësimin gjinor në borde. Pa këtë angazhim, progresi do të mbetet i ngadalshëm dhe i varur nga individë të veçantë.

Përvoja ime personale më ka mësuar se ndryshimi nuk vjen duke pritur. Ai vjen duke vepruar. Dhe sot, veprimi më i rëndësishëm është i qartë: kuota të guximshme, borde të hapura dhe sisteme që e bëjnë përfshirjen e grave normë, jo përjashtim.

GRATË DHE MINIERAT E KOSOVËS: KONTRIBUTI I HARRUAR DHE MUNDËSITË E PASHFRYTËZUARA



Shkruan: Shqipe Neziri Vela,
Kryesuese dhe Bashkëthemeluese,
Gratë në Energji dhe Miniera

Ndërkohë që sektori minerar vlerësohet mbi 13 miliardë euro dhe ofron mundësi për investime dhe vende pune, gratë vazhdojnë të përjashtohen nga pozicionet kyçe, duke humbur jo vetëm barazinë, por edhe zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë.

Sektori minerar ka qenë dhe mbetet një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Resurset minerare të vendit, përfshijnë qymyr, metalet bazë dhe minerale të tjera strategjike, që jo vetëm kontribuojnë në energjinë dhe industrinë vendore, por ofrojnë potencial të madh për investime të reja, krijim të vendeve të punës dhe zhvillim rajonal. Në një ekonomi të vogël si Kosova, ku fuqia punëtore dhe kapitali janë të kufizuara, sektori minerar përfaqëson një mundësi të jashtëzakonshme për rritje ekonomike dhe stabilitet social.

Megjithatë, ky potencial nuk është shfrytëzuar në mënyrë të barabartë. Roli i grave në këtë sektor ka qenë historikisht i kufizuar, jo për mungesë aftësish, por për shkak të strukturave institucionale, barrierave kulturore dhe stereotipeve shoqërore që e kanë mbajtur pjesëmarrjen e tyre të marginalizuar. Në minierat kryesore të Trepçës, prej vitit 1926 kur ka nisur veprimtaria minerare, gratë kanë punuar si inxhinierë, kanë qenë të pranishme në laboratorë teknikë dhe kanë mbajtur role të rëndësishme në administratë. Ky fakt historik tregon se gratë gjithmonë kanë pasur potencial të madh për t'u angazhuar në sektor, por mungesa e politikave gjithëpërfshirëse dhe stereotipet gjinore kanë penguar avancimin e tyre.

Gjatë periudhës së ish-Jugosllavisë, Trepça ishte një nga komplekset industriale më të mëdha në rajon. Në kulmin e funksionimit të saj, ndërmarrja punësonte dhjetëra mijëra punëtorë dhe ishte shtyllë ekonomike për komunitete të tëra, duke ofruar punësim të qëndrueshëm dhe shërbime sociale për qytetet përreth, si Mitrovica. Edhe pse gratë gjetën hapësirë kryesisht në administratë, laboratorë dhe role inxhinierike mbështetëse, puna operative nën tokë dhe pozicionet vendimmarrëse mbetën të

dominuara nga burrat. Ky dallim nuk ishte rezultat i mungesës së aftësive, por i kufizimeve kulturore dhe strukturore që përcaktonin se cilat role ishin "të përshtatshme" për gratë.

Pas viteve '90 dhe veçanërisht pas luftës së vitit 1999, sektori minerar dhe energjetik përballej me sfidën e rindërtimit dhe modernizimit. Ligjërisht, nuk ekzistojnë pengesa për gratë që të punojnë në miniera, por barrierat praktike, strukturore dhe kulturore vazhduan të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë. Në ndërmarrjet kryesore publike, si Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) dhe Trepça, gratë përbëjnë vetëm një përqindje të vogël të fuqisë punëtore operative. Në KEK, nga rreth 3,952 punëtorë aktivë, vetëm 204 janë gra, që përbën rreth 5% të totalit. Ato janë të përqendruara kryesisht në administratë dhe role mbështetëse, ndërsa pozicionet operative dhe menaxheriale mbeten pothuajse ekskluzivisht mashkullore.

Stereotipet gjinore vazhdojnë të luajnë rol kyç. Minierat perceptohen si ambiente të rrezikshme dhe të ashpra, ku gratë nuk do të përshtateshin. Ky perceptim shpesh formohet që në shkollë, ku vajzat rrallë inkurajohen të ndjekin fusha teknike si inxhinieria minerare, gjeologjia apo mekanika industriale. Edhe kur ato ndjekin këto fusha, mungesa e programeve të specializuara dhe mentorimi i pakët i pengojnë të avancojnë.

Të dhënat nga Fakulteti i Gjeoshkencave në Universitetin Publik të Mitrovicës tregojnë një pabarazi të theksuar gjinore. Në programet Bachelor, rreth 65% e studentëve janë gra, ndërsa burrat përbëjnë 35%. Kjo tregon një interes të madh fillestar të vajzave për shkencat e tokës dhe teknologjitë minerare. Por në nivelin Master, ky raport ndryshon drastikisht: vetëm 19% e studentëve janë gra, ndërsa burrat përbëjnë 81%. Ky rënie reflekton mungesën e mbështetjes, barrierat institucionale dhe stereotipet shoqërore që pengojnë vazhdimësinë dhe avancimin e grave në karrierë teknike.

Për më tepër, pjesëmarrja e grave në sektorin privat të minierave është edhe më e kufizuar. Sipas numrit të licensave aktive nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, gratë zotërojnë më pak se 0.1% të bizneseve minerare, një tregues i qartë i mungesës së pjesëmarrjes në pozicione vendimmarrëse dhe kapital-intensive. Oda e Minierave të Kosovës, e themeluar në vitin 2024 për të përfaqësuar interesat e sektorit minerar, deri më sot nuk ka asnjë kompani anëtare që drejtohet nga një grua. Në përgjithësi, vetëm 18% e bizneseve në Kosovë janë në pronësi të grave, shumica e të cilave janë mikro-biznese me më pak se 10 punonjës, ndërsa bizneset e mëdha dhe kapital-intensive mbeten pothuajse të gjitha në duart e burrave. Ky hendek ekonomik nënvizon se edhe në aspektin ekonomik, potenciali i grave mbetet i pashfrytëzuar.

Një tjetër barriërë e rëndësishme lidhet me strukturën sociale dhe ekonomike. Gratë në Kosovë mbajnë barrën kryesore të punës së papaguar në familje, duke përfshirë kujdesin për fëmijët dhe të moshuarit. Minierat kërkojnë orare të gjata dhe shpesh punë me ndërrime, gjë që e bën të vështirë për gratë të përballojnë detyrimet familjare dhe profesionin. Në mungesë të politikave institucionale mbështetëse, shumë gra përjashtohen automatikisht nga sektori, jo për shkak të mungesës së interesit apo aftësive, por për shkak të kushteve strukturore.

Vitet e fundit kanë sjellë disa iniciativa pozitive. Rrjetet e grave në energji dhe miniera, siç është iniciativa Gratë në Energji dhe Miniera, së bashku me programet e mentorimit dhe nismat për fuqizimin e grave në sektorët teknikë, kanë filluar të sfidojnë status quo-në. Edhe pse ndikimi numerik mbetet i kufizuar, këto programe kanë rëndësi strategjike: të ndryshojnë narrativën dhe krijojnë modele të reja për brezat e rinj. Prania e grave si inxhinierë, gjeologe apo menaxhere projektsh është dëshmi se sektori minerar nuk është i paarritshëm për gratë, por kërkon mbështetje të qëndrueshme dhe politika gjithëpërfshirëse.

Rritja e rolit të grave nuk duhet parë vetëm si çështje barazie gjinore, por edhe si domosdoshmëri për zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë. Diversiteti gjinor rrit sigurinë në punë, përmirëson vendimmarrjen dhe kontribuon në një kulturë institucionale më transparente. Në një sektor me rrezik të lartë si minierat, kjo nuk është luks, por domosdoshmëri. Përjashtimi i grave nga pozicionet kyçe operative dhe menaxheriale është humbje e drejtpërdrejtë e potencialit njerëzor dhe ekonomik, veçanërisht në një ekonomi të vogël si Kosova.

Në përfundim, historia e grave në minierat e Kosovës është histori e pranishmërisë së kufizuar, por gjithmonë me potencial të padiskutueshëm. Gratë kanë qenë aty – si inxhinierë në tri minierat kryesore të Trepçës, në laboratorë, administratë dhe role mbështetëse – por nuk kanë pasur hapësirë për të ndikuar strukturën e sektorit dhe për të avancuar në karrierë. Sot, me statistika në dorë, shohim se pjesëmarrja e grave në arsimin teknik fillestar është e lartë, por rruga drejt niveleve të avancuara është e bllokuar, dhe pronësia e grave në biznese minerare është pothuajse e papërfaqësuar.

Pyetja që mbetet është e qartë: nuk është nëse gratë mund të punojnë në miniera – ato tashmë e kanë bërë këtë. Pyetja është nëse Kosova është e gatshme të ndërtojë një sektor minerar që shfrytëzon gjithë potencialin njerëzor dhe reflekton një shoqëri të drejtë dhe të qëndrueshme. Vazhdimi i përjashtimit të grave nuk është traditë; është zgjedhje. Dhe kjo është zgjedhje që Kosova nuk mund ta përballojë.

JO VETËM BIZNES: ÇMIMI I PADUKSHËM I SUKSESIT PËR GRATË SIPËRMARRËSE



Shkruan: Bleta Zeqiri, Drejtoresha e Chocolate Corner

Fuqizimi i grave në biznes në Kosovë nuk është vetëm një koncept teorik apo një qëllim politik, por një realitet i ndërtuar mbi përvojat personale, sakrificat dhe qëndrueshmërinë e grave që çdo ditë përpiqen të ndërtojnë ëndrrën e tyre. Që nga viti 2007, kur fillova rrugëtimin tim si grua në biznes, kam qenë dëshmitare e sfidave të vazhdueshme që gratë përballin për të mbajtur dhe zhvilluar biznese në një mjedis që ende nuk i trajton ato në mënyrë të barabartë. Si themeluese dhe pronare e Chocolate Corner, rruga ime ka qenë e shoqëruar me vështirësi reale, por edhe me besim të palëkundur në punën dhe potencialin tim.

Në fillimet e mia, të qenit grua në biznes shpesh nënkuptonte mungesë besimi nga të tjerët dhe nevojën për të dëshmuar vazhdimisht vlerën time profesionale. Çdo vendim duhej justifikuar më shumë, çdo sukses duhej fituar me përpjekje të dyfishtë. Përveç këtyre sfidave profesionale, gratë shpesh përballen edhe me pritje shoqërore që e vendosin barrën kryesore të familjes mbi to, duke e bërë rrugëtimin sipërmarrës edhe më të vështirë.

Një nga periudhat më sfiduese të jetës sime profesionale dhe personale ka qenë lindja e fëmiut tim të parë. Në atë kohë, ndryshe nga punëtorët që gëzojnë pushim të paguar lehonat, unë si pronare e biznesit nuk kisha as zëvendësim dhe as mbështetje institucionale. Mungesa ime në biznes u reflektua menjëherë në ritmin e zhvillimit dhe në qëndrueshmërinë e tij. Me bindje të plotë mund të them se, po të kisha pasur mbështetje adekuate institucionale dhe shoqërore në atë periudhë, përparimi i biznesit do të kishte qenë më i shpejtë dhe jo kaq i ngadalësuar. Në mes të gjithë këtij angazhimi dhe presioni për të mos dështuar biznesi, sot e kuptoj se nuk më kujtohet që e kam shijuar plotësisht atë periudhë të bukur me fëmiun tim, sepse mendja ime ishte vazhdimisht e përqendruar te mbijetesa e biznesit. Ky është një çmim i padukshëm, por shumë real, që shumë gra sipërmarrëse e paguajnë në heshtje.

Pikërisht këtu qëndron thelbi i problemit: edhe pse përkrahja familjare ishte gjithmonë aty për mua, potenciali i grave shpesh ngadalësohet për shkak të mungesës së mbështetjes

institucionale, shoqërore dhe strukturore. Kur kjo mbështetje ekziston, gratë kanë mundësi të fokusohen plotësisht në rritjen e biznesit, të krijojnë vende të reja pune dhe të kontribuojnë më shumë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Përkrahja nuk nënkupton privilegj, por krijim të kushteve të barabarta që i lejojnë gratë të kontribuojnë në mënyrë të plotë, humane dhe të qëndrueshme.

Në rastin tim, pavarësisht mungesës së mbështetjes strukturore në momente kyçe, vullneti personal dhe këmbëngulja kanë qenë forca kryesore që më kanë shtyrë përpara. Megjithatë, duhet theksuar se jo çdo grua ka mundësi ta përballojë këtë rrugë pa mbështetje të jashtme. Shumë ide të mira, biznese potenciale dhe kontribuime të vlefshme për shoqërinë mbesin të perealizuara pikërisht për shkak të mungesës së mbështetjes institucionale dhe shoqërore.

Përveç kontributit të grave në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, unë si tatimpaguese e përkushtuar dua të theksoj se e dua vendin tim dhe përipiqem që me biznesin tim të ndihmoj edhe shtetin. Përveç kësaj, kujdesem shumë që të gjithë ata që hyjnë në Chocolate Corner të përfitojnë dhe të ndihen të respektuar, duke e bërë çdo vizitë një eksperiencë pozitive dhe të këndshme. Ky përkushtim ndaj klientëve dhe shoqërisë është pjesë e vizionit tim për një biznes që nuk ka vetëm fitim, por edhe ndikim të mirë dhe pozitiv në komunitet. Ky realitet tregon se tatimpaguesit, dhe sidomos gratë sipërmarrëse, duhet të vlerësohen dhe të mbështeten, sepse përkushtimi i tyre është një investim drejtpërdrejt në zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë.

Kur gratë përkrahen në mënyrë reale dhe strukturore, përfiton jo vetëm individi, por e gjithë shoqëria. Një ekonomi ku gratë janë aktive, të sigurta dhe të mbështetura është një ekonomi më e qëndrueshme, më inovative dhe më gjithëpërfshirëse. Gratë në biznes nuk janë vetëm bartëse të fitimit, por edhe krijuese të vlerave sociale, stabilitetit familjar dhe zhvillimit afatgjatë.

Sot, me afro dy dekada përvojë në biznes, besoj fuqishëm se ndryshimi fillon nga vullneti personal, por nuk mund të përfundojë aty. Gratë duhet të besojnë në veten e tyre dhe të mos ndalen, por njëkohësisht shoqëria dhe institucionet duhet të krijojnë mekanizma realë përkrahës. Potenciali i grave është i madh dhe i dëshmuar. Kur ky potencial mbështetet dhe vlerësohet, ai shndërrohet në forcë që e çon përpara jo vetëm një biznes, por tërë shoqërinë.

Ky shkrim është një reflektim personal, por edhe një mesazh i qartë: gratë kanë kapacitetin për të bërë shumë më tepër sesa u lejohet shpesh. Me përkrahje reale dhe strukturore, ato nuk ecin vetëm më shpejt, por ecin më larg. Dhe kur një grua ecën përpara, ajo nuk e bën këtë vetëm për veten e saj, por hap rrugë për të tjerat gra dhe kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë së vendit.

NDËRMARRËSIA E GRAVE NË KOSOVË: MES NORMAVE KULTURORE DHE MBIJETESËS EKONOMIKE



Shkruan: Arta Istrefi, Hulumtuese

Në Kosovë, ndërmarrësia e grave mbetet një nga format më të diskutuara, por njëkohësisht më të keqkuptuara të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës. Shpeshherë ajo prezantohet si histori suksesi individual ose si zgjidhje për papunësinë e grave, pa u analizuar mjaftueshëm konteksti kulturor, strukturor dhe institucional që e përcakton këtë realitet. Në këtë kuptim, ndërmarrësia e grave nuk mund të trajtohet e shkëputur nga kultura, rolet gjinore dhe mënyra se si shoqëria kosovare e koncepton punën, familjen dhe pushtetin ekonomik.

Ende jemi larg një realiteti ku gratë ndërmarrëse do të konsiderohen thjesht si “ndërmarrëse”. Normat kulturore, pritjet shoqërore dhe stereotipet gjinore vazhdojnë ta pozicionojnë gruan më afër rolit të kujdestarisë sesa rolit të krijueses së vlerës ekonomike. Ky perceptim ndikon drejtpërdrejt në vetëbesimin e grave për të hyrë në tregun e punës, për të marrë rrezik ekonomik dhe për të ndërtuar biznese me vizion afatgjatë.

Studimi mbi të cilin mbështetet ky shkrim është realizuar në kuadër të doktoratës dhe përdor qasjen e studimit të rastit për të analizuar ndikimin e kulturës në ndërmarrësinë e grave në Kosovë. Hulumtimi është bazuar në intervista individuale me 15 gra ndërmarrëse të moshës 20–60 vjeç, nga sektorë të ndryshëm (IT, tekstil, përpunim ushqimi, bukuri, marketing) dhe nga rajone urbane dhe rurale të Kosovës. Madhësia e biznesit të tyre ishte 2-50 punëtor. Qëllimi i studimit ishte të kuptohet jo vetëm pengesat, por edhe mënyrën se si gratë e përjetojnë ndërmarrësinë brenda roleve të tyre familjare dhe shoqërore.

Rezultatet tregojnë se përvoja e ndërmarrësve gra në Kosovë ndryshon sipas rajonit dhe ndikimeve kulturore. Disa gra përfitojnë mbështetje familjare që lehtëson sfidat kulturore, ndërsa të tjera, sidomos në zona rurale, përballen me turp dhe pengesa tradicionale. Gratë e mbështetura nga prindërit menaxhojnë role të ndryshme dhe kanë vizion global, ndërsa gjenerata X në zona rurale shpesh mbajnë biznes për familje dhe kanë frikë të dalin jashtë rrethit të tyre. Millennial-et janë më modernë dhe të hapur ndaj

teknologjisë. Pandemia COVID-19 ka rritur ngarkesën, por ka nxjerrë në pah rëndësinë e digjitalizimit. Mbështetja familjare dhe edukimi lejojnë gratë të tejkalojnë barrierat kulturore dhe të arrijnë sukses.

Puna nuk nis nga e njëjta pikë për gratë

Një nga gjetjet kryesore të punimit është se kultura vepron si një “filtër” që përcakton se kush hyn në tregun e punës, në çfarë forme dhe me çfarë ambicieje. Gratë që vijnë nga familje më mbështetëse, veçanërisht ato që janë rritur duke parë nëna aktive profesionalisht, shfaqin më shumë vetëbesim dhe gatishmëri për të ndërtuar biznese që synojnë rritjen dhe formalizimin. Në të kundërt, gratë e rritura në mjedise më tradicionale e përjetojnë ndërmarrësinë si përjashtim nga norma, shpesh të shoqëruar me ndjenjë faji ose frikë nga gjykimi shoqëror.

Rezultatet tregojnë dallime të theksuara mes zonave urbane dhe rurale. Gratë në zonat rurale janë më risk-averse, më pak të orientuara drejt teknologjisë dhe më të kufizuara në qasje ndaj tregjeve dhe rrjeteve profesionale. Bizneset e tyre shpesh mbeten të vogla dhe të orientuara drejt mbijetesës ekonomike të familjes, jo drejt rritjes apo punësimit të të tjerëve. Ndërkohë, gratë në zonat urbane kanë më shumë gjasa të investojnë në zhvillim biznesi, marketing digjital dhe strategji afatmesme.

Financat, pronësia dhe pabarazia strukturore

Një pengesë qendrore e identifikuar nga të gjitha të intervistuarat është qasja në financa. Tradita e trashëgimisë në Kosovë, ku prona u takon kryesisht burrave, ka lënë gratë pa kolateral për kredi bankare. Vetëm rreth 16% e pronave janë të regjistruara në emër të grave, çka i përjashton ato nga sistemi formal financiar dhe i shtyn drejt vetëfinancimit ose mbështetjes familjare. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në llojin e bizneseve që gratë mund të nisin dhe në shkallën e tyre të rritjes.

Me pjesëmarrje dukshëm më të ulët në tregun e punës dhe me barrierë strukturore të vazhdueshme, shumë gra në Kosovë e përjetojnë ndërmarrësinë më tepër si domosdoshmëri sesa si zgjedhje të lirë ekonomike.

Puna e papaguar dhe rolet familjare

Studimi konfirmon se barra e punës së papaguar, kujdesi për fëmijët, të moshuarit dhe shtëpinë, mbetet një nga faktorët kryesorë që kufizon pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe në ndërmarrësi. Sipas të dhënave të D4D, mbi 53% e grave deklarojnë se obligimet familjare i pengojnë të nisin një biznes. Gratë ndërmarrëse shpesh operojnë në një “rrymë të dyfishtë”: biznes gjatë ditës dhe punë shtëpiake pa ndërprerje.

Pandemia COVID-19 e thelloi këtë pabarazi. Gratë ndërmarrëse, veçanërisht ato me fëmijë të vegjël, raportuan se puna nga shtëpia nuk solli fleksibilitet, por rritje të ndjeshme të ngarkesës. Vetëm një numër i vogël raportoi ndryshim në ndarjen e përgjegjësiwe familjare gjatë pandemisë, kryesisht në familjet me fëmijë më të rritur.

Digjitalizimi: mundësi e pabarabartë

Një tjetër gjetje e rëndësishme lidhet me përdorimin e teknologjisë. Rreth 70% e grave të intervistuar kanë filluar të përdorin rrjetet sociale për biznes në tre vitet e fundit. Megjithatë, gratë mbi 40 vjeç në zonat rurale shpesh e shohin veten si “shumë të vjetra” për të mësuar teknologji, ndërsa gratë më të reja e shohin digjitalizimin si pjesë integrale të biznesit. Në zonat rurale, hendeku digjital mbetet edhe më i theksuar.

Nga histori individuale në politika publike

Nga të gjeturat e këtij punimi, mund të konkludojmë se ndërmarrësia e grave në Kosovë është e kushtëzuar nga kultura, struktura familjare dhe qasja në burime. Gratë me arsim më të lartë dhe nga zonat urbane arrijnë të organizojnë më mirë kujdesin familjar përmes mbështetjes së jashtme dhe të investojnë në rritje biznesi. Këto janë “gratë e dalluara” që arrijnë të tejkalojnë normat tradicionale.

Në të kundërt, shumica e bizneseve të grave mbeten mikro ose të vogla, pa strategji të qartë rritjeje, duke reflektuar mungesën e mbështetjes strukturore dhe kulturore. Mundësitë në zonat rurale perceptohen kryesisht si grante afatshkurtra, jo si platforma për ndërtim rrjetesh apo ekosistemi ndërmarrës.

Ky punim dhe përvojat e grave të intervistuar tregojnë se ndërmarrësia e grave nuk është thjesht çështje motivimi individual. Ajo është pasqyrë e mënyrës se si tregu i punës, kultura dhe politikat publike ndërveprojnë. Për një ekonomi më gjithëpërfshirëse dhe një treg pune më të drejtë, Kosova ka nevojë për politika që adresojnë pronësinë, kujdesin për fëmijët, edukimin digjital dhe ndryshimin e normave shoqërore. Në fund, fuqizimi ekonomik i grave nuk është vetëm çështje barazie gjinore, por është çështje zhvillimi ekonomik, stabiliteti social dhe vizioni për të ardhmen e vendit.

MITI I KOSTOS SË ULËT: PSE PËRJASHTIMI I GRAVE I KUSHTON SHITRENJTË KOSOVËS?



Shkruan: Erisa Kallaba,
Hulumtuese, Instituti Riinvest

Mospërfshirja e grave dhe vajzave në tregun e punës mbetet ndër temat më të diskutuara në shoqërinë tonë. Nga 50% e popullsisë së vendit që përbëjnë gratë, vetëm një çerek (25.9%) janë pjesë e tregut të punës. Edhe pse dëshpëruese, këto shifra janë rezultat i një strukture shoqërore të ndërtuar ndër dekada. Në një shoqëri ku rolet gjinore ndahen qysh në fëmijëri, vajzave dhe grave u takon roli kryesor për kujdesin, ndërsa djemtë dhe burrat marrin përsipër barrën financiare të shtëpisë. Në po këtë shoqëri, vajzat ende cilësohen “për derë të huaj”, duke reflektuar në investimet më të ulëta në edukimin e vajzave krahasuar me atë të djemve, si dhe në pabarazinë e ndarjes së pronës, ku përkundër legjislacionit aktual, vajzat dhe gratë ende përbëjnë vetëm 21% të pronareve të pronës së paluajtshme.

Normat gjinore dhe përgjegjësitë e kujdesit janë barrierat kryesore që pengojnë përfshirjen e grave në tregun e punës. Duke e pasur të domosdoshme balancimin e karrierës dhe kujdesit, gratë shpesh hyjnë në drejtime me orare fleksibile, paga më të vogla dhe rritje më të ulët ekonomike. Si rrjedhojë, burrat mbesin të mbipërfaqësuar në sektorët me rritje të shpejtë ekonomike dhe kërkesë të madhe për punëtorë, duke ndikuar në hendekun gjinor në paga. Burrat fitojnë më shumë se gratë, jo vetëm sepse kanë shkallë më të larta arsimi dhe shkathtësi më të mira, por për shkak të një trajektoreje karriere të pandërprerë nga përgjegjësitë e kujdesit, që u mundëson të fokusohen më shumë në zhvillimin profesional, të punojnë në sektorë me potencial rritjeje dhe të avancojnë më shpesh në pozita vendimmarrëse. Nga ana tjetër, gratë përballen gjatë gjithë jetës me diskriminim dhe ndërprerje të vazhdueshme në karrierë. Fillimisht, familja ndikon në edukimin që ato përzgjedhin, sepse vajzat duhet zgjedhur karriera fleksibile, që kërkojnë më pak angazhim profesional, dhe marrin më pak kohë, duke pasur parasysht përgjegjësitë e kujdesit dhe punët brenda shtëpisë, të cilat përpos që marrin kohë, janë të pa paguara. Pastaj, ato duhet gjetur një punë afër shtëpisë, në mënyrë që logjistikat e udhëtimit të mos zgjasin periudhën e kohës që gratë kalojnë jashtë shtëpisë.

Për më tepër, pushimi prindëror i diskriminon gratë, meqë atyre u takojnë deri në 12 muaj pushim lehonie, ndërsa babait i takojnë deri në 10 ditë të pa paguara. Shkëputja nga tregu i punës për një kohë

kaq të gjatë për gratë nënkupton zvogëlim të kapitalit njerëzor, më pak eksperiencë pune, si dhe ulje të përgjegjësisë dhe pagë më të vogël pas kthimit në punë. Mungesa e kopshteve për kujdesin e fëmijëve e vështirëson më tutje qasjen e grave në tregun e punës. Numri i çerdheve publike nuk arrin të mbulojë kërkesat, ndërsa çmimet e larta të çerdheve private shpesh i dekurajojnë gratë të gjejnë punë. Është “më lirë” për nënën apo gjyshen të kujdeset për fëmijën, duke reflektuar se politikat aktuale kufizojnë zgjedhjen individuale të grave për të hyrë apo qëndruar në tregun e punës.

Diskriminimi sistematik në familje, shoqëri dhe punë ka ndikuar në një cikël vicioz të nën përfaqësimit të grave edhe në pozita vendimmarrëse dhe udhëheqëse. Mirëpo, trendet demografike dhe ndryshimet socio-ekonomike çdoherë e më shumë po e shtojnë presionin e përfshirjes së grave në tregun e punës. Por çka mund t'i sjellin gratë ekonomisë së vendit?

Potenciali i pashfrytëzuar ekonomik i grave në Kosovë

Duke parë se me vite të tëra është përfolur për përfitimet që gratë mund t'i sjellin ekonomisë së vendit, Instituti Riinvest për herë të parë në Kosovë mat një model se çka do përfitojë ekonomia e vendit nëse mbyllim hendekun gjinor në punësim dhe në pjesëmarrje në fuqinë punëtore. Duke përdorur të dhënat e fundit nga Anketa e Fuqisë Punëtore, rezultatet tregojnë se mbyllja e hendekut gjinor në punësim do rrisë Bruto Produktin Vendor (BPV) për kokë banori për 21.1% në termin afatgjatë. Për t'u përkthyer në terma monetarë, kjo është rreth 2 miliardë euro më shumë në vit. Ndërsa, vetëm mbyllja e hendekut gjinor në pjesëmarrje në fuqinë punëtore mund të rrisë BPV për kokë banori për afro 5.9%. Këto shifra janë marramendëse dhe shpërfaqin në numër se sa shumë është duke humb Kosova nga ky potencial i pa shfrytëzuar. Shifrat e tilla duhet të ndikojnë në politika të menjëhershme. Investimet në qendra për kujdesin e fëmijëve, edukim dhe trajnim të grave dhe vajzave në fusha me rritje të shpejtë ekonomike, ofrimi i transportit të sigurt dhe gjithpërfshirës, si dhe reformimi i vendeve të punës që të jenë miqësore për familjen, janë investime relativisht të ulëta krahas përfitimeve ekonomike dhe sociale nga përfshirja më e madhe e grave në tregun e punës.

Më shumë gra në tregun e punës nënkupton më shumë taksapagues dhe bazë më të gjerë për të mbuluar kostot si pasojë e zgjerimit të popullsisë që përfitojnë nga skemat pensionale. Më shumë gra në tregun e punës nënkupton investim më të madh në edukimin e fëmijëve, në përmirësimin e vendimmarrjes brenda shtëpisë, dhe në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike brenda familjes. Nëse dëshirojmë të kemi një ekonomi dhe zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen, shtylla e kësaj do jenë gratë. Gra të edukuara përpos që rrisin investimet dhe përfitimet ekonomike nga taksat, ato edhe rrisin fëmijë me aspirata dhe edukim më të lartë, që do dërgojnë para zhvillimin ekonomik të vendit.

GRATË QË PO UDHËHEQIN LUFTËN KUNDËR NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË KOSOVË



Shkruan: Uran Haxha, Gazetar
Hulumtues

Përballë ndikimeve të ndryshimeve klimatike në Kosovë, disa gra kanë dalë në krye të betejës për një të ardhme më të qëndrueshme dhe për mjedis më të pastër. Me punën e tyre në energjinë e ripërtëritshme, mbrojtjen e natyrës dhe ripyllëzimin e kodrave dhe fushave, këto gra janë duke ndihmuar në ndryshimin e perceptimeve duke treguar se gjithsecili mund të bëjë një ndryshim të madh. Ato janë bërë shembuj frymëzimi duke treguar fuqinë e përkushtimit dhe të inovacionit për të ndaluar degradimin e mjedisit dhe për të edukuar brezat e ardhshëm.

Vera e vitit 2024 do të mbahet mend gjatë për ditët e njëpasnjëshme që temperaturat i mbanin tek 40 e më shumë gradë Celsius. Ngjashëm thuhej edhe për verën e vitit 2023, por mbamendja zgjati vetëm një vit. Kështu vit pas viti, verat po bëhen më të nxehta, më të thata dhe më të rrezikshme për njerëzit. Megjithatë qytetarët, disa edhe me ndihmën e Qeverisë së Kosovës, kanë instaluar kondicionerët në shtëpitë e tyre, një pjesë e ekosistemit sikur flora dhe fauna mbetet në mëshirën e klimës.

Por, qarku se prej kujt vjen energjia elektrike që ne flladism ambientet e brendshme, është një nga shkaktarët kryesorë për këto ndryshime. Pikërisht ndryshimet që edhe dimrat po i bëjnë jo si dikur të ftohtë e me borë, por në rastin më të ngjashëm me dimër, po i bëjnë vetëm të ftohtë dhe pa borë.

Kosova është një nga ekonomitë më të varura nga burimet fosile dhe kalimi në burime të ripërtëritshme të energjisë është i ngadaltë, ngaqë ende sipas të dhënave të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, pjesa dërmuese e energjisë vjen nga qymyri. Kjo situatë e bën të domosdoshme një angazhim të fortë nga të gjithë sektorët e shoqërisë për të përshpejtuar kalimin në burime energjie të pastra dhe për të mbrojtur ekosistemet që janë të kërcënuara nga zhvillimi i paplanifikuar dhe i dëmshëm.

Në këtë kontekst, disa gra kosovare janë duke udhëhequr një revolucion herë të heshtur e herë shumë të vështirë, por të

fuqishëm, në përpjekjet për të zvogëluar ndikimin e ndryshimeve klimatike. Hapat e tyre sa janë inovativë në punë, janë edhe të guximshëm për një të ardhme më të gjelbër dhe më të qëndrueshme. Përmes iniciativave që variojnë nga instalimi i energjisë solare, mbrojtja e mjedisit dhe ripyllëzimi i kodrave dhe fushave, këto gra janë duke ndihmuar në ndryshimin e perceptimeve duke treguar se gjithsecili mund të bëjë një ndryshim të madh.

Njëra prej këtyre grave është Gentiana Alija Shala, një grua që ka vendosur të sfidojë normat e industrisë dhe të udhëheqë një kompani për dizajnimin dhe instalimin e paneleve solare në një sektor që është ende mjaft i dominuar nga burrat. Ajo po e ndihmon Kosovën në zhvillimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme dhe po kontribuon në ndihmën për arritjen e qëllimeve për uljen e ndotjes.

Po ashtu, Egzona Shala-Kadiu, udhëheqëse e organizatës jo-qeveritare “Eco Z”, është angazhuar në mbrojtjen e ekosistemeve dhe parqeve nacionale të Kosovës, duke bërë që investimet kapitale të cilat kanë efekte negative në mjedis të vihen në pikëpyetje.

Në anën tjetër, Indira Kallatozi ka ndërtuar një karrierë të fortë në fushën e ripyllëzimit, duke përdorur teknologji inovative si dronët për të hedhur toptha druri për të rivendosur pyjet që janë dëmtuar gjatë viteve. Ajo udhëheq organizatën “Sustainability Leadership Kosova”, një organizatë që angazhon rininë dhe bizneset për një të ardhme më të pastër dhe më të qëndrueshme.

Fushatat mjedisore të suksesshme po drejtohen nga gratë

Në 25 korrikun e 2023, kur termometri shënonte 45 gradë Celsius, Egzona Shala-Kadiu u gjend në mes të një turme të shqetësuar në Klinë, e rrethuar nga banorë që luftonin për të mbrojtur shtëpitë dhe komunitetin e tyre nga një fabrikë çimentoje, që ata do t'i ndotte çdo ditë edhe me zhurmë dhe me rrezik për burimet e ujit. Mes shumë tjerëve që flisnin me terme shkencore, Egzona Shala Kadiu vendosi që të fliste me gjuhën që ata e kuptojnë, që ata e ndjenjë.

“Pse me marrë dikush prej zyrës për shtëpinë time. Nëse dojnë ata, le te marrin fabrikën edhe ta çojnë të shtëpia e vet dhe ta provojnë nëse edhe për ata është e mirë në atë aspekt. Edhe tekefundit çka ka Gjermania më shumë se Klina”, ju kishte folur ajo një mase të madhe të qytetarëve, që realisht ishin mërgimtarë.

Egzona, e cila sot udhëheq organizatën mjedisore Eco-Z, e përshkruan atë moment si një nga më të rëndësishmit në karrierën e saj si aktiviste. Por kjo nuk ishte hera e parë që ajo kishte luftuar për të mbrojtur natyrën dhe të drejtat e komuniteteve. Rruga e saj drejt aktivizmit filloi shumë më herët, duke u ndërtuar mbi një lidhje të thellë me mjedisin që nisi që nga fëmijëria. Ajo kujton me humor se nëna e saj ishte shtatzënë me të gjatë studimeve në biologji, ndërkaq që bënë shaka se ndoshta ka mësuar për ekologjinë që para se të lindte.

Në vitet e para të Eco-Z, sfidat ishin të pafundme. Ishte një kohë kur fjala “mjedis” ngjallte pak interes, dhe “ndryshimet klimatike” tingëllonin si një term i largët për shumicën. Donatorët nuk e kishin si objektiv në thirrjet e tyre, por temat mjedisore ajo me organizatën e saj i përfshinin në projekte të kulturës e rinisë, apo edhe tek ato të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit, duke tentuar që gjithkund të gjenin një vegjë.

Viti 2016 krahasuar me sot, për Egzonën ka shumë ndryshim në perceptimin e temës së ndryshimeve klimatike. Ajo ishte në krye të shumë fushatave për mbrojtjen e mjedisit, por që godisin bizneset.

“E kjo është më e keqja, sepse ti je kundër një investitori. Kjo në zhvillimin e Kosovës, investitori u pa si pare për njerëzit, dhe natyrën e kanë të fundit në mendje. Mirëpo, kur afektohen njerëzit, ndryshon situata”, rrëfen ajo lidhjen me komunitetin.

Një mësim që e ndihmoi shumë Egzonën ishte rëndësia e qasjes së drejtpërdrejtë dhe sinqeritetit në komunikim. Një trajnim në Japoni nga JICA e mësoi se mënyra më e mirë për të fituar besimin e komunitetit ishte të fliste me zemër, duke dëgjuar me vëmendje shqetësimet e tyre dhe duke ofruar zgjidhje të arritshme. Kjo strategji i ndihmoi Eco-Z të ndërtojë një reputacion të fortë në terren, duke u bërë zëri kryesor kundër ndotjes dhe abuzimeve mjedisore.

Një nga luftërat më të mëdha të Eco-Z ka qenë kundër ndërtimit të hidrocentraleve në zonat e mbrojtura. Vet fakti që ato janë të shpallur parqe kombëtare do të thotë se nuk duhet të ndërtohet asgjë, e le më hidrocentrale. “Sharr National Park, NO DAMS” shkruante në një faqe mali të Brezovicës ku Eco Z i kishin shtrirë shkronjat për të alarmuar se parku nacional po preket nga abuzimi me ujin e rrjedhës aty, por gjatë asaj kohe ata kishin marrë një lajm të madh.

“Avokimi është shumë i paparashikueshëm. Kurrë nuk e din se kur vjen një zhvillim për të cilin ti avokon. Ne duke i shtri shkronjat në Brezovicë, na ka ardh lajmi që është anulë pëlqimi për hidrocentrale”, tregon ajo, teksa qeshet, por që ngulmon se hidrocentralet janë diçka që është më e keqja që i ka ndodhur vendit tonë.

Egzona paralajmëron se dëmet e shkaktuara nga këto projekte janë të parikuperueshme dhe do të ndikojnë për dekada me pasoja si përmbytjet dhe shkatërrimi i ekosistemeve. Aktivizmi i saj ka rezultuar me fitore të rëndësishme, si anulimi i lejeve në disa zona, por ajo e di se lufta nuk ka mbaruar. Së fundi ajo dhe bashkëpunëtorët e saj kanë dorëzuar ankesë në Komunitetin e Energjisë në Vjenë kundër katër hidrocentraleve në Parkun Kombëtar “Sharri”. Kosova është pjesë e këtij Komuniteti që nga viti 2005, ndërsa organizatat kanë kërkuar hetim mbi mënyrën e ndërtimit dhe të funksionimit të këtyre hidrocentraleve.

E gjithë bota njeh Greta Thunberg, vajza suedeze që u bë sinonim i luftës për të ndaluar aktivitetet që ndikojnë në ndryshime klimatike.

Ajo mobilizoi një pjesë të madhe të botës. Duke e kthyer në kontekstin e Kosovës, Egzona thotë se gratë janë shtylla kryesore në këtë luftë, jo vetëm për edukimin e brezave të rinj, por edhe për vendosmërinë që tregojnë në terren.

“Komuniteti e ka njëfarë bindje që mundesh me punu më shumë me gruan. Mundem me thënë nëse një grua është në krye të një fushatë, puna në terren ka me qenë më e suksesshme”, thotë ajo, që sa herë merr rrugën për takim me komunitet vesh çizme e veshje terreni, “sepse ata të duan sikur veten, jo me shku me ju mbajt ligjërata koti”.

Pyllëzimi me dron, një ëndërr e realizuar me shumë punë

Indira Kartallozi, një emër që ndoshta shumë njerëz nuk e njohin ende në Kosovë, është një forcë e pashtershme në përpjekjet për të luftuar ndryshimet klimatike dhe për të rigjeneruar natyrën në vendlindjen e saj. Pavarësisht se ka kaluar më shumë se tri dekada në Angli, ajo ka vendosur të kthehet dhe të kontribuojë në një kauzë që i flet zemrës dhe fëmijërisë së saj: ruajtja e natyrës dhe krijimi i një të ardhmeje të qëndrueshme për Kosovën.

Indira është rritur në Kapeshnicë, një lagje e bukur e Pejës, ku natyra ishte pjesë e pandashme e jetës së saj. Teksa qeshet, tregon se si fëmijë, bashkë me vëllanë e saj, humbiste nëpër mal duke ndjekur dhitë e fqinjëve.

“Prindërit na mësonin gjithmonë të respektonim natyrën, ta lëmë ashtu siç e gjetëm”, thotë ajo. Kjo dashuri e hershme për natyrën, megjithëse atëherë pa njohuritë për ndryshimet klimatike, e ka ndjekur gjatë gjithë jetës.

Puna e saj në fushën e të drejtave të njeriut dhe përkushtimi për refugjatët dhe komunitetet e marginalizuara në Angli e kanë ndihmuar të kuptojë lidhjen e ngushtë mes ndryshimeve klimatike dhe migrimit të njerëzve.

“Ndryshimet klimatike zhvendosin më shumë njerëz sesa luftërat”, thotë ajo, që kur kishte ikur nga Kosova, ishte ndërjerë sikur e dështuar duke lënë mbrapa një vend me luftë.

Mirëpo kthimi në vend gjithmonë ka qenë aty, në një xhep të mendjes së saj. Kështu pas disa aktiviteteve me të rinjtë e Pejës, ajo themeloi organizatën Sustainability Leadership Kosova (SLK) në vitin 2018, duke nisur një rrugëtim të ri për të mbështetur të rinjtë dhe për të adresuar sfidat klimatike në Kosovë. Projekt pas projekti, duke aplikuar një qasje kreative në aktivizëm, kishte nisur bashkë me ekipin e saj të punojnë për të luftuar shpyllëzimin.

“Mes viteve 2000 dhe 2022, Kosova humbi gati 16 mijë hektarë pyje. Me ekipin tim dhe teknologji atraktive, filluam një fushatë krijuese kundër shpyllëzimit. E quajtmë ‘Mos e Merr Malin’ dhe tani është një platformë që ndërgjegjëson dhe aktivizon komunitetet”, thotë ajo, që përmend një moment kur Faruk Foniqit, kolegut të saj i kishte thënë që në fund të projektit do të mbjellin pyjet me dron.

“Aiii Indire larg është ajo prej neve”, i kishte thënë Faruku, që sot bashkë me Indirën, po bëjnë gati 50,000 toptha me rreth 800,000 fara të bimëve të ndryshme që po i hedhin me dron nëpër hapësira të shpyllëzuara. Katër vjet punë e pandalshme në këtë projekt sot i jep një ndenjë të papërshkrueshme Indirës, pasi pritja ka qenë e vështirë.

E hasur në sfida, sidomos me skepticizmin fillestar të disa njerëzve në Kosovë. “Kam kuptuar se nuk mund të vij me një mendësi perëndimore, por si kosovare që ndan të njëjtat probleme me ta”, thotë ajo. Megjithatë, mbështetja që ka marrë nga të rinjtë e ka mbushur me optimizëm.

“Ata thjesht janë pjesë e zgjidhjes dhe jep shpresë për të ardhmen, reagimet janë shumë të mira. Unë personalisht çdo ditë kam qenë e emocionuar. Kemi pasë thirrje dhe vullnetarë prej gjithkaj, jo vetëm rini, por edhe sektori privat që i sillte punëtorët me punu me neve”, thotë ajo, që rrugën Londër-Prishtinë e ka bërë të shpeshtë tashmë. Më të shpeshtë po e bën edhe përshtypja se ka nisur ndryshimi në mendësi për t’ju bashkuar luftës për të ndaluar hovin e shpyllëzimit, e që kontribuon direkt në lirim të madh të karbonit, pasi me mungesën e pyjeve, karbonin s’ka kush e thithë.

E vetmja grua që udhëheq kompani të energjisë së ripërtëritshme

Karboni më së shumti në vendin tonë lirohet nga termocentralet Kosova A dhe Kosova B. Këto termocentralet mund të zëvendësohen me prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme.

Në Kosovë tashmë ka një numër të madh të kompanive që dizajnojnë dhe implementojnë projekte të tilla, por që është një industri e dominuar nga burrat. Megjithatë, është një dhe e vetme, Gentiana Alija Shala qëndron si një shembull frymëzues në Kosovë me kompaninë e saj “Alfa Solar Energy”. Ajo ka ndërtuar një karrierë që është më shumë sesa një arritje personale, është shndërruar në një person që pothuajse të gjitha inxhinierët e reja e pyesin për të kryer praktikën të kompania e saj.

Gentiana nuk ëndërronte të bëhej inxhinierë. Synimi i saj ishte mjekësia, por një kthesë e papritur e çoi drejt një udhe tjetër.

“Nuk u pranova në fakultetin e mjekësisë dhe pa shumë mendim, e pashë Fakultetin Teknik duke u kthyer rrugës, shkova e pashë ku ka më shumë vende të lira për studentë dhe aplikova në degën e elektroenergjetikës industriale. Ishte një zgjedhje e rastësishme, por u bë fillimi i një udhëtimi që nuk e kisha imagjinuar”, thotë ajo. Pavarësisht nga sfidat fillestare dhe mospërgatitja në matematikë dhe fizikë, ajo nuk u dorëzua.

“Babai më tha se nuk di matematikë dhe fizikë, por iu përgjigja se do t’i mësoj. Ai më angazhoi kurs privat dhe arrita të pranohem”, tregon ajo.

Përkushtimi i saj për energjinë e ripërtëritshme lindi në mënyrë po aq spontane sa dhe zgjedhja e studimeve. Një bisedë rastësore me një koleg e frymëzoi të hulumtojë fuqinë e energjisë solare.

“Në Kosovë ka një potencial të jashtëzakonshëm për energjinë e ripërtëritshme. Nuk kemi ku të shkojmë tjetër, është e ardhmja, shihe ajrin si e kemi tash dimrit”, thotë Alija-Shala.

Pas diplomimit, ajo nisi praktikën në një kompani vendore. Më pas ambiciet në rritje e shtynë atë që të themelonte kompaninë e saj së bashku me një punëdhënëse të mëparshme në industri tjetër.

“Unë pata punuar në industri të IT-së. E thirra ish-shëfimin edhe i thash, ti i ke paret, unë di çka me ba, hajde t’ia nisim”, kështu nisi gjithçka në vitin 2020.

“Gjithmonë kam dashur të jem pjesë e një ndryshimi më të madh. Kur përballesh me ndryshimet klimatike, nuk ke luksin të presësh”, thotë ajo.

Përmes projekteve të saj, Gentiana ndihmon në zvogëlimin e ndotjes dhe promovimin e burimeve të qëndrueshme të energjisë. Kështu u rrit kompania fillimisht të projektet e vogla në sektorin e bujqësisë. Kështu hap pas hapi, Gentiana me një karakter shpërthyes dhe asnjëherë e mjaftueshme për atë që ka arritur, arriti tregun ndërkombëtar.

“Kam hy në LinkedIn edhe ju kam shkruar gjithë CEO-ve (udhëheqësve) të kompanive në Gjermani. Tri përgjigje i kam marrë dhe me të tri ato kompani vazhdoj të punoj në gjithë Evropën”, thotë ajo, teksa qeshet dhe thotë se të qenit grua nuk e ka ndaluar në asnjë hap. Ajo madje thotë se komuniteti i industrisë së kompanive të energjisë që punojnë në energjinë e ripërtëritshme, e kishin pritur shumë mirë.

“Në Kosovë, përkrahja ka qenë e jashtëzakonshme. Kam pasur kolegë që gjithmonë më kanë ndihmuar kur kam pasur nevojë,” thotë ajo, që e gjen veten shpesh duke shërbyer si një zë frymëzues për gratë e tjera që dëshirojnë të ndjekin këtë rrugë. Profesionalizmi i saj kalon kufijtë, ngaqë Gentiana në vitin 2024 është zgjedhur në 100 gratë më të suksesshme në botë në fushën e energjisë së ripërtëritshme.

Në përballje me krizën klimatike, edhe Gentiana ka përshtypjen se vendosmëria dhe vizioni i gruas din të lulëzojë sukses të sigurtë.

“Unë besoj se gratë kanë potencial të jashtëzakonshëm për të udhëhequr ndryshime pozitive në çdo sektor. Kam dëshirë të shoh më shumë gra në këtë industri, sepse energjia e ripërtëritshme nuk është vetëm teknologji, është e ardhmja jonë,” përfundon ajo.

Megjithatë punët në Kosovë i ka me kapacitet jo shumë të madh, krahësuar me ato jashtë vendit, ajo dëshirën nuk e fsheh që Kosova duhet të hapë dyert edhe më shumë për projekte të mëdha, si zgjidhje për të hequr dorë nga karboni.

PËRKRAHUR NGA:



**Funded by
the European Union**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO



Përmbajtja e kësaj shtojce është përgjegjësi e autores/it/eve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e donatorëve.

Iniciativa Kosovare për Stabilitet

www.iksweb.org

info@iksweb.org



Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Gender Studies Center



Forumi Ekonomik i Grave
Ekonomski Forum Žena
Women's Economic Forum